

35853

DRAFT
12/18/00 5:05PM

KONFLIKTI DHE NDRYSHIMET NË KOSOVË:

PASOJAT NË INSTITUCIONET DHE SHOQËRINË

Nga

Gloria La Cava, Raffaella Nanetti, Stephanie Schwandner-Sievers, Arjan Gjonca, Taies
Nezam dhe Barbara Balaj

me

Astrit Salihu, Francesco del Re dhe Deborah Davis

BANKA BOTËRORE

Zhvillimi i mjedisit dhe i një shoqërie të qëndrueshme (ECSSD)

Evropa lindore dhe regjioni i Azisë qendrore

Dhjetor 2000

PARATHËNIA-----	I
AKRONIMET -----	III
PËRMBLEDHJE DREJTUESE -----	IV
I. HYRJE-----	1
HISTORIKU-----	1
KORNIZA KONCEPTUALE: NEVOJA PËR NDËRTIMIN E INSTITUCIONEVE	
SHOQËRORE INKLUZIVE NË KOSOVË-----	2
METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA-----	4
II. ANALIZA MAKRO SOCIALE, 1991 DERI 2000-----	6
NDRYSHIMET DEMOGRAFIKE-----	6
Projekcionet mbi popullatën-----	6
Trendet demografike -----	8
Struktura etnike e popullatës-----	9
Struktura e popullatës aktive-----	10
Përbërja rurale dhe urbane-----	11
Zhvendosjet dhe dëmet nga konflikti-----	12
Pasojat nga emigrimi dhe konflikti i gjinive-----	14
NDRYSHIMET SHOQËRORE DHE EKONOMIKE-----	15
Shëndetësia-----	16
Arsimi-----	17
Punësimi -----	17
Të ardhurat-----	18
Mjete jetese-----	19
III. VLERËSIMI I INSTITUCIONEVE SHOQËRORE	
INSTITUCIONET ZYRTARE	
<i>UNMIK-u dhe Strukturat e përbashkëta të përkohshme administartive</i>	
<i>Strukturat e përbashkëta të përkohshme administrative: rezultatet e vlerësimit</i>	
Prishtinë	
Gjilan	
Prizren	
Malishevë	
Pejë	
Studimi i rasteve të kapitalit shoqëror në dy vende	
INSTITUCIONET JOZYRTARE	
<i>Shoqëria civile; rezultatet komparative të institucioneve jozyrtare</i>	
Llojet e grupeve të shoqërisë civile	
Mbështetja ndërkombëtare për grupet që promovojnë përfshirjen dhe kapitalin shoqëror të huazuar	
<i>Familja tradicionale kosovare: analizë e kapitalit shoqëror detyruës</i>	
Familja tipike kosovare	
Tradita dhe gjinitë: rrezikimi i gruas	
Përfaqësimi politik i fshatit	

Familja dhe kombi
Traditat në zgjidhjen e konflikteve brenda dhe ndërmjet komuniteteve
Strategjitë për mbijetesë: fitimi i të ardhurave familjare
Besimi
Pjesëmarrje

IV. VLERËSIMI SHOQËROR

PERCEPTIMET E ZHVENDOSJEVE, SHKATËRRIMIT TË SHTËPIVE DHE RINDËRTIMIT
Shkatërrimi i shtëpive dhe zvendosjet

Rindërtimi

PERCEPTIMET E SIGURISË, BASHKËJETESËS NDËR-ETNIKE DHE DREJTËSISË

Kërcënimet ndaj sigurisë

Minat tokësore

Kriminaliteti

Besimi për mbështetje

Bashkëjetesa ndëretnike

Thirrja në drejtësi

Përgjegjësia për vrasjet në Kosovën e pas luftës

PERCEPTIMET NË ARSIM

Ndryshimet dhe kontinuiteti

Problemet aktuale

Kostoja e shkollimit

Kufizimet në qasje

Angazhimi i arsimtarëve

Kualiteti i mësimdhënies dhe pajisjet

Probleme të tjera

PERCEPTIMET E GRUPVE TË CENUESHME DHE SHKAKU I CENUESHMËRISË

Pikëpamjet e grave mbi kufizimet e solidaritetit familjar

Cenueshmëria e gruas

Cenueshmëria e personave të zvendosur brenda territorit

Cenueshmëria e të kthyerëve

SITUATA E PAKICAVE

Serbët

Romët

Sllavët musliman

Goranët

Turqit

OPINIONET E POPULLATËS VENDËSE PËR ZHVILLIMIN E TYRE

Perceptimet e popullatës për nevojat e tyre imediate

Idetë sipërmarrëse dhe nevojat kreditore

Perspektivat për të ardhmen dhe promovuesit e ndryshimeve

V. VLERËSIMI I DIASPORËS

HISTORIA DHE DEMOGRAFIA

Situata e punësimit

Struktura e popullsisë

POLITIKAT E SHTETEVE NIKOQIRE DHE PROGRAMET PËR NDIHMA

ORGANIZATAT DHE RELACIONET E KOMUNITETIT NË SHTETIN NIKOQIR

KRIMINALITETI I TË RINJËVE NË SHTETET NIKOQIRE

ROLI I PARAVE TË DËRGUARA (NGA JASHTË) PËR MBAJTJEN E FAMILJEVE NË KOSOVË

PRESIONET E QEVERISË NIKOQIRE DHE NXITJA PËR KTHIM

Presionet për kthim

Nxitjet për kthim

FAKTORËT INFLUENCUES PËR KTHIM

Faktorët në favor tëkthimit në Kosovë
Faktorët në favor të mbetjes në shtetin nikoqir
NDIKIMET E PRITURA NGA RIATDHESIMI

VI. PËRFUNDIMET

SHTOJCA I
SHTOJCA II
SHTOJCA III
SHTOJCA IV
SHTOJCA V

BIBLIOGRAFIA

FIGURAT

Figura 1. Struktura moshore e popullatës së Kosovës, 1991 dhe 2000
Figura 2. Ndryshimet në strukturën moshore të popullatës aktive
Figura 3. Popullata fshatare sipas nënregjioneve në vitin 1991 dhe 2000 (në përqindje)
Figura 4. Vlerësimi i dëmtimeve të ndërtesave

TABELAT

Tabela 1. Projeksionet e popullatës të moshës mesatare sipas moshës dhe gjinisë
Tabela 2. Indikatorët demografik për Kosovë në vitin 1990
Tabela 3. Vlerësimet e etniteteve minoritare në Kosovë në vitin 2000
Tabela 4. Proporcionet e varshmërisë së popullatës në vitin 1991, 1996 dhe 2000
Tabela 5. Shkalla e arsimit për popullatën 10 e më tepër vjeçare, 1991-1999
Tabela 6. Përqindja e popullsisë sipas aktivitetit, 1999
Tabela 7. Të ardhurat familjare mesatare (në DM dhe përqindje)
Tabela 8. Kërcënimet ndaj sigurisë
Tabela 9. Pikëpamjet për ardhmërinë e bashkëjetesës ndër-etnike
Tabela 10. Grupet e cenusshme
Tabela 11. Perspektivat për të ardhmen
Tabela 12. Promovuesit e ndryshimeve
Tabela 13. Qytetarët e RFJ-së: Kohëzgjatja e qëndrimit në Gjermani, 1997
Tabela 14. Vendbanimi/statusi legal i shqiptarëve të Kosovës të kthyer nga Zvicra, 2000

NDARJET

Ndarja 1. Kapitali shoqëror detyruar dhe shoqëria civile në Pejë
Ndarja 2. Kapitali shoqëror i huazuar dhe sistemi i bashkëudhëheqjes në Prizren
Ndarja 3. Përfaqësimi politik i fshatit
Ndarja 4. Këshillat për pajtimin e gjaqeve
Ndarja 5. Proverbat kulturore shqiptare për paratë
Ndarja 6. Vlerat kulturore shqiptare lidhur me punën
Ndarja 7. Simboli kulturor i shtëpisë tek shqiptarët
Ndarja 8. Drejtësia dhe bashkëjetesa fshatare ndër-etnike
Ndarja 9. Emërimet reciproke serbe dhe shqiptare
Ndarja 10. Opinionet për të ardhmen multi-etnike
Ndarja 11. Opinionet mbi përgjegjësinë për dhunë

Ndarja 12. Shpenzimet e udhëtimit për shkollim

Ndarja 13. Kufizimet dhe aspiratat e grave të reja fshatare

Parathënie

Kosova është përshkruar si një krahinë ku ka dominuar urrejtja. Megjithatë, kur e shikojmë zhvillimin e institucioneve shoqërore gjatë kohës mund të zbulojmë tradita të bashkëjetesës dhe bashkëpunimit ndëretnik dhe brenda komunitetit. Ky studim ndjek potencialin që e mbështet këto tradita përmes themelimit të institucioneve shoqërore gjithpërfshirëse të cilat nxisin besimin, bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në mesin e shqiptarëve kosovar dhe në mes të shqiptarëve dhe grupeve të tjera etnike. Gjithashtu, në studim propozohet një strategji afatmesme për zhvillimin e regjionit duke u bazuar në forcimin e kapitalit shoqëror dhe mbështetjen e aktiviteteve të grupeve në shoqërinë civile. Studimi nuk përqëndrohet në çështje emergjente siç janë strehimi, sigurimi i ushqimit dhe llojet tjera të ndihmave humanitare, shumica e të cilave janë analizuar dhe raportuar gjetiu nga shumica e agjencive të cituara në fusnota dhe në bibliografi. Gjithashtu, studimi nuk shqyrton në mënyrë ekskluzive çështjet ekonomike të cenueshmërisë dhe varfërisë të cilat do të shqyrtohen nga një vlerësim i ardhshëm i Bankës Botërore mbi varfërinë.

Lexuesi duhet patur parasysh se ky studim është mbështetur në të dhëna të mbledhura nga agjenci të ndryshme në rrethana të vështira. Megjithatë, në disa raste shifrat për pesronat e zhvendosur përbrenda vendit (IDP), refugjatët, pakicat dhe të kthyerit mund të ndryshojnë deri një shkallë. Është bërë përpjekje për të siguruar saktësinë e numrave dhe për të cituar burime të ndryshme kur nuk përputhen numrat. Gjithashtu, edhe shuma për parat e dërguara (nga jashtë) mund të ndryshojnë. Megjithatë, ato janë dhënë në dollar, marka gjermane ose franga zvicerane varësisht se si janë mbledhur të dhënat. Për arsye të luhatjeve në kursin e këmbimit ishte më e arsyeshme që këto numra të jepen ashtu siç janë dhënë atëherë se sa të konvertohen në një monedhë.

Studimi është përgatitur nga ekip i udhëhequr nga **Gloria La Cava**, shkencëtare me përvojë e shkencave shoqërore për Evropën juglindore pranë Bankës Botërore. **Raffaella Nanetti**, profesoreshë e planifikimit urban në Universitetin e Illinoisit në Çikago e cila ishte përgjegjëse për përgatitjen e metodologjisë së vlerësimit, sektori për institucionet zyrtare dhe studimet e rastit për besimin dhe kapitalin shoqëror. Ajo gjithashtu ka dhënë kontribut në kapitullin përmbyllës. **Stephanie Schwandner-Sievers**, anëtare e shkollës për studime sllave në Universitetin e Londrës dhe antropologe që është duke specializuar për çështjet shqiptare, ka qenë përgjegjëse për analizat dhe kërkimet në terren. **Arjan Gjonca**, demograf në Fakultetin e ekonomisë në Londër ka bërë analizat makro-sociale. **Taies Nezam**, specialiste për zhvillimet shoqërore pranë Bankës Botërore, kontribuoi në projektimin e studimi, kërkimet në terren dhe në sektorin për çështje të pakicave. Ajo gjithashtu ishte përgjegjëse për inkorporimin e vërejtjeve dhe revidimin e teksteve të ndryshme. **Barbara Balaj**, shkencëtare politike dhe këshilltare në Bankën Botërore, ka udhëhequr kërkimet dhe analizat e kosovarëve nga diaspora. **Astrit Salihu**, sociolog në Universitetin e Prishtinës dhe hulumtues i pavarur kontribuoi në kërkimet në terren mbi institucionet jozyrtare dhe në vlerësimin shoqëror. **Francesko del Re**, agronom në FAO/WFP njësia mbikëqyrëse për sigurimin e ushqimit në Kosovë, kontribuoi në analizat makro-sociale dhe siguroi udhëzimin e përgjithshëm për ekipin vlerësues. **Deborah Davis**, shkrimtar dhe botues, përgatiti verzionin e fundit të studimit. **Natasha Bolger**, antropologe në Kolegjin e Universitetit në Londër i asistoi Zonjushës Schwandner-Sievers në kërkimet në terren mbi institucionet jozyrtare dhe për vlerësimin shoqëror. Në fund, **Rathna Chiniah**, **Daphne Sawyerr-Dunn** dhe **Beulah Noble** ofruan ndihmë në përpunimin dhe formatizimin e drafteve të ndryshme të raportit. Ekipi u është mirënjohës për komentet gjithpërfshirëse të pranuar për draftet e mëparshme nga **Muhamet Mustafa**, RIINVEST, **Flaka Surroi**, Fondi për zhvillimin e komunitetit, **Mark Baskin**, Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK); **Stephan Muller**, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE); dhe **Amina Tirana**, Refugjatët ndërkombëtarë. Jemi gjithashtu mirënjohës për komentet e pranuar nga një numër i kolegëve nga Banka Botërore, përfshirë edhe **Andras Horvai**, **Xavier Devictor**, **Madalene O Donnell**, **Giuseppe Zampaglione**, **Nat Colleta** dhe **Alexandre Mac**.

AKRONIMET

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
BHRC	Dhoma e Avokatëve të Anglisë dhe Vellsit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut
DFID	Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar
DM	Marka Gjermane
EU	Unioni Evropian
EWD	Autorizimi i Vejshave në Zhvillim
FAO	Organizata për Ushqim dhe Bujqësi
FRY	Republika Federale e Jugosllavisë
FYROM	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
GDP	Prodhim i Përgjithshëm Bruto
GNP	Prodhim i Përgjithshëm Kombëtar
ICG	Grupi Ndërkombëtar i Krizës
IDP	Personat e Zhvendosur Brenda (vendit)
IMG	Grupi Ndërkombëtar Menaxhues
IAC	Këshilli i Përkopshëm Administrativ
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
IRC	Komiteti Ndërkombëtar për Shpëtim
JIAS	Strukturat e Përbashkëta të Përkohshme Administrative
KFOR	Forcat e Kosovës (NATO)
KLA	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
KPC	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
KTC	Këshilli Tranzitor i Kosovës
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
MA	Administratori Komunal
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
NGO	Organizatata Joqeveritare
NIMA	Agjencia Kombëtare për Ikona dhe Hartografi
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
RIINVEST	Instituti për Kërkime Zhvillimore
SFRY	Republika Socialiste Federale e Jugosllavisë
SNC	Këshilli Nacional Serb
UN	Kombet e Bashkuara
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Veprimtari për Popullsinë
UNHCR	Komesariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
UNIFEM	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Gruas
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
WFP	Programi Botëror i Ushqimit
WHO	Organizata Botërore e Shëndetësisë

PËRMBLEDHJE ZBATUESE

I. HYRJE

Në këtë vlerësim sqarohet se si konflikti dhe zhvendosjet në Kosovë kanë ndikuar në marrëdhëniet shoqërore dhe institucionet gjatë dekadës së fundit. Këtu përfshihen një sërë çështjesh të zgjëruara dhe komplekse të cilat, shikuar në tërësi, krijojnë një vështrim të shoqërisë kosovare gjatë adaptimit të saj në ndryshimet ekonomike dhe politike të shkaktuara nga: (a) shpërbërja e Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë (SFRY); (b) periudha e zbatimit kur popullata shumicë shqiptare u përjashtua nga jeta publike; (c) dhuna e motivuar etnike dhe zhvendosjet: dhe së voni, (d) kthimi i refugjatëve shqiptarë dhe themelimi i administratës ndërkombëtare. Gjatë periudhës më të vonshme, dhuna e brenda dhe ndërmjet entiteteve ka vazhduar me pjesën e mbetur të serbëve të Kosovës dhe pakicave tjera që pësojnë nga përjashtimi prej jetës shoqërore në shkallë të ndryshme.

Me angazhimin e shpejtë të Bankës Botërore dhe aktivistëve të tjerë ndërkombëtarë në krahinë, një vlerësim shoqëror gjithëpërfshirës i këtij lloji ishte i pamundur para hartimit të projekteve dhe programeve emergjente. Megjithatë, shpresojmë se programet për zhvillim dhe rindërtim dhe përcaktimet politike në të ardhmen do të përfitojnë nga ky studim i cili është njëri nga një sërë studimesh të institucioneve në nivel lokal që janë duke u realizuar nga Banka Botërore me qëllim të mbikëqyrjes së implementimit të strategjive regjionale për Evropën Juglindore.

Korniza konceptuale: Nevoja për ndërtimin e institucioneve shoqërore inkluzive në Kosovë

Ky studim është bërë në periudhën kur ka pasur ndihme intenzive ndërkombëtare dhe kur behej zhvillimi i strategjive për rikonstruim dhe zhvillim. Premisa e këtij studimi qëndron në faktin se, përpjekjet për arritjen e një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm dhe stabil në Kosovë, varen nga krijimi i institucioneve inkluzive që promovojnë kohezionin përbrenda komunitetit dhe pajtimin ndëretnik. Konceptet e ndërlidhura të kohezionit shoqëror, kapitalit shoqëror dhe pajtimit janë çështje qëndrore në këtë analizë. Raporti vlerëson prezencën e dy llojeve të kapitalit shoqëror në Kosovë - atij kufizues dhe huazues, implikimet e secilit prej tyre në kohezionin shoqëror dhe trajtimin e konfliktit brenda dhe në mes të grupeve të ndryshme etnike në Kosovë. Nëse kapitali shoqëror *kufizues* përjashtohet, lidhjet brenda vet grupeve etnike përforcohen duke promovuar mosbesim ndaj grupit tjetër, dhe si pasojë kemi ndarjen dhe varfërimin e jetës shoqërore, kurse kapitali shoqëror *huazues* synon t'i përforcojë marrëdhëniet në mes të grupeve të ndryshme, dhe kështu të promovojë përfshirjen, pajtimin dhe kohezionin. Ky vlerësim përqendrohet në potencialin e Kosovës për zhvillimin e kapitalit shoqëror kontraktues si një parakusht për paraqitjen e kapitalit shoqëror *ndërlidhës* i cili nënkuptohet për institucionet shtetërore që janë inkluzive dhe të autorizuara që të nxisin pjesëmarrjen dhe transparencën në proceset vendimmarrëse, dhe kështu të mundësojnë angazhimin kooperativ e të gjitha grupeve në krijimin e një shoqërie paqesore. Megjithatë, zhvillimi i lidhjes së kapitalit shoqëror në Kosovë nuk është vlerësuar në mënyrë të veçantë në këtë raport për shkak të natyrës evolutive të institucioneve shtetërore.

Gjithashtu, është me rëndësi të kihet parasysh se studimi nuk përqendrohet në çështje emergjente siç janë strehimi, sigurimi i ushqimit, dhe llojet tjera të ndihmës humanitare, shumica e të cilave janë dhënë dhe analizuar detajisht gjetiu, përfshirë edhe agjencitë e shumta të cituara në këtë raport. Studimi, gjithashtu

nuk trajton ekskluzivisht çështje të varfërisë dhe cenueshmërisë ekonomike, të cilat do të analizohen në një vlerësim të ardhshëm të Bankës Botërore mbi varfërinë.

Metodologjia dhe shtrirja e punës

Analiza niset nga niveli makro dhe përfundon me nivelin mikro - nga institucionet zyrtare në ato jozyrtare nga familjet dhe individët - për të vrojtuar perspektivat e ndryshme të procesit mbi ndryshimet shoqërore dhe institucionale në Kosovë. Analiza është ndarë në katër ndarje kryesore, ku secila analizon një grup të caktuar të çështjeve.

- ❖ ***Analiza makro sociale*** përqëndrohet në ndryshimet e gjëra hapsinore dhe kohore në Kosovë gjatë viteve të 90-ta si pasojë e dëmeve të luftës, zhvendosjeve dhe prezencës ndërkombëtare. Së pari trajton karakteristikat demografike të këtij ndryshimi përfshirë moshën, gjininë dhe prejardhjen etnike. Pastaj analizon dimenzionet socio-ekonomike siç janë shëndetësia, arsimi, punësimi dhe të ardhurat.
- ❖ ***Vlerësimi i institucioneve shoqërore*** përfshin institucionet zyrtare dhe jozyrtare. Pjesa mbi ***institucionet zyrtare*** përqëndrohet në përvojën e bashkëudhëheqjes në nivel komunal dhe në perspektivat për ngritjen e institucioneve komunale. Përmban, gjithashtu, një shqyrtim të institucioneve zyrtare në kontekst të të cilave mund të kuptohen institucionet shoqërore jozyrtare. Pjesa e ***institucioneve jozyrtare*** përqëndrohet në institucionet jozyrtare në nivel grupor siç janë rrjeti familjar, këshillat e fshatit, familja dhe grupet e shoqërisë civile; si dhe bën ekzaminimin e ndryshimeve të këtyre institucioneve me kalimin e kohës.
- ❖ ***Vlerësimi shoqëror*** trajton nevojat dhe cenueshmërinë e popullatës duke përfshirë edhe (a) strategjitë e familjeve për sigurimin e ushqimit, strehimit dhe arsimit; (b) perceptimet e njerëzve për sigurinë për shkak të krimit dhe prezencën e mëtejme të dhunës ndëretnike; (c) gjendja e grave dhe vajzave, pakicave dhe grupeve të tjera të cenueshme; dhe (d) mundësinë për bashkëjetesë ndëretnike dhe pajtim. Kjo pjesë, gjithashtu, vlerëson pikëpamjet e popullatës mbi efikasitetin e institucioneve dhe kapacitetin e tyre për promovimin e modernizimit dhe demokratizimit.
- ❖ ***Vlerësimi i diasporës*** përqëndrohet në historinë dhe demografinë e emigrimit, modelet e dërgimit të parave nga jashtë, stimulimi dhe presioni për t'u kthyer, dhe rolin që diaspora mund t'a luajë në rindërtimin e Kosovës.

Makro-analizat janë të bazuara në të dhëna të ndryshme nga krahina prej 1990 deri në 2000. Për periudhën para konfliktit (1990-1999), të dhënat janë marrë nga vjetari zyrtar statistikor i RSFJ-së dhe publikimet mbi regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë. Regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë i vitit 1991 është përdorur për projektimin e saj, kurse aspektet demografike u mbështetën në burime të tjera zyrtare. Për periudhën pas luftës (1999-2000) janë marrë kryesisht burime nga vlerësimet e mëvonshme të realizuara nga organizatat qeveritare, joqeveritare dhe ndërkombëtare.

Vlerësimet institucionale dhe shoqërore janë në masë të madhe të bazuara në punën në terren, të realizuar në mars dhe prill të vitit 2000 në pesë regjione reprezentuese – Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjiilan dhe Malishevë. Për shkaqe sigurie dhe për shkak të pengesave të tjera, shumica e kësaj pune në terren u përqëndrua tek shqiptarët e Kosovës të cilët përbëjnë mbi 90 % të popullatës së tanishme. Janë zhvilluar diskutime të veçanta grupore në çdo vend me meshkuj të rritur, femra të rritura, meshkuj të rinj (ndërmjet 15 dhe 25 vjet), dhe femra të reja (ndërmjet 15 dhe 25 vjeçare). Përveç kësaj, janë zhvilluar një sërë intervistash të papërcaktuara me përfaqësuesit e institucioneve zyrtare dhe jozyrtare. Gjithashtu, janë zhvilluar intervista të papërcaktuara dhe diskutime grupore me grupe të cenueshme (me vejanet e luftës, popullatën e zhvendosur brenda vendit dhe të kthyerit) dhe pakicat (serbët, romët, turqit dhe sllavët musliman) në vende me numër të madh të tyre. Vlerësimet institucionale dhe shoqërore gjithashtu përfituan nga puna e një numri të organizatave ndërkombëtare dhe lokale.

Vlerësimi i diasporës është i bazuar në punën në terren, të realizuar në Gjermani dhe Zvicër përfshirë edhe intervistat me zyrtarët e shteteve nikoqire dhe përfaqësuesit e agjencive ndërkombëtare të cilat punojnë dhe zhvillojnë diskutime grupore me të mërguarit.

Rezultatet e studimit janë përmbledhur më poshtë.

II. ANALIZA MAKRO-SOCIALE

Ky kapitull përqëndrohet në karakteristikat demografike të ndryshimeve në Kosovë gjatë vitit 1990 si dhe në aspektet shoqërore dhe ekonomike.

Ndryshimet demografike

Trendet demografike. Përkundër emigrimit masiv të meshkujve në moshën reproduktive dhe rënien e fertilitetit (2.5 fëmijë për grua), popullata e Kosovës është shumë e re. Kështu 46 % e popullatës në vitin 2000 janë nën moshën 25 vjeç. Aktualisht, moshë mesatare është 22.2 vjeç. Gjithashtu, ekziston një shmangie e dukshme e strukturës moshore për vitin 2000, për shkak të emigrimit dramatik (posaçërisht të meshkujve) të moshës 20-40 vjeç. Kosova ka përjetuar edhe ndryshime tjera dramatike demografike si pasojë e konfliktit, duke përfshirë edhe rënien e shkallës reale të natalitetit dhe rritjen e shkallës së mortalitetit dhe, për çudi, një rënie të vdekshmërisë së foshnjeve, edhe pse kushtet shëndetësore në krahinë janë keqësuar gjatë dekadës së fundit.

Strukturat etnike. Me përfundimin e konfliktit kah mesi i vitit 1999, struktura etnike e popullatës ndryshoi në mënyrë drastike. Prej 350,000 nga popullata joshqiptare në Kosovë në vitin 1991, rreth 200,000 ishin ende në krahinë në fillim të vitit 2000: - prej tyre, 100,000 serbë, 47,000 sllavë musliman, 30,000 romë dhe 20,000 turq. Gjatë periudhës pas konfliktit përkatësia etnike mbetet faktor kyç për rënien e viktimave për shkak të sulmeve të parreshtura dhe dhunës. Si rezultat i kësaj, pjesa e mbetur e grupeve të pakicave vazhdojnë të braktisin Kosovën ose të rivendosen nga qytetet dhe fshatërat e përziera në regjione etnike homogjene. Kjo, posaçërisht është e theksuar për serbët dhe romët e Kosovës.

Struktura e popullatës aktive. Shkalla e popullatës aktive (ndërmjet 15 dhe 60 vjeç) ka mbetur relativisht stabile përafërsisht deri në 55 % në mes të 1991 dhe 2000. Proporcioni i varshmërisë ishte i lartë, rreth 72 % gjatë tërë periudhës për shkak të proporcionit të lartë të popullatës nën moshën 15 vjeçare. Këta njerëz të rinjë do t'i bashkohen popullatës aktive në vitet e ardhshme duke siguruar që Kosova mos të ballafaqohet me krizë moshore ngjashëm me atë në shtetet e Evropës Juglindore.

Përbërja ruralo-urbane. Popullata rurale e krahinës ka rënë pak gjatë dekadës së fundit, prej 62.7% nga numri i përgjithshëm në vitin 1991 në 58.6% në vitin 2000. Megjithatë, në nivel komunal, përbërja ruralo-urbane e grupeve etnike ka ndryshuar në mënyrë drastike me zvogëlimin e popullatës serbe në qytete dhe rritjen e tyre në vendet rurale, ndërsa popullata shqiptare tregon trend të kundërt. Nëse Kosova e ndjek përvojën e shteteve tjera ballkanike do t'i nënshtrohet një ndryshimi të shpejtë kah urbanizimi në vitet e ardhshme si rezultat i reformave ekonomike. Përfituesit më të rëndësishëm do të jenë qytetet e mëdha ku do të përqëndrohen shumica e aktiviteteve ekonomike, shoqërore dhe civile, siç janë Prishtina, Prizreni dhe Gjakova.

Zhvendosjet dhe dëmet e lidhura me konfliktin. Regjionet me numër më të madh të personave të zhvendosur (IDP edhe ata të cilët migruan në shtetet fqinje), gjithashtu pësuan dëme të mëdha të shtëpive, shkollave, qendrave shëndetësore dhe ekonomisë fermere. Më shumë se 25 % e të gjithë shtëpive në krahinë ishin të dëmtuara rëndë ose të shkatërruara në tërësi. Shumica e fshatërave i humbën shkollat e vetme dhe klinikat shëndetësore, gjë që shkaktoi ngurrim tek shumë fshatarë që të kthehen në fshatërat e tyre. Pasuria e fermave u shkatërrua në masë të madhe, ku me zëvendësimin e vlerës së kafshëve, ndërtesave të fermave dhe makineria bujqësore që vlerësohen në 700 deri në 800 milion US \$. Gjithashtu, janë shkaktuar dëme të konsiderueshme dhe plaçkitje e pajisjeve agro-përpunuese, posaçërisht në fermat private të vogla dhe të mesme. Përveç kësaj, kërkesat e mëdha për dru (për lëndë djegëse dhe për ndërtim) pas konfliktit kanë shkaktuar rritje të trusnisë mbi pyje; ndërsa minat tokësore kufizojnë qasjen në tokën bujqësore dhe pyje.

Pasojat e migrimit dhe mospërputhjet në gjini.

Si rezultat i numrit të madh të meshkujve që migruan ose u vranë gjatë luftës, më se 15 % e familjeve në Kosovë tani udhëhiqen nga gratë. Këto familje mund të jenë në mesin e atyre që janë më të cenueshme në pikëpamje të nevojave ekonomike dhe sociale, përfshirë punësimin, ushqimin, arsimimin dhe kujdesin shëndetësor.

Ndryshimet shoqërore dhe ekonomike.

Shëndetësia. Popullata ka jetëzgjatje mesatare relativisht të lartë. Shumica e vdekjeve në mesin e popullatës shqiptare shkaktohen nga sëmundjet jo-ngjitëse për shkak të pirjes së duhanit dhe regjimit në ushqim duke ndikuar në një strukturë epidemiologjike që është më tepër në përputhje me një vend të industrializuar se sa të zhvilluar. Kujdesi para dhe pas lindjes momentalisht është joadekuat.

Arsimi. Në vitin 1991, 28 % e popullatës kosovare të moshës 10 vjeçare ose më të vjetër nuk shkolloheshin krahasuar me 13% për pjesën tjetër të RSFJ-së. %ja e popullatës kosovare me shkollim fillor, të mesëm dhe të lartë është rritur dukshëm gjatë vitit 1990, përkundër konfliktit dhe sistemit arsimor paralel për popullatën shumicë shqiptare. Mirëpo, shqetësimet rreth kualitetit të këtij arsimit dhe pabarazisë gjinore në nivelin e shkollimit të mesëm dhe universitar janë ende prezente.

Punësimi. Në vitin 1984, zyrtarisht numri i personave të punësuar në çdo një mijë të njerëzve të moshës për punë ishte 223 në Kosovë krahasuar me 426 në RSFJ si tërësi, 665 në Slloveni dhe 409 në Serbi. Kjo situatë u keqësua gjatë vitit 1990 kur shqiptarët e Kosovës u dëbuan nga punësimi publik, por u përmirësua në vitin 1999 kur shumica kërkuan kthimin në pozitën e mëparshme. Për momentin, papunësia është më e lartë në mesin e serbëve të Kosovës për shkak të zhvendosjes përbrenda vendit dhe humbjes së punës në sektorin industrial dhe në administratën publike.

Të ardhurat. Gjatë periudhës para konfliktit, të ardhurat familjare ishin tri herë më të mëdha se tani, ku pjesa më e madhe e të ardhurave (32 %) fitohet nga aktivitetet afariste të vogla dhe të mesme, ndërsa prej pagave (23 %). Gjithashtu, rreth një e katërta e të ardhurave familjare fitoheshin nga paratë që vinin nga jashtë. Pas luftës, sasia e parave të dërguara nga jashtë dhe ndihmat humanitare u shtuan, ndërsa të ardhurat nga afarizmi privat u zvogëluar.

Jetesa. Nga analizat e bëra rezulton se Kosova ende mbetet një shoqëri patriarkale rurale e madhe e cila është shumë e lidhur me tokën. Më se 50 % e popullatës merret me bujqësi në ferma bujqësore prej 2-3 hektarësh. Para konfliktit, rreth gjysma e të ardhurave të familjes rurale fitohet nga prodhimet nga bagëtia

dhe pjesa tjetër nga tregtia e shkallës së ulët, mjeshtëritë dhe punët e rastit, parave të dërguara nga jashtë, dhe punësimi zyrtar. Gjatë periudhës pas konfliktit, përkundër humbjes së punësimit zyrtar nga mbyllja e fabrikave dhe veprimtarive afariste, mundësitë për punë mjeshtrie dhe krahu janë rritur për shkak të programeve të shpëtimit dhe rindërtimit, posaçërisht në regjionet urbane. Gjithashtu, hapësira e lirë ekonomike dhe përdorimi i gjërë i valutës konvertibile ka stimuluar krijimin e bizneseve të vogla tregtare dhe projekte të vetpunësimit, posaçërisht në sektorin e rindërtimit dhe transportit.

III. VLERËSIMI I INSTITUCIONEVE SHOQËRORE

Në këtë kapitull bëhet vlerësimi i institucioneve shoqërore zyrtare dhe jozyrtare gjatë viteve të 90-ta përfshirë edhe qershorin e vitit 1999 deri tani.

Institucionet zyrtare

Pjesa e parë përqendrohet në institucionet zyrtare e në veçanti në përvojën e bashkëudhëheqjes në nivel komunal nën UNMIK-un, në pesë regjionet reprezentuese-Prishtinë, Gjiilan, Prizren, Malishevë dhe Pejë. Gjatë kësaj periudhe, kosovarët dhe veprimtarët ndërkombëtarë kanë punuar për të themeluar një sistem të qëndrueshëm të qeverisjes lokale të karakterizuar nga institucionet inkluzive, një burokraci të përgjegjshme dhe një shoqëri të angazhuar civile.

- ❖ **Në Prishtinë**, kryeqyteti i Kosovës, sistemi i bashkëudhëheqjes esencialisht ishte në rregull, por marrëdhëniet në mes të UNMIK-ut dhe zyrtarëve lokal ishin jo edhe aq të mira, ku udhëheqësia lokale vazhdimisht testonte atë çka ata e quanin sistem “i imponuar nga UNMIK-u”, dhe duke e kritikuar për shërbime jo adekuate. Kjo gjendje pa rrugëdalje në mes të partnerëve të bashkëudhëheqësisë rezultoi me tjerash me ndërtimin e pakontrolluar urban dhe rritjen e kriminalitetit. Përveç kësaj, komunave u mungonte autorizimi për pagimin e tatimit ose ndarjen e mjeteve, që rezultoi me shërbime joadekuate dhe shkaktoi vonesa në pagimin e të punësuarve në komuna. Kjo siç duket, nxiti korruptionin dhe detyroi shumë nëpunës civil përfshirë edhe arsimtarët të kërkojnë punë shtesë në organizatat ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, është kritikuar sjellja e OJQ-ve të huaja për arsye se kërkonin leje për aktivitetet e tyre nga UNMIK-u, e jo nga zyrtarët lokal kosovar. Gjithashtu, ekzistojnë dëshmi për kontroll në baza partiake për qasje në shërbimet shoqërore, edhe pse OJQ-të ndërkombëtare dhe KFOR-i siguruan shërbime shoqërore për personat e zhvendosur brenda vendit dhe pakicat.

Derisa perspektiva për vetëqeverisjen komunale në kryeqytet nuk premtonte shumë në një afat të shkurtër, një “program i universitetit urban”, i rezervuar për Universitetin e Prishtinës, mund të shërbente si model për përmirësim të qeverisjes komunale, duke ndërtuar rrjetin komunikues dhe profesional në kryeqytet, për zbutjen e problemeve të qytetit. Universiteti momentalisht është duke përgatitur një strukturë administrative, e cila është më transparente dhe e përgjegjshme, dhe e cila do të jetë në pozitë më të mirë për zhvillimin e ekspertizave teknike, për të ndihmuar zbatimin e reformave në nivel komunal.

- ❖ **Gjiilani** ishte regjioni i vetëm i zyrës së UNMIK-ut ku për shkak të dhunës së vazhdueshme ndaj serbëve ka munguar një bashkëudhëheqje efektive. Problemi i sigurisë rezultoi me krijimin e sistemit paralel nga UNMIK-u për shërbime themelore komunale - njëri përfshinte shkollat, klinikat dhe shërbimet tjera të përdorura kryesisht nga shqiptarë etnik; dhe tjetri nga një përzjerje e shërbimeve që sigurohej direkt për serbët dhe pakicat e romëve e plotësuar me shërbime bazike të cilat ata i siguronin për vete.

Sistemi i bashkëudhëheqjes jokomplete institucionale për nga definicioni nuk ishte inkluziv. Megjithatë, sistemi paralel i shërbimeve tentonte të siguronte qasje në shërbimet qeveritare lokale për të gjitha grupet e popullatës, kurse UNMIK-u provoi të krijojë kushte për një përfshirje më të gjërë. Në ndërkohë, zhvendosjet e serbëve nga viset urbane në ato rurale krijuan enklavat e izoluar serbe në fshatëra, ndërsa zhvendosjet e shqiptarëve prej viseve rurale në ato urbane shtruan kërkesa për strehim dhe mundësi më të mëdha ekonomike. Për aspektin e sigurisë dhe të

shërbimeve, të dy grupet ishin të varura nga prezenca e ndërkombëtarëve. Në të njëjtën kohë, shtresa e mesme dhe intelgjencia e Gjilanit u zvogëluara, gjë që shkaktoi pesimizëm tek UNMIK-u për perspektivën në të ardhmen e afërt.

- ❖ Në **Prizren**, sistemi i bashkëudhëheqjes nuk ishte komplet pas shkarkimit të kryetarit të Kuvendit Komunal i cili nuk dëshironte të punojë me UNMIK-un. Kualiteti i fuqisë punëtore në komunë ishte i ulët për shkak të punëve zejtare të tejkaluara, shpërngulje e intelgjencës nga Prizreni në kryeqytet, dhe punës nën mbikëqyrje në komunë. Përveç kësaj, UNMIK-u ishte i pafuqishëm të ndërmer aksione për të ndaluar ndërtimin e paligjshëm, ku siç duket pjesa më e madhe është financuar nga tregtia ndërkufitare me Shqipërinë. Gjithashtu, ka të dhëna për kidnapimin e vajzave, sulme të parreshtura dhe përfshirje ekonomike dhe shoqërore të pakicave.
- ❖ Në **Malishevë**, e cila nuk ishte komunë zyrtare dhe nuk kishte strukturë komunale zyrtare, UNMIK-u synonte të zyrtarizojë strukturën institucionale paralele të themeluar nga UÇK-ja pas vitit 1991. Natyra paralele e këtij sistemi institucional ekzistonte akoma meqenëse UNMIK-u nuk kishte buxhet për këtë dhe nuk kishte qendër zyrtare në Malishevë, dhe administratori komunal udhëtonte për në Malishevë. Megjithatë, relacionet në mes të UNMIK-ut dhe zyrtarëve lokal ishin të afërta dhe UNMIK-u u lejoi udhëheqësve të fshatit që t'i tatonjë aktivitetet tregtare për financimin e shërbimeve lokale. Kjo në të vërtetë, i dha qeverisjes lokale më tepër liri për vetëqeverim.

Situata institucionale e përzier ishte një nga pengesat për të tërhequr burimet ndërkombëtare për ndërtim duke përfshirë edhe materiale ndërtimore për rindërtimin e shtëpive. Kjo siç duket i largonte OJQ-të lokale. Zyrtarët lokal e shfrytëzuan vizionin e UNMIK-ut për rindërtim përfshirë edhe rimëkëmbjen e bujqësisë dhe promovimin e turizmit, edhe pse ky vizion nuk mund të realizohej për shkak të mungesës së mjeteve. Në vend të kësaj, administrata lokale u përqëndrua në organizimin politik dhe përkrahjen për krijimin e grupeve të reja që vepronin përbrenda kësaj shoqërie tradicionale fshatare. P.sh., shoqata e gruaz, e themeluar në janar të vitit 1999, aftëson gra të reja fshatare dhe vejane për rrobaqepësi, dhe ofron këshilla mjekësore për gratë shtatëzëna. Edhe pse kjo qasje bazike ishte e pranueshme, nuk dihet sa ka qenë inkluzive administrata lokale në përmbushjen e aktiviteteve tjera.

- ❖ **Peja** ka pasur një strukturë bashkëudhëheqëse complete dhe departamentet komunale me personel të aftësuar mirë profesionalisht, përkundër faktit se Peja pësoi shkatërrimet më të mëdha gjatë konfliktit përshkak të popullatës shumicë shqiptare. Relacionet në mes të UNMIK-ut dhe zyrtarëve lokal u zhvillua me hapa të ngadalshëm pas marrëdhënieve të ftohta në fillim dhe me zvogëlimin e traumave psikologjike që shkaktoi konflikti. Megjithatë, ekzistonte dhunë ndër-etnike për shkak të konfliktit të interesave në mes të grupeve tradicionale familjare të cilat janë ende shumë të forta në këtë regjion. Gjithashtu, kishte shumë shpjegime të luftëtarëve të ish UÇK-së të cilët ende silleshin si polic në këtë qytet, posaçërisht gjatë natës; dhe aktiviteteve të organizuara kriminale.

Institucionet jozyrtare

Ky kapitull përqëndrohet në ndryshimet që kanë ndodhur në institucionet jozyrtare të Kosovës - organizatat e shoqërisë civile, këshillat e fshatit dhe strukturat familjare gjatë viteve të 90-ta. Ky kapitull së pari përshkruan grupet e shoqërisë civile që kanë të bëjnë me orientimin e tyre (bazuar në vendin, identitetin, çështjet me interes publik, dhe të vet-interesit); llojin e kapitalit shoqëror që e promovon secili, dhe ndikimin e prezencës ndërkombëtare mbi këto grupe etnike. Pastaj, do të përqëndrohemi në një analizë më të thellë të parimit të grupit etnik në bazë të vendit, në familjen e madhe tradicionale kosovare; si janë përdorur familja dhe traditat si strategji ballafaquese gjatë konfliktit dhe çfarë ndikimi ka pasur te femrat rishfaqja e familjes tradicionale. Së fundi, kapitulli merr në konsideratë mënyrën se si mungesa e besimit dhe pjesëmarrjes pengon zhvillimin e atyre grupeve që promovojnë kapitalin shoqëror huazues.

Grupet shoqërore civile

- ❖ **Grupet në bazë të vendit.** Parimi i grupit në bazë të vendit është familja e madhe patriarkale tradicionale që tenton të nxisë kapitalin e brendshëm shoqëror huazues. Ky institucion u përforcua si rezultat i konfliktit, posaçërisht në fshatëra por edhe në qytete më të mëdha, ku më shumë familje të vogla moderne bërthamore tentonin të mbesin në lagjen e njëjtë sikurse të afërmmat e tyre.
- ❖ **Grupet në bazë të identitetit.** Grupet që për pak e përkufizojnë vehten nga aspekti i prejardhjes etnike ose religjionit gjithashtu u përforcuan si rezultat i marrëdhënieve me UNMIK-un dhe agjencitë tjera ndërkombëtare, shpesh si përfaqësues të vetëm ose sigures të shërbimeve për anëtarët e tyre. Kjo e rriti legjitimitetin e udhëheqësisë në bazë të identitetit dhe keqësoi tendencën e grupeve të ndryshme kishtarë, klubeve shoqërore, sindikatave dhe organizatave të mirëqenies për të vepruar jo vetëm ndarazi por edhe në opozitë njëra me tjetrën.
- ❖ **Grupet në bazë të çështjeve me interes publik.** Legalizimi i dhunës dhe mosbesimit, penguan formimin e grupeve të reja të orientuara kah interesi publik që mund të ndihmonte në balancimin e ndikimit të grupeve të bazuara në identitet dhe në krijimin e kapitalit shoqëror huazues që nevojitej për zhvillimin bashkiak. U zbulua se vetëm disa nga vendet kishin biznese të mëdha ose asociacione kulturore, edhe pse grupet e grave dhe të rinisë kanë bërë një punë të mrekullueshme në krijimin e kapitalit shoqëror huazues duke nxitur marrëdhënie jashtë kufive etnik dhe barazpeshuar ndikimin e strukturës së madhe familjare.
- ❖ **Grupet në bazë të çështjeve të vetinteresit.** Kushtet e njëjta që konsoliduan grupet në bazë të identitetit, inkurajuan paraqitjen e grupeve të vetinteresit destruktive për ndërtimin shoqëror. Këto grupe, që në masë të madhe u përqëndruan në përfitime të nëdha pasurore dhe kontroll territorial përmes dhunës dhe aktiviteteve kriminele kanë nxitur energjinë e rinisë së papunësuar, me mundësi që u ofrohen në një mjedis me pasiguri ligjore dhe rritje të prezencës të rrjetit kriminal në Kosovë. Në të gjitha vendet, pjesëmarrësit e grupeve të anketuara shprehën shqetësimet e tyre të mëdha për kriminalizimin e shpejtë të ekonomisë së Kosovës dhe paaftësinë e UNMIK-ut dhe KFOR-it për të kontrolluar këtë problematikë.

Mbështetja e UNMIK-ut grupeve që promovojnë përfshirjen dhe kapitalin shoqëror huazues

Komuniteti ndërkombëtarë ka shqyrtuar paraqitjen e grupeve me orientim në interesin publik të Kosovës si rrjet gërshtues që do të lidhë institucionet lokale moderne dhe reprezentuese për nevojat më të zgjëruara shoqërore. UNMIK-u ka siguruar mbështetje efektive për këto grupe, shumica e të cilave kanë kërkuar të pranohen si OJQ, përderisa pikëpamjet dhe aktivitetet e tyre nuk janë në konflikt me mandatin e UNMIK-ut.

Familja tradicionale kosovare: përballimi i krizën përmes kapitalit shoqëror detyrues

Nga vlerësimi u konstatua se përjashtimi nga strukturat shtetërore para konfliktit, vet konflikti, zhvendosjet pas konfliktit dhe humbja e shtëpive, zbrapsi trendin e filluar në vitin 1970 dhe 1980 kah formimi i familjeve të ngushta në mesin e shqiptarëve kosovar. Pjesëmarrësit e grupeve të anketuara, përfshirë pleqtë e fshatit, vazhdimisht vënë në dukje se rishfaqja e familjes së madhe patriarkale “tipike kosovare” gjatë krizës ishte një strategji për t’u ballafaquar me varfërinë ekonomike dhe kërcënimet për mbijetesë. Përveç kësaj, shumë të anketuar, posaçërisht të rinjtë, shprehën dëshirën që këto familje të ndahen në familje të ngushta, aq sa të lejojnë kushtet ekonomike dhe të sigurisë. Familja tipike kosovare është njëkohësisht mbrojtje por edhe rrezikim për femrat. Familja e burrit është e obliguar që të kujdeset për gruan e tij por ajo gjithmonë konsiderohet si e afërme e jashtme, ndërsa fëmijët e saj i përkasin “ për nga gjaku” familjes së burrit. Kështu, nëse burri vdes, ajo mund të detyrohet ta lëshojë shtëpinë dhe t’i lë fëmijët. Kjo situatë krijon një rrezik të madh të keqpërdorimit. Në të njëjtën kohë, femrat të cilat nuk kanë mbrojtje nga burri, babai ose ndonjë i afërm tjetër mashkull janë të cënueshme nga pikëpamja ekonomike dhe sociale.

Gjithashtu, familja tradicionale ka qenë e përcjellur me armiqësi gjaku dhe rregulla të pajtimit, që historikisht janë kryer duke u kërcënuar nga jashtë për të krijuar kohezion në mesin e gjithë shqiptarëve. Në vitin 1990 u inicua një përpjekje e madhe për pajtim brenda komunitetit i bazuar në këto tradita për t'i zgjidhur këto armiqësi të zakonshme gjaku të shqiptarëve, për hir të zhvillimit dhe kohezionit kombëtar në prani të rritjes së hegjemonisë serbe. Gjithashtu, ekzis tojnë dëshmi se kjo iniciativë e pajtimit ka siguruar logjistikën për shfaqjen e shtetit paralel gjatë viteve të 90-ta.

Numri i meshkujve të moshës së aftë për punë në familje përcakton aftësinë e familjes për të mbijetuar. Posaçërisht në viset rurale meshkujt sigurojnë të ardhurat e familjes, edhe pse, shumica do të dëshironin të kenë një treg më të madh të punësimit me mundësi punësimi për femra. Derisa disa gra të reja shprehën krenari për përkushtimin e tyre fëmijëve, shtëpisë dhe punës së dorës, të tjerat kanë filluar me disa ndërmarrje të vogla siç janë fermat e pulave dhe bletaria, për të ndihmuar familjet e tyre.

Familjet gjithashtu janë të varura nga paratë e dërguara nga jashtë, nga anëtarët meshkuj të familjeve të tyre. Një shumë sado e vogël e dërguar nga jashtë prej 100 DM ose 150 në muaj u mundëson anëtarëve të familjes në Kosovë të vazhdojnë bujqësinë, tregtinë lokale ose aktivitete të tjera fitimprurëse. Çfarëdo shume e mbetur e parave të gatshme do të mund të investohej në shkollimin e anëtarëve të rinj të familjes duke u dhënë prioritet djemve. Këto para të dërguara nga jashtë u bënë më të rëndësishme gjatë dhe pas konfliktit, kur u ndërpreu mbjelljet dhe të korrurat, u mundësua përhapja e vjedhjeve dhe shkatërrimi i mjeteve dhe bagëtisë, dhe kur shumë toka bujqësore ishin pa qasje për shkak të minave.

Shumë fshatarë të anketuar, thanë se u kanë lakmi banorëve të qytetit për mundësitë e shumta të punësimit që i kanë nga komuniteti ndërkombëtar dhe për rastin që u jepet për të fituar shuma të jashtëzakonshme të parave sipas bindjeve të tyre. Gjithashtu, ata thanë se u kanë lakmi banorëve të qytetit nga fakti se gratë edhe burrat kanë mundësi punësimi, për të fituar për një familje relativisht të vogël. Edhe pse familjet qytetare tentojnë të kenë më pak fëmijë dhe struktra e familjes së madhe është më pak e përhapur, sigurimi për pleqëri arrihet përmes rregullave martesore patriarkale mashkullore si në qytet ashtu edhe në fshat. Ky parim gjithmonë garanton se njëri djalë gjithmonë do të mbetet me familjen e tij të ngushtë në shtëpinë apo banesën e prindërve dhe do t'i sigurojë ata. Vëllezërit që jetojnë jashtë do t'i kontribuojnë jetesës së kësaj familje përmes parave të dërguara nga jashtë.

Besimi dhe pjesëmarrja në institucionet lokale

Ky vlerësim, gjithashtu ka analizuar dy parametra kyçe të kapitalit shoqëror – besimin dhe pjesëmarrjen përmes pyetësorëve të strukturuar. U përqëndruam në nivelin e besimit në institucionet lokale siç janë këshillat e fshatit dhe administratat komunale; dhe në nivelin e pjesëmarrjes në shoqata të ndryshme. Nga të dhënat shifet se: (i) mungon besimi në mes të njerëzve jashtë strukturës së familjes së madhe i cili është një nga pengesat kyçe për zhvillimin e institucioneve lokale inkluzive; dhe (ii) efektiviteti i organizatave të shoqërisë civile është i penguar nga mungesa e pjesëmarrjes. Gratë në mënyrë të konsiderueshme kishin më tepër besim se burrat dhe besimi në viset rurale ishte pak më i lartë se në viset urbane. Burrat morrën pjesë në shoqata më tepër se gratë dhe viset urbane kishin një pjesëmarrje dukshëm më të lartë se sa viset rurale.

III. VLERËSIMI SHOQËROR

Vlerësimi shoqëror shqyrton përvojën dhe perceptimet e popullatës lidhur me shkatërrimet e shtëpive, zhvendosjet dhe rindërtimet; sigurinë dhe drejtësinë; bashkëjetesën ndëretnike, sistemin shkollor; situatën e grupeve të cënueshme dhe pakicave. Kjo pjesë gjithashtu prezenton idetë e popullatës për mundësitë e zhvillimit të tyre.

Perceptimet për zhvendosjen dhe shkatërrimin dhe rindërtimin e shtëpive. Shumica e pjesëmarrësve të grupit paraqitën përvojën e tyre traumatike të zhvendosjeve gjatë konfliktit. Shumica shkuan në shtete tjera; vajzat dhe pleqtë e kaluan kohën duke u fshehur nëpër pyje; të gjithë banorët e fshatit u bartën në kufi; gratë i panë burrat e tyre duke i rrahur apo ekzekutuar; fqinjët serb i tradhtuan duke treguar vendet ku janë fshehur shqiptarët. Në anën tjetër, shqiptarët u mbrojtën nga fqinjët e tyre serb, dhe disa prej meshkujve shqiptarë i fshehën armët e tyre në vend se të luftonin për të parandaluar vrasjen e grave dhe fëmijëve në shenjë hakmarrjeje.

Pas konfliktit ekzistonte një dëshirë e madhe për riparimin e shtëpive të shkatërruara me ose pa ndihmën ndërkombëtare. Në qytete, kryesisht ka psur ndërtime pa leje, ndërsa komunat luftonin për mbrojtjen e të drejtës së tyre legjitime për planifikimin e qytetit, edhe pse njerëzit prioritet më të madh i dhanë përshpejtimit të rindërtimit se sa rregulloreve.

Perceptimet e sigurisë, bashkëjetesës ndëretnike dhe drejtësisë. Ambienti i pasluftës me të cilin u ballafaquan shumë pakica karakterizohet me kufizimin e lirisë dhe lëvizjes, qasjes së kufizuar në punësim dhe shërbime dhe shqetësime me dhunë. Por, të anketuarit shqiptarë theksuan se janë kundër dhunës së vazhdueshme etnike. Në vend të kësaj ata dëshirojnë një sistem ligjor i cili do të persekutonte kundërvajtësit nga të gjitha grupet etnike. Ndjenja e sigurisë kohët e fundit është rritur në saje të prezencës ndërkombëtare dhe homogjenitetit të rritur etnik në fshatëra dhe lagje të qyteteve. Në vazhdim, shumë të anketuar besojnë se gjasat për paraqitjen e problemeve janë më të mëdha në ato lagje ku ende jetojnë serbët. Megjithate, siç duket është më saktë të flitet për frikën etnike se sa urrejtjen etnike në mesin e shumicës së popullatës.

Kërcënimet tjera ndaj sigurisë përfshijnë minat tokësore në viset rurale dhe kriminaliteti në viset urbane. Rritja e kriminalitetit pas luftës ishte e lidhur me vakumin e pushtetit, neglizhencën e policisë dhe keqpërdorimin e sundimit të së drejtës. Megjithate, tani ekziston frika nga krimet e reja siç janë kontrabandimi me drogë, vjedhja e veturave, kidnapimi dhe kërcënimet me vrasje të shkaktuara nga bandat që kalojnë kufirin nga Shqipëria dhe ekstremistët politik. Personat që merren me tregti ndërkufitare, gjithashtu vënë në spikamë krimin e organizuar dhe korrupcionin e zyrtarëve të doganës.

Sa i përket sistemit ligjor, përkundër vështirësive për themelimin e një gjyqësie multi-etnike efektive, njerëzit e të gjitha grupeve etnike dhe besimtarët fetar parashihnin një të ardhme multietnike nëse persekutohen krimet individuale të luftës.

Perceptimi i arsimimit. Të gjithë të anketuarit shqiptarë vënë në dukje një përmirësim të rëndësishëm në sistemin arsimor krahasuar me periudhën para konfliktit, që më së shumti është i lidhur me rivendosjen në ndërtesa shkollore dhe ndihmën ndërkombëtare në riparim dhe pajisje të këtyre ndërtesave. Megjithate, përkundër këtyre përmirësimeve fizike, të rinjtë e qytetit u ankuan në kualitetin e varfër dhe plane të tejkaluara të arsimit si dhe stilin e të mësuarit autoritar që ende e karakterizon sistemin arsimor. Një specialist i arsimit nga UNMIK-u në Pejë ishte gjithashtu i shqetësuar për përhapjen e dënimeve fizike nëpër shkolla, dhe potencoi nevojën urgjente për riaftësimin e arsimtarëve. Përveç kësaj, ekipi vlerësues ka zbuluar pak shoqata të prindërve dhe arsimtarëve në mbarë Kosovën që mund të ushtronte ndikim pozitiv në demokratizimin dhe modernizimin e sistemit shkollor, nëse promovohet në mbarë krahinën. Problemet tjera përfshijnë shpenzimet e mëdha të shkollimit, kufizime në qasje dhe mungesë të angazhimit nga ana e arsimtarëve për shkak të vështirësive ekonomike.

Perceptimet e grupeve të cenueshme. Kosovarët ende e shohin familjen si garancionin më të madh të sigurisë, dhe ata pa familje ende i konsiderojnë si pjesëtarë më të cenueshëm të shoqërisë. Këtu përfshihen gratë që i kanë humbur burrat, fëmijët pa baballarë dhe vëllezër, të moshuarit pa fëmijë, të sëmurët dhe të hendikepuarit pa familje për tu kujdesur për ta, dhe familjet tjera pa meshkuj për t'i mbajtur familjet përmes punës së tyre.

Perceptimet e kufizimeve të solidaritetit familjar. Derisa meshkujt ndihen përgjegjës për gratë dhe familjen, gratë janë shumë më të vetëdijshme për kufizimet e solidaritetit familjar dhe për cenueshmërinë që rrjedh nga përjashtimi prej shoqërisë më të gjërë. Gratë gjithashtu janë shumë më të vetëdijshme se solidariteti familjar nuk mund ta mbrojë rininë nga papunësia dhe kriminaliteti; ose t'i mbrojë të moshuarit, pesnionistët, të sëmurët dhe të hendikepuarit të cilëve u nevojiten shërbime sociale. Kjo siç duket e konfirmon konstatimin e mëhershëm se gratë janë burim i kapitalit shoqëror detyruar në Kosovë; ku edhe në situata të mbijetesës kur familja e madhe supozohet të jetë primare, ata janë të vetëdijshme për situatën e të tjerëve, dhe shpesh veprojnë për ndërmjetësim dhe ndërlidhje në mes të strukturës tradicionale dhe njerëzve e grupeve të jashtme.

Cenueshmëria e personave të zhvendosur brenda vendit. Personat e zhvendosur brenda vendit (IDP) përbëjnë pjesën më të madhe të popullatës dhe janë të koncentruar nëpër qytete siç janë Prishtina, Prizreni dhe Peja. Shumica nuk janë kthyer sepse shtëpitë e tyre nuk janë riparuar, dhe shërbimet siç është p.sh. arsimit, nuk janë në dispozicion, ose nuk kanë qasje në tokën e tyre punuese për shkak të minave. Të tjerët nuk dëshirojnë të nënshtrohen programeve për aftësim profesional të udhëhequra nga OJQ-të, ose t'i lënë bizneset e tyre që i filluan gjatë zhvendosjes; ose presin stimulime siç janë huatë e vogla për blerjen e bagëtisë ose material ndërtimor.

Shumica e IDP-ve rurale që jetojnë nëpër qytete janë të pargjistruar. Disa jetojnë me farefisën, disa në shtëpitë e të afërmëve të cilët janë jashtë vendit, ose në qendra kolektive. Të tjerët jetojnë nëpër banesa, shtëpi ose bodrumet që dikur u përkisnin Serbëve. Shumica e popullatës urbane i fajësojnë IDP-të si dhe pjesën më të madhe të atyre nga fshatërat, për rënien e pastërtisë dhe rendit publik. Kjo urrejtje shton pasigurinë e IDP-ve.

Cenueshmëritë e të kthyerëve. Planet e Gjermanisë dhe të Zvicrës për kthimin e një numri të madh të të mërguarëve dhe refugjatëve shqiptarë nga Kosova ka shkaktuar shqetësime të mëdha në mesin e familjeve që varen nga parat e dërguara nga jashtë për mbijetesën e tyre. Gjithashtu, shprehen shqetësime për vet re-integrimin e të kthyerëve si edhe për një numër të madh të pakicave kosovare të cilët janë regjistruar në shtetet evropiane nikoqire si shqiptarë kosovar dhe mund të kthehen në një mjedis të pasigurt.

Cenueshmëria e pakicave. Edhe pse incidentet e krimeve të rënda kanë shënuar rënie, sulmet e motivuara etnike dhe kërcënimet, vazhdojnë të jenë prezente në mbarë krahinën. Si rezultat i kësaj, pakicat ballafaqohen me restriksione të mëdha të lëvizjes dhe qasjes për punësim dhe shërbime shoqërore – një proces i përjashtimit që i bën ata edhe më të cenueshëm ekonomikisht dhe në pikëpamje sociale. Duke u bazuar në informatat e kufizuara që i patëm në disponim për këto grupe, dhe në intervistat me anëtarët e serbëve, romëve, sllavëve musliman (përfshirë edhe goranët) dhe në anëtarët e komunitetit turk, ekipi vlerësues tentoi të shënojë llojet dhe shkallët e ndryshme të cenueshmërisë dhe perspektivën e çdo grupi për pajtim me popullatën shumicë shqiptare. Në përgjithësi, ekipi konstatoi se:

- ❖ Edhe pse mendohet se serbët e përfshirë në akte kriminale u larguan me tërheqjen e forcave jugosllave, prezumimi i fajësisë kolektive ende vazhdon. Në një ambient të tillë, e tërë popullata e mbetur serbe konsiderohet të jetë në shënjestër të radikalëve shqiptarë nga Kosova. Shumica janë rivendosur në enklavat serbe në viset rurale ku u ofrohen kushte më të mira për siguri dhe qasje në prodhimet bujqësore dhe të bagëtisë. Megjithatë, në shumicën e viseve urbane dhe vendeve të tjera heterogjene në pikëpamje etnike, shumica e serbëve nuk janë në gjendje t'i lënë shtëpitë e tyre, kanë mundësi të vogla për të ardhura dhe kërkojnë mbrojtjen e KFOR-it dhe ndihmë humanitare. Serbët ballafaqohen me sfidat më të vështira të çfaredo grupi për pakicave për sa i përket bashkëjetesës dhe pajtimit me popullatën shumicë shqiptare.
- ❖ Romët (duke përfshirë edhe romët etnik, ashkalinjtë dhe egjiptasit) janë popullata më e cenueshme ekonomike dhe e përjashtuar shoqërisht. Edhe pse ata nuk përjetuan zhvendosje dhe sulme hakmarrëse në atë shkallë siç përjetuan serbët, ata veç ishin një grup në pozitë të pavolitshme para luftës, me mundësi të vogla për tokë dhe bagëti ose për punësim zyrtar. Mirëpo perspektivat e tyre për pajtim nëse jo për përfshirjen e tyre në jetën ekonomike dhe shoqërore relativisht janë më të mira se sa për serbët.
- ❖ Sllavët musliman janë më pak të cenueshëm nga aspekti social dhe ekonomik se sa serbët dhe romët. Ata ishin një grup relativisht me perspektivë para luftës, me shkallë të lartë të arsimimit dhe të aktiviteteve sipërmarrëse. Në të njëjtën kohë, tani ata janë duke përjetuar një përjashtim për shkak të gjuhës dhe lidhjeve të tjera me serbët. Në veçanti, kjo është e vërtetë për goranët, të cilët siç duket përjetojnë më tepër përjashtim shoqëror se sa sllavët tjerë musliman për shkak të lidhjeve të tyre me administratën e mëparshme serbe. Megjithatë, sllavët musliman kanë perspektivë të mirë për pajtim dhe integrim ekonomik për shkak të lidhjeve të tyre religjioze me popullatën shumicë shqiptare.

- ❖ Turqit janë grupi i pakicave më pak të cenueshme në Kosovë për shkak të lidhjeve të tyre të ngushta kulturore me popullatën shqiptare dhe aftësitë e tyre sipërmarrëse. Ata kanë përjetuar më pak sulme hakmarrëse dhe më pak zhvendosje. Perspektiva për përfshirje ekonomike dhe shoqërore është më e mirë për këtë grup minoritar.

Idetë e popullatës lokale për zhvillimin e tyre. Pjesa e fundit e vlerësimit shoqëror është një shqyrtim largpamës, se si shqiptarët kosovar dhe pakicat i perceptojnë nevojat e tyre immediate dhe perspektivat për zhvillim gjatë tri ose pesë viteve të ardhshme. Rezultatet tregojnë një ndjenjë të vazhdueshme të cenueshmërisë për momentin, por optimizëm për të ardhmen, e posaçërisht një përcaktim për t'ju shmangur ndihmës ndërkombëtare. Si femrat ashtu edhe meshkujt e anketuar, shprehën nevojën për lloje specifike të ndihmës ndërkombëtare, ku meshkujt dëshironin kredi për t'i mbështetur idetë e tyre sipërmarrëse e gratë aftësim për punë, posaçërisht për rrobaqepësi, floktari, anglisht dhe shkathtësi kompjuterike. Në viset rurale, meshkujt e anketuar më së shumti përmendën mikro-kreditë për blerjen e mjeteve prodhuese (farat, plehërat, pajisjet bujqësore, bagëtinë), dhe zgjerimin e veprimtarive bujqësore. Gratë e qytetit si dhe ata të fshatit dëshironin shërbime më të mira shoqërore (posaçërisht kujdes shëndetësor), sigurim të ushqimit dhe sigurim fizik (posaçërisht pastrimin e minave tokësore).

Të anketuarit gjithashtu kishin ide të mira zhvillimore sipërmarrëse të përshtatshme për rrethanat e tyre lokale, duke përfshirë nevojat për kredi, kthimin sa më shpejtë të parave për t'ju shmangur borxheve afatgjata, dhe punësimin e njerëzve. Shumica kërkonin informata se cilave agjenci duhet drejtuar për kredi dhe aftësim për çështjet e sektorit privat, siç janë përcaktimi i kërkesës dhe ofertës.

IV. VLERËSIMI I DIASPORËS

Analizat e diasporës shqyrtojnë situatën e shqiptarëve kosovar në Gjermani dhe Zvicër, ku ata përbëjnë grupin e dytë më të madh të huajve. Të mërguar erdhën në tri valë të veçanta: (a) vala e parë (në fund të viteve të 60-ta/fillim i 70-tave) e shqiptarëve kosovar që ishin punëtorë mysafir, shumica e të cilëve ishin pa përvojë, pak të arsimuar, nga vise rurale të Kosovës.; (b) vala e dytë, prej 1989-1993 në Gjermani, dhe 1981-1990 në Zvicër, prej të cilëve shumica ishin shqiptarë kosovar të shkolluar dhe të aftësuar më mirë, nga viset urbane të Kosovës, dhe të rinjtë që kërkonin t'ju shmangen shërbimit ushtarak në armatën jugosllave gjatë luftës në Ballkan (1992-1995); dhe (c) vala e tretë e azilkërkuesëve dhe refugjatëve nga konflikti i viteve 1998-1999 në Kosovë, të përzier nga aspekti i arsimit dhe prejardhjes. Vlerësimi përqëndrohet në situatën e punësimit të këtyre të mërguarëve; politikën e shteteve nikoqire; paratë e dërguara nga jashtë; presioni mbi të mërguarët për tu kthyer, dhe efektet e mundshme në Kosovë me rastin e kthimit të tyre.

Situata e punësimit. Situata e punësimit për të mërguarët shqiptarët kosovar është e vështirë, posaçërisht në Gjermani, ku shumica nuk kanë mundur t'i marrin lejet e punës. Si rezultat i kësaj, ata me më pak mjete kanë qenë të detyruar të punojnë në mënyrë ilegale, ndërsa ata me më shumë mjete kanë themeluar biznese private siç janë restorantet dhe agjencitë turistike.

Politika dhe programet e ndihmave. Gjermania është duke udhëhequr një inivativë më të gjërë të UE, për të harmonizuar politikën për azil dhe për refugjatë brenda pesë viteve, duke filluar nga kontrolli i kufijve dhe kërkesat strikte për viza. Kjo është duke u bërë pjesërisht për të zvogëluar shpenzimet e larta të qeverisë gjermane për ndihmë refugjatëve që aktualisht është rreth 500 milion DM për një vit. Në Zvicër, kriza e Kosovës e nxiti sërish debatin e gjatë për ligjet e shtetit për azil dhe refugjatë. Disa ndryshime të mëvonshme në ligjet e Zvicrës i kanë vështirësuar edhe më tepër kushtet për shqiptarët kosovar. Të dy shtetet orvaten t'i trajtojnë një sërë çështjesh të lidhura me refugjatët duke përfshirë racizmin, sulmet e dhunshme dhe diskriminimi socio-ekonomik kundër të huajve; kriminalitetin në mesin e të huajve dhe kërcënimet në sigurinë e brendshme nga bartja e lëvizjeve politike dhe konflikteve nga shtetet e tyre amë.

Në Gjermani, çdo shtet ka Zyrën e komisionerit për çështje të të huajve për të siguruar këshillime dhe shërbime shoqërore dhe ndihmë për riatdhesim. Edhe pse vitet e fundit, ndihma e këtillë ka rënë dukshëm dhe kushtet për të huajt vazhdimisht po bëhen më pak atraktive; p.sh. restriksionet në bashkimin familjar, riatdhesimi pa dashje dhe zvogëlimi i përfitimeve sociale.

Në anën tjetër, qeveria e Svicrës është ende shumë aktive në ofrimin e ndihmës për të huajt, në mënyrë direkte dhe përmes OJQ-ve, duke ofruar arsim, aftësim, këshillime, shërbime sociale dhe ligjore dhe ndihmë të mirëqenies dhe të integritit. *Universiteti popullor shqiptar (UPA)* në Gjenevë posaçërisht synon që 10,000 anëtarëve shqiptarë dhe komunitetit të shqiptarëve kosovar tu sigurojë aktivitete arsimore, shoqërore, kulturore dhe sportive.

Paratë e dërguara nga jashtë. Paratë nga jashtë kanë kontribuar në mbijetesën dhe në mirëqenien e familjeve kosovare, si dhe gjendjen e mirë të ekonomisë kosovare. Paratë e dërguara u rritën dukshëm si rezultat i konfliktit, prej rreth një e katërta e të ardhurave familjare para luftës, deri rreth gjysma e të ardhurave familjare pas luftës. RIINVESTI vlerëson se gati gjysma e familjeve në Kosovë marrin para nga jashtë. Fondet e përgjithshme nga jashtë janë vlerësuar të jenë 750-850 milion DM në vit, dhe më së tepërmi shfrytëzoehn për strehim, transport dhe aktivitete tregtare.

Kthimi. Në Gjermani, 60,000 shqiptarë kosovar u detyruan të kthehen kah fundi i marsit të vitit 2000 dhe pjesa tjetër (180,000), do të detyrohen të kthehen në të ardhmen e afërt. Shumica nga grupi i dytë janë azilkërkues, disa prej të cilëve për 8-9 vite jetojnë në Gjermani dhe kërkesat e tyre për azil u refuzuan. Zyrtarët gjerman parashikojnë një debat të vështirë politik për të ardhmen e këtij grupi. Gjermania ka përgatitur ndihma speciale për serbët dhe romët të cilët nuk do të detyrohen të kthehen dhe zyrtarët qeveritar parashikojnë nevojën e sigurimit të ndihmave të vazhdueshme sociale për këto grupe. Në Zvicër – rreth 18,500 shqiptarë kosovar u kthyen në Kosovë kah fundi i dhjetorit 1999. Edhe një pjesë prej 65,000 do të detyrohen të kthehen këtë vit, duke përfshirë këtu edhe ata me status të përkohshëm, azilkërkuesit dhe refugjatët e luftës.

Qeveria gjermane dhe zvicerane sigurojnë programe të shumta për ndihma për të lehtësuar riatdhesimin dhe reintegrimin e të kthyerve shqiptarë. Përveç kësaj, një numër i organizatave siç është Komësariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) dhe Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) janë duke punuar me këto qeveri për t'i organizuar këto kthime.

Ndikimi i riatdhesimit. Shumë të mërguar nga vala e parë shprehin dëshirë për t'u kthyer në Kosovë. Kosovarët e moshuar, shumica prej të cilëve filluan të punojnë si punëtorë të papërvojë por që më vonë zhvilluan shkathhtësi dhe biznese, do të mund të sillnin pasurinë në vendin e tyre së bashku me njohuri të gjuhëve të huaja, dhe investimin e kapitalit për themelimin e bizneseve dhe krijimin e vendeve të punës. Disa planifikojnë t'a ndajnë kohën dhe mjetet në mes të shtetit nikoqir dhe Kosovës. Megjithate, ata të cilët kthehen për tu pensionuar do të ishin një ngarkesë shtesë për shërbimet sociale, posaçërisht nëse fëmijët e tyre nuk kthehem me ta.

Vala e dytë e të mërguarëve, shumica e të cilëve kishin arsimim të lartë kur e lëshuan Kosovën, gjithashtu do të sillnin shkathhtësi të reja, njohuri të gjuhëve të huaja, përvoja në biznes dhe kapital investues. Ky grup ka një mentalitet më modern dhe është i orientuar kah ekonomia e re. Disa prej këtij grupi, gjithashtu, kanë shprehur dëshirën të jetojnë në të dy vendet. Fëmijët e familjeve të këtij grupi ka gjasa të kthehen në Kosovë me prindërit e tyre dhe të sigurojë një infuzion të ri për kapitalin njerëzor të aftësuar dhe mirë të arsimuar. Megjithate, ky grup mund të paraqiste një ngarkesë shtesë për strehim dhe për tregun e punës, për shkollim dhe për mjete mjekësore.

Vala e tretë e të mërguarëve, refugjatët e luftës dhe azilkërkuesit e lëshuan Kosovën nën rrethana të tmerrshme, dhe shumica nuk kanë shtëpi apo punë ku të kthehen. Megjithate, ata mund të kenë fituar shkathhtësi dhe aftësim të dobishëm dhe mjete financiare dhe materiale nga programet e qeverive nikoqire. Ata do të shtojnë kërkesat për strehim, punësim dhe sigurimin e shërbimeve sociale.

Meshkujt e rinjë nga ky grup, shumica e të cilëve janë me shkollim të ndërprerë dhe joadekuat, do të paraqesin një sfidë të veçantë. Shumica e tyre janë të çorientuar dhe të traumatizuar nga lufta dhe janë përballur me papunësim, ndarje nga anëtarët e familjes, diskriminim dhe kushte të vështira jetese në shtetet nikoqire. Disa prej tyre janë marrë me aktivitete kriminale, dhe këtë mund ta vazhdojnë në Kosovë. Do të nevojiten programe të reja për t'i trajtuar nevojat e veçanta të rinisë, posaçërisht të atyre të cilëve më së shumti u janë mohuar të drejtat.

VI. Konkluzione

Një numër i rezultateve që dalin nga analizat duke përfshirë edhe nevojën për institucionet inkluzive, që promovojnë kohezionin ndërbashkiak dhe pajtimin ndëretnik; shqetësimet e vazhdueshme të mbijetesës ekonomike dhe të sigurisë së grupeve të cënueshme dhe dëshirën e popullatës për një sistem ligjor efektiv. Analizat gjithashtu zbuluan dëshmi se kapitali shoqëror huazues mund të zhvillohet dhe mbështetet përmes politikave dhe programeve adekuate. Këto zbulime kanë implikacione për hartimin e strategjive të ndihmave gjatë një afati të mesëm. Në veçanti:

Institucionet lokale duhet përforcuar për të promovuar kapitalin shoqëror huazues. Ekziston nevoja për përpjekje më të mëdha sistematike për të zhvilluar aftësimin kadrovik lokal në sektorin qeveritar dhe joqeveritar në nivel lokal, ndërtimin e përvojës së bujshme organizative dhe institucionale, të fituar gjatë periudhës së vetqeverisjes. Gjithashtu, ekziston nevoja për programe për të nxitur besimin dhe ndërtimin e marrëveshjeve të përgjithshme në mes të zyrtarëve të huaj dhe atyre lokal, e në veçanti në mes të grupeve civile lokale të shoqërisë me orientim kah interesi publik dhe administrata e nivelit lokal. Përpjekjet për zhvillim, të udhëhequra nga komuniteti, mund të bëhen më efektive nëse aftësia e qeverive lokale për të promovuar marrëdhënie kontraktuese ndërmjet komuniteteve themelore rivlerësohet në projektet investuese.

Komunat, komunitetet dhe grupet e orientuara kah interesi publik duhet të autorizohen për t'i trajtuar nevojat e segmenteve të cënueshme dhe të përjashtuara në popullatën shqiptare kosovare. Një qasje e mbrojtjes gjithëpërfshirëse shoqërore duhet të orientojë shërbimet shoqërore të bazuara në komunitet dhe të rrisë vetëdijen për nevojat e veçanta të grave dhe vajzave. Ndihi ma e specializuar për fëmijët e traumatizuar, grupet tjera të ndikuara nga lufta, për individët e paaftë, është nevojë prioritare për të lehtësuar risocializimin e tyre dhe për të zbutur ngarkesën e tepërt të familjeve.

Duhet shqyrtuar nevojën për zhvillimin e shpejtë të qyteteve. Qyteteve u mungon infrastruktura, shërbimet publike, kapaciteti i administratës dhe struktura ekonomike për t'i përmbushur nevojat e popullatës. Prandaj, ndihma dhe përpjekjet për krijimin e politikës duhet të përqëndrohen në planifikimin urban, shërbimet, infrastrukturën, krijimin e vendeve të punës dhe një kornizë adekuate për politikë publike për të mundësuar zhvillimin e një shoqërie urbane të qëndrueshme dhe funksionale.

Specifikat lokale dhe pasuritë duhet të merren parasysh gjatë hartimit të programeve dhe projekteve zhvillimore konsistente.

Kosova ka rregullime të ndryshme nënregjionale/lokale, ku pasuritë e ndryshme kulturore, institucionale, dhe shoqërore mund të përdoren për intervenime zhvillimore. Të gjitha aktivitetet e tilla duhet të planifikohen me një element të fuqishëm të pjesëmarrjes së qytetarëve.

Duhet përforcuar pozitën e grave përmes arsimimit të vajzave, qasjes në vlerat produktive dhe mekanizmat e sigurisë që janë të rëndësishme për nevojat e grave.

Sa i përket arsimimit, ekziston nevoja për grante për vajzat të cilat janë në pozitë të papëlqyeshme nga viset rurale, për shkak të shpenzimeve të mëdha të transportit dhe pengesave tjera kulturore dhe materiale. Lidhur me veprimtaritë produktive, gratë fshatare, në veçanti vejanet, kërkuan bagëti për të shtuar ushqimin e familjeve të tyre. Sa i përket aftësimin për punë, gratë e anketuara theksuan rëndësinë e veprimeve të shtuara në zhvillimin e roleve profesionale për të mos provokuar konfrontimet ose izolimin nga familjet e tyre dhe komuniteti. Gratë janë pranuar shumë mirë si arsimtare, punëtore të kujdesit shëndetësor dhe mikro-sipërmarrëse. Sa i përket sigurisë, ekziston nevoja për mekanizma dhe institucione, siç janë stacionet policore me femra të punësuar, me ç' rast gratë mund të ndihen të sigurta kur denoncojnë dhunën gjinore.

Një sistem i fuqishëm juridik dhe programet e përbashkëta lokale mund të nxisin besimin ndëretnik dhe bashkëpunimin. Nga vlerësimi shoqëror u konstatua se përkundër mosbesimit të përhapur etnik, ekzistojnë embrione të tolerancës në mes të shqiptarëve kosovar dhe pakicave. Pengesat për rithemelimin e kësaj bashkëjetese kryesisht kanë të bëjnë me aspektin e sigurisë. Megjithatë, rezultatet tregojnë se një %je e konsiderueshme e shqiptarëve, incidentet e tilla i shohin si akte kriminale dhe do të pranonin idenë e bashkëjetesës, me kusht që të persekutohen kundërvajtësit. Këto rezultate tregojnë se ecja përpara në këto çështje të urrejtjes etnike lidhen me themelimin e një sistemi ligjor zyrtar, përfshirë ligjet, policinë, gjykatat

dhe burgjet, për të ndihmuar stabilizimin e shoqërisë dhe mundësinë e pajtimit, duke eliminuar dhunën e vazhdueshme. Të anketuarit gjithashtu vënë në spikamë nevojën që programet bazike të përdoren bashkarisht me mirëkuptim, për të lehtësuar dialogun dhe zhvillimin e mundësive shoqërore dhe ekonomike, ku secila palë do të ndihmojë në zvogëlimin e tensioneve etnike dhe do të mbështesë procesin delikat të pajtimit. Këto lloje të intervenimeve të vogla do të jenë më pak të ndieshme ndaj kërcënimeve dhe dhunës nga ekstremistët, se sa orvatjet e dukshme nga komuniteti ndërkombëtar për të nxitur pajtimin.

Cenueshmëria e pakicave ekziston për shkak të përjashtimeve të mëdha shoqërore dhe nevoja e programeve për t'i trajtuar efektet dhe nëse ka mundësi shkaqet. Përjashtimi i serbëve dhe romëve dhe në shkallë më të ulët i sllavëve musliman përcakton nevojën për: (a) investime multisektoriale, që në veçanti do të përqëndroheshin në nevojat e popullatës pakicë; dhe (b) intervenimet e udhëhequra nga komuniteti, që përfshijnë elemente pjesëmarrëse të fuqishme. P.sh. donatorët mund të ndihmojnë përpjekjet lokale në rritjen e bashkëpunimit ndërkufitar në mes të fshatërave të goranëve në Kosovë dhe Shqipëri. Përveç kësaj, mbetet ende shumë për tu bërë për të përmirësuar cenueshmërinë sociale dhe ekonomike.

Zhvillimi i sektorit privat duhet t'i drejtojë kërkesat e sipërmarrësve mikro dhe të vogël lokal. Programet duhet të sigurojnë kredi për biznesin e vogël dhe këshilla e ndihmë teknike, përfshirë edhe informacione mbi funksionimin e ekonomisë së tregut.

Komuniteti i diasporës është një burim i rëndësishëm për investime dhe bartjen e shkëmbësive, por për këtë qëllim nevojiten nxitje për kthim. Nxitjet duhet të përfshijnë forcimin e bankave lokale; lehtësi për sigurimin e strehimit dhe të kredive hipotekare; vizita për të vlerësuar situatën në Kosovë; mbështetje për investime në sektorin privat në Kosovë; dhe shërbime shoqërore, arsimore dhe programe aftësimi për të kthyerit.

I. HYRJE

Deri në vitet e fundit, puna analitike e Bankës në disa raste i ka përkushtuar vëmendje të kufizuar mosbaraspeshës distribucionale dhe regjionale, tensioneve etnike, politikës së përjashtimit dhe grabitjes dhe çështjeve tjera që u kontribuojnë ngjarjeve politike që çojnë në krizë. Kjo mund të ketë rezultuar për shkak të humbjes së mundësive për të promovuar barazinë dhe zhvillimin e tërësishëm¹

Ky vlerësim verifikon se si konflikti dhe zhvendosjet në Kosovë² gjatë dekadës së fundit kanë ndikuar në marrëdhëniet shoqërore dhe në institucione. Mbulon një grup çështjesh të gjëra dhe komplekse, të cilat marrë në tërësi, formojnë një pasqyrë të shoqërisë kosovare gjatë adaptimit të saj me ndryshimet politike dhe ekonomike që u shkaktuan nga: (i) dezintegrimi i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ-së); (ii) periudha e zbatimit të masave të dhunshme, kur shumica e popullatës shqiptare u përjashtua nga jeta publike; (iii) dhuna e motivuar etnike dhe zhvendosjet; dhe tash së voni, (iv) kthimi i refugjatëve shqiptarë dhe themelimi i administratës ndërkombëtare. Gjatë periudhës më të vonshme, dhuna e brendshme dhe ndërëtnike ka vazhduar, dhe pjesa e mbetur e popullatës serbe dhe e pakicave tjera, përjetojnë përjashtime shoqërore në shkallë të ndryshme. Me angazhimin e shpejtë të Bankës Botërore dhe aktivistëve të tjerë ndërkombëtarë në krahinë një studim i tillë ishte i pamundur para hartimit të programit dhe projektit. Shpresojmë se vendimet programeve dhe politikës për zhvillimet dhe ndërtimet në të ardhmen do të përfitojnë nga ky studim për të kaluarën. Studimi është pjesë e një sërë studimesh të institucioneve në nivel lokal që realizohen nga Banka Botërore për të mbikëqyrur implementimin e strategjisë regjionale për Evropën Juglindore.³

¹ Kreimer et al. (1998).

² Kosova, Republika Federale e Jugosllavisë (Serbia dhe Mali i Zi), më tej Kosova.

³ Strategjia regjionale për Evropën Juglindore e përgatitur nga Banka Botërore për Paktin e Stabilitetit, potencon kohezionin dhe institucionet inkluzive shoqërore brenda dhe në mes të shteteve të Evropës Juglindore (SEE), të cilat janë kushte esenciale për paqe dhe zhvillim ekonomik në këtë regjion. Në nivel shtetëror kjo nënkupton një orvatje sistematike për: (i) trajtimin e nevojave të grupeve të cenueshme dhe të ndikuara nga lufta; (ii) rritjen e të drejtave të pakicave, pjesëmarrjen dhe qasje në resurse dhe shërbime; dhe (iii) identifikimin dhe autorizimin e atyre grupeve shoqërore, ku ka gjasa më të mëdha të ndodhin ndryshime shoqërore. Shif Banka Botërore (2000 c).

Historiku

Sipas kushtetutës së vitit 1974 të RSFJ-së, Kosova gëzonte një shkallë të lartë të autonomisë dhe një status gati i barabartë me gjashtë republikat tjera jugosllave. Krahinë ishte në gjendje, përveç tjerash, të zhvillonte politikën shëndetësore dhe arsimore dhe shërbimet e decentralizuara të deleguara në komunanë. Megjithatë, kjo periudhë e definuar në këtë raport si *autonomi pa kalim kompetencash* - karakterizohet me mungesën e përfaqësimit të institucioneve lokale, një burokracie të papërgjegjshme dhe mungesë relative të angazhimit të shoqërisë civile.

Me propozimin e ndryshimeve kushtetuese në Beograd në vitin 1989, autonomia e krahinës u kufizua shumë. Një sërë masash të dhunshme gjatë dekadës së ardhshme, përjashtuan shumicën e shqiptarëve etnik nga institucionet zyrtare publike dhe private. Kjo periudhë - e definuar këtu si *centralizim me dominim* – u karakterizua nga institucionet politike joreprezentuese dhe të centralizuara një burokraci e papërgjegjshme me represion të shoqërisë civile. Shqiptarët kosovar u përgjegjën këtyre masave me: (i) zhvillimin e institucioneve të tyre paralele (p.sh. për shërbimet shëndetësore dhe arsimore), të financuara nga komuniteti shqiptarë në Kosovë dhe nga diaspora e zgjeruar; (ii) krijimin e bizneseve të vogla (shitore, restorante, fabrika etj.); dhe (iii) migrimin masovik nga krahinë. Konflikti etnik u rrit me dezintegrimin e RSFJ-së në vitin 1991 dhe me sanksionet pasuese të Kombeve të Bashkuara (KB) kundër Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ-së). Ndërmjet 1990 dhe 1995, ekonomia e tkurrur e Kosovës në rreth 50 %, duke e ulur prodhimin e përgjithshëm bruto (GDP) në një vlerë të llogaritur prej 720 milion US \$ ose më pak se rreth 400 US \$ për frymë (duke mos përfshirë paratë e dërguara nga jashtë)-më i ulët se ai në Shqipëri, shteti më i varfër në Evropë.

Dhuna etnike eskaloi në vitin 1998 dhe 1999, duke bërë presion të madh në strukturën e ndieshme shoqërore dhe në zhvendosjet masive. Më se 800,000 kosovar u zhvendosën në shtetet fqinje dhe të jashtme, 500,000 të tjerë u zhvendosën brenda krahinës dhe 9,000-10,000⁴ u vranë ose janë të zhdukur. Në fund të konfliktit, me kthimin e shumicës së refugjatëve shqiptarë në krahinë më se 100,000 serb dhe rom nga Kosova u larguan duke iu frikësuar hakmarrjes.⁵

Konflikti përfundoi në qershor të vitit 1999 me Rezolutën 1244 të KB-ve, e cila i akordoi krahinës një “autonomi substanciale dhe vetadministrim kuptimplotë”, duke pranuar “soveranitetin dhe integritetin territorial të Republikës Federative të Jugosllavisë“. Gjithashtu, Rezoluta vendosi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-un), si qeveri tranzicionale me katër fusha nën përgjegjësinë e vet: (i) çështjet humanitare; (ii) administratën e përkohshme civile; (iii) themelimin e institucioneve; dhe (iv) rindërtimin. Gjashtë muaj më vonë, UNMIK-u nënshkroi marrëveshjen për Strukturat e Përbashkëta të Përkohshme Administrative (SPPA) me një numër të përfaqësuesëve kosovar. Momentalisht, kjo strukturë është duke e administruar krahinën. Gjatë kësaj periudhe - të definuar si *autonomi me kalim kompetencash (devolucion)* – kosovarët dhe veprimtarët ndërkombëtarë janë përpjekur të vendosin një sistem të qëndrueshëm të qeverisjes lokale të karakterizuar me institucione inkluzive, burokraci të përgjegjshme dhe një shoqëri të angazhuar civile. Një komponentë e këtij studimi shqyrton evoluimin e kësaj përpjekje (shif Kornizën konceptuale, poshtë).

Autonomia e periudhës me kalimin e kompetencave – gjithashtu është karakterizuar me përpjekjet e bëra për të demilitarizuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-në), dhe reintegrimin e ish-luftëtarëve në shoqëri - përpjekje kjo e vështirë për shkak të strukturave të decentralizuara të UÇK-së. Nga zanafilla e saj si grup gueril në vitin 1993, rekrutët u tërhoqën nga disa vise rurale dhe udhëheqësit lokal u pajisën me shkallë të lartë të autonomisë. Kjo strukturë i ka udhëhequr disa analist që organizatës t’i referohen si “një shoqatë që më shumë u përngjan klaneve se sa forcave militare klerarkike”⁶. Analistë të tjerë e kanë krahasuar këtë organizatën me Lidhjen Demokratike të Kosovës si më urbane, më intelektuale dhe të

⁴ Shifra më e ulët është vlerësim i UNFPA/IOM (2000); shifra më e lartë është vlerësim i UNHCR (qershor 1999).

⁵ Vlerësim i UNHCR-së (qershor 1999).

⁶ ICG (2000b).

moderuar, tërheqja jo e dhunshme e së cilës nga institucionet serbe më 1990⁷ imponoi sistemin paralel. Menjëherë pas luftës, disa përkrahës të UÇK-së formuan disa parti politike përfshirë edhe Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe u rekrutuan në gardë kombëtare si Trupa Mbrojtëse të Kosovës (TMK). Përkrahësit e tjerë të UÇK-së mendohet se janë të involvuar në aktet e vazhdueshme të dhunës kundër grupeve të tjera etnike dhe shqiptarëve më të moderuar.

Korniza konceptuale: Nevoja për ndërtimin e institucioneve inkluzive në Kosovë

Ky studim u realizua në kuadër të përpjekjeve të mëdha për ndihmë ndërkombëtare dhe për zhvillimin e një strategjie për rindërtim dhe zhvillim. Mbështetet në idenë se arritja e stabilitetit dhe zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm është një proces i ndërlikuar që varet nga faktorë shoqëror, në veçanti, institucionet inkluzive që promovojnë kohezionin brenda komunitetit dhe pajtimin ndëretnik. Konceptet e ndërlidhura të kohezionit shoqëror, kapitalit shoqëror dhe pajtimit janë në fakt çështje qendrore për këtë analizë. Derisa definicionet ndryshojnë, ekziston një koncensus se kapitali shoqëror paraqet aftësinë e individëve dhe grupeve (familjeve, lidhjeve farefisnore, shoqatave lokale) për të siguruar fitime si rezultat i marrëdhënieve të tyre me njëri tjetrin, dhe se është e qenësishme në normat e besimit dhe reciprocitetit që drejtojnë interaksionet e tyre. Raporti përqëndrohet në vlerësimin e dy lloj kapitalëve në Kosovë - *kufizues* dhe *huazues* – të cilat karakterizohen nga relacionet horizontale brenda dhe në mes të grupeve të ndryshme. Këto lloje të kapitalit shoqëror kanë implikime të ndryshme për promovimin e kohezionit shoqëror dhe menaxhimin e konfliktit. Derisa kapitali shoqëror *kufizues* mund të përjashtohet, duke përforcuar lidhjet brenda grupeve, por duke promovuar mosbesimin e të huajve, dhe kështu, ndarje shoqërore dhe varfërim të jetës publike, kapitali shoqëror *huazues* tenton të kultivojë marrëdhëniet përmes grupeve dhe përfshirjen, pajtimin dhe kohezionin e tyre.⁸ Kapitali i njëjtë shoqëror *kufizues* që u mundëson grupeve të mbijetojnë gjatë krizave, mund të pengojë ose vonojë rindërtimin dhe zhvillimin socio-ekonomik që varet nga bashkëpunimi i grupeve të ndryshme. Lloji i tretë, kapitalit shoqëror *ndërlidhës*, është vertikal në kuptim të interaksioneve në mes të qytetarëve dhe institucioneve shtetërore. Kapitali shoqëror ndërlidhës është i nënkuptuar në institucionet shtetërore të cilat janë inkluzive dhe të autorizuara që të nxisin pjesëmarrjen dhe transparencën e proceseve vendimmarrëse dhe, në rastin e Kosovës, bëjnë të mundur angazhimin bashkëpunues të të gjithë grupeve në ndërtimin e një shoqërie paqesore. Prezenca e kapitalit shoqëror ndërlidhës në Kosovë nuk është objekt vështrimi i këtij vlerësimi duke ditur statusin e pasigurt politik të krahinës dhe natyrën evolutive të institucioneve të saj. Në vend të kësaj, vlerësimi përqëndrohet në potencialin për zhvillimin e kapitalit shoqëror huazues si parakusht për zhvillimin e kapitalit shoqëror ndërlidhës dhe inkluziv, që plotfuqizon institucionet shtetërore në të ardhmen.

Studimi mbështet përpjekjet për kultivimin e përfshirjes shoqërore dhe kohezionin duke identifikuar: (i) mënyrën e evoluimit të institucioneve vendëse zyrtare dhe jozyrtare në Kosovë gjatë viteve të 90-ta, dhe shkallët e ndryshimit të përfshirjes dhe përjashtimit gjatë periudhave të ndryshme të konfliktit; (ii) strategjitë e grupeve të ndryshme gjatë ballafaqimit me përjashtimet shoqërore, ekonomike, marginalizimin dhe zhvendosjen fizike; dhe (iii) mënyrat se si kohezioni shoqëror dhe pajtimi mund të mbështeten nga institucioneve inkluzive dhe nga zhvillimi ekonomik lokal. Njohuritë e tilla janë esenciale për hartimin e politikës dhe programeve që promovojnë kohezionin e nevojshëm për stabilitet dhe zhvillim. Gjithashtu, është esenciale për zhvillimin e kapacitetit të 30 komunave të Kosovës – të cilat pas zgjedhjeve të tetorit 2000 u bënë njësi të rëndësishme administrative në krahinë, për planifikimin e viseve urbane dhe rurale, duke filluar nga shëndetësia, arsimimi, furnizimi me ujë dhe energji elektrike.⁹ Prandaj, ky studim

⁷ Rohde (2000)

⁸ Për shqyrtim më të detajuar të kapitalit shoqëror në shtetet e ndikuara nga konflikti shif Colletta dhe Cullen (2000). Për shqyrtim të kapitalit shoqëror dhe zvogëlimi i varfërisë shif Bankën Botërore (2000).

⁹ Draft rregullorja e UNMIK-ut mbi vetqeverisjen e komunave në Kosovë (qershor 2000) parashef se: “njësia bazë territoriale e vetqeverisjes lokale në Kosovë do të jetë komuna, e cila do të ushtrojë tërë pushtetin që shprehimisht nuk i është lënë Autoritetit qendror.” Më tej thekson se “të gjitha organet dhe trupat e komunës do t’ju sigurojnë banorëve gëzimin e të gjitha të drejtave dhe lirive pa dallim race, prejardhje etnike, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, opinionin politik, prejardhja kombëtare apo shoqërore, pasurie, status i lindjes ose ndojnë status tjetër, dhe që ata të kenë mundësi punësimi të paanshëm dhe të barabartë në shërbimet komunale në të gjitha nivelet. Komunitat duhet të ndikojnë me politikën dhe praktikën e tyre në nevojën e promovimit të bashkëjetesës në mes të banorëve të saj dhe të krijojnë kushte adekuate

potencon kapacitetin e komunave dhe institucioneve tjera lokale jo vetëm që t'i përmbushin këto funksione të vetqeverisjes, por t'i krijojë kushtet për autorizim, përfshirje dhe pajtim të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Metodologjia dhe veprimtaria

Ky vlerësim paraqet një analizë kualitative të *procesit* të ndryshimeve institucionale dhe shoqërore. Analiza zhvillohet prej nivelit makro në atë mikro, prej institucioneve zyrtare në ato jozyrtare - për të tërheq vëmendjen për varietetet e perspektivave mbi konfliktet dhe ndryshimet në Kosovë. Analiza është ndarë në katër pjesë kryesore, ku secila analizon një pako të ndarë të çështjeve. Fushë veprimi dhe metodologjia për çdo pjesë është përshkruar më poshtë.

Analiza makro-sociale përqëndrohet në një sërë dimenzionesh të gjëra hapsinore dhe kohore të ndryshimeve në Kosovë gjatë viteve të 90-ta. Fillon me shqyrtimin e karakteristikave demografike të këtij ndryshimi, përfshirë moshën, gjininë dhe prejardhjen. Pastaj, analizon dimenzionet socio-ekonomike, siç janë shëndetësia, arsimi, punësimi dhe të ardhurat.

Analiza është e bazuar në të dhëna të ndryshme për krahinën prej 1990 deri 2000. Për periudhën para konfliktit (1990-1999), të dhënat janë mbledhur nga vjetari statistikor zyrtar i SFRJ-së dhe publikimet mbi regjistrimin e popullatës.¹⁰ Regjistrimi i popullatës i vitit 1991¹¹ është shfrytëzuar për projektimin për popullatën, kurse aspektet demografike mbështeten në burime tjera zyrtare.¹² Për periudhën pas luftës (1999-2000), burimet janë marrë kryesisht nga vlerësimet e fundit që u realizuan nga një numër i organizatave qeveritare e joqeveritare dhe ndërkombëtare, dhe citohen në vazhdim.

Vlerësimi i institucioneve zyrtare përqëndrohet në përvojën e bashkëudhëheqjes në nivel komunal dhe në perspektivën për avancimin e kapacitetit institucional të komunës. Ky vlerësim nuk siguron një analizë

për tu mundësuar të gjitha komuniteteve të shprehin, ruajnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre etnik, kulturor, religjioz dhe gjuhësor. Në këtë rregullore, nocioni 'komunitete' do të thotë banorët që i përkasin grupit të njëjtë etnik, religjioz dhe/ose gjuhësor.

¹⁰ Savezni Zavod za Statistiku (1992-1998).

¹¹ Duhet patur parasysh se regjistrimi i përgjithshëm u bojkotua nga shumica e shqiptarëve kosovar dhe disa rom të Kosovës, kështu që të dhënat në masë të madhe bazohen në vlerësimet e autoriteteve të Beogradit.

¹² Savezni Zavod za Statistiku (1990).

gjithëpërfshirëse për të gjitha institucionet zyrtare dhe të gjitha aspektet e sistemit të bashkëudhëheqjes, siç janë punësimi i personelit dhe planifikimi i buxhetit. Në vend të kësaj, vlerësimi synon të sigurojë një vështrim në kontekstin institucional zyrtar brenda të cilave mund të nënkuptohen institucionet shoqërore jozyrtare.

Vlerësimi i institucioneve jozyrtare përqëndrohet në institucionet jozyrtare të nivelit grupor, siç janë lidhjet familjare, këshillat e fshatit, familja dhe grupet e shoqërisë civil; dhe vlerëson ndryshimin e këtyre institucioneve gjatë kohës.¹³

Vlerësimi i çështjeve shoqërore siguron një vështrim më të thellë për nevojat dhe cenueshmëritë e popullatës duke përfshirë edhe: (i) strategjitë e nivelit familjar për sigurimin e ushqimit, strehimit dhe arsimit; (ii) perceptimet e popullatës për sigurinë nga krimi dhe prezenca e dhunës ndëretnike; (iii) situatën e grave dhe vajzave, pakicave dhe grupeve të tjera të cenueshme; dhe (iv) mundësitë për bashkëjetesën ndëretnike dhe pajtim. Kjo pjesë gjithashtu vlerëson pikëpamjet e popullatës mbi efektivitetin e institucioneve dhe aftësinë e tyre për promovimin e modernizimit dhe demokratizimit.

Vlerësimet institucionale dhe shoqërore në masë të madhe bazohen në punën e bërë në terren të realizuar në mars dhe prill të vitit 2000. Pjesa më e madhe e punës në terren u përqëndrua tek shqiptarët e Kosovës të cilët përbëjnë më se 90 % të popullatës. Nga Kosova u zgjedhën pesë regjione reprezentuese (Prishtina,¹⁴ Peja, Prizreni dhe Malisheva dhe, brenda çdo regjioni u zgjedhën nga një vend urban dhe një rural. Në çdo vend është zhvilluar nga një diskutim grupor me grup të meshkujve të rritur, femrave të rritura, meshkujve të rinjë (prej 15 dhe 25 vjet), dhe femrave të reja (prej 15 deri 25 vjet). Përveç kësaj, janë zhvilluar një numër i intervistave të papërcaktuara me reprezentues të institucioneve zyrtare dhe jozyrtare.

Ekipi vlerësues gjithashtu ka zhvilluar një sërë diskutimesh grupore dhe intervistash të papërcaktuara me grupe të cenueshme (vejane të luftës, IDP-të, të kthyerit) dhe pakicat (serbët, romët, turqit dhe sllavët musliman) në ato vende ku këto grupe janë prezente në numër të madh.

Në fund, vlerësimet institucionale dhe shoqërore gjithashtu përfshijnë rezultate prej vështrimeve dhe vlerësimeve të realizuara nga OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare, agjencitë bilaterale dhe agjencitë e KB-së (shif Shtojcën I dhe II).

Analizat e diasporës kosovare përqëndrohen në historinë dhe demografinë e emigracionit, mënyrave të dërgimit të parave nga jashtë, stimulimet dhe presionet për tu kthyer, dhe rolin që diaspora mund ta luajë në rindërtimin e Kosovës.

Kjo analizë është e bazuar në punën e zhvilluar në terren në Gjermani (Berlin, Frankfurt dhe Ludwigshafen) dhe Zvicër (Zurich, Berne dhe Gjenevë). Janë zhvilluar një numër i intervistave me zyrtarë qeveritar nikoqir, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare; ekspertë të migracionit; dhe udhëheqës bashkiak, afarist dhe organizativ nga rradhët e të mërguarëve shqiptarë kosovar. Përveç kësaj, u zhvilluan 10 diskutime grupore me të mërguar për të kuptuar situatën e tyre në shtetin nikoqir dhe lidhjet e tyre me Kosovën. Tri grupe ishin në shënjestër dhe kërkojnë vëmendje të posaçme: rinia, femrat dhe ata që janë aktiv në sektorin privat (shif Shtojcën I dhe II).

II. ANALIZAT MAKRO-SOCIALE, 1991 - 2000

Ky kapitull përqëndrohet në një numër të dimenzioneve hapsinore dhe kohore të ndryshimeve në Kosovë gjatë viteve të 90-ta. Fillon me shqyrtimin e karakteristikave demografike të këtij ndryshimi përfshirë

¹³ Edhe pse vlerësimi fillimisht tentonte të qartësojë relacionet fafëfisnore, udhëheqësinë politike dhe rrjetet ilegale, kjo ishte një sferë shumë e ndieshme dhe e vështirë për të zhvilluar kërkime në një mjedis të pasigurt, ku ishim të kufizuar edhe në kohë.

¹⁴ Ju lutemi të vëni re se emrat e komunave do të shënohen në shqip; mirëpo emrat e fshatërave do të jepen në gjuhën e popullatës shumicë që jeton në ato fshatëra.

moshën, gjininë dhe prejardhjen etnike. Pastaj, analizon dimensionet socio-ekonomike siç janë shëndetësia, arsimi, punësimi dhe të ardhurat.

Analiza është e bazuar në disa të dhëna të ndryshme për krahinën prej 1990 deri 2000. Për periudhën para konfliktit (1990-1999), të dhënat janë marrë nga vjetarët statistikorë zyrtar të RSFJ-së dhe publikimet mbi regjistrimin e përgjithshëm të popullatës.¹⁵ Regjistrimi i përgjithshëm i vitit 1991¹⁶ është shfrytëzuar për projektimet për popullatën, ndërsa aspektet demografike mbështeten në burimet zyrtare.¹⁷ Për periudhën e pas luftës, janë marrë kryesisht burimet e vlerësimeve të fundit të zhvilluara nga një numër i organizatave qeveritare, joqeveritare ndërkombëtare dhe do të citohen në vazhdim.

Ndryshimet demografike

Projeksionet për popullatën

Gjatë dekadës së fundit, Kosova ka përjetuar shumë ndryshime demografike për shkak të migrimit, dhunës ndëretnike dhe zhvendosjeve në shkallë të lartë. Duke i marrë parasysh këto dhe ngjarje të tjera, popullimi aktual i Kosovës është vlerësuar duke shfrytëzuar metoda demografike konvencionale në bazë të karakteristikave të ndryshme demografike dhe socio-ekonomike. Vlerësimet e moshës dhe gjinisë së popullatës janë të bazuara në tri komponente të ndryshimeve të popullatës - mortaliteti, fertiliteti dhe migrimi. Secila prej këtyre komponenteve - bazuar në supozimet e shënuara më poshtë - janë shfrytëzuar për të projektuar tri variante të ndryshimeve të popullsisë (e ulët, e mesme dhe e lartë) për 1996 dhe 2000. Shumica e analizave në këtë raport mbështeten në variantin e mesëm.

Mortaliteti. Vlerësimet e mortalitetit janë të bazuara në dy supozime bazë: (i) që shkalla e mbijetesës nuk ka ndryshuar gjatë periudhës së viteve 1991-1998. Ky supozim është i bazuar në faktin se nuk ka pasur ndryshime dramatike në faktorët që përcaktojnë llojet e mortalitetit gjatë kësaj periudhe krahasuar me periudhën para 1991, dhe (ii), që rreth 9,000 njerëz u vranë në konfliktin gjatë viteve 1998-1999 ose ende figurojnë si të zhdukur,¹⁸ shumica e të cilëve janë meshkuj të rritur.

Fertiliteti. Derisa mortaliteti nuk ndryshoi në mënyrë rapide gjatë 1991-2000, fertiliteti ra prej 3.9 në 2.5 fëmijë për një grua në vitin 2000. Ky vlerësim është bazuar në një vështrim të vonshëm,¹⁹ dhe në ndryshimin drastik në proporcion me gjininë për njerëzit e moshës reproduktive (15-45 për femra, 20-50 për meshkuj) - për shkak të shkallës së lartë të migrimit gjatë viteve të 90-ta (shif figurën 1 dhe tabelën 1). Ky proporcion është 72 meshkuj në vitin 2000 (variant i mesëm), krahasuar me 92 meshkuj me 100 femra në vitin 1991.

¹⁵ Savezni Zavod za Statistiku (1992-1998).


¹⁶ Duhet shënuar se shumica e popullatës shqiptare kosovare refruzuan të marrin pjesë në këtë regjistrim kështu që të dhënat bazohen në masë të madhe në vlerësimet e autoriteteve të Beogradit.

¹⁷ Savezni Zavod za Statistiku (1990).

¹⁸ Siç është shënuar në fusnotën 4, egzistojnë dy vlerësime për këtë shifër. Analiza do të shfrytëzojë shifrën e UNFPA/IOM (2000) prej 9,000 sepse është e bazuar në një vështrim të gjërë kuantitativ në krahinë.

¹⁹ UNFPA/IOM (2000).

Figura 1. Struktura e moshës së popullatës në Kosovë, 1991 dhe 2000



Për variantin e lartë të ndryshimit të popullatës, shkalla e përgjithshme e fertilitetit është vlerësuar në 3.5 fëmijë për një grua gjatë viteve 1991-1996, dhe 2.8 gjatë 1996-2000. Për variantin e mesëm dhe të atë të ulët, shkalla e fertilitetit është vlerësuar në 3.1 fëmijë për një grua gjatë viteve 1991-1996, dhe 2.5 gjatë 1996-2000. Të gjitha këto janë shkallë relativisht të larta sipas standardeve evropiane.

Migrimi. Për shkak të migrimit gjatë viteve 1991-2000, të tri vlerësimet e ndryshimit të popullatës janë bazuar në supozime të ndryshme:

- ❖ Për variantin e lartë, supozimi është një migrim negativ neto prej 100,000 gjatë 1991-1996, dhe rreth 300,000 gjatë viteve 1996-2000.
- ❖ Për variantin e mesëm, një migrim negativ neto prej 150,000 gjatë viteve 1991-1996, dhe rreth 300,000 gjatë 1996-2000.
- ❖ Për variantin e ulët, një migrim negativ neto prej 200,000 gjatë 1991-1996, dhe rreth 300,000 gjatë 1996-2000.

Këto vlerësime bazohen në: (i) shifra nga shtete të ndryshme evropiane të cilët tregojnë një shifër të përgjithshme rreth 400,000 të mërguar nga Kosova në Evropën Perëndimore gjatë viteve 1993-1998;²⁰ (ii) një vështrim të realizuar nga RIINVESTI²¹ në Kosovën e pas luftës duke shikuar moshën dhe gjininë e të mërguarëve, ku u zbulua se migrimi ishte i shpejtë dhe se të mërguarit përgjithësisht ishin të rinj; (iii) ndikimin e ngjarjeve të ndryshme politike dhe ekonomike në Kosovë në valën e migrimit; dhe (iv) regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë të vitit 1991.

²⁰ Vickers (1998) vlerëson se gjatë kësaj periudhe, 120,000 të mërguar shkuan në Gjermani; 95,000 në Zvicër; 35,000 në Suedi; 23,000 në Austri; 8,000 në Belgjikë; 5,000 në Francë; 5,000 në Danimarkë; 4,000 në Itali; 3,500 në Norvegji; 3,000 në Britani; 2,000 në Holandë; 600 në Finlandë; dhe 200 në Luksemburg.

²¹ RIINVEST (1999c; 1999d).

Në bazë të këtyre burimeve variantet e ulta, të mesme dhe të larta të projekteve për popullatën u realizuan për vitet 1996 dhe 2000, siç është treguar në Tabelën 1.

Tabela 1. E projektuar kah mesi i vitit për moshën dhe gjininë e popullatës

Varianti	1991			1996			2000		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Ulët	1,009,474	946,723	1,956,197	971,189	959,557	1,930,746	841,663	905,270	1,746,932
mesëm	1,009,474	946,723	1,956,176	1,004,746	981,094	1,985,840	879,234	930,824	1,810,058
Lartë	1,009,474	946,743	1,956,197	1,052,466	1,016,167	2,068,632	942,536	980,878	1,923,413

Të tri variantet tregojnë një zhvillim negativ të popullatës ndërmjet viteve 1996 dhe 2000, përkundër fertilitetit relativisht të lartë në vitin 2000. Kështu, nga tri komponentet e zhvillimit të popullatës, migrimi ka pasur efekte të konsiderueshme që ka rezultuar në zvogëlimin e popullatës në rreth 175,782 njerëz ndërmjet dy viteve sipas variantit të mesëm.

Trendet demografike

Përkundër migrimit masiv të meshkujve të moshës reproduktive dhe rënies së fertilitetit, popullata e Kosovës është përsëri e re. Njerëzit nën moshën 25 vjeçare përbënin 46,4 % të popullatës në vitin 2000, krahasuar me 57,9 % të vitit 1991. Moshja mesatare në vitin 2000 është 22.2 vite krahasuar me 20.9 në vitin 1991. Megjithatë, ekziston një ndryshim i qartë i strukturës moshore për vitin 2000 (shif Figurën 1), ku migracioni në mënyrë drastike ka ndikuar në moshat 20-40 vjet, popsaçërisht tek meshkujt.

Kosova ka përjetuar ndryshime tjera drastike demografike si pasojë e konfliktit, përfshirë edhe rënien e vrazhdë të natalitetit dhe rritjen e vrazhdë të mortalitetit, dhe, për çudi, një rënie të vdekshmërisë së foshnjeve (shif Tabelën 2) edhe pse kushtet shëndetësore në krahinë ishin keqësuar. Shifrat e fundit duhet trajtuar me kujdes dhe për këta shifra nevojiten kërkime të mëtejme.

Tabela 2. Indikatorët demografik për Kosovën në vitet e 90-ta

	1991	1996	2000
Popullata	1,956,197	1,985,840	1,810,058
Rritja neto		-29,643	-175,782
Moshja mesatare	20.9	21.8	22.4
Shkalla e vrazhdë e natalitetit	28.7	23.5	18.9
Shkalla e vrazhdë e mortalitetit	5.3	5.3	5.8
Shkalla e përgjithshme e fertilit.	3.9	3.1	2.5
Shkalla e vdekshmërisë së foshnjeve (për 1,000 lindje)	51	33	25

Burimet: Shifrat për vitin 1996 dhe 2000 janë bazuar në variantin e mesëm për projektimin për popullatën; shifrat për vitin 1991 janë bazuar në *Savezni Zavod za Statistiku* (1990, 1993, 1993b); dhe shifrat për shkallën e përgjithshme të fertilitetit për vitin 1996 dhe 2000 dhe vdekshmërinë e foshnjeve janë bazuar në UNFPA/IOM (2000).

Struktura etnike e popullatës²²

Me përfundimin e konfliktit u bënë ndryshime të mëdha në strukturën etnike të popullatës kosovare. Sipas autoriteteve të Beogradit, ka pasur përafërsisht 347,000 popullatë joshqiptare në vitin 1991 (18 % e popullatës) në Kosovë, ku 195,000 kanë qenë serb, 57,000 sllav musliman, 43,000 romë,²³

²²Luteti t'i referoheni gjithashtu Kapitullit IV, pjesa e situatës mbi pakicat etnike.

²³Numri aktual i romëve në Kosovë në vitin 1991 besohet të ketë qenë shumë më i lartë.

11,000 turq dhe 41,000 malazes, kroat dhe grupe të tjera.²⁴ Në shkurt të vitit 2000, UNHCR/OSCE ka vlerësuar popullatën pakicë në rreth 197,000 - që është rreth 56% e popullatës para konfliktit - bazuar në burime të ndryshme, përfshirë edhe udhëheqësit e komunitetit, Forcat e Kosovës (KFOR), dhe policinë e UNMIK-ut ²⁵ Shif Tabelën 3 të zëbërthyer për grupe të ndryshme

Tabela 3. Vlerësimet e popullatës etnike pakicë në Kosovë, 2000

Serbët	Sllavët musliman ²⁶	Romët ²⁷	Turqit
100,000	47,000	30,000	20,000

Burimi: UNHCR/OSCE (2000a)

Gjatë periudhës pas konfliktit, meqenëse prejardhja etnike mbetet faktor përcaktues i rrezikut për viktimizim nga sulmet e rreshtura dhe dhunës, shumica e pakicave të mbetura vazhdojnë të zhvendosen prej qyteteve dhe fshatërave të përziera në regjione homogjene etnike. Në komunat veriore të Mitrovicës, Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit, popullata serbe tani jeton në veri të lumit Ibër, dhe numri i tyre rritet për shkak të dyndjeve së serbëve prej viseve të tjera të Kosovës. Në Kosovën qendrore, popullata serbe vazhdimisht është duke u zvogëluar dhe tani është koncentruar në disa fshatëra të vogla në komunat e Obiliqit, Prishtinës, Fushë Kosovës dhe Lipjanit. Ka pasur rreth 700-800 serb në Prishtinë në shkurt të vitit 2000, prej 20,000 sa ka pasur në vitin 1998. Në Shtërpcë popullata serbe është shumicë, ndërsa shumica e shqiptarëve jetojnë në katër fshatëra homogjene. Në juglindje, serbët në masë të madhe janë duke e braktisur qytetin e Gjilanit për të gjetur fshatëra më të sigurta ku dominojnë serbët. Në pjesën lindore të krahinës është Kamenica, njëra prej komunave të pakta që nuk ka përjetuar zvogëlim të madh të popullatës serbe.²⁸

Ka pasur një zvogëlim të ngjashëm për popullatën e romëve me tendencë që edhe romët të zhvendosen në zona homogjene ose në disa raste në zona të serbëve. Romët janë koncentruar në komunat perëndimore, në Gjakovë, Prizren dhe Pejë dhe në komunën lindore, në Ferizaj.²⁹ Janë zvogëluar gjithashtu, grupet tjera të cilat janë ndikuar më pak nga konflikti. Pjesa e mbetur e goranëve ende janë të koncentruar në komunën jugore të krahinës, në Dragash; dhe pjesa e mbetur e turqive dhe sllavëve musliman, ende paraqesin një grup të madh në Prizren.

Struktura e popullatës aktive

Struktura e popullatës aktive (ndërmjet 15-60 vjet) nuk ka ndryshuar shumë ndërmjet 1991 dhe 2000 (55.6 dhe 54.2 %, përkatësisht; shif Figurën 2). Megjithate, ka pasur një rritje të vogël të popullatës mbi moshën 60 vjeçare, kryesisht për arsye se popullata nën 15 vjet është zvogëluar si rezultat i rënies së fertilitetit.

²⁴Regjistrimi i përgjithshëm i vitit 1991.

²⁵ UNHCR/OSCE (2000a).


²⁶ Prej këtij numri, 12,000 janë goran

²⁷ Numri aktual i romëve në Kosovë momentalisht besohet të jetë shumë më i lartë.

²⁸ UNHCR/OSCE (2000a).

²⁹ UNHCR/OSCE (2000a)

Figura 2. Ndryshime në strukturën moshore të popullatës aktive



Burimet: Shifrat e vitit 1991 janë bazuar në regjistrimin e vitit 1991; dhe shifrat e vitit 1996 dhe 2000 janë bazuar në variantin mesatar të projektimit të popullatës.

Derisa %ja e popullatës aktive nuk ka ndryshuar, proporcioni i gjinisë ka ndryshuar dukshëm, si rezultat i migrimit të lartë të meshkujve, që u përmend më lartë. Në vitin 2000, proporcioni ishte rreth 90 meshkuj ndaj 100 femra, ndërmjet moshës 15-60 vjet, kurse në vitin 1991, rreth 108 meshkuj ndaj 100 femrave. Ky ndryshim në proporcionin e gjinisë ishte shumë i rëndësishëm, kur kihet parasysh struktura tradicionale e shoqërisë kosovare, ku meshkujt janë mbajtësit kryesor të familjes, dhe ku vetëm një %je e vogël e femrave janë përfshirë në fuqinë punëtore. Në vitin 1990, femrat ishin të përfaqësuara me me 24.3 % në fuqinë punëtore të Kosovës krahasuar me 41 % në RSFJ-së.³⁰ Ndryshimi në proporcionin e gjinisë pritet të ketë një ndikim të dukshëm në bursën e punës.

Shkalla e varshmërisë (popullata ekonomikisht aktive dhe joaktive) në Kosovë ishte e lartë gjatë tërë periudhës 10 vjeçare, duke filluar prej 72 ndaj 100 në vitin 1991 në 73.5 ndaj 100 në vitin 2000 (shif Tabelën 4). Nëse varshmëria në mesin e popullatës ndahet në ata që janë nën 15 vjet dhe 65 vjet e më tepër, bëhet e qartë se shkalla është e lartë për shkak të shkallës së lartë të njerëzve nën 15 vjet. Megjithatë, kjo popullatë do t'i bashkohet popullatës aktive në vitet e ardhshme, duke siguruar që Kosova të mos të ballafaqohet me krizë moshore ngjashëm me ato të shteteve të Evropës Juglindore, siç janë Bullgaria, Greqia dhe Rumunia.

Tabela 4. Shkalla e varshmërisë së popullatës në vitin 1991, 1996 dhe 2000

Viti	Nën 15	65 dhe më tepër	Nën 15 dhe 65 dhe më tepër
1991	64.3	7.7	72.0

³⁰ Savezni Zavod za Statistiku (1995).

1996	62.1	9.1	71.2
2000	61.6	11.9	73.5

Shënim: Shkalla është llogaritur si persona vartës (nën 15, 65 dhe më tepër, dhe të dyja së bashku) për 100 persona 15 deri 65 vjet të moshës.


Burimet: Shifrat e vitit 1991 janë bazuar në regjistrimin e përgjithshëm të vitit 1991; dhe shifrat e vitit 1996 dhe 2000 janë bazuar në variantin mesatar të projektimit për popullatën.

Përbërja ruralo-urbane

Në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, Kosova kryesisht ishte një shoqëri rurale, ku popullata rurale përbënte 80.4 % të popullatës së përgjithshme krahasuar me 70.3 % për RSFJ-në si tërësi,³¹ dhe 77 % për Shqipërinë.³² Përkundër ndryshimeve të mëdha gjatë dekadave të ardhshme, Kosova mbeti njësi federale më rurale e RSFJ-së. Në vitin 1991, popullata e Kosovës ende ishte 62.7 % rurale, krahasuar me 64.45 % në Shqipëri.

Në nivel krahinor, situata nuk ndryshoi dukshëm gjatë viteve të 90-ta. Popullata rurale vlerësohej në 58.6 % nga ajo e përgjithshme në vitin 2000, pra pak më e vogël se në vitin 1991. Megjithatë, në nivel komunal paraqiten disa raste interesante. Me rastin e situatës së sigurisë pas konfliktit me të cilën ballafaqohej popullata kosovare serbe, shumica e atyre që mbetën në vise urbane janë duke u larguar në enklava rurale më të sigurta, posaçërisht në veri dhe në lindje të krahinës. Derisa popullata serbe zvogëlohet në qytete si në: Prishtinë, Pejë dhe Prizren, në komunat rurale siç janë Leposaviqi dhe Zveçani popullata është duke u rritur për shkak të IDP-ve. Megjithatë, IDP-të shqiptarë kosovar janë duke u zmadhuar me vendosjen në vise urbane si Prishtina, Prizreni, Peja dhe Ferizaji, përshkak të shkatërrimeve në viset rurale ku ata jetonin gjatë konfliktit.³³ Meqenëse është vështirë të parashohim ndryshimet urbano-rurale në të ardhmen, nëse Kosova ndjek përvojën e shteteve tjera ballkanike do të përjetojë një ndryshim rapid kah urbanizimi si rezultat i reformave ekonomike. Përfituesit më të rëndësishëm do të jenë qytetet e mëdha siç janë: Prishtina, Prizreni dhe Gjakova, ku më së shumti do të përqëndrohen aktivitetet ekonomike, shoqërore dhe civile. Shenjat e urbanizimit mund të shihen në zvogëlimin e popullatës rurale të Prishtinës dhe Prizrenit (shif Figurën 3).

Figura 3. Popullata rurale sipas nën-regjioneve në vitin 1991 dhe 2000 (në %je)



³¹ Savezni Zavod za Statistiku (1992).

³² INSTAT

³³ Vlerësim i WFP bazuar në shpërndarjen e shifrave.

Burimet: Shifrat e vitit 1991 janë bazuar në regjistrimin e përgjithshëm të vitit 1991; dhe shifrat e vitit 2000 janë bazuar në variantin mesatar të projektimit për popullatën.

Zhvendosjet dhe dëmet e shkaktuara nga konflikti

Siç është shënuar më lartë, ndër pasojat më të mëdha nga konflikti ishte zhvendosja masive e shqiptarëve kosovar.³⁴ Mbi 800,000 u zhvendosën në shtetet fqinje (Shqipëri, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në Mal të Zi, RFJ) dhe jashtë, ndërsa 500,000 u zhvendosën përbrenda krahinës.³⁵

Regjionet me numrin më të madh të personave të zhvendosur – Deçani, Glogovci, Rahoveci dhe Skenderaji - gjithashtu pësuan dëme të mëdha të shtëpive, shkollave, qendrave shëndetësore dhe pasurisë bujqësore.

Nga 128,000³⁶ shtëpi të dëmtuara në Kosovë, më se 84,000 (25% e gjithë shtëpive në Kosovë) u dëmtuan rëndë ose u shkatërruan tërësisht.³⁷ Komunitet me shkallë më të lartë të shkatërrimit ishin Deçani, Skenderaji, Glogovci dhe Peja, ku gati 60 % e gjithë shtëpive u dëmtuan rëndë ose u shkatërruan tërësisht.

Dëmet më të mëdha në shkolla ishin në Skenderaj, Deçan dhe Rahovec. Vetëm 17% e shkollave në të gjitha fshatërat pësuan dëme, kurse 24% patën dëme mesatare. Megjithatë, shkatërrimi i objekteve shkollore ishte vetëm një pjesë e shkatërrimeve të infrastrukturës arsimore. Egziston nevojë e madhe për pajisje dhe mjete shkollore. Për më tepër, numri i arsimtarëve është shumë i vogël, dhe aktualisht janë të përbushura vetëm 36% e vendeve në arsim nëpër fshatëra.³⁸

Situatë e ngjashme është nëpër qendra mjekësore rurale. Vetëm 23% e fshatërave kishin qendra shëndetësore në korrik të vitit 1999, edhe pse shkalla e punëtorëve shëndetësor nëpër fshatëra është më shumë se 2/3 (68%) ndaj shkallës para konfliktit.

Pasuria bujqësore gjatë konfliktit u shkatërrua në masë të madhe, dhe në kundërvlerë të kafshëve, objekteve të fermave dhe makinerisë bujqësore vlerësohen në 700 deri 800 milion US\$. Shumica e humbjeve në pajisje dhe objekte të fermave ishin në komunitet perëndimor. Gjithashtu, ka pasur dëme të mëdha në vjedhje të pajisjeve bujqësore përpunuese, në veçanti në fermat private të vogla dhe të mesme. Në fund, kërkesat e mëdha për dru (për lëndë djegëse dhe ndërtim) pas konfliktit është duke shtuar presionin në pyje, ndërsa minat tokësore kufizojnë qasjen në tokën bujqësore dhe në pyje.

³⁴ Zhvendosjet pas konfliktit të popullatës shumicë janë sqaruar detajisht në Kapitullin IV.


³⁵ Vlerësime të UNHCR-it

³⁶ IMG (2000)

³⁷ IMG (2000); UNHCR/KFOR (2000).

³⁸ UNHCR/KFOR (2000).

Figura 4. Vlerësimi i dëmeve të ndërtesave



Pasojat e migrimit dhe disproporcioni i gjinive

Një vështrim i UNFPA/IOM ³⁹ ka zbuluar se aktualisht gratë janë në krye të familjes në 15% në Kosovë - një shifër shumë e lartë kur kihet parasysh struktura tradicionale patriarkale e shoqërisë. Derisa është shumë vështirë të jepen arsyet precize për këtë situatë, ato mund të shpjegohen nga dy faktorë. I pari,

³⁹UNFPA/IOM (2000).

migrimi i 450,000 shqipëtarëve (vlerësim i variantit të mesëm) nga Kosova gjatë viteve të 90-ta ishte një fenomen ku dominonin meshkujt, dhe mund të ketë ndodhur që femrat dhe fëmijët të lehen pas dore pa mashkull të rritur në familje. Faktorë tjetër mund të jenë meshkujt e vrarë gjatë luftës. Nevojiten informacione më të detajuara për vdekjet dhe migrimet, të zbërthyer nga aspekti i moshës dhe gjinisë për të përcaktuar rëndësinë relative të secilit prej këtyre faktorëve. Në çdo rast, këto familje mund të jenë në mesin e familjeve më të cënueshme nga aspekti i nevojave ekonomike dhe sociale (punësimi, të ardhurat, furnizimi me ushqim, arsimit, kujdesi shëndetësor etj.), dhe duhet të merren parasysh në ndërtimin e politikave sociale dhe projektet investuese. Edhe pse, rrjeti familjar mund ta lehtësojë këtë ngarkesë sociale në një afat të shkurtër, kalimi në një shoqëri moderne do ta imponojë nevojën për institucione të llojeve të tjera për t'i përmbushur nevojat e këtyre familjeve.

Ndryshimet shoqërore dhe ekonomike

Kjo pjesë siguron një vështrim të gjërë të ndryshimeve shoqërore dhe ekonomike në krahinë. Së bashku me pjesën e mëparshme të ndryshimeve demografike krijon një kontekst për të kuptuar pjesën tjetër të analizës. Analiza më të detajuara ekonomike dhe sektorale janë realizuar gjetiu.⁴⁰

Shëndetësia

Popullata e Kosovës ka realtivisht jetë të gjatë . Në vitin 1990 jetëgjatësia për meshkuj ishte 69.5 vjet dhe për femra 76.2 vjet, përkundër shkallës së vdekshmërisë së foshnjeve prej 52 dhe 51 vdekje për 1,000 lindje për meshkuj respektivisht femra⁴¹, që ishte shumë e lartë sipas standardeve evropiane. Kohëve të fundit, mortaliteti i foshjeve ka rënë në 25 vdekje për 1,000 lindje për vitin 2000.⁴² Mortaliteti i të rriturve ka qenë dhe mbetet i ulët.

Vështrimet e më vonshme tregojnë se shumica e vdekjeve (53 %) në mesin e popullatës shqiptare⁴³ të Kosovës shkaktohen nga sëmundjet jo ngjitëse përcjellur me vdekjet e të posalindurve (28 %), dhe vdekjet nga sëmundjet ngjitëse (12 %).⁴⁴ Proporcioni relativisht i lartë i vdekshmërisë nga sëmundjet jo ngjitëse për shkak të pirjes së duhanit (në veçanti meshkujt e rinjë) dhe regjimit të ushqimit ndikojnë në modelin epidemiologjik që i përngjan më tepër një vendi të industrializuar se sa një vendi në zhvillim e sipër. Derisa dëmet e fundit në pajisjet e ujit dhe infrastrukturës sanitare kanë rritur gjasat e sëmundjeve ngjitëse, shkatërrimet e tilla nuk pritet që të paraqesin një rrezik të madh shëndetësor. Rreziqet e shoqëruara me pirjen e duhanit dhe regjimin e ushqimit janë më shqetësuese për një afat të mesëm dhe të gjatë.

Në mesin e fëmijëve shqiptarë kosovar nën moshën 6 muajshe, 64 % ushqehen me qumësht të nënës, që është mbi nivelin në shumicën e shteteve evropiane - ndërsa të tjerët ushqehen me përzierje ushqimesh për fëmijë dhe qumështin e lopës. Dominimi i diuresës është relativisht i lartë (24 % në viset urbane dhe 36 % në viset rurale) pjesërisht për shkak të mungesës së ujit nga ujësjellësi. Shkalla e imunitetit është e ulët në një numër të madh të fëmijëve nën moshën 5 vjeçare, të cilët nuk e kanë përfunduar vaksinimin e plotë. Fëmijët e moshës 2 deri 3 vjeç edhe pse nuk janë përfshirë mjaft, ata janë përfshirë në një shkallë më të lartë se fëmijët e moshës 1 deri 2 vite, por kjo përfshirje vazhdimisht ka qenë duke rënë. Kjo mund të jetë pasojë e zvogëlimit të qasjeve në shërbimet e shëndetit publik, ose e zvogëlimit të besimit në këto shërbime, nga shqiptarët kosovar gjatë dekadës së fundit.⁴⁵

Derisa mortaliteti i të rriturve në përgjithësi është i ulët, egzistojnë probleme lidhur me shëndetin dhe kujdesin shëndetësor të nënave. Kujdesi pas lindjes në Kosovë është jo adekuat - 15 % të grave shtatëzëna

⁴⁰ Shif, p.sh., Banka Botërore (2000).

⁴¹ Savezni Zavod za Statistiku (1990).

⁴² UNFPA/IOM (2000).

⁴³ Një vështrim i ngjashëm gjithashtu është zhvilluar nga popullata serbe e Kosovës por rezultate nuk i patëm në dispozitim.

⁴⁴ Spiegel dhe Salama (2000).

⁴⁵ Spiegel dhe Salama (2000).

nuk e vizitojnë mjekun ose punëtorin për kujdes shëndetësor, gjatë shtatëzënisë së tyre, dhe 20 % e lindjeve bëhen në shtëpi, pa ndihmën e mamisë ose mjekut.⁴⁶

Arsimimi

Pas mbarimit të Luftës së dytë botërore, Kosova ishte regjioni më i pa arsimuar në RSFJ-në e re. Shtatëdhjetë e një përqind e popullatës të moshës 10 vjeçare apo më të vjetër ishin të paarsimuar. Si rezultat i kësaj krahina kishte pak profesionist apo specialist. Kjo situatë u përmirësua në masë të dukshme gjatë dekadave të ardhshme. Megjithatë, në vitin 1991, 27.9 % e popullatës së moshës 10 vjeçare apo më të vjetër ende ishin të paarsimuar krahasuar me 17.3 % në RSFJ-në, 3.6 % në Slloveni, 13.5 % në Kroaci dhe 25.2 % në Bosnë dhe Hercegovinë.⁴⁷ Përqindja e popullatës me arsim fillor, të mesëm dhe të lartë u rrit dukshëm në vitin 1999.⁴⁸ Megjithatë, pabarazia gjinore në shkollimin e mesëm dhe passhkollor është ende prezente (shif Tabela 5), duke ndikuar në strukturën tradicionale të shoqërisë kosovare.

Tabela 5. Niveli i arsimit për njerëzit e moshës 10 vjeçare dhe më të vjetër, 1991-1999

Niveli i arsimit	1991	1999 (1)			1999 (2)
	Kosovë	Meshkuj	Femra	Kosovë	Kosovë
Të paarsimuar	28	10	17	14	14
Më pak se fillor	18	11	15	13	---
Fillor	35	27	39	33	39
I mesëm	15	40	24	31	38
I lartë	4	12	5	9	9
Gjithsej	100	100	100	100	100

1.UNFPA/IOM (2000).

2.RIINVEST (2000a).

Burimet: Përveç në rastet ku është shënuar, shifrat e vitit 1991 janë bazuar në vjetarin statistikor të Jugosllavisë (1990).

Kur i analizojmë këto shifra, është me rëndësi të kihet parasysh se arsimimi në gjuhën shqipe në Kosovë u anulua në vitin 1991, dhe rezultoi me krijimin e sistemit arsimor paralel të popullatës shqiptare kosovare. Përkundër rezultateve pozitive të këtij sistemi, këto masa drastike e ngadalësuan progresin e arritur në arsimin e lartë, dhe mbyllja e shkollave shkaktoi një valë të madhe të të mërguarëve. Arsimi i integruar ende nuk është normuar në Kosovë, dhe shumica e pakicave ndjekin mësimin në shkolla të ndara dhe me planprograme të ndryshme.

Punësimi

Në vitin 1984 numri i njerëzve të punësuar formalisht për 1000 persona të moshës punonjëse në Kosovë ishte 223, krahasuar me 426 në RSFJ si tërësi, 665 në Slloveni dhe 409 në Serbi. Kjo situatë u

⁴⁶ UNFPA/IOM (2000).

⁴⁷ Savezni Zavod za Statistiku (1986).

⁴⁸ Rezultatet e UNFPA/IOM dhe vështrimet e RIINVEST-it janë të ngjashme. Të dhënat e UNFPA/IOM janë shfrytëzuar kryesisht për arsye se tregojnë nivelein e arsimit në bazë të gjinisë.

keqësua gjatë viteve të 90-ta, kur shqiptarët kosovar u dëbuan nga punësimi publik, por u përmirësua në vitin 1999, kur shumica sërsih u kthyen në pozitat e mëparshme. Për momentin, papunësia është më e lartë në mesin e popullatës serbe për shkak të zhvendosjeve të brendshme dhe humbjes së vendeve të punës në sektorin industrial dhe në administratën publike (shif Tabelën 6). Papunësia gjithashtu është e lartë në mesin e meshkujve krahasuar me femrat e popullatës shqiptare dhe serbe (21% dhe 37 % respektivisht), edhe pse përqindja e madhe e femrave të popullatës serbe është duke kërkuar punësim.

Tabela 6. Përqindja e popullatës sipas aktivitetit, 1999

Aktiviteti	Serbët		Shqiptarët		Kosovë		
	Meshkujt	Femrat	Meshkujt	Femrat	Meshkujt	Femrat	Gjithsej
Të punësuar	16	14	19	7	18	8	13
Të vetpunësuar	1	0	5	0	4	0	2
Punëtori që i kontribuon familjes	1	1	2	1	2	1	1
Të papunësuar	37	23	21	9	23	10	16
Shtëpiake	0	26	0	41	0	40	20
Në shkollim	33	30	45	39	44	38	41
Të pensionuar	10	4	6	2	6	2	4
Të tjerë	1	1	3	2	3	2	2
Gjithsej	100	100	100	100	100	100	100

Burimi: UNFPA/IOM (2000).

Të ardhurat

Vështirë është të krahasohet situata para dhe pas konfliktit përkitazi me ekonominë shtëpiake/të ardhurat e familjes, duke ditur indikatorët e llojeve të ndryshme të përdorur nga institucionet e ndryshme gjatë dy periudhave. Analiza jonë mbështetet në një sërë vështrimesh të realizuara nga RIINVEST-i (shif Tabelën 7).

Tabela 7. Të ardhurat mesatare familjare (në DM dhe përqindje)

Burimet	para konfliktit	% nga të ar. e përgj.	pas konfliktit	% nga të ar. e përgj.
Pagat	770.0	23.4	186.0	18.2
Pensionet	129.1	3.9	35.6	3.5
Ndihma humanitare	27.0	0.8	110.7	10.8
Paratë nga jashtë	811.3	24.7	460.5	45.1
Qiraja	74.6	2.3	7.3	0.7
Biznesi privat	1,042.5	31.7	172.9	16.9
Burime të tjera	430.8	13.1	48.9	4.9
Gjithsej:	3,285.3	100.0	1,021.9	100.0

Burimet: RIINVEST (1999c; 1999d)

Të dhënat tregojnë se të ardhurat mesatare familjare në Kosovë para konfliktit ishin për tri herë më të mëdha se sa pas konfliktit; dhe se gjatë periudhës para konfliktit, shumica e këtyre të ardhurave (31.7 %) fitoheshin nga bizneset private, kurse 23.4 % nga pagat. Kjo tregon se ekonomia kosovare para konfliktit ishte e orientuar kah bizneset e vogla dhe të mesme, duke ditur faktin se në punësimin publik nuk kishte qasje për shumicën e popullatës shqiptare. Përveç kësaj, një përqindje mjaft e lartë e të

ardhurave familjare fitoheshin nga paratë e dërguara nga jashtë. Pas luftës, këto para dhe ndihma humanitare u rritën si përgjigje ndaj kërkesave për rindërtim, derisa të ardhurat nga bizneset private u zvogëluan.

Gjithashtu, vështrimet e njëjta tregojnë se shpenzimet për nevojat themelore pas konfliktit u rritën prej 13.8 % në 19.4 % për ushqim, 5.2 % deri 7.8 % për veshëmbathje dhe, 3.2 % deri 4.9 % për kujdes shëndetësor.⁴⁹

Jetesa

Kosova ende është një shoqëri patriarkale rurale në masë të madhe e lidhur mjaft me tokën. Më se 50 % e popullatës merret me bujqësi në një sektor të karakterizuar me më se 160,000 prona tokësore prej 2 deri 3 hektarë. Edhe pse prodhimtaria ndonjëherë është i ulët, bujqësia ende është shtyllë kryesore e familjes fshatare dhe garanton mbijetesën gjatë periudhave të vështira.

Dy regionet kryesore bujqësore janë dy luginat themelore që ujiten nga lumenj të shumtë duke u zgjerruar prej vargmaleve për në veri dhe lindje. Sistemi bujqësor përfshin prodhimin e madh nga fusha e lëvrueshme; drithëra të përziera dhe prodhime të rrushit në sipërfaqe piemonte qendrore dhe periferike; nga pylltaria dhe kullosat masive nëpër male. Shumimi i bagëtisë është gjithmonë i shoqëruar me kultivim por supozohet të jetë më i rëndësishme në viset malore qendrore dhe pjesën perëndimore të krahinës. Prodhimet më të rëndësishme janë: gruri, elbi, tërshëra, misri, luledielli dhe perimet. Ujitja është e rëndësishme për bujqësi intensive në stinën e pranverës dhe verës.

Para konfliktit, rreth gjysma e të ardhurave familjare fshatare fitoheshin nga prodhimet e bagëtisë, ndërsa prodhimi i drithërave u përdor kryesisht për vetkonsumim dhe ushqimin e bagëtisë. Vetëm fermat me hapësira tokësore të mëdha dhe me traktorë angazhoheshin në prodhimin tregtar të grurit. Pjesa tjetër e të ardhurave familjare fitoheshin nga tregtia në shkallë të ulët, puna profesionale dhe e rastit, paratë e dërguara nga jashtë dhe nga punësimi zyrtar. Kjo varshmëri nga punësimi zyrtar nënkuptonte kohën kur puna për shqiptarët kosovar ishte e rrallë gjatë periudhës së masave të dhunshme dhe migrimi ishte opioni i vetëm për shumë familje. Kjo ishte posaçërisht e vërtetë për ata të cilët nuk kishin mundësi të fillojnë mikro biznese apo të vogla. Brenda disa viteve gati 20 % e popullatës emigruan në shtetet e Evropës Perëndimore dhe mjetet e tyre ishin shumë të rëndësishme për mbijetesën e familjeve të mbetura në Kosovë. Tani, rreth gjysma e familjeve fshatare marrin mjete mesatare mujore nga jashtë prej 250 US\$ deri 500 US\$ (shif Kapitullin V).

Në periudhën pas konfliktit, përkundër humbjeve të vendeve zyrtare të punës për shkak të mbylljes së fabrikave dhe bizneseve, mundësitë për për personat e kualifikuar dhe të pakualifikuar janë rritur për shkak të programeve të shpëtimit dhe rindërtimit, posaçërisht në viset urbane. Mjedisi i lirë ekonomik dhe përdorimi i valutës konvertibile gjithashtu ka stimuluar krijimin e bizneseve të vogla dhe projektet e vetpunësimit, në veçanti në sektorin e ndërtimit dhe transportit.

III. VLERËSIMI I INSTITUCIONEVE SHOQËRORE

Në këtë kapitull vlerësohen institucionet shoqërore të Kosovës gjatë viteve të 90-ta, përfshirë edhe periudhën e *autonomisë me kalimin e kompetencave*, nga qershori i vitit 1999 deri tani. Pjesa e parë e kapitullit përqëndrohet në institucionet zyrtare, në veçanti në përvojën e bashkëudhëheqjes në nivel komunal nën UNMIK-un. Gjatë kësaj periudhe, kosovarët dhe aktivistët ndërkombëtarë kanë punuar në themelimin e një sistemi të qëndrueshëm të qeverisjes lokale të karakterizuar me institucione inkluzive, burokraci përgjegjëse dhe angazhim të shoqërisë civile. Jemi përqëndruar në ato institucione lokale ku në vazhdim e sipër është ndërveprimi në mes të kontrollit të resurseve dhe demokratizimit. Siç është shënuar në kapitullin hyrës, këtu nuk paraqesim analizë gjithëpërfshirëse të institucioneve zyrtare në Kosovë, as të gjitha aspektet e sistemit të bashkëudhëheqjes. Në vend të kësaj, vështrimi i paraqitur i institucioneve zyrtare ka për qëllim të sigurojë kontekstin për të kuptuar institucionet jozyrtare shoqërore lokale në krahinë (organizatat e shoqërisë civile, këshillat e fshatit, sistemin e

⁴⁹ RIINVEST (1999c; 199d).

familjeve të mëdha e kështu me radhë). Në pjesën e dytë të kapitullit vlerësohen ndryshimet në institucionet jozyrtare gjatë viteve të 90-ta dhe mundësitë se si ata mund t'i krijojnë kushte për kalimin e kompetencave, për kapitalin shoqëror huazues, si dhe për pajtim dhe demokratizim.

Institucionet zyrtare

Struktura e Përbashkët e Përkohshme Administrative (JIAS) është vlerësuar në pesë vende reprezentuese – Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjilan dhe Malishevë - përkitazi me pesë aspekte të ndryshme: (i) sa është i kompletuar ky sistem i përbashkët në secilin vend; (ii) shkalla e bashkëpunimit në mes të aktivistëve të ndryshëm politik - si kusht i rëndësishëm, në mënyrë që sistemi të jetë operacional; (iii) efikasiteti i sistemit; d.m.th. rezultate konkrete gjatë ballafaqimit me kufizime të resurseve; (iv) efektiviteti i sistemit; d.m.th. kufirin deri në ç'masë shprehen nevojat dhe aspiratat e njerëzve; (v) legjitimiteti i tij; d.m.th. shkallën e reprezentimit të popullatës shumicë dhe pakicë në Kosovës; dhe (vi) sa është duke u avancuar ngritja e kuadrit të Kosovës, në institucionet komunale për të krijuar dhe ruajtur kushtet për të marrë kompetencat, kapitalin shoqëror huazues dhe pajtimin e të gjithë qytetarëve të Kosovës (shif Shtojcën II, Udhëzimi nga intervistat për vlerësimin e institucioneve lokale).

UNMIK-u dhe Strukturat e Përkohshme të Përbashkëta Administrative

Që nga themelimi i UNMIK-ut më 13 qershor 1999, me mandat për të shërbyer si administratë e përkohshme në Kosovë, duke pritur një zgjidhje përfundimtare, qëllimi i tij është të sigurojë një administratë të përkohshme, duke organizuar dhe mbikëqyrur zhvillimin e institucioneve të përkohshme për vetqeverisje autonome dhe demokratike përfshirë edhe mbajtjen e zgjedhjeve.

Në fillim, sfida kryesore e UNMIK-ut ishte që të vendosë se a do të përdorë një qasje direkte administrative apo do të përpiqet të veprojë përmes administratave të përkohshme komunale, shumica e të cilave ishin themeluar javët e para ndërmjet përfundimit të konfliktit dhe kohën kur u organizua UNMIK-u. Duke pasur parasysh kohën e shkurtër për tu përgatitur për të ushtruar rolin e tij, dhe njohuritë e pakta për çështjet komunale dhe aktivistët lokal, UNMIK-u u përcaktua për qasjen direkte, posaçërisht për sa u përket shërbimeve emergjente dhe administratën komunale. Megjithatë, në realitet shumica e administratorëve komunal të UNMIK-ut që arritën në verë të vitit 1999, për t'i ndërruar kryetarët e vetëshpallur të komunave, nuk kishin mjete (zyra, staf ose mjete materiale) dhe udhëzime të qarta nga qendra kryesore e UNMIK-ut në Prishtinë - dhe për tu vendosur, duhej mbështetur në ato kryetar të komunave dhe kosovarëve të tjerë në këtë rajon.

Gjashtë muaj më vonë, me njohjen e këtij realiteti, UNMIK-u themeloi Strukturat e Përkohshme të Përbashkëta Administrative që integruan elemente të administratës direkte të UNMIK-ut me një mbështetje në administratorët kosovar lokal dhe udhëheqësve komunal – edhe pse kryetarët e përkohshëm të komunave nuk ishin të pranuar nga politika e UNMIK-ut për ta vazhduar edhe më tej qëllimin e sistemit të bashkë-udhëheqjes, në mënyrë që të minimizohej ndikimi partiak politik dhe mostoleranca ndaj pakicave.⁵⁰

Administrativisht, sistemi i bashkëudhëheqjes formoi dy grupe: (i) ndërkombëtarët dhe disa kosovarë, shumica personel ndihmës në strukturat e UNMIK-ut ; dhe (ii) nëpunës civil kosovar përfshirë edhe udhëheqësit e rinjë të departamenteve, gjyqtarët dhe personelin e emëruar nga UNMIK-u. Personeli i këtyre dy grupeve ndonjëherë i ndanin zyrat edhe pse buxheti i UNMIK-ut vjen nga Asambleja e Përgjithshme e KB-së dhe nga pagesat për paqeruajtje, derisa nëpunësit civil paguheshin nga buxheti mjaft i kufizuar i vendit dhe donatorët direkt.

Në nivel qendror, SPPA janë organizuar në 20 departamente ku secili bashkëudhëhiqet nga një ndërkombëtarë dhe një kosovar. Kosovarët u zgjedhën përmes një procesi të vështirë negociatash me parti të përçara politike të cilat bëjnë rivalitet për të pasur ndikim në numrin dhe rëndësinë e departamentit të cilin do ta udhëheqin.

⁵⁰ ICG (1999g).

Në nivel komunal, Administrator komunal, i emëruar nga UNMIK-u, zgjodhi një këshill komunal inkluziv, e organizoi komunën në departamente dhe emëroi personelin komunal sipas kritereve etnike dhe përfshirjes gjinore. Administratori komunal gjithashtu emëroi bordin administrativ, të përbërë nga udhëheqësit e departamenteve dhe anëtarë tjerë që përmbushnin funksione administrative; i aprovonin të gjitha aktivitetet fitimprurëse; dhe, në pajtim me rregulloret në mbarë Kosovën aplikonin tatime dhe taksë për shërbime. Komunat siguronin dhe mbledhnin pak mjete, dhe nga sa thuhet merrnin vetëm 4 % nga buxheti i Kosovës.

Derisa fleksibiliteti i këtij sistemi ofronte mundësi për t'ju përgjegjur nevojave lokale, është konstatuar se bashkëpunimi dhe përcaktimet tjera të suksesit (shif lartë) ndryshojnë mjaft në pesë qendrat tjera, varësisht nga marrëdhëniet që u vendosën në mes të UNMIK-ut dhe zyrtarëve lokal. Si rezultat, sistemet lokale u zhvilluan në mënyra të ndryshme gjatë periudhës së mëvonshme duke inkorporuar mbetjet e sistemit të centralizuar apo paralel (1989-1999) në shkallë të ndryshme, me implikime në kapacitetin e tyre për vetqeverisje të plotë. Ndikimi i përkrahjes së UNMIK-ut për institucione inkluzive jozyrtare dhe grupet e shoqërisë civile, siç është sqaruar në pjesën e dytë të këtij kapitulli, ka ndryshuar në bazë të rrethanave lokale.

Strukturat e përbashkëta të përkohshme administrative: zbulimet nga vlerësimi i vendeve

Prishtinë

Prishtina, kryeqyteti i Kosovës, karakterizohet nga një infrastrukturë jashtëzakonisht e varfër; ndërtim i pakontrolluar dhe i kualitetit të dobët; shtëpi të pasura nëpër kodra; shtëpi më të varfëra në sektorin e zgjëruar komercial, koncentrim të madh të zyrave ndërkombëtare (përfshirë edhe 300 OJQ), zhvillim të pakontrolluar në qendrën urbane; shumica e mallërave janë të importuara, përfshirë edhe ushqimin bazë; varfëri e madhe publike,⁵¹ dhe një klimë e pasigurisë personale. Gjithashtu, ka pasur dëshmi për mundim të fëmijëve dhe për pushim nga puna për një segment relativisht të vogël të popullatës.

Statusi/bashkëpunimi. Sistemi i bashkëudhëheqjes esencialisht ishte në rregull në Prishtinë por, marrëdhëniet ndërmjet UNMIK-ut dhe zyrtarëve lokal nuk ishin ideale, dhe udhëheqësia lokale vazhdimisht testonte fuqinë e sistemit të “imponuar nga UNMIK-u” dhe duke e kritikuar për shërbime të dobëta, për vendosjen në zgjedhjen e kandidatëve për aftësimin e policisë dhe për ndërhyrjen në mënyra tjera në autonominë e komunave. Në të njëjtën kohë, udhëheqësia lokale pak ka kontribuar në zgjidhjen e problemeve komunale.

Efikasiteti/efektiviteti. Derisa udhëheqësit e departamenteve kishin pak aftësi profesionale në fushat përkatëse të përgjegjësisë,⁵² ata që nuk i përkisnin këtij bordi udhëheqës siç duket nuk janë shfrytëzuar shumë. Ekipi vlerësues nuk zbuloi dëshmi për përgatitjen e projektpropozimeve nga ana e departamenteve të ndryshme për t'ia parashtruar UNMIK-ut. Përkundrazi, zyrtarët komunal nuk kishin aftësi për t'i caktuar prioritet apo për t'i kontrolluar aktivitetet siç janë krimet dhe ndërtimi pa leje. Në fakt, gara institucionale në mes të partnerëve bashkëudhëheqës krijoi një gjendje pa rrugëdalje që rezultoi në mes tjerash në zhvillim të pakontrolluar urban dhe kriminalitet. UNMIK-u është kritikuar shumë për mosefikasitet kundër krimin, por zyrtarët thoshin se ishte e “pamundur” të ndalin ndërtimin për shkak të mungesës së gjykatave, dhe as të ndalin marrjen me forcë të banesave nëpër qytet nga krimi i organizuar. Komunave gjithashtu u mungonte mandati ligjor për të vënë tarifa dhe taksa lokale apo të shpërndajë resurse, që rezultoi me shërbime të dobëta dhe vonesë për pagesat e të punësuarve komunal – një situatë që nxiti korrupsionin dhe detyroi shumicën e nëpunësve civil, përfshirë edhe

⁵¹ Varfëria publike është koncept që shpreh mungesën e kohezionit në shoqëri. Karakterizohet me ngecje të hapsirës publike dhe dëshmi të tjera për mungesën e kujdesit për kualitetin e jetës jashtë shtëpisë.

⁵² Një problem i përgjithshëm në pesë qendrat ishte aftësimi profesionale i tejmoduar për shkak të pamundësive të njerëzve që t'i nënshtrohen trainimit aktual qoftë në universitete dhe institute aftësimi apo përmes udhëtimeve në botën e jashtme. Përdorimi i termit “aftësi teknike” dhe “aftësi profesionale” të përdorura në këtë raport e shqyrtojnë këtë problem.

arsimtarët të kërkojnë punë shtesë në organizatat ndërkombëtare.⁵³ Përveç kësaj, zbatimi i ligjit në nivel lokal ishte jashtëzakonisht i kufizuar nga faktorët e jashtëm siç ishin mungesa e policisë ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, u kritikuan OJQ-të për shkak se kërkonin leje për aktivitetet e tyre nga UNMIK-u e jo nga bordi kryesues.

Legjitimiteti/perspektivat. Nuk janë zbuluar dëshmi se kanë vazhduar të funksionojnë bashkësitë lokale (këshillat në nivel të komunitetit që ekzistonin në sistemin komunist). Në vend të kësaj, janë gjetur dëshmi për kontrollimin në kanale partiake, për të pasur qasje në këto shërbime përfshirë edhe informatat p.sh. se cila shkollë çfarë programi ofron në ndrrimet e dyfishta të saj. Prishtina gjithashtu ka pasur rrjet të pjesshëm ndihmës të diferencuar në baza partiake që punojnë me personat e zhvendosur përbrenda (IDP), edhe pse shumica e ndihmës për popullatën pakicë u sigurua nga UNMIK-u, OJQ-të ndërkombëtare dhe KFOR-i i cili u desht të tregojë forcën që fëmijët e Romëve të pranohen në shkollat komunale. Sa i përket çështjes së krimit dhe sigurisë pjesëmarrësit e grupit të shqyrtuar, kritikuan UNMIK-un përse ka qenë shumë pasiv duke "provokuar meshkujt e rinjë kosovar" që të sillen qoftë si kriminel apo t'i mbrojnë vet familjet e tyre.

Në përgjithësi, perspektiva e vetqeverisjes komunale në kryeqytet dukej më pak se premtuese në një afat të shkurtër, edhe pse zhvillimi institucional dhe reformat e inicuar nga administratori i UNMIK-ut për të rritur përgjegjësinë dhe transparencën në Universitetin e Prishtinës mund të shërbenin si model për përmirësimin e qeverisjes komunale.

Gjilan

Gjilani u karakterizua nga ndarja fizike e pakicës serbe; prezenca e militarëve rreth kishës orthodokse me shkallë të lartë të tensioneve dhe kontrollime të sigurisë; shtëpi të djegura dhe me pak dëshmi për ndërtimin e shtëpive të reja; infrastrukturë rrugore e mirë; dhe objekte të paprekuara tregtare të zhgarravitur me mbishkrime.

Statusi/bashkëpunimi. Gjilani është një nga regjionet ku sistemi i bashkëqeverisjes më pak i kompletuar, për shkak të refuzimit të serbëve që t'i zgjedhin reprezentuesit e tyre nëpër këshillat komunale.⁵⁴ Ky refuzim u bazua në faktin se shumica e serbëve u larguan nga qyteti pas përfundimit të konfliktit duke e zvogëluar numrin prej 50 % në 2 % të popullatës; dhe në insistimin e tyre që pozitën në këshill dhe bashkëudhëheqësi të departamenteve të bazohen në numrin e popullatës së tyre para se të ndodhin këto rënie. Serbët gjithashtu dëshironin që UNMIK-u ta përhrasë kthimin e një proporcioni të përafërt me numrin e serbëve etnik të zhvendosur përbrenda vendit. Ata gjithashtu ishin të shqetësuar për sigurinë si pasojë e vazhdimit të akteve të dhunës dhe të geto izolimit në zona të veçuara të qytetit ku tani jetojnë pjesa e mbetur e serbëve në Gjilan. Si pasojë, UNMIK-u ende udhëheq në mënyrë direkte çështjet komunale.

Efikasiteti/efektiviteti.

Gjilani ishte zyra e vetme regjionale e UNMIK-ut ku për shkak të dhunës së vazhdueshme ndaj serbëve ka munguar efektiviteti i bashkëudhëheqjes. Në të vërtetë, problemi i sigurisë rezultoi kur UNMIK-u krijoi sistemin paralel për shërbimet themelore komunale – njëri ku përfshiheshin shkollat, klinikat, posta të përdorur kryesisht nga shqiptarët etnik; dhe tjetri i përbërë nga disa shërbime të përziera që drejtpërdrejt u siguroheshin pakicave serbe dhe rome dhe të plotësuara me disa shërbime tjera bazë që këto grupe i siguronin për vehte. Shembuj të shërbimeve të UNMIK-ut që u sigurohen drejtpërdrejt serbëve dhe romëve janë edhe operacionet e shërbimit të ambulancave UNMIK-ut dhe klinika në kompleksin e kishës orthodokse, dhe autobusi i UNMIK-ut dhe shërbimet e mbrojtjes së armatosur për funeralet që nisen prej kishës për në varreza. Derisa mendohet se sistemi paralel ka qenë i nevojshëm, ku sistem pakicave serbe dhe rome u siguroi më pak se shërbimet optimale. P.sh. Fëmijët serb prej fshatërave nuk mund të vijonin shkollimin e mesëm në qytet dhe shpesh orët mbaheshin në

⁵³ Dallimet në pagesa nga organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të në raport me pagesat lokale janë siaps rendit 10-50 ndaj 1. Shif Morozzo Della Rocca (2000).

⁵⁴ Në prill të vitit 2000, Këshilli nacional serb vendosi ta pezullojë bojkotimin në sistemin e bashkëudhëheqjes dhe të marrin pjesë si vëzhgues për tre muaj.

tenda dhe shtëpi private. Përveç kësaj, ky sistem nuk krijoi shumë aktivitete ekonomike dhe vazhdoi me ndarjen e pakicave.

Problemi i sigurisë goditi edhe popullatën shumicë shqiptare posaçërisht gratë e reja të cilat vazhdimisht ishin në rrezik që të kidnapohen dhe të dërgohen në Evropë për eksploatim seksual.⁵⁵ Dhuna e motivuar politike dhe ekonomike përfshirë edhe djegien e shtëpive, kërcënimet dhe vrasjet gjithashtu u kërcnoshin nëpunësve civil siç janë gjyqtarët dhe mjekët që punojnë për UNMIK-un dhe disa simpatizuesve të LDK-së

Legjiti miteti/perspektivat. Sistemi i pakompletuar institucional i bashkëudhëheqjes nuk ishte inkluziv. Megjithatë, sistemi paralel i shërbimeve përqipëj të siguronte qasje në shërbimet qeveritare lokale për të gjitha grupet e popullatës, derisa UNMIK-u provonte të krijojë kushtet për një përfshirje më të gjërë. Në ndërkohë, zhvendosjet serbe prej qytetit në fshat rezultuan me enklava të izoluar serbe në fshatëra, kurse zhvendosja e shqiptarëve prej fshatit në qytet shkaktoi nevojën për strehim dhe mundësi më të mëdha ekonomike. Të dy grupet ishin të varura nga prezenca ndërkombëtare për sigurinë dhe shërbimet. Në të njëjtën kohë, numri i shtresës së mesme dhe inteligjencës së Gjilanit u zvogëlua, duke i kontribuar pesimizmit të UNMIK-ut për perspektivën e së ardhmes së afërt.

Prizreni

Prizreni u karakterizua me shkatërrime të pakta të qytetit por shkatërrime më të mëdha në viset fshatare; dyndje të IDP-ve që e dyfishuan popullatën e qytetit; fabrika jashtë përdorimit; shërbime themelore joadekuate; ndërtime të shumta pa leje; degradim të mjedisit ku monumentet historike janë në rrezik; infrastrukturë të dobët; ndërtesa komunale të prishura; një qendër e gjallë e qytetit; dhe disa qendra të mbrojtura mirë tregtare.

Statusi/bashkëpunimi. Sistemi i bashkëudhëheqjes ishte i pakompletuar pas shkarkimit të kryetarit të këshillit komunal – ish kryetari i përkohshëm i komunës, i cili nuk dëshironte të punonte me UNMIK-un. Një ish komandant i lartë i UÇK-së ka shërbyer një kohë si drejtor komunal për çështje të mjedisit dhe punoi për të promovuar përfshirjen serbe, por toleranca dështoi në fillim të pranverës së vitit 2000 kur ai u vra për arsye politike. Dobësia e institucioneve qeveritare lokale ishte evidente në mardhëniet në mes të komunës dhe UNMIK-ut, në shërbimet që i inicone UNMIK-u, siç janë ruajtja e monumenteve historike dhe mbledhja e hedhurinave në qendër të qytetit.

Efikasiteti/efektiviteti. Edhe pse mbajnë përgjegjësi për moskompletim, sistemi i bashkëudhëheqjes ka funksionuar në një nivel shumë të ulët për shkak të kualitetit të dobët të fuqisë punëtore komunale me aftësi profesionale të tejkaluara dhe mungesës së profesionistëve përbrenda dhe jashtë Kosovës; largimi i inteligjencës nga Prizreni në kryeqytet; dhe mbikqyrja në punët komunale. Përveç kësaj, shumë të emëruar komunal kundërshtonin që të pranojnë ndihmë teknike nga UNMIK-u për aktivitete siç janë ruajtja e monumenteve historike. Zyrtarët komunal gjithashtu kanë kërkuar mito prej atyre që paraqiteshin për leje ndërtimi.

Punët kryeshin më mirë në lëmin e arsimit, ku qyteti kishte riparuar shumicën e 48 shkollave me 28,000 nxënës. 30 % e nxënësve ishin sllav musliman dhe 8 % turq.

Legjitimiteti/perspektivat. Shtresa profesionalisht e arsimuar e Prizrenit, zejtaria dhe artizanatet, dhe historia e tij si një qendër tregtare regjionale, i dhanë atij një vitalitet ekonomik dhe një traditë në diversitetin etnik dhe tolerancë mbi të cilën ka mundur të ndërtohet sistemi i bashkëudhëheqjes. Megjithatë, aktivitetet e shtuara ilegale ndërkufitare me Shqipërinë e minojnë legjitimitetin e sistemit të përbashkët.⁵⁶ Dramat e kidnapimit të vajzave nëpër fshatëra të cilat duhej të liroheshin nga forcat ndërkombëtare, edhe më shumë e rritnin shqetësimin.

⁵⁵ Derisa prostitucioni është në rritje e sipër në Gjilan, siç duket femrat e reja nga shtetet e Evropës Lindore merren me prostitucion kurse femrat e reja shqiptare me forcë dërgohen në Evropë. Shif Strazzari dhe Dognini (2000) në një përmbledhje për të dhënat për shtypin për këtë problem.

⁵⁶ Morozza Della Rocca (2000).

Prizreni kishte ende pakica të shumta në numra dhe proporcione më të mëdha se sa në viset tjera të Kosovës. Por, dhuna dhe kërcënimet i detyruan sllavët musliman dhe turqit të largohen gjatë vjeshtës dhe dimrit. Ka pasur indikacione për largimin e katolikëve të paktë. Përveç kësaj, goranët përjetuan përjashtime të mëdha ekonomike, shoqërore dhe politike dhe kërcënime, dhe të gjitha këto kontribuan në migrimin e vazhdueshëm jashtë. Gjithashtu, ka pasur përpjekje direkte për të kufizuar përfshirjen e tyre në qeverisjen lokale përmes akteve të dhunshme të motivuara politikisht, duke përfshirë edhe vrasje të shumta të zyrtarëve të UÇK-së, siç u përmend më lartë. Kështu, kultura multi-etnike e qytetit dhe regjionit ishte në rrezik.

Malisheva

Malisheva karakterizohet me fshatëra rurale jashtëzakonisht të vogla dhe të pazhvilluara; ekspozim të madh të flamurit shqiptarë; mosegzistim të infrastrukturës rrugore; pajisje elektrike joadekuate; shkatërrime të mëdha të shtëpive; vetçkurorizim të burrave dhe grave; kufizim të disponueshmërisë të mallërave themelore tregtare; konsum të kufizuar; dhe varfëri të madhe.

Statusi/bashkëpunimi. Malisheva ende nuk ishte njohur si komunë zyrtare kështu që nuk kishte strukturë komunale zyrtare. Në vend të kësaj, implementimi i sistemit të bashkëudhëheqjes nga ana e UNMIK-ut synonte të zyrtarizojë strukturën institucionale paralele të krijuar nga shqiptarët kosovar pasi Beogradi në vitin 1991 45 fshatërat i shpërndau nëpër katër komunat tjera. Natyra paralele e këtij sistemi institucional ende ishte prezent meqë UNMIK-u nuk kishte buxhet për një lokal zyrtar në Malishevë, dhe administratori i saj komunal udhëtonte nga Prizreni. Megjithatë, marrdhëniet në mes të UNMIK-ut dhe zyrtarëve lokal ishin të afërta, dhe UNMIK-u lejoi udhëheqsit fshatarë që t'i tatonjë aktivitetet tregtare për të financuar shërbimet lokale. Kjo nënkuptonte se udhëheqja lokale në të vërtetë kishte më tepër liri për vetqeverisje. Meqenëse Malisheva ka qenë bastion i UÇK-së gjatë konfliktit, nuk është për tu befasuar se ish luftëtarët e UÇK-së kanë udhëhequr institucionet paralele gjatë periudhës së bashkëudhëheqjes.

Efikasiteti/efektiviteti. Varfërisë së këtij regjioni i kontribuoi edhe shkatërrimi i tmerrshëm që e përjetoi ky vend pas konfliktit, dhe mungesa e mjeteve për rindërtim, krahasuar me vise të tjera për shkak të situatës së përzier institucionale. Shumica e OJQ-ve siç duket nuk angazhoheshin për shkak të mungesës së mjeteve. Në fakt, mungesa relative e OJQ-ve në Malishevë tregoi aftësinë e kufizuar të UNMIK-ut për të drejtuar mjetet e ndihmës së huaj për këtë regjion, përfshirë këtu edhe materialin ndërtimor për ndërtimin e shtëpive. Zyrtarët lokal, shumica e të cilëve ishin ish luftëtarë – disa me diploma fakulteti- kishin një vizion të qartë për zhvillimin e regjionit, edhe pse nga aspekti kohor dhe resurset e parashikuara, kjo dukej joreale. Vizionet e tyre kanë pasur ndikim të thuktë në planet e UNMIK-ut për rindërtim, që përfshinte forcimin e bujqësisë dhe promovimin e turizmit që lidhej me ekzistimin e shpellave, banjave dhe ujëvareve. Megjithatë, ishte vështirë për ekipin të vlerësojë ndikimin operacional të administratës lokale për shkak të kushteve mbizotëruese të mungesës së mjeteve dhe pazhvillueshmërisë.

Legjitimiteti/perspektivat. Pasi Malisheva të fitojë sërish statusin e komunës do të ketë më tepër qasje në resurset ndërkombëtare. Në ndërkohë, administrata lokale është përqëndruar në organizimin politik dhe në dhënien e mbështetjes për krijimin e grupeve të reja operationale përbrenda këtij regjioni rural dhe kësaj shoqërie tradicionale. Një shembull i dalluar ishte shoqata e grave e themeluar në janar të vitit 1999 nga tri gra lokale të afërta me administratën dhe të cilat vepronin jashtë ndërtesës të dhuruar nga zyrtarët lokal dhe të riparuar me resurset publike. Kjo shoqatë aftësonte gra të reja fshatare dhe vejane për rrobaqepësi dhe u siguroi këshilla mjekësore grave shtatëzëna. Derisa kjo qasje jetike ishte e shkëlqyeshme, nuk dihet se sa ka qenë e përfshirë administrata lokale në përbushjen e aktiviteteve tjera të saj.

Peja

Peja karakterizohet me shkatërrime të mëdha dhe dhe rindërtim të qytetit; infrastrukturë relativisht të mirë; shumë ndërtesa të mëdha të reja; pak ndërtesa të mbetura historike; shtëpi të shumta private mjaft të qëndrueshme; një hapsirë e madhe tregtare në qendër; dhe indikatorë i konsumit të vazhdueshëm.

Statusi/bashkëpunimi. Struktura e bashkëudhëheqjes ka qenë complete, dhe ka dëshmi të qarta mbi punë më të mirë të departamenteve se në vendet tjera, përkundër faktit se Peja përjetoi shkatërrimet më të mëdha gjatë konfliktit për shkak të numrit të madh popullatës shqiptare etnike, prezencës së manastireve të mëdha orthodoxe dhe kufiri me Malin e Zi, prej nga vinte ndihma për ushtrinë jugosllave. Marrëdhëniet në mes të UNMIK-ut dhe zyrtarëve lokal u zhvilluan me hapa të ngadalshëm pas një fillimi të kujdesshëm me zvogëlimin e traumave psikologjike nga konflikti. Gjatë mbledhjeve të para me përfaqësuesit e UNMIK-ut ka pasur mjaft pozim/fryemje nga zyrtarët komunal, duke përfshirë edhe ekspozimin e armëve, dhe një mosbesim të qartë ndaj komunitetit ndërkombëtarë dhe mandatit për qeverisje. Qasja e zyrës regjionale duke mos iu përgjegjur një sjellje të tillë, dhe duke përcjellur porosinë se dëshiron marrëdhënie profesionale, siç duket ka pasur mjaft sukses. Marrëdhëniet filluan të karakterizohen me besim dhe ndjenjën e pragmatizmit. Këtyre marrëdhënieve u kontribuonte mungesa e pakicave.

Efektiviteti/efikasiteti. Departamentet komunale kishin punësuar personel profesional; mirë të aftësuar, disa prej të cilëve kishin studiuar jashtë. Kur përfundoi periudha e emergjencës, departamentet punonin në mënyrë të koordinuar në projektet e rikonstruktimit. Përmes një komisioni ndërdepartamental (i ndarë në seksione) dhe i themeluar nga administratori komunal. Detyra më urgjente ishte rindërtimi, kështu që një grup i vogël por i mirë i arkitektëve punuan në këtë plan të qytetit të ndihmuar nga një ekip i përkohshëm i arkitektëve nga Barcelona. OJQ-të që ndihmonin në rindërtimin e ndërtesave të mbetura private – vlerësuar se 70 % nga shuma e përgjithshme, janë udhëzuar të kërkojnë dëshmimin për pronësi dhe leje për ndërtim nga komuna. Dy arkitektë nga UNMIK-u kanë punuar me profesionistët komunal në planet për ndërtimin e shtëpive mirëpo për këtë qëllim nevojiteshin më tepër sish. Gjithashtu, ka pasur nevojë për specialist për ruajtjen e monumenteve historike në tregun e vjetër i cili ishte i shkatërruar. Një shembull tjetër i marrëdhënieve me UNMIK-un ishte dorëzimi i kërkesave administratorit të aftësuar ligjor të UNMIK-ut nga planifikuesit komunal, për të aprovuar eksproprijimin e pasurisë kur ajo kërkohej sipas planeve të rindërtimit.

Përveç rindërtimit të ndërtesave private, UNMIK-u është përqëndruar gjithashtu në probleme më të rënda të infrastrukturës së lagjeve, duke filluar nga rrugët deri në hapësirat e gjelbëruara. Vendimi për ta përtërirë planin e qytetit të vitit 1963 ishin në harmoni me këtë, por pengesat ishin të mëdha. Disa ishin teknike, siç ishte vështirësia për gjetjen e domukenteve mbi pronësinë që serbët i kishin dërguar në Patriarki. Ky plan gjithashtu është ballafaquar me kundërshtime nga interesi privat, dhe i nevojës për një shfrytëzim më të madh të resurseve të mëdha nga shtetet kryesore donatore. Derisa regjioni i Pejës kishte një rrjet të zgjëruar të OJQ-ve dhe merrte më shumë mjete nga donatorët se sa viset tjera, detyrim i njejtë financiar nuk është siguruar në të ardhmen.

Lidhur me çështjen e rindërtimit rural, sistemi i bashkëudhëheqjes themeloi një drejtori për zhvillimin rural, për të biseduar me donatorët për mënyrat e zhvillimit për të lehtësuar këthimin e IDP-ve në fshatërat përreth, me krijimin e mundësive të punësimit. Në arsim, UNMIK-u luajti rol udhëheqës në integrimin e numrit të vogël të fëmijëve romë nëpër shkolla. Është treguar se integrimi i fëmijëve të pakicave të sllavëve muslimanëve ka qenë i suksesshëm, dhe numri i tyre vlerësohet prej 1 deri 2 %. Nga 120 shkollat që ishin krejtësisht të demoluara, 20 u rindërtuan edhe pse flitet për një rindërtim të kualitetit të dobët. Gjithashtu, vëmendje u është kushtuar planprogrameve të reja duke përmirësuar trainimit e arsimtarëve.

Sa i përket çështjes së sigurisë, dihet se ka pasur dhunë ndëretnike dhe të brendshme për shkak të konfliktit të interesave në mesin e grupeve tradicionale familjare, të cilat janë ende të fuqishme në viset malore të Kosovës. Ka pasur shumë njerëz përgjegjës të ish UÇK-së që veprojnë si polic në qytet posaçërisht natën. Gjithashtu, është folur për shumë kërcënime dhe kanosje, duke përfshirë edhe ato në gjykata, nga njerëz që dihet se kanë qenë në UÇK. Si në Prishtinë dhe Ferizaj, ata kanë pretenduar të mbledhin tatime nga biznesi dhe u janë kërcënuar personave afarist dhe zyrtarëve gjyqësor. Pakënaqësia i'u shpreh në mënyrë të kujdesshme por të qartë ekipit studiues edhe pse denoncim të hapur nuk pati. Ka pasur shpjegime të shumta të konfirmuara nga UNMIK-u të aktiviteteve të kimit të

organizuar, përfshirë tregtinë në kufi dhe kontrabandim që tërhoqën vëmendjen e shtypit ndërkombëtarë.⁵⁷

Legjitimiteti/perspektiva. Peja, për çudi, ende kishte institucione të vjetra për ndërmjetësim si *bashkësi lokale*, 12 prej të cilave vepronin në lagjet e qytetit, dhe 16 tjera në 91 fshatërat e komunës. Më aktive siç duket ishin në fshatra, ku siguronin shërbime direkte siç janë dokumentacion dhe regjistrim të popullatës. *Bashkësitë lokale* ishin të vendosura në zyrat komunale dhe pagat e stafit të tyre të vogël i siguronte UNMIK-u.

Studimi i rastit të kapitalit shoqëror në dy vende.

Për të bërë kërkime më të thella të efekteve të kapitalit kufizues dhe huazues në Kosovë, ekipi vlerësues realizoi studime të shkurtëra rasti në dy qytete: Pejë ku kapitali shoqëror kufizues mund të kufizojë zhvillimin e një shoqërie të fortë civile (Ndarja 1); dhe Prizren, ku organizatat e shoqërisë civile me mbështetjen e UNMIK-ut janë duke e fuqizuar kapitalin shoqëror huazues të qytetit nëpër komunitete. (Ndarja 2).

Ndarja 1. Kapitali shoqëror kufizues dhe shoqëria civile në Pejë

Peja është një qytet i vjetër tregtar i Ballkanit dhe qendër afariste e pozicionuar në kalimet këmbësore të kodrave të pyjeve që kufizohet me Malin e Zi. Që nga mesjeta ka pasur një kulturë serbe, shqiptare dhe turke me shumë kisha, xhamia dhe një nga manastiret më të rëndësishme të kishës orthodoxe serbe. Qendra e vjetër e qytetit, në veçanti rrugët e pazarit të vjetër, kanë qenë gati krejtësisht të djegur gjatë luftës, dhe tani qyteti është ekskluzivisht i përbërë nga shqiptarët pa serb dhe një numër i vogël i romëve.

Ekonomia e Pejës ndodhet në duart e pesë familjeve të pasura dhe të fuqishme ku secila paraqet një gjak. Këto familje bëjnë gara me njëra tjetrën edhe nga aspekti komercial dhe shoqëror dhe, shpesh e përdorin pasurinë e tyre për qëllime filantropike. P.sh.

- Një familje është pronare e një shtëpie botuese dhe një stacioni televiziv dhe të radios. Gjatë sistemit paralel, familja shtypte dhe shpërndante libra shkollor shqip dhe punësoi më tepër njerëz se sa që nevojitej. Së voni, familja organizoi dhe pagoi heqjen e hedhurinave buzë rrugëve dhe organizoi një radio-kampanjë për vetëdijësimin e mjedisit.
- Një familje tjetër është pronare e fabrikës së pajisjeve shtëpiake dhe nën bashkëudhëheqje, një anëtarë ishte drejtor i sistemit të elektroenergjisë për Pejë.
- Një familje tjetër, ish tregtarë të frutave, tani është pronare e fabrikës së lëngjeve në Shqipëri, tri fabrika të ndryshme afër Pejës, një fabrikë për përpunimin e ushqimit me një partner shqiptar nga Kroacia dhe, një kompleks të qendrës tregtare në qendër të qytetit ku e ka edhe restorantin e vet. Ndërmjet viteve 1985 dhe 1990 rreth 350 meshkuj farefis prej kësaj familje drejtonin 650 supermarkete në Kosovë dhe punësuan 7,500 punëtorë. Gjatë konfliktit, ata shpërndanin qumësht nëpër të gjitha shkollat komunale me çmim të fabrikës. Ata gjithashtu kanë qenë ndërmjetësues të konflikteve brenda vendit, dhe u siguronin zyra OJQ-ve lokale.

- Dy familjet tjera janë më pak aktive në aspektin shoqëror; njëra është pronare e fabrikës së sfungjerave dhe tjetra ka ekonomi të mëdha të pasurisë së patundshme, dhe OSBE-së i ka dhënë me qira një objekt të tillë.

Përkundër këtyre aktiviteteve filantropike, disa banorë të qytetit këto familje i shikojnë si të luhatshme për shkak të kontrollit të ngjeshur që ushtrojnë në ekonominë e qytetit. Të tjerët hamenden se si pasuria e tyre iu shpëtoi shkatërrimeve gjatë luftës. Gjithashtu, ekziston dyshimi se disa anëtarë të këtyre familjeve janë involvuar në krime të organizuara. Kapitali shoqëror kufizues që posedojnë këto familje, mund të limitojë mundësitë për zhvillimin e një shoqërie të fortë civile - edhe pse anëtarët më përparimtarë prej disa familjeve të tilla gjithashtu mund të paraqesin mundësi për transformimin e kapitalit shoqëror kufizues në kapital shoqëror huazues, duke ju dhënë mbështetje grupeve të shoqërisë civile që punojnë për ndryshime shoqërore.

Peja deri tani ka një zhvillim relativisht modest sa u përket këtyre grupeve të cilët përgjithsisht dështuan që të zhvillohen, edhe përkundër traditës relativisht të fortë të stabilitetit politik dhe administratës profesionale me pak ndryshime të të punësuarit komunal. Prej 36 grupeve të shoqërive civile që ekzistuan në Pejë nga prilli i vitit 2000 vetëm pak prej tyre janë aktive. Njëra prej atyre më aktive është një grup i grave që ekziston që nga viti 1989 e cila është e bashkuar me LDK-në. Ky grup u ndihmon grave të fshatit që t'i ekspozojnë zëjet e tyre dhe u ndihmon grave të cilave u janë zhdukur anëtarët e familjes. Prej dy shoqatave mbi të drejtat e njeriut, njëra ekziston që nga viti 1991 dhe tani i është përkushtuar zbulimit të krimeve të luftës. Aktive gjithashtu kanë qenë edhe dy shoqata të pakicave – njëra OJQ e sllavëve muslimanë dhe tjetra është shoqatë e romëve. Që të dyja janë duke u përkrahur nga komuniteti ndërkombëtarë, në ndihmën ofruar familjeve të pakicave që të kalojnë prej familjeve që ndihmohen me ndihma humanitare, në famile me sigurim të mjeteve nga puna. Prezenca e madhe e OJQ-ve ndërkombëtare në Pejë është e ngjashme me viset tjera të Kosovës, shpatë me dy teha; ata sigurojnë ndihmën më se të nevojshme por janë duke penguar zhvillimin e grupeve lokale.

Ndarja 2. Kapitali shoqëror huazues dhe sistemi i bashkëudhëheqjes në Prizren

Prizreni është një qytet tregtar mesjetar pitoresk i njohur për artizanate, punë metalike dhe të lëkurës. Tradicionalisht ka qenë një nga qytetet me kultura me prejardhje etnike prej më të ndryshmeve në Kosovë, me shumë ndërtesa historike, 28 xhamia, 9 kisha orthodoxe serbe, 5 kisha katolike, kala antike, hamame turke dhe hane të vjetra, vende ku kanë qëndruar karavanet osmane tregtare gjatë natës. Prizreni ishte vend i rilindjes shqiptare me shkollën e pare në gjuhën shqipe dhe njërën prej shkollave të para të vajzave shqiptare. Pavarësisht nga kjo është ruajtur një shkallë relativisht e lartë e tolerancës multietnike.

Fryma e tolerances në qytet dominonte kryesisht për shkak të shtresës intelektuale dhe shoqatave profesionale (arsimtarët dhe mjekët), të cilët luajtën një rol të rëndësishëm gjatë periudhës të sistemit paralel. Në të njëjtën kohë, shumica e këtyre shoqatave përfshinin popullatë joshqiptare me përjashtim të serbëve. Konflikti dhe migrimi i jashtëm i viteve të 90-ta dukshëm e zvogëloi dallimin në baza etnike për krijimin e shoqatave dhe shumica e shoqatave ishin më pak të gatshme për bashkëpunim ndëretnik se sa në dekadat e mëparshme, Tani, për kundër moskompletimit të sistemit të bashkëudhëheqjes, shumica e këtyre shoqatave dhe grupeve tjera të shoqërisë civile kanë kompenzuar punën e administratës komunale. P.sh. ka ekzistuar shkallë e lartë e bashkëpunimit me UNMIK-un për çështje të arsimit në 9 shkolla filllore (prej gjithsej 39) dhe në 5 shkolla të mesme (prej gjithsej 5) ku mësimi mbahej në disa gjuhë.

Përveç kësaj, përpjekjet e UNMIK-ut për të promovuar shoqatat e tilla të orientuara kah interesi publik u kurorëzuan me sukses të dalluar. Më 8 mars të vitit 2000, Qendra e resurseve të OJQ-së në OSBE hapi një zyrë qendrore në Prizren në afërsi të Internet Kafes së IOM-it dhe Shtëpisë së kulturës. Qëllimi primar i qendrës është që të ndihmojë në rindërtimin e marrëdhënieve ndëretnike në komunitetet shumicë dhe pakicë të Prizrenit, duke siguruar ndihmë profesionale, ndihmë në pajisje dhe vende takimi për OJQ-të e reja kulturore dhe shërbyese. Kjo qendër gjithashtu ka inkurajuar regjistrimin e OJQ-ve lokale që i

plotësojnë standardet etike dhe operacionale të UNMIK-ut. Që nga prilli i vitit 2000 regjistrimi i OJQ-ve të popullatës shumicë (shqiptare) dhe pakicave (muslimanët, turqit, romët) në komunën e Prizrenit numrojnë 62 organizata: 7 të grave, 2 të fëmijëve, 3 të rinisë, 14 kulturore, 12 humanitare, 9 për rindërtim dhe zhvillim ekonomik, 2 për mbrojtjen e lirisë fetare, 2 për mjedisin dhe 11 organizata profesionale. Gjatë kohës së vlerësimit, 34 e këtyre grupeve kishin dorëzuar dokumentacionin për regjistrim zyrtar si OJQ; 7 të tjera theksuan se kanë pasur për qëllim t'i kompletojnë këto dokumente së shpejti; njëra ka qenë e regjistruar në tërësi, ndërsa të tjerat nuk kishin inicuar këtë proces.

Me rendësi të posaçme është shfaqja e shoqatave për zhvillim ekonomik, të cilat janë duke zëvendësuar rrjetet e bazuara në familje brenda komuniteteve tregtare dhe zejtare të qytetit. Mbështetja e UNMIK-ut dhënë këtyre OJQ-ve lokale rezultoi me krijimin e Odës së pare ekonomike në Kosovë. UNMIK-u i ka siguruar kësaj organizate ndihmë teknike që të mund t'ju ofrojë anëtarëve udhëheqës aftësim dhe programe për planifikim financiar. Shfaqja e sindikatave të pavarura, klubeve të sipërmarrësve dhe e një forumi qytetar mbi çështje zhvillimore që premtim krijimin e kapitalit shoqëror huazues dhe zhvillim ekonomik.

Gjithashtu, UNMIK-u ka bërë përpjekje të posaçme për të promovuar organizatat e grave. Një propozim parashihte organizimin e grupeve të grave për të restauruar një hamam turk, në muze me hapësirë për aktivitete zejtare. UNMIK-u dhe komuniteti ndërkombëtar gjithashtu ka mbështetur bashkëpunimin ndëretnik në mesin e rinisë duke investuar në objekte rekreative dhe sportive.

Institucionet jozyrtare

Këtu do të vazhdojmë të analizojmë se si institucionet lokale krijojnë kushte për marrjen e autorizimeve, kapitalit shoqëror huazues, pajtimin dhe demokratizimin. Kjo pjesë është përqëndruar në ndryshimet që u paraqitën në institucionet jozyrtare të Kosovës - organizatat e shoqërisë civile, këshillat e fshatit dhe sistemet familjare - gjatë viteve të 90-ta. Pjesa e parë e analizës merret me grupet e shoqërisë civile. Këto grupe i përshkruan nga aspekti i orientimit të tyre (në bazë të vendit, identitetit dhe çështjes me orientim kah interesi publik, në bazë të çështjes me orientim kah vetinteresi); llojit të kapitalit shoqëror që e promovon secili; dhe ndikimi i i prezencës ndërkombëtare në këto grupe. Pastaj, përqëndrohemi në një analizë më të thellë sipas parimit të grupit në bazë të vendit, familjes së madhe tradicionale kosovare, dhe si janë përdorur tradita dhe familja si strategji për përballimin e konfliktit. Gjithashtu, kjo pjesë shqyrton se si sistemet familjare tradicionale janë të lidhura me institucionet politike lokale, në veçanti këshillat e fshatit dhe mekanizmat për zgjidhjen e konflikteve në nivel të fshatit; se si i kontribuojnë jetesës së anëtarëve të tyre, dhe implikimet gjinore në rishfaqjen e sistemeve të tilla. Së fundi, kapitulli shqyrton se si mungesa e besimit dhe pjesëmarrjes pengon zhvillimin e atyre grupeve që promovojnë kapitalin shoqëror huazues.

Shoqëria civile: zbulime komparative mbi institucionet jozyrtare

Vlerësimi identifikoi ngjashmëritë dhe ndryshimet në mënyrat se si ndryshuan organizatat e shoqërisë civile në pesë vendet e përmendura, si pasojë e konfliktit dhe prezencës ndërkombëtare.

Llojet e grupeve të shoqërisë civile

Grupet në bazë të vendit. Parimi i grupit në bazë të vendit është familja e madhe patrialkale tradicionale, që nxit kapitalin e brendshëm shoqëror kufizues. Ky institucion u forcua si rezultat i konfliktit, posaçërisht nëpër fshatëra por edhe në qytete të mëdha, ku familjet e ngushta më moderne dëshironin të mbeten në lagjen e njëjtë sikurse farefisi i tyre. Konflikti gjithashtu i përforcoi lidhjet me të kthyerit dhe IDP-të, shumica e të cilëve vareshin nga familjet e mëdha për të mbijetuar; dhe nga anëtarët e familjes nga diaspora të cilët e kanë ndihmuar jashtëzakonisht rindërtimin, posaçërisht në viset e rrënuara perëndimore dhe viset malore. Komuniteti ndërkombëtarë ishte një burim i jashtëm për këto familje, duke u mundësuar atyre që të mbijetojnë duke zëvendësuar mjetet dhe prodhimet e humbura, si dhe rihapjen e shkollave lokale dhe sigurimin e punësimit.

Gjithashtu, këshillat e fshatit mbijetuan gjatë si institucione lokale, ku familjet ishin të përfaqësuara në këto këshilla në proporcion me madhësinë e dhe fuqinë e tyre ekonomike. Në realitet, konflikti e rriti transparencën dhe rendësinë e këshillave, të cilat gjatë periudhës së bashkëudhëheqjes luanin rolin e

sigurimit të mbrojtjes fizike për banorët e fshatit, paraqitjen e nevojave agjencive ndërkombëtare dhe negocimin me përfaqësuesit e UNMIK-ut.

Grupet në bazë të identitetit. Grupet që përpikërisht përcaktoheshin nga aspekti i prejardhjes etnike ose religjionit u mbështetën si rezultat i kontakteve të tyre me UNMIK-un dhe agjencitë e tjera ndërkombëtare, shpesh si përfaqësues të vetëm të anëtarëve të tyre. Shumica e këtyre grupeve i zgjëruan funksionet e tyre si ofrues të shërbimeve dhe burimeve të ndihmave humanitare për anëtarët e tyre, të cilët e rritën legjitimitetin e udhëheqësisë në bazë të identitetit dhe keqësoi tendencën e klubeve shoqërore, sindikatave dhe organizatave të përkujdesjes që të vepronjë jo vetëm ndarazi por edhe me njëra tjetrën. Edhe në diasporë gjithashtu, vetselektimi i kosovarëve në grupe në bazë të prejardhjes etnike dhe religjionit ka penguar integrimin e tyre në shtetet nikoqire.

Grupet në bazë të çështjeve të interesi publik. Dhuna e trashëguar pas konfliktit dhe mosbesimi kanë penguar formimin e grupeve të reja të orientuara kah interesi publik që mund të ndihmonin për të balancuar ndikimin e rritur të grupeve në bazë të identitetit dhe krijimin e kapitalit shoqëror huazues që nevojitet për zhvillimin e qytetit. U konstatua se pak nga këto vende kanë biznese të mëdha apo shoqata kulturore, edhe pse gratë dhe rinia kanë bërë një punë të mrekullueshme në krijimin e kapitalit shoqëror huazues.

Poasçërisht në Prizren, gratë e reja kanë treguar një aftësi huazues e në krijimin e marrëdhënieve dhe në organizimin e aktiviteteve dhe OJQ-ve tej kufijve etnik.⁵⁸ Gjithashtu, janë disa femra të pavaruara me ndikim nëpër fshatëra, disa prej të cilave kanë qenë reprezentuese të grupit të grave të LDK-së para konfliktit. Gjatë viteve të 90-ta, LDK-ja kishte vazhduar traditën komuniste të organizatave të grave të cilat mbulonin tërë territorin me degë dhe nëndegë. Edhe pse këto struktura nuk janë ribashkuar në Kosovën e pas luftës, grupet e grave ende janë shumë të rëndësishme për lokalitete. Në fshatin Cernicë, p.sh. ata janë bashkuar në punën e këshillave komunale.

Aktivitete delikate të OJQ-ve të organizuara prej grupeve siç janë Qendra për mbrojtjen e gruas dhe fëmijëve,⁵⁹ Forumi i gruas,⁶⁰ dhe Motrat Qiriazit⁶¹, kanë në shënjestër gratë fshatare dhe të qytetit në viset ku jetojnë, sepse disa nuk mund të largohen nga fshati as edhe nga oborri për arsye të sigurisë ose për shkak se janë të varfëra dhe duhet të punojnë punë dore gjatë tërë ditës. Shërbimet e OJQ-ve që kërkohen më së shumti janë këshillimet psikologjike dhe kurse për rrobaqepësi, shkathtësi kompjuterike, anglisht, kujdsin shëndetësor dhe planifikimin e familjes. Pjesëmarrësit e grupit të anketuar shprehën nevojën për të hequr nga mendja vështirësitë e përditshme dhe traumat por edhe monotoninë e përditshme, por prap se prapë kishin një vision të qartë për nevojën e krijimit të mundësive të tyre ekonomike. Gratë kërkuan ndihmë poasçërisht në shitjen e produkteve të tyre shtëpiake siç janë qendistartitë dhe qilimat e vegjël. Për t'ju përgjegjur një kërkesë të tillë, në Pejë, zyra e Qendrës për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve organizoi një ekspozitë të produkteve shtëpiake fshatare dhe zejeve në qytet. Drejtori ekzekutiv i kësaj organizate beson se autorizimi i grave me mundësitë ekonomike ka gjithashtu një efekt pozitiv në zvogëlimin e dhunës që ushtrohet në familje. Megjithatë, ajo bëri me dije se proporcioni i lartë i fondeve që harxhohen për OJQ-të ndërkombëtare shkon në dëm të iniciativave lokale të shoqërisë civile që do të mund të ndihmonin në zhvillimin e strukturave patriarkale më pak të zhvilluara.⁶²

Drejtoresha e “Motrave Qiriazit” shprehu shqetësimin e saj për numrin e vogël të femrave të emëruara dhe të promovuara përbrenda UNMIK-ut, që, siç thotë ajo, i kontribuoi restaurimit të shoqërisë patriarkale kosovare.⁶³

⁵⁸ Diskutime me Benedicte Giaver, drejtor, dhe Ingrid Halmova, OJQ/Zyra e shoqërisë civile, regjioni i Prizrenit, OSBE, 14 prill, 2000.

⁵⁹ Intervista me Vjosa Dobrunën, themeluese, Prishtinë, 20 janar, 2000; Sevdije Ahmeti, drejtor ekzekutiv, Prishtinë, 19 janar, 2000; dhe Mimi Mysafere Shoshi, Drejtor i zyrës në Pejë, 19 prill, 2000. Organizata ka tetë zyra nëpër Kosovë. Bashkëspozorizimi Italian ishte duke u mbaruar në kohën e intervistave.

⁶⁰ Intervista me aktivistët e Forumit të Gruas në një stehim të IDP-ve, 5 prill, 2000.

⁶¹ Intervistë me Igballe Rugovën, Motrat Qiriazit, Prishtinë, janar, 2000.

⁶² Intervistë me Sevdije Ahmetin, Drejtor ekzekutiv, Qendra për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve, Prishtinë, 19 janar, 2000.

⁶³ Intervistë me Igballe Rugovën, Motrat Qiriazit, Prishtinë, janar, 2000.

Grupet e rinisë, sikurse grupet e grave kanë luajtur një rol të rëndësishëm në jetën e anëtarëve të tyre dhe vepruan si balancim në strukturën familjare të madhe. Shqiptarët dhe serbët kanë tentuar të kenë organizata të ndara, përkundër aktiviteteve të ngashme - futball, skijim, bjeshkatari, ekologji, kulturë folklorike, mirëqenie sociale, poezi, vallëzim modern dhe muzikë. Dëshira e këtyre grupeve për të këmbyer përvojat me organizatat tjera ka krijuar mundësi për kapitalin shoqëror huazues. Megjithatë, duhet shënuar se organizatat serbe të rinisë për momentin janë duke u ballafaquar me probleme të sigurisë dhe me kufizime të mjeteve nga komuniteti ndërkombëtarë. Organizatat e serbëve dhe shqiptarëve kanë një proporcion mashkull-femër dy me një, që mund të jetë për shkak të faktit se femrat e reja preferojnë të bashkohen me organizatave lokale të gruas.⁶⁴

Grupet në bazë të çështjeve të vetinteresit. Kushtet e njëjta në të cilat mbështetën grupet në bazë të identitetit dhe diskurajimi i krijimit të grupeve të orientuara kah interesi publik gjatë periudhës së bashkëudhëheqjes, inkurajoi shfaqjen e grupeve të vetinteresit - si grupe destruktive për zhvillimin shoqëror, përfshirë edhe institucionet tradicionale në bazë të vendit. Këto grupe, kanë qenë shumë të anketuara për të fituar pasuri të mëdha dhe kontroll territorial përmes dhunës dhe aktiviteteve kriminale. Struktura tradicionale e familjes mund ta ketë lehtësuar zhvillimin e tyre duke i mbrojtur anëtarët e familjes të përfshirë në këto aktivitete.

Këto grupe kanë shfrytëzuar si burim për rekrutim rininë e bollshme të papunësuar (në të gjitha vendet) dhe lidhjet e tyre me grupe kriminelësh në diasporë (në Prishtinë dhe në Pejë), rritjen e prezencës së rrjetit të kriminelëve në Kosovë nga shqiptarët e Shqipërisë (Prizreni dhe Gjilani), dhe mundësitë e mëdha që sigurohen nga statusi ligjor ekonomik dhe pasurisë së pasigurtë banesore. Krimi i organizuar në mesin e shqiptarëve të Kosovës është mjaft i përhapur. Aktivitetet ekonomike të kontrolluara nga këto grupe grupohen sipas aktiviteteve në shpërndarjen e benzinës, pronësisë së hoteleve dhe qendrave tregtare (Prishtinë), për të kontrolluar ndërtimin e paligjshëm dhe tregtimin me pasuri të patundshme (Prishtinë dhe Prizren), pranim-dorëzimin e pronës (Gjilan), kërkimin me detyrim të taksave (në të gjitha vendet), kontrollin e tregtisë kufitare (Pejë). Aktivitetet më kriminale dhe më të dhunshme rradhiten prej kidnapimit dhe kontrabandimit të grave për prostitucion (prezente në Gjilan, Prishtinë dhe Prizren), konsumimi i drogës, tregtia me armë dhe kontrabandimi me të mërguar (Pejë dhe Prizren). Pjesëmarrësit e grupit të anketuar në të gjitha vendet shprehën shqetësim të madh lidhur me rritjen rapide të kriminalitetit në Kosovë dhe paaftësinë e UNMIK-it dhe KFOR-it për të pasur nën kontroll këtë problem.

Mbështetja ndërkombëtare për grupet që promovojnë përfshirjen dhe kapitalin shoqëror huazues

Komuniteti ndërkombëtarë e shikon shfaqjen e grupeve në Kosovë të orientuara kah interesi publik si një rrjet lidhës që do të bashkojë institucionet lokale reprezentuese me nevojat më të gjëra shoqërore. Këto grupe kuptohen edhe si kundërpeshë e rëndësishme për forcat konzervative të grupeve në bazë të vendit, prezencën përçarëse të grupeve në bazë të identitetit dhe, fuqinë kriminale të disa grupeve të vetinteresit.

UNMIK-u u ka ofruar mbështetje të vërtetë këtyre grupeve të orientuara kah interesi publik, shumica prej të cilave kërkuar të pranohen si OJQ,⁶⁵ përderisa opinionet dhe aktivitetet e tyre janë në harmoni me mandatin e UNMIK-un. Mbështetja e zyrave regjionale të UNMIK-it përfshin (i) ndihmën teknike për projektet që realizohen nga grupe të reja; (ii) përgatitjen për nevojat e vlerësimit, si mënyrë për të involvuar OJQ-të lokale në programimin e shërbimeve ndihmëse (Gjilan); dhe (iii) planifikimin për sesionin diskutues me prindër dhe arsimtarë që synon formimin e shoqatave të prindërve dhe arsimtarëve (Pejë). Përveç kësaj, UNMIK-u ka mbështetur projektet që synonin të rrisin numrin e OJQ-ve që janë formuar nga grupet minoritare (Prizren). Përpjekjet për të mbështetur grupet e tilla të orientuara kah interesi publik ndryshuan, varësisht nga kushtet në çdo vend. Në Prizren, p.sh. përpjekjet e tilla zhvilluan ekonominë e fortë të qytetit dhe traditat kulturore; kurse në Pejë ato u bazuan në suksesin dhe stabilitetin relativ të sistemit të bashkëudhëheqjes dhe qeverisjes komunale.

⁶⁴ UNICEF (2000a).

⁶⁵ Është prezent shqetësimi se OJQ-të ndërkombëtare pengojnë zhvillimin dhe përpjekjet e OJQ-ve lokale për krijimin e kuadrave, në veçanti kur punësojnë stafin më me përvojë dhe të aftë të organizatave lokale.

Familja tradicionale kosovare: analizë e kapitalit shoqëror kufizues

Nga analiza e bërë erdhëm në përfundim se përjashtimi nga strukturat shtetërore, konflikti dhe humbja e banesave në vitin 1990 kishte kthyer trendin në mesin e shqiptarëve të Kosovës në nivelin e vitin 1970 dhe 1980, në drejtim të formimit të familjeve të ngushta dhe integrimin e tyre në strukturat shoqërore. Pjesëmarrësit e grupit të anketuar, përfshirë edhe pleqtë e fshatit, vazhdimisht potencuan se rishfaqja e familjes së madhe patriarkale “tipike kosovare” gjatë kohës së krizës ishte strategji për tu adaptuar në ekonominë e dobët dhe kërcënimet për mbijetesë. Në veçanti të rinjtë, shprehën dëshirën e tyre që këto familje të ndahen në familje më të vogla, kur të lejojnë kushtet ekonomike dhe të sigurisë.⁶⁶

Është me rëndësi fundamentale që të kuptohen këto aspirata, meqenëse disa analistë i kanë lidhur familjet tradicionale dhe ekstremistët individual duke vepruar nën maskën e “nderit” dhe të “burrërisë” në eskalimin e dhunës dhe krizës në fund të vitit 1990.⁶⁷ Megjithatë, pjesëmarrësit e grupit të anketuar treguan shumë tregime për burrat shqiptarë të cilët i fshehën armët për ti ikur involvimit në traditat e dhunshme të rreptaljeve dhe hakmarrjes dhe, shumica shpresonin se këto tradita së shpejti do t’i takojnë së kaluarës.

Familja tipike kosovare

Familja tipike kosovare është e strukturuar sipas një rregulle të banimit pasmartesor të burrit. Në viset fshatare martesat e reja bëhen vetëm përmes të afërmive të tyre dhe kanë mundësi të kufizuara për të takuar partnerin e martesës. Me rastin e martesës, nusja vjen në familjen e re të burrit. Në viset qytetare, gruaja mund të jetojë me vjehërritë e saj. Në viset fshatare, ajo mund të jetojë me kunetër dhe kunata (parim vëllazror). Gruaja, gjithmonë e huaj nga të afërmit e burrit përjetësisht do të quhet “nuse”, kurse fëmijët e saj do t’i përkasin sipas “afrisë së gjakut” familjes së babait. Prandaj, në rastet kur gruaja kthehet në familjen e saj - nëse shkurëzohet ose gjatë vejërisë - fëmijët do të mbesin me familjen e burrit, nëse respektohen traditat.⁶⁸

Nusja rahatohet në familjen e burrit përmes lindjes së fëmijëve, sjelljes dhe punës me të cilën i kontribuon familjes.⁶⁹ Posaçërisht, në viset rurale ku ka alternativa të pakta për të fituar prestigj, nusja tenton t’i ruajë idetë tradicionale të konformitetit shumë më tepër se motrat e pamartuara të burrit ose vajzat e vjehërrive. Të pamartuarit që jetojnë në shtëpinë ku kanë lindur në mesin e të afërmëve meshkuj sillen si të rebeluar.⁷⁰ Mirëpo, edhe femrat e reja të rebeluara jetojnë në një botë të ndarë nga vëllezërit e tyre. “Ne nuk dimë se çka mendojnë ata, dhe as që dëshirojmë të dimë,” tha një femër 23 vjeçare e pamartuar e cila fuqimisht shpreson për më tepër të drejta të barabarta në punësim dhe arsim.

Traditat dhe gjinitë: femrat e rrezikuara?

Me eskalimin e konfliktit, dhe asaj që disa e konsiderojnë si kthim gradual i traditave patriarkale lokale të përfshira nën termin *kanun*, situata e femrave është keqësuar.⁷¹ Në veçanti, një raport i fundit i UNICEF-it thekson se kontrabandimi i femrave shqiptare është rritur si rezultat i zhvendosjeve gjatë luftës dhe eskalimit këtij fenomeni në shtetet fqinje.⁷² Disa të anketuar përmendën rritjen e numrit të kidnapimeve,

⁶⁶ Disa gjithashtu potencuan se përpjekjt ndërkombëtare siç janë programi i vitit të kaluar për përgatitjen për dimër kanë rifuqar pa dashje familjen e madhe, duke iu ofruar ndihmë familjeve që ishin të gatshëm të pranojnë anëtarë pa shtëpi të familjes.

⁶⁷ Shif Judah (2000)

⁶⁸ Rastet ishin në Prishtinë dhe Prizren ku nëna u kthye te prindërit e saj dhe fëmijët i la me familjen e burrit pasi u bë vejjane si pasojë e konfliktit të fundit.

⁶⁹ Reineck (1991) përshkruan sistemin e prestigjit dhe konfliktet që i përcjellin gratë e reja që kalojnë në familjen e krijuar, dhe si merret kjo parasysh në kultivimin e vlerave tradicionale. Gjithashtu, shif Becker (1983) për elaborim se si rrjetet dhe aleancat te familjes patriarkale janë ruajtur përmes gruas e cila nuk ka pasur shumë kontakte me farefisën e saj dhe me gra të tjera

⁷⁰ Rezultatet e vlerësimit nga grupet e anketuara tentojnë të konfirmojnë interpretimin e Reineck-ut (1991).

⁷¹ Për sqarim të *kanunit*, shif La Cava dhe Nanetti (2000) dhe Schwandner-Sievers (1999).

⁷² UNICEF (2000b).

posaçërisht në Ferizaj dhe Viti dhe lidhjen e tyre me prostitucionin⁷³ në Kosovë, (posaçërisht në Gjilan⁷⁴) dhe në shtete të tjera evropiane, dhe me Italinë e cila i pranon shumicën e prostituteve shqiptare.⁷⁵ Femrat aktiviste treguan për kidnapime në kampet e refugjatëve gjatë luftës ku viktimat e moshës më të re ishin 13 vjeç. Një i anketuar na tregoi një rast që i ra ndërmend për dasmat fshatare, ku nusja bëhet pjesë e prostitucionit evropian pasi martohet me një burrë i cili ka qenë banor legal në një shtet të Evropës Perëndimore.⁷⁶ Me paraqitjen e këtyre problemeve të reja, Qendra për mbrojtjen e gruas dhe fëmijëve e ka zhvendosur përqëndrimin prej shëndetit reprodutiv në çështje që lidhen me dhunën, dhe tani punon me viktima të kidnapimeve, kontrabandimit dhe dhunimit. Përveç kësaj, Qendra u ofron ndihmë grave dhe fëmijëve që kanë përjetuar dhunë në familje që sipas raporteve është në rritje për shkak të situatës së kufizimeve shtëpiake.

Në të njëjtën kohë, duke pasur parasysh strukturën tradicionale të shoqërisë kosovare, posaçërisht në vise rurale një burim tjetër i rëndësishëm për rrezikimin e gruas është vdekja ose zhdukja e bashkëshortit, babait apo të afërmeve të tjerë meshkuj.

Përfaqësimi politik nga fshati

Rendi shoqëror patrilinear krijon njësi territoriale të bazuara në grupe të farefisit të përbërë nga meshkuj dhe grupe të solidaritetit të cilët sillen si vëllezër, djem, baballarë dhe kushërinjë. Pra, ky lloj i rendit shoqëror krijon një përputhje të parimeve territoriale dhe farefisnore që në veçanti reflektohet në modelin lokal të vënies së emrave. Fshati mund ta bart emrin e themeluesit, i cili gjithashtu do të jetë paraardhës i pasardhësit patriarkal më të fuqishëm. Këshilli i fshatit pasqyron këtë sistem të farefisnisë me përfaqësim proporcional. Pasardhësit patriarkal më të fuqishëm bazuar në numrin e shtëpive në fshat do të përfaqësohen me një shumë se një anëtarë. Ato familje me një histori më të gjatë të banimit në fshat janë më të fuqishme sepse gjatë kohës janë ndarë në shumë njësi (Shif ndarjen 3).⁷⁷

Ndarja 3. Përfaqësimi politik nga fshati

Në fshatin Piran, janë 24 mbiemra familjesh të ndryshme ku jetojnë 2,310 banorë në 231 familje të (zgjëruara) të tipit kosovar dhe 500 të tipit evropian (të ngushtë). Nga kërkimet shihet se familjet e mëdha zhvillohen dhe ndahen në një qarkore sipas brezave (gjeneratave), dhe se familjet e ngushta dhe të mëdha bashkëekzistojnë si pjesë e këtij modeli të rendit shoqëror.⁷⁸ Në këtë rast, proporcioni i përfaqësimit farefisnor në Këshillin e fshatit nuk korrespondon anëtarësimin politik, sepse ky fshat ishte në tërësi aleat i LDK-së. Për dallim nga kjo, fshati i Černicës, ka pesë mbiemra familjesh për 310 familje, ku secila mesatarisht ka 7 anëtarë dhe 9 vende në Këshillin shqiptar të fshatit - që ekziston në mënyrë paralele me Këshillin serb të fshatit - janë të ndarë në LDK dhe PDK. Pasardhësi më i madh patriarkal ka ka tri prej këtyre posteve. Një me LDK-në, një me PDK-në dhe një, që e ka përfaqësuesi nga Bashkësia komunale. Dy pasardhësit e tjerë patriarkal kanë secili nga dy vende në këshill duke përfaqësuar të dy partitë dhe Shoqatën “Nëna Tereze”. Dy pasardhësit patriarkal më pak të fuqishëm secili kanë nga një anëtarë në këshill, njëri nga LDK-ja e tjetri nga PDK-ja.

Nga familja në komb?

Pasardhësi patriarkal, si një sitem i rendit shqiptarëve të Kosovës, garanton identitet të fortë kombëtar anëtarëve të njërit nga zbulimet e reja *fisit* ose fiseve patrilineare.⁷⁹ Kur shqiptarët takohen për herë të parë, ata zakonisht janë në gjendje ta identifikojnë njëri tjetrin sipas këtij sistemi të prejardhjes si edhe përmes

⁷³ Gjithashtu, disa të anketuar rritjen e prostitucionit e lidhën me prezencën e KFOR-it dhe atë ushtarake.

⁷⁴ Gjilani, paraqet gjithashtu pikën hyrëse të heroinës për në Kosovë. Shif ICG (2000b).

⁷⁵ Intervistë me përfaqësues të një OJQ-je italiane dedikuar mbrojtjes së gruas dhe fëmijëve.

⁷⁶ Intervistë me zyrtarin e UNMIK-ut, Gjilan, mars 2000.

⁷⁷ UNFPA/IOM (2000).

⁷⁸ Shif Todorova (1990).

⁷⁹ Mungesën për kuptimin e komunitetit në mesin e shqiptarëve kosovar, shumica e shpjegojnë me anë të lojalitetit të tyre më tepër për kombin se sa për lagjen dhe komunitetin, derisa lojaliteti ndaj komunitetit është veti tipik serbe.

martesës, lagjes, marrëdhënieve miqësore dhe vendlindjes. Në këtë mënyrë, e tërët Kosova mund të duket si një fshat. Anëtarët shqiptarë të ekipit vlerësues i gjurmonin këto relacione të përbashkëta me çdonjërin që ishte i përfshirë gjatë punës së kërkimit, dhe - në rastet kur takoheshin me turqirt dhe muslimanët sllav - këto lidhje zgjeroheshin edhe jashtë komunitetit etnik për shak të marrëdhënieve martesore. Në të njëjtën kohë, lidhjet e tjera, përfshirë edhe marrëdhëniet ndëretnike ekzistojnë për shkak të përvojave të përbashkëta në punë dhe arsimim para periudhës së sistemit paralel. Shumica e të anketuarëve në moshë kishin kujtime të mira nga këto kohëra.

Traditat e zgjidhjes së konflikteve brenda dhe në mes të komunitetit.

Gjatë kohës së kërkimit, në shumë fshatëra, shqiptarët ishin duke festuar 10 vjetorin e pajtimit brenda komunitetit.⁸⁰ Ky pajtim, kishte filluar në vitin 1990 kur studentët shqiptarë në Universitetin e Prishtinës e pyetën profesorin e etnografisë, Anton Çettën, për këshilla se si ta bëjnë këtë në mënyrë sa më adekuate - d.m.th. sipas traditave zakonore fshatare - në të mirë të zhvillimit dhe kohezionit kombëtar për shkak të rritjes së hegjemonizmit serb. Në të njëjtin vit, Profesor Çetta, së bashku me studentët dhe klerikët, organizuan ritualet e pajtimit të hakmarrjes në përmasa të mëdha në mbarë Kosovën,⁸¹ duke e përdorur konceptin e *kanunit të "besëlidhjes"*, d.m.th. sipas zakonit hiqet dorë nga hakmarrjet familjare përpara dëshmitarëve (Shif ndarjen 4).⁸² Ritualet⁸³ e tilla historikisht janë përdorur në mesin e shqiptarëve për të themeluar kohezionin e brendshëm për hir të kërcënimeve të jashtme. Në fakt, këto iniciativa të pajtimit mund ta kenë siguruar shtetin paralel (të LDK-së), për të pasur qasje tek qytetarët individual.⁸⁴ P.sh. Shoqata Nëna Tereze, e themeluar në vitin 1990 (me Profesor Çettën anëtar themelues) e organizuar sipas parimit farefisnor patrilinear u shëndrrua në organizatë kombëtare shqiptare për ndihmë shëndetësore dhe sociale në sistemin paralel. Shoqata kishte 44 degë, 636 nëndegë dhe 92 klinika në fshatëra dhe qytete në mbarë Kosovën. Në Cërnicë (shif ndarjen 4), një vend në këshillin e fshatit i takonte kësaj organizate. Kjo shoqatë gjithashtu u përdor për të shpërndarë donacionet ndërkombëtare nga Caritasi dhe Kryqi i Kuq, dhe organizata tjera, dhe për të mbledhur informata për sëmundje dhe epidemi. Siç duket kjo shoqatë i ka koordinuar këto distribuime dhe mbledhje të ndihmave së bashku me këshillat e fshatit; d.m.th. përmes strukturave farefisnore proporcionale patrilineare.

Ndarja 4. Këshillat për pajtimin e gjaqeve

Këshillat për pajtimin e gjaqeve ekzistuan para iniciativës së Profesor Çettës, dhe ende ekzistonin në fshatërat e Cërnicës dhe Piranës në kohën e vlerësimit. Në Cërnicë, këshilli ndër morri dy aksione gjatë 10 viteve të kaluara për të parandaluar eskalimin e konflikteve, ku në njërin rast kishin të bënin me xhelozin në mes të dy burrave shqiptarë për një femër të re, dhe tjetri për një mosmarrëveshje rreth kufirit të tokës në pronësi private. Në një rast të mëvonshëm, një shqiptar uzurpoi tokën e fqit serb, dhe këshilli i pajtimit kërkoi nga ai që ta lëshojë tokën. Ky incident ndodhi në vitin 1989 para segregacionit në mes të serbëve dhe shqiptarëve dhe ndihmoi parandalimin e konfliktit ndëretnik të komunitetit. Megjithatë, përkundër suksesit të këtij mekanizmi, anëtarët e këshillit komunal thonë se *kanuni* nuk është mënyrë adekuate për të kthyer drejtësinë, dhe se ata presin krijimin e vërtetë të sundimit të së drejtës.

Strategjitë për mbijetimin: Krijimi i të ardhurave familjare

Në shumë pjesë të Kosovës, numri i meshkujve të moshës aktive për punë, përcakton aftësinë e familjes për të mbijetuar, dhe reprezentuesit meshkuj në grupet e anketuara potencuan përgjegjësinë që ata e ndiejnë në këtë aspekt. Veçanësisht, në viset rurale, meshkujt i krijojnë të ardhurat e familjes, edhe pse shumë meshkuj dhe femra do të dëshironin të shohin një treg më të madh të punësimit me mundësi të ngjashme për femra. Derisa disa femra të reja shprehën krenarinë e tyre që u janë përkushtuar fëmijëve të tyre,

⁸⁰ Raporte të detajuara të këtyre përvojave janë paraqitur në gazetata lokale kosovare siç janë *Koha Ditore* dhe *Bota Sot*, gjatë periudhës së hulumtimit.

⁸¹ Për informata të detajuara u jemi mirënjohës Dr. Michael Stewart, Drejtimi i Antropologjisë, Kolegji Universitar i Londrës, dhe, Lala Meredith-Vula, Londër, që i fotografoi këto rituale masive.

⁸² Për interpretim të detajuar të *besës*, shif Schwandner-Sievers (1999).

⁸³ Për interpretim të detajuar të *besës*, shif Schwandner-Sievers (1999).

⁸⁴ Ekziston një nevojë e madhe për kërkime të mëtejme për këtë çështje. Shif, p.sh. Haegemas (2000).

shtëpisë dhe punës së dorës, femrat tjera kanë filluar me disa ndërmarrje të vogla. P.sh. femrat në Llukarë, një fshat afër Prishtinës që nuk pësoi shumë humbje nga lufta, janë duke mbajtur një fermë të pulave dhe bletë për prodhimin e mjaltit.

Siç është shënuar edhe më parë, familjet e mëdha fshatare gjithashtu varen nga paratë e dërguara prej një deri në tre anëtarëve meshkuj të familjes që jetojnë jashtë. Azilkërkuesi është në gjendje të dërgojë vetëm 100 ose 150 DM në muaj, mirëpo ky kontribut i ëndësishëm për të ardhurat e familjes së madhe u mundëson meshkujve të tjerë në familje të vazhdojnë të merren me bujqësi, tregti lokale ose me aktivitete të tjera fitimprurëse, ku në të njëjtën kohë kujdesen edhe për prindërit e moshuar. Çfarëdo teprice e parave të gatshme mund të shfrytëzohet për arsimimin e anëtarëve të rinj të familjes, ku prioritet u jepet djemve. Varshmëritë e tilla janë arsyeja kryesore pse anëtarët e rinj të familjes, në veçanti femrat e reja, në viset rurale dëshirojnë të kenë shtëpinë dhe familjen e tyre të ngushtë dhe t'i ikin jetës në familje të mëdha. (shif ndarjen 5).

Ndarja 5. Proverbat kulturore shqiptare për paratë

Thëniet shqiptare përcaktojnë se kujt i takon pushteti dhe kush merr vendime në familje, veçanërisht në rastet kur mjetet e jetesës janë të kufizuara dhe duhet të merret vendim se kush do të shkollohet:

- Ai që i ka paratë i cakton rregullat;
- E huaja asnjëherë nuk bëhet e jotja;
- Sa para aq muzikë.

Të mërguarit nga Kosova shkuan në Gjermani dhe Zvicër dhe një numër më i vogël në Itali, Slloveni, Suedi, Danimarkë dhe Kroaci. Dërgimi i parave nga jashtë që i marrin familjet e mëdha mund të rrezikohet vetëm atëherë kur mashkulli migron me familjen e tij të ngushtë ose krijon familje jashtë. Shumë familje frigohen nga humbja e parave të dërguara për shkak të kthimit të një numri të madh të të mërguarëve kosovar nga Gjermania dhe Zvicra; ndërsa të tjerët kanë anëtarë të familjes që do të kthehen me pensione. P.sh. një patriark i një familjeje të madhe nga fshati Piranë merr pension prej 230 DM në muaj nga Gjermania sepse i ka humbur disa gishtërinjë në një fatkeqësi në fabrikë. E tërë familja e tij 11 anëtarëshe jeton nga këto të ardhura. Në Prizren, një familje 20 anëtarëshe e kryesuar nga dy vëllezërit më të moshuar e ku jetojnë të gjithë djemtë tjerë dhe familjet e tyre, jeton nga një pension mujor prej 1000 DM, të cilin e merr njëri prej tyre që ka punuar 20 vite në një fabrikë të Gjermanisë. Familje të tjera përballen me vështirësi në marrjen e pensioneve nga jashtë sepse bankat e Kosovës nuk funksionojnë si duhet. Megjithatë, shumica besojnë se kërkesat e tyre për këto pensione eventualisht do të përmbushen. Për dallim nga këto, ata të cilët kërkojnë pensionet e Jugosllavisë janë më pak optimist dhe janë shumë të cenueshëm.

Paratë e dërguara nga jashtë dhe pensionet prej kohës së luftës janë bërë më të rëndësishme, sepse ajo ndërpreu mbjelljet dhe të korrat dhe mundësoi vjedhje dhe shkatërrime të mëdha të mjeteve të punës. Në kohërat e paraluftës, bujqët shpesh prodhonin një tepricë të vogël e cila shitej në tregun lokal, p.sh. në Piranë. Një bujk nga Černica, i cili jeton në një shtëpi me katër vëllezërit e tij të rritur dhe familjet e tyre tha "ne gjithmonë kemi qenë një familje kolektive, nëse doni mund t'a quani edhe kooperativë private bujqësore." Ata kultivonin perime, duhan, grurë, misër dhe tërfil për ushqimin e bagëtisë. Megjithatë, të gjitha mjetet e tyre bujqësore u vodhën gjatë luftës dhe ende nuk janë zëvendësuar, dhe nuk kanë pasur korrje në vitin 1999. Në shumë raste, fushat nuk punohen për shkak se janë të minuara ose njerëzit frigohen se janë të minuara, si në Rugovë, Piranë dhe fshatëra afër Malishevës.

Përveç pajisjeve, bujqëve u mungojnë farërat, plehërat, bagëtia dhe kredi për të financuar blerjen e këtyre mjeteve themelore të prodhimit. Siç duket, pajisjet bujqësore dhe maqinaria janë shkatërruar në përmasa të mëdha, dhe bagëtia sistematikisht është konfiskuar në mbarë Kosovën, nga forcat ushtarake ose paramilitare serbe, edhe në fshatërat që pësuan pak humbje të tjera. Kjo ka qenë katastrofale, posaçërisht për familjet që jetonin nga blegtoia, siç është një familje në Dragobil që posedonte 320 dele, 10 lopë dhe 600 pula para luftës, prej të cilave gati krejt janë vjedhur. Në raste të rralla, kur bagëtia mund të përtëritet, ekziston rreziku nga uria e tyre, meqenëse, siç tha një bujk nga fshati Piranë, "nuk ka ndihma në ushqim për gjedhe," dhe as rezerva të tërëfilit nga vjeshta e kaluar. Shumica e bujqëve e potencuan nevojën urgjente

për farëra ose kredi për farëra, dhe mjete për të filluar mbjelljet me kohë që të kenë të korra për vitin 2000, dhe të mos varemi nga ndihmat humanitare edhe një vit tjetër.

Në kohën e vlerësimit, ndihmat humanitare dhe mbështetja tjetër ndërkombëtare ndaheshin në baza komunale. Kështu, fshatërat tërësisht të shkatërruara, siç janë ata në rrugën që lidh Prizrenin dhe regjionin e Drenicës, ishin në rrezik të mos marrin ndihma të mjaftueshme, edhe pse qendra komunale, në këtë rast Prizreni ishte krahasimisht i pasur. Përkundër pyetjeve direkte, ne nuk pamë shenja të ndërrimit mall me mall në fshatërat e tilla, edhe pse ekzistonte një nevojë e evidente për para të gatshme. Disa femra nuk ngurrojnë t'i shesin stolitë e arit ose tokën e tyre për para të gatshme; por, stolitë e tyre ishin vjedhur, ndërsa për tokën nuk kishin blerës.

Punëtorët e sektorit publik rural, siç janë arsimtarët, pjesëtarët e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) dhe policët zakonisht janë anëtarë të familjeve të mëdha dhe u kontribuojnë në mënyrë efektive të ardhurave të familjes përmes punëve të llojllojshme. Megjithatë, arsimtarët u ankuan se të ardhurat e tyre zakonisht nuk mjaftojnë për të mbajtur familjen e tyre të ngushtë. Kur nuk ka të ardhura nga ndonjë anëtarë tjetër i familjes, arsimtarët kërkojnë të merren me aktivitete të tjera fitimprurëse. P.sh. një arsimtar i fshatit mund të jetë edhe bujk ose tregtar (i cigareve në Cërnicë); ndërsa, në qytet, përkthyes për organizatat e komunitetit ndërkombëtar, vozitës apo gazetar. Nevoja e arsimtarëve për tu marrë me profesione të tjera paraqet një pengesë kryesore për arsimim kualitativ. Shumica do të pajtoheshin me një arsimtar tjetër në Cërnicë i cili e potencoi vlerën e punës (shif ndarjen 6), duke thënë se ai është i lumtur që mundet të punojë punë fizike si bujk, ndërsa është duke mbajtur mësim për arsye patriotike, sepse “arsimimi paraqet bazën e çdo shteti.”

Ndarja 6. Vlerat kulturore shqiptare lidhur me punën

Puna shpreh vlerë të lartë simbolike dhe materiale. Kur njerëzit flasin për meshkuj, vise të tjera të Kosovës ose kombe të tjera, ata gjithmonë i vlerësojnë ata nga aspekti i (supozuar) i aftësisë punuese. “Ai është punëtor,” që do të thotë se “ai është punëtor i madh,” është lëvdata më e lartë për njeriun; dhe “ata janë punëtorë” është lëvdata më e lartë për kombin dhe përfaqësuesit e tij. Përfaqësuesit e grupeve të anketuara shpjeguan se kjo varet pak nga lloji i punës që ata e kryejnë (ai mund të jetë intelektual ose punëtor sezonal i mërguar) ndaj dëshirës së tij për të punuar dhe aftësia e tij për të fituar të ardhura, të mbajë familjen dhe të ndërtojë shtëpi. Prandaj, reputacioni i tij si punëtor është element përcaktues për politikën e martesës në viset rurale.

Shumë sipërmarrës nga fshati dhe qyteti, siç janë pronarët e garazhave, auto mekanikët, punëtorët e ndërtimit, prodhuesit e tullave, shitësit e artikujve ushqimor, bukëpjekësit, pronarët e mullinjëve dhe përpunuesit e produkteve të qumështit, gjithashtu pësuan humbje ose shkatërrime të pajisjeve dhe mjeteve prodhuese, posaçërisht në Dragobil, Cërnicë, Piranë dhe Rugovë. Vetëm ata që marrin para të dërguara ose kredi kanë pasur mundësi t'i ristartojnë bizneset e tyre në kohën kur ka kërkesa të mëdha për shërbime. Shumica e këtyre sipërmarrësve të shkallës së vogël merren me punë lokale të rindërtimit. Në Maalishevë, pronari i një biznesi për përpunimin e drurit shprehu nevojën për kredi për të zgjeruar biznesin për prodhimin e dyerëve dhe dritareve. Shumica e pjesëmarrësve nga grupet e anketuara u ankuan se për shkak të mungesës së kredive dhe pajisjeve shumica e materialeve ndërtimore dhe tregtare që impotohen nga shtetet fqinje shumë lehtë do të mund të prodhoheshin këtu. Në disa fshatëra, meshkujt kanë filluar të shesin produktet lokale (ilegalisht) për punë ndërtimore, siç janë druajt nga viset malore (Bjeshkët e Rugovës afër Pejës) ose rërë nga një lumë (afër Prizrenit) për shkak të përpjekjeve të pashpresa për të fituar para të gatshme.

Disa të anketuar fshatar thanë se ua kanë zilinë banorëve të qytetit sepse ata kanë qasje në mundësi të shumta punësimi, në veçanti tek komuniteti ndërkombëtar (UNMIK, OJQ-të, etj.), dhe kanë rastin për të fituar shuma të jashtëzakonshme të parave. Në qytete, shumica kanë gjetur punë si vozitës, përkthyes dhe administartorë, dhe shpeshherë paguhen dhjetë herë më shumë se nëpunësit civil (arsimtarët, policët, mjekët, etj.). Të anketuarit e fshatit gjithashtu thanë se ua kanë zilinë banorëve të qytetit, meshkujve dhe

femrave sepse kanë mundësi punësimi, dhe familjet e tyre shkojnë kah ajo që të jenë më të vogla. Në Gjilan dhe Malishevë ka pasur femra të reja që u kontribuojnë të ardhurave të familjes së bashku me meshkujt - si motra dhe bija - të punësuar në shitoret në pronësi të familjes dhe në administratën lokale. Megjithatë, me rastin e martesës, roli i tyre fillon të ndryshojë dhe puna e tyre është më tepër e mbyllur në shtëpi. Edhe pse familjet e qytetit tentojnë që të kenë më pak fëmijë, dhe struktura e familjes së madhe është më pak e zakonshme, siguria e të moshuarëve arrihet përmes kujdesit të nuses, sepse rregullat martesore patriarkale janë të ngjashme si në qytet ashtu edhe në fshat. Këto parime garantojnë se njëri djalë dhe familja e tij e ngushtë gjithmonë do të jetojnë në shtëpinë ose banesën e prindërve dhe do t'i sigurojnë ata. Vëllezërit nga jashtë do të vazhdojnë t'u kontribuojnë shpenzimeve të jetesës së kësaj familje.

Disa lloje të punësimit urban – arsimit, gazetaria, biznesi, tregtia, restorantet, shitoret dhe zejtaria (punime argjendi të mirënjohura në Prizren dhe Gjilan) - janë më të rëndësishme tani se para konfliktit, edhe pse sipërmarrësit tani kanë më tepër liri se sa që patën nën administratën lokale të udhëhequr nga serbët. Gjithashtu, tani ka më tepër punë për shqiptarët në ndërmarrjet në pronësi shtetërore siç janë shërbimet publike të energjisë elektrike, hekurudhat, tekstili, fabrika e baterive, farmaceutika, dhe fabrikat metalurgjike - punë që u humbën gjatë viteve të 90-ta. Tani romët dhe sllavët musliman po e humbin punën. Megjithatë, shumica e të ardhurave për familjet e qytetit fitohen nga punësimi. Administrimi qeveritar dhe joqeveritar, shërbime të përkthimit dhe vozitjes, dhënia e banesave apo shtëpive me qira të huajve, janë mundësi fitimprurëse që lidhen me prezencën e ndërkombëtarëve. Në të njëjtën kohë, çmimet për këto shërbime janë rritur jashtëzakonisht shumë. Kryesisht në kryeqytet, të intervistuarit shprehën shqetësimin se si prezenca e të huajve e ka ndryshuar ekonominë lokale dhe ka krijuar varshmëri me punësimin e një numri kaq të madh të njerëzve, në veçanti të atyre me njohuri nga gjuha angleze. Njerëzit tjerë me kualifikime të larta, siç janë disa profesor universitar, janë ndier të frustruar dhe në pozitë të papëlqyer, dhe në masë të madhe janë tërhequr nga angazhimi i tyre në shoqërinë bashkëkohore.

Besimi dhe pjesëmarrja në institucionet lokale.

Janë përgatitur pyetësorë të strukturuar (shif Shtojcën IID) për pjesëmarrësit e grupeve të anketuara për të caktuar përafërsisht dy variabla kyçe - besimin dhe pjesëmarrjen, që përbëjnë dy nocione multidimensionale të kapitalit shoqëror.⁸⁵ U përqëndruam në shkallën e besimit në institucionet lokale siç janë këshillat e fshatit dhe administrata komunale; dhe shkalla e pjesëmarrjes në lloje të ndryshme të shoqatave. Të dhënat tregojnë se: (i) ekziston mungesë e besimit në mes të njerëzve jashtë sistemit të familjes së madhe që është njëra nga pengesat kyçe për zhvillimin e institucioneve lokale inkluzive; dhe (ii) efektiviteti i organizatave të shoqërisë civile është i kufizuar nga mungesa e pjesëmarrjes.

Besimi

Të dhënat mbi shkallën e besimit në institucionet lokale u analizuan sipas variablave të moshës, gjinisë dhe vendit. Për të gjithë të anketuarit, besimi nuk ishte më i lartë se 34 %. Të rriturit (N=455) kishin pak më tepër besim (31.9%) se sa të anketuarit e rinj (N=445; 27 %); femrat (N=490) kishin dukshëm më tepër besim (33.3 %) se sa meshkujt (N=410; 24.9 %); dhe besimi në viset rurale (N=485) ishte pak më i lartë (30.5 %) se sa në viset urbane (N=415; 28.2 %).

Gjithashtu, shkalla e besimit ndryshoi në pesë vende. Tërë regjioni rural i Malishevës (N=115), me sistemin e mbetur paralel, këshillat tradicionale të fshatit dhe mungesë e tërësishme e ndihmës nga jashtë, kishte shkallën më të lartë të besimit në institucionet e veta lokale (49.6 %). Katër vendet tjera, me një përzierje ruralo-urbane, treguan një shkallë shumë më të ulët të besimit institucional. Në Gjilan, (N=200), ku sistemi paralel i plotësoi nevojat e popullatës pakicë të segreguar, besimi ishte më i lartë (26.5 %) se sa në Prishtinë (N=210; 20.5 %), ku ishte shkalla më e ulët në krahasim me vendeve tjera. Peja (N=120), ku sistemi i bashkëudhëheqjes funksionoi pa pengesa, ekzistonte një shkallë diç më e lartë e besimit (34.2 %), se sa në Prizren (N=255; 27.8 %), ku sistemi nuk ishte i kompletuar.

⁸⁵ Nocioni i kapitalit shoqëror përmban besimin ndërpersonal, vlerat e komunitetit, sjelljen politike dhe sjelljes asociacionale. Matje më të përpunuara të kapitalit shoqëror janë përbërë nga indeksat e jo nga variablat e vetme.

Gjithashtu, të anketuarit kishin pikëpamje të dryshme për llojet e ndryshme të institucioneve lokale. Në viset urbane, deri në 77.8 % e të anketuarëve nuk e pranonin ekzistencën e institucioneve lokale në nivel të lagjes siç është *bashkësia lokale* – d.m.th. ata thanë se pyetja nuk ishte e përshtatshme, dhe vetëm 12.2 % u besonin atyre në ato vise ku ato i pranonin. Nga të anketuarit 40.6 % e thanë se *bashkësia lokale* ishte jooperative, kurse çdo i katërti (24.5 %) tha se i besonin. Në pikëpamje të ngjashme, tri institucionet lokale më të besueshme ishin këshillat e fshatit, (35.0 %), administrata komunale (40.0 %), dhe partitë politike (40.6 %). Derisa ishte vështirë të përcaktojmë shkallën e besimit të partive të veçanta, ose shkallën deri ku pikëpamjet për administratën komunale kanë mundur të ndikohen nga debati i vazhdueshëm i zgjedhjeve të ardhshme lokale, nga këto rezultate shihet se njerëzit kishin një mirënjohje të posaçme për sistemin e bashkëudhëqjes dhe aspiratat e tij për stabilitet.

Pjesëmarrja

Shkalla e pjesëmarrjes ishte e ulët për të gjitha llojet e shoqatave. Rezultatet treguan se të rriturit morrën pjesë në mënyrë marginale (19.8 %) më shumë se sa të rinjtë e anketuar (15.2 %), dhe meshkujt (20.7 %) morrën pjesë në shkallë më të lartë se femrat (14.8 %). Këto rezultate nuk janë befasese kur kihat parasysh struktura tradicionale e familjes, ku mbizotërojnë pikëpamjet e meshkujve dhe ku sjellja shoqërore e meshkujve përcakton pozitën politike të familjes ndaj botës së jashtme. Një shkallë e ulët e pjesëmarrjes u konfirmua nga fakti se, gati gjysma e të anketuarëve (47.3 % e të rriturve, 44.8 % e të rriturve të rinjë), thanë se pyetja ishte e papërshtatshme. Megjithatë, më pak se 1/3 e meshkujve (30.5 %), e dhanë këtë përgjegje, krahasuar me gati dyfishin e numrit (59.1 %) për femra. Pjesa dërmuese e të anketuarëve besonin se shoqatat nuk ekzistojnë, edhe pse shumica thanë se ata do të sigurojnë mundësi të rëndësishme. Disa të anketuar këtë e shpjeguan me efektet destruktive që pati kriza në rrjetin e aktiviteteve të familjes drejtpërdrejt, dhe nevojën për tu përqëndruar në prioritetet tjera gjatë periudhës pas konfliktit.

Dallimet më të mëdha në pjesëmarrje ishin në meset e viseve rurale ndaj atyre urbane (11.4 dhe 24.7 %). Tërë rajoni rural i Malishevës e ka shkallën më të ulët të pjesëmarrjes (8.1 %) prej pesë vendeve, ku tre, prej katër të anketuarëve (76.1 %), thanë se pyetja ishte e papërshtatshme. Në Gjilan, pjesëmarrja ishte gjithashtu shumë e ulët (9.4 %), më së shumti për shkak të konfliktit të vazhdueshëm etnik dhe kthimit të madh të popullatës. Vetëm një nga tri të anketuarit atje (36.6 %), tha se nuk ekzistojnë shoqatat. Në tri vendet tjera, ku një numër i konsiderueshëm i personave të zhvendosur brenda, janë vendosur nëpër qytete, shkalla e pjesëmarrjes ishte shumë e përafërt (Prishtinë, 23.2 %; Pejë 25.0 %). Pjesëmarrja në shoqata bamirëse (27.3 %), arsimore (21.6 %), rekreacionale (21.7 %), dhe politike (15.0 %) u pa se është shumë më e lartë se sa në shoqatat religjioze (6.7 %). Këto rezultate, në mes tjerash, tregojnë se si sistemi arsimor paralel krijoi një trashëgimi të lidhjeve të qëndrueshme në mes të institucioneve dhe familjeve bamirëse dhe arsimore.

IV. VLERËSIMI SHOQËROR

Kjo kapitull është një analizë e mikro-nivelit se si popullata e Kosovës u ndikua nga konflikti, me theks të posaçëm në arsim dhe sektorin e sigurisë. Nga të anketuarit, këto sektorë u konsideruan si fusha prioritare të shqetësimit, ku shumë pak është ditur për interaksionin ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve lokale në këto sektorë.⁸⁶ Ngjashëm si vlerësimi i institucioneve zyrtare dhe jozyrtare, ky kapitull është i bazuar kryesisht në rezultatet e intervistave dhe diskutimeve grupore të realizuara në pesë vendet reprezentuese, të plotësuara me intervista me zyrtarët lokal dhe reprezentues të grupeve të shoqërisë civile. Ky kapitull, së pari shqyrton përvojat dhe perceptimet e popullatës përkitazi me (i) shkatërrimin e shtëpive, zhvendosjet dhe rindërtimi i shtëpive ; (ii) sigurinë (minat tokësore, kriminaliteti), drejtësinë dhe bashkëjetesën ndëretnike; dhe (iii) problemet e arsimit (shpenzimet e bëra për këtë qëllim, ekskluziviteti shoqëror, mungesa e mjeteve financiare). Pastaj, paraqiten perceptimet e të anketuarëve rreth grupeve më të cenueshme të shoqërisë (ata pa familje, femrat që jetojnë pa meshkuj, të varfërit dhe të papunësuarit, jetimat, vejanet, pensionistët, të sëmurët dhe të traumatizuarit, personat e zhvendosur brenda vendit dhe personat e kthyer), si dhe në çfarë aspekti janë të cenueshëm. Pjesa e tretë e analizës, e bazuar në intervista

⁸⁶ Në sektorin e shëndetësisë, p.sh. një numër i vlerësimeve janë realizuar nga UNFPA/IOM, Spiegel dhe Salama, etj.

dhe diskutime grupore si dhe në burime sekundare shqyrton situatën e pakicave – serbëve, romëve, turqive, sllavëve musliman, duke përfshirë edhe goranët.

Perceptimet e zhvendosjes, shkatërrimi i shtëpive dhe rindërtimi⁸⁷

Pjesa vijuese shkurtimisht përmbledh perceptimet e të anketuarëve përkitazi me zhvendosjet, në mënyrë që të bëjë të mundshme të kuptuarit e pjesës tjetër të vlerësimit shoqëror.

Shkatërrimi i shtëpive dhe zhvendosjet

Shumica e pjesëmarrësve nga grupi i anketuar kanë treguar se kanë përjetuar së paku zhvendosje të përkohshme gjatë konfliktit dhe kanë kërkuar të shkojnë refugjatë në: Shqipëri, Mal të Zi, Maqedoni, Turqi, Evropë Perëndimore ose në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Të tjerët, në veçanti vajzat dhe meshkujt e moshuar, janë fshehur nëpër pyje. Banorët e tërë fshatërave, përfshirë edhe Cërnicën, Llukarën dhe Piranën u dërguan në kufi. Femrat në detaje tregojnë se si meshkujt janë zgjedhur individualisht dhe janë rrahur, ekzekutuar ose burgosur. Në Piranë, të anketuarit i treguan ekipit vlerësues se si ata janë shfrytëzuar si mburojë e gjallë nga forcat serbe, derisa disa anëtarë të pakicave turke nga fshati Mamushë i shoqëruan deri në kufi. Në Gjilan, një tregtar shqiptar është mbrojtur nga forcat paramilitare nga fqiu i tij serb, derisa në Prizren, Serbët vazhdimisht tregonin se ku janë fshehur fqinjët e tyre shqiptarë. Në Prishtinë, meshkujt rrëfenin se si i kanë fshehur armët në vend se të luftonin, për të parandaluar vrasjet politike në shenjë hakmarrje.

Në Prishtinë, disa familje qëndruan në banesat e tyre gjatë luftës, dhe ishin detyruar që fëmijët e tyre t'i mbajnë të qetë të fshehur pas dritareve të errësuar për më tepër se dy muaj. Një numër i banorëve nga fshati janë fshehur nëpër qyteza (Llukarë afër Prishtinës). Sikurse shumë njerëz të tjerë, që jetojnë nën rrethana të vështira të banimit, ata u ankuan për mungesë të hapsirës dhe jetës private, posaçërisht kur disa anëtarë të familjes, në veçanti adoleshentët, ishin të traumatizuar. Familjet që gjatë luftës qëndruan në Prishtinë dhe Gjilan, ku gati se nuk ka pasur shkatërrime të shtëpive, është dashur t'i mbajnë disa kartela me datën e lindjes dhe numrin e fëmijëve të tyre, që disa e quanin “ylli i çifutëve.”

Shumica u kthyen nëpër shtëpitë ose banesat që i lanë. Gati të gjithë i gjetën të vjedhura, dhe ndonjëherë i shihnin gjërat me sytë e tyre tek fqinjët e tyre serb, p.sh. traktor, lodra fëmijësh (Cërnicë), bllok çeqesh (Prishtinë). Shumica e këtyre fqinjëve tani ose kanë shkuar ose janë të mbrojtur, së bashku me gjërat e vjedhura, nga patrolat e KFOR-it (Cërnicë) për hir të bashkëjetesës paqesore. Në shumicën e rasteve, posaçërisht në viset rurale, personat e kthyer i gjetën shtëpitë e tyre të djegura (shtëpia ishte e një rëndësi të madhe simbolike (shif Ndarjen 7).

Ndarja 7. Shtëpia si simbol domethënës shqiptar

Shkatërrimi i shtëpisë simbolikisht është domethënës në një rend shoqëror ku përputhen parimet territoriale dhe farefisnore. Shtëpia, njëkohësisht do të thotë e tërë familja dhe integriteti i saj, dhe shtëpia e madhe nënkuptohet si ekspozim i prestigjit. Familjet e mëdha shqiptare kosovare shpesh i organizojnë familjet e tyre të ngushta sipas “kateve” ose “pullazeve”. Një shtëpi shumëkatëshe e fshatit mund të ketë disa kate, ku njëri kat është i nxënë nga prindërit dhe fëmijët e pamartuar, dhe të tjerët nga djemtë tjerë të martuar dhe familjet e tyre. Një familje e madhe mund të ndahet edhe nëpër shtëpi të ndryshme të lidhura me një oborr. Tërheqja e shqiptarëve në sistemin paralel në vitete e 90-ta imponoi kohezionin në mesin e familjeve të tilla, ndërsa paratë e dërguara nga jashtë, mundësuan që këto familje të ndërtojnë shtëpia të mëdha. Kështu, djegia e shtëpive (në veçanti “pullazeve”) nuk bazohet vetëm në zili. (Disa të anketuar dyshonin se fqinjët e tyre serb kishin zili për shumtë të mëdha të parave të dërguara nga jashtë.) Gjithashtu, kjo nënkupton një sulm të përgjithshëm mbi integritetin e familjes, posaçërisht nëse mashkulli ka kaluar jetën duke punuar jashtë dhe ka sakrifikuar familjen. Kjo është ilustruar në tregimin e një femre të pamartuar të zhvendosur brenda vendit (Gjilan): “Babai nuk më ka parë mua dhe motrat e vëllezërit e mi si janë rritur sepse ka punuar në Zvicër për të ndërtuar këtë shtëpi, të cilën serbët e dogjën në tërësi. Ka shkuar krejt

⁸⁷ Fillimisht, vlerësimi synonte të shqyrtojë sektorin e banesave, por ky sektor vlerësohej nga një numër i agjencive të tjera (UNHCR, IMG, etj.) kështu që u përqëndruam në perceptimet e të anketuarëve.

kot....”Motrat e mia, vëllezërit dhe unë duam të punojmë për të ndërtuar këtë shtëpi.”

Rindërtimi

Programi për përgatitjen dimërore i vitit 1999/2000 për fshatëra, u siguroi pronarëve të shtëpive të kategorisë 4 të shkatërrimeve (d.m.th. shtëpi që mund të riparohen) pullaze dhe materiale tjera për rindërtim, me kusht që ata të marrin fqinjë të tyre të cilët në tërësi i kishin humbur shtëpitë e tyre (kategoria 5 e shkatërrimeve).⁸⁸ Shumica e fqinjëve ishin farefis, por në Cërnice janë pranuar edhe të huaj prej fshatërave tjerë. Në Piranë, shumë fshatarë shqiptarë e kishin kaluar dimrin paraprak duke jetuar 20 persona në një shtëpi të improvizuar vetëm në një dhomë. Në pranverën e vitit 2000, shumica ende jetonin në tenda të siguruar nga komuniteti ndërkombëtar, ose posa ktheheshin nga kampet e Ish RJ të Maqedonisë ose nga Shqipëria. Të tjerët ktheheshin për t'i ndërtuar shtëpitë e tyre, meqenëse dimrin e kishin kaluar me farefis në qytetet e afërta.

Ky është një vullnet i paparë për të ndërtuar shtëpitë e shkatërruara. Në mbarë Kosovën, popullata shfrytëzon ndihmën ndërkombëtare për rindërtim ose punojnë vet apo me ndihmën e farefisit ose fqinjëve për të rifituar tokën e humbur dhe standardin themelor të banimit. Disa familje me shtëpi të shkatërruara të kategorisë së 5-të u ankuan për mosmarrjen e ndihmave për t'i rindërtuar shtëpitë e tyre, ndërsa disa kanë filluar t'i rindërtojnë me mjete private (Piranë). Nëpër qytete ka kryesisht ndërtim pa leje dhe komunat janë duke luftuar për të mbrojtur sërish legalitetin e planifikimit të qytetit (Pejë, Prishtinë) në një kohë kur njerëzit rindërtojnë e konsiderojnë më të rëndësishëm se rregulloret.

Perceptimet e sigurisë, bashkëjetesës ndëretnike dhe drejtësisë

Ambienti i pas luftës me të cilin ballafaqohen shumica e pakicave karakterizohet me kufizim të lirisë dhe lëvizjeve dhe qasje të kufizuar për punësim dhe shërbime, për të mos përmendur shqetësimet dhe dhunën (shif Kapitullin IV, pjesa mbi situatën e pakicave). Mirëpo, të anketuarit shqiptarë potencuan se ata nuk e përkrahin dhunën e vazhdueshme ndëretnike as ndërmarrjen e aksioneve ligjore shtesë për të siguruar drejtësinë. Në vend të kësaj, ata ndiejnë nevojë urgjente për një sistem ligjor që persekuton kundërvajtësit e dhunshëm nga të gjitha komunitetet etnike (shif Ndarjen 8).

Ndarja 8. Drejtësia dhe bashkëjetesa fshatare ndëretnike

Në Cërnice, ku $\frac{1}{4}$ e popullatës janë serbe dhe $\frac{3}{4}$ shqiptare, të ndarë nga njëri tjetri nga postblloku i KFOR-it, një mekanik shqiptar ankohet se një mekanik serb ia ka vjedhur makinerinë. Gati çdo shtëpi shqiptare në këtë fshat ishte e djegur, traktorë dhe pajisje të tjera bujqësore të vjedhura, fusha të minuara dhe bagëti e zhdukur. Fqinjët serb kanë kthyer rreth 10 % të gjërave personale të shqiptarëve duke pohuar se ata i kanë ruajtur gjatë kohës kur shqiptarët kanë qenë refugjatë. Megjithatë, shqiptarët nuk e besojnë këtë. Një komandant i ushtrisë serbe nga Gjilani u tregoi meshkujve shqiptarë se shumica e dëmit ishte bërë nga fqinjët serb në “natën e përgjakshme” të 20 shkurtit, 1999. Shqiptarët ende besojnë se 40 ish paramilitarë ende jetojnë në anën e serbëve. Shqiptarët dorëzuan një listë të gjërave të vjedhura tek komandanti lokal i KFOR-it i cili, për shkak të mungesës së mandatit juridik, nuk kishte mundësi tu ndihmojë. Mekaniku tha, “Unë do jesh mekaniku i parë që do ta padis në gjyq mekanikun serb posa të jetë e mundur një gjë e tillë.” Shqiptarët duan persekutim ligjor: “Kriminelët e luftës të cilët janë përgjegjës për masakra ose zjarrëvënie duhet të arrestohen....të tjerët mund të jetojnë me ne.”

Shumë shqiptarë janë ende të traumatizuar nga keqësimi i situatës gjatë viteve të 90-ta kur kishin marrëdhënie të mira me fqinjët e tyre serb. Disa treguan se fëmijët e tyre luanin bashkë. Arsimitarët treguan për ish kolegët e tyre serb të cilët befasisht filluan t'i injorojnë ata. Prindërit rikujtuan frikën e përditshme kur i dërgonin fëmijët në shkollat paralele shqiptare duke u frikuar se do të merren në pyetje nga policia serbe (Prishtinë, Llukarë). Femrat rikujtuan kur duhej të rrinin në rresht për qumësht dhe bukë kurse kolegët e tyre serb ishin të favorizuar (Gjilani). Gratë shtatëzëna shqetësoheshin kur kërkonin ndihmë mjekësore në spital (Malishevë). Meshkujt e rinj përpiqeshin që të mos bien në sy që t'i shpëtojnë rrahjes apo paraburgimit. Gjatë konfliktit, meshkujt e lagjeve të qytetit dhe fshatit organizuan roje për t'i lajmëruar familjet që të ikin ose të fshehen nga paramilitarët, në shumicën e rasteve pa shpresë për mbrojtje (ku fshati nuk kishte njerëz të involvuar në luftimet e UÇK-së, si në Piranë ose Dragobil). Kjo mbrojtje e organizuar

⁸⁸ Shkalla e shkatërrimit të shtëpive rradhitet prej më të ultës (1) deri tek më e larta (5).

ishite rasti i vetëm i vetorganizimit që zbuloi ekipi vlerësues. Në kohën e vlerësimit, shumica e popullatës jetonin me ndjenjën e re të sigurisë, duke i'u falënderuar prezencës së trupave ndërkombëtare. Ndërsa, në lagje ose fshatëra ku serbët janë larguar, siguria gjithmonë lidhet me këtë fakt: “Ne tani ndihemi të sigurt që të lëvizim” ose “tani që *shkijet* kanë shkuar, ne ndihemi të sigurt” (shif Ndarjen 9).

Ndarja 9. Emërtimet reciproke të serbëve dhe shqiptarëve

Shkijet është termi nënçmues shqiptarë për serbët. Disa treguan se buron nga emërtimi origjinal i paanshëm “schismatics,” d.m.th. ata nga Krishtianizmi ortodoks i lindjes. Serbët përdorin *shiptar* për shqiptarët, që nuk është më pak nënçmues. Kjo origjinën e ka në vetemërtimin e shqiptarëve *shqiptar* që etimologjia popullore e lidh me *shqiponjën*, (si në flamurin kombëtar shqiptar), por që nga pikëpamja linguistike lidhet me *shqiptoj* “të folurit qartë”

Homogjeniteti etnik në një fshat ose ngjashëm në një lagje të qytetit është garancion i sigurisë dhe shumë të anketuar besojnë se gjasat për paraqitjen e problemeve janë shumë më të mëdha në ato lagje ku ka serb. Kështu, Cërnica me një popullatë të përzier është i vetmi vend ku ende ekziston frika nga fshati se sa nga jashtë fshatit. Kjo frikë është rritur kohët e fundit, ku banorët shqiptarë kanë vërejtur se më shumë serb, ndoshta persona të zhvendosur nga Gjilani janë zhvendosur në pjesën e serbëve në fshat. Udhëtimi nëpër këto regjione ku ndodhen një numër i fshatërave homogjene serbe rrezikon sigurinë. Në fshatërat afër kufirit me Malin e Zi, larg nga pika më e afërt e mbrojtjes së KFOR-it, ekziston frikë e madhe nga paramilitarët serb ose provokatorët që e kalojnë kufirin.

Në mënyrë të përmbledhur, do të ishte më adekuate të flasim për frikë etnike se sa për urrejtje etnike në mesin e kosovarëve, shumica e të cilëve nuk janë radikal ose ekstremist. Megjithatë, kjo frikë vazhdon të përjetohej si mosbesimin ndëretnik.

Kërcënimet ndaj sigurisë

Përgjegjet e dhëna në pyetjet rreth kërcënimeve të sigurisë lokale potencojnë faktin se mund të ndodhë që të ketë në shumë frikë ndëretnike se sa urrejtje në Kosovë, që mund të ketë implikime për zhvillimin e institucioneve inkluzive. Përveç frikës ndëretnike, shumë të anketuar rural përmendën minat tokësore si kërcënim, ndërsa të anketuarit urban përmendën kriminalitetin (shif Tabelën 8).

Tabela 8. Kërcënimet ndaj sigurisë

(identifikimi i shumëfishtë ishte i mundur)

Kërcënimet sipas rendit të prioritetit	përqindja/numri i grupeve (prej 40)	Ndarja urbane/rurale	Vërejtjet
Serbët	60 % (26 grupe)	12 urbane 14 rurale	Ky kërcënim u kuptua më shumë si kushtimor: “Po të ishin prezent, po të kthehen prapë, nëse KFOR-i nuk është aty, ku tani ndihen të sigurtë vetëm për shkak se ata janë larguar.”
Minat	47.5 % (19 grupe)	4 urbane/15 rurale	Dominim rural
Kriminaliteti	42.5 % (17 grupe)	12 urbane/5 rurale	Dominim urban, përveç në Gjilan ku nuk ka frikë për shkak të orës policore
Pa rreziqe	2.5 % (1 grup)	urbane	Pejë, meshkuj të rritur urban

Minat tokësore

Të gjitha fshatërat shprehën shqetësimin e tyre për minat tokësore, dhe shumica njihnin fëmijë dhe meshkuj të rinjë të cilët ishin lënduar ose vrarë nga ato. Nga minat është vrarë edhe bagëti. Strategjia e vetme mbrojtëse e mundshme ishte shmanjia. Në Dragobil, ku janë pastruar minat tokësore nga oborri i shkollës, prindërit u tërheqin vërejtjen fëmijëve mos të largohen nga rruga kryesore ose oborri shkollor. Në të gjitha fshatërat, fëmijëve u është tërhequr vërejtja mos të hyjnë në zona të pabanuara ku ka shumë gurë dhe kaçuba. Kur zbulohet ndonjë armatim ose minë, njoftohet fshati lokal ose TMK-ja lokale. Këta zyrtarë lokal e përcjellin informatën në postin më të afërt të KFOR-it i cili informon sektorin për spastrimin e minave.

Kriminaliteti

Gjithashtu ekziston frikë nga kriminaliteti i rritur, posaçërisht në qytetet e mëdha dhe viset në kufi me Shqipërinë dhe Malin e Zi. Edhe pse shumica dërmuese e të anketuarëve thonë se siguria është rritur krahasuar me periudhën para konfliktit, meshkujt e rinjë të Prishtinës, Pejës dhe Prizrenit, ndihen më të frikësuar, në veçanti për shkak të rrezikut nga kidnapimet. Gati të gjithë të anketuarit në të gjitha vendet thanë se ishin të vetëdijshëm për këtë frikë.⁸⁹ Femrat e reja ndërmarrin masa paraprake, siç është udhëtimi në grup apo me anëtarë meshkuj të familjes vetëm gjatë ditës. Në Prizren, femrat e pamartuara kërkojnë ndihmën e vëllezërve dhe supozojnë se do të jenë më të mbrojtura pasi të martohen, dhe shumicën e obligimeve do t'i kryejnë në shtëpi. Në Prizren, femrat e rritura thanë se mbrojtja është më e mirë në familje sa më të mëdha, edhe pse shumica e femrave të reja ende preferojnë të jetojnë në familje të ngushta.

Vakumi i pushtetit shtetëror, neglizhenca e policisë dhe mungesa e sundimit të së drejtës ishin shkaktarë të rritjes së krimeve pas luftës. Megjithatë, tani frigohen nga krimet e reja, siç janë kontrabandimi me drogë, vjedhja e veturave, kidnapimi dhe kërcënimet për vrasje e krime, që konsideroheshin të zhdokura nga shoqëria, por që u përtërinë nga bandat që kalojnë kufirin nga Shqipëria, ekstremistët (përfshirë edhe personat e kthyer), serbët dhe romët e mbetur, ose provokatorët serb nga Mali i Zi (Pejë). Disa gjithashtu, rritjen e shkallës së krimeve e lidhin me varfërinë dhe papunësimin e të rinjëve në Kosovë pas luftës. Personat që merren me tregti ndërkufitare, posaçërisht në Gjilan, Prizren dhe në Pejë përmendën krimet doganore, korrupsionin dhe “mafinit” si pengesa për zhvillimin e tregtisë. Në veçanti, në Prizren, meshkujt dëshironin që të ketë më tepër bashkëpunim në mes të forcave ndërkombëtare dhe policisë shqiptare, dhe duan që policia shqiptare të jetë më e fuqishme dhe më aktive. Disa mendojnë se nuk mund t’ju besohet forcave ndërkombëtare për t’i mbrojtur ata nga krimet, qoftë për arsye se është shumë vështirë apo sepse ata e injorojnë problemin. Në anën tjetër, në Prizren, thirrja e policisë për ndihmë kundër kriminelëve mund të sjellë deri te hakmarrja nga ana e kriminelëve, kështu që, ish luftëtarët e armatosur të UÇK-së e plotësojnë vakumin e pushtetit policor. Pjesëmarrësit shënuan një fatkeqësi në të cilin UÇK-ja i dorëzoi disa vrasës UNMIK-ut, por ata shpejt u liruan për shkak të mangësive të sistemit ligjor. Në një fatkeqësi tjetër, 300 shtëpia serbe u dogjën në Prizren pas luftës dhe askush nga forcat e sigurisë lokale nuk intervenuan.⁹⁰

Kujt duhet besuar për mbështetje?

Shumica e të anketuarëve thanë se, në rast të paraqitjes së problemeve të sigurisë, ata do të kërkonin ndihmë nga forcat ndërkombëtare; d.m.th. KFOR-i dhe policia e UNMIK-ut. Banorët e Gjilanit dhe nga fshati i afërt i Čerņicës janë shumë mirënjohës për sigurinë e ofruar me anë të orës policore dhe patrollave të KFOR-it.

Pikëpamjet për TMK-në, shumica e të cilëve janë ish luftëtarë të UÇK-së janë të paqarta. Atyre nuk u besohet (Pejë); u besohet “vetëm nën komandën e KFOR-it” (Gjilan); ose konsiderohet se nuk kanë “kompetenca të mjaftueshme për të mbajtur rendin dhe qetësinë dhe për të zbatuar ligjin” ose “nuk janë pushtet i vërtetë” sepse u “demilitarizuan.” Të tjerët TMK-në e shohin si të aftë për të luftuar krimet lokale të shkallës më të ulët, dhe kërkonin që ata të bashkëpunojnë më tepër me forcat ndërkombëtare (Prizren, Pejë). Në vende si Malisheva, ku UÇK-ja ka qenë shumë aktive, meshkujt e rritur nuk u besojnë forcave

⁸⁹ Duhet theksuar se kidnapimi ishte një shqetësim i madh në mbarë Kosovën gjatë periudhës së menjëhershme të pas luftës. Që atëherë, sipas disa kritikëve tanë, shqetësimi rreth kësaj çështje ka filluar të bie.

shqiptare, por vetëm atyre ndërkombëtare, ndërsa femrat e rritura, ato të reja dhe meshkujt e rinjë shprehën besim vetëm në TMK-në. Në Pejë dhe Gjilan, thanë se trupat e TMK-së do t'i kuptonin ato më mirë se ato të KFOR-it, sepse TMK-ja e kupton gjuhën dhe kulturën e tyre. Në përgjithësi, femrat fshatare i besojnë këshillit të fshatit, vëllezërve, anëtarëve të tjerë meshkuj të familjes, dhe fqinjëve në rast të emergjencës.

Bashkëjetesa ndëretnike

Në rastet ku të anketuarit kishin pësuar humbje shumë të mëdha, si në Rugovë ose Dragobil, t'i pyesish për perceptimet e bashkëjetesës ndër-etnike në të ardhmen nuk ishte adekuate. Në raste të tjera, të anketuarit refuzuan të përgjigjen në pyetje duke thënë se: “na jepni një apo dy vite para se ta marrim parasysh këtë. Sa vite, apo sa gjenerata duhet të kalonin që Franca dhe Gjermania të bëhen përsëri miq pas luftës?” Intervistuesit, në veçanti e kishin vështirë tu qasen meshkujve për këtë pyetje. Prandaj, shtatë grupe u përjashtuan nga pyetja rreth perspektivës për bashkëjetesën ndëretnike. Grupet e tjera u ndanë rreth pyetjes se a thua bashkëjetesa ndëretnike është e mundur. Në rastet kur grupet u ndanë përafërsisht në mënyrë të barabartë, mendimi është marrë parasysh në të dy kategoritë. Në rastet kur mendimi i një personi ndryshonte nga ai i grupit, mendimi i atij personi nuk është përfshirë në tabelën vijuese. Në tri rastet e intervistave grupe dominonte personaliteti i fuqishëm dhe radikal, kështu që, mendimet më moderne nuk vinin në shprehje. Rasti i tillë ishte me të rejtat në Dragobil (Malishevë), të rejtat e Gjilanit, dhe femrat e rritura të Prishtinës, ku një femër radikale dominoi mbi mendimin e grupit.

Tabela 9. Pikëpamjet për bashkëjetesën ndëretnike në të ardhmen

<i>Pikëpamjet</i>	<i>Numri i grupeve (prej 33)</i>	<i>Lloji i grupit dhe vërejtjet</i>
Po të kishte drejtësi dhe persekutim të krimeve të luftës, do të mund të jetonim me çdokend që nuk është kriminel	13	Dominim urban, të dy gjinitë, të rinjtë dhe të moshuarit, tërë fshati multietnik i Cërnicsës.
E mundshme me kohë, pasi të kalojë një gjeneratë,	3	Femra të reja urbane; meshkuj të rritur rural dhe urban.
Vështirë; Pikëpamjet e serbëve për shqiptarët duhet të ndryshojnë.	4	Të gjitha llojet e grupeve
Asnjëherë më me serbët, por me anëtarë të pakicave të tjera etnike (posaçërisht me turqit, sllavët musliman, goranët), për derisa nuk kanë qenë të përfshirë në krime të luftës. Kishte edhe dilema rreth asaj se a thua romët ishin në anën e serbëve.	12	Prizreni në tërësi ishte i përfaqësuar, përveç meshkujve të rritur; vetëm një grup mendojnë se bashkëjetesa me turqit është e mundshme (të rejtat e Dragobilit).
Nuk është e mundshme që ndonjëherë të jetohet bashkë me serbët.	10	Dragobili dhe Malisheva janë përfaqësuar në tërësi.

Gjithashtu, është me rëndësi të shënohet se një kërkim i realizuar në mbarë Kosovën nga Instituti i Filozofisë dhe Sociologjisë të Universitetit të Prishtinës, ka arritur rezultate të njëjta, ku 48 % e të anketuarëve pajtohen që “pakicat t'i gëzojnë të drejtat e njeriut dhe të drejtat qytetare.”⁹¹

Thirrja për drejtësi

Sot në Kosovë, përkundër përpjekjeve të OSBE-së dhe UNMIK-ut, për të themeluar një gjyqësi multietnike, shumica e gjyqtarëve janë shqiptarë, shumica e të cilëve janë me shkathtësi të zvogëluara për

⁹¹ *Koha Ditore* (2000).

shkak se u përjashtuan nga vendet e tyre të punës gjatë 10 viteve të fundit. Sipas Komitetit të Avokatëve të Drejtave të Njeriut në Angli dhe Wales (BHRC),⁹² kjo situatë krijon mundësi për keqpërdorimin e të drejtave të njeriut. Komiteti shprehu shqetësim se gjyqtarët kosovar shqiptarë lokal nuk do të jenë në gjendje të gjykojnë në mënyrë të drejtë, sepse ata vazhdimisht kërcënohen dhe mitosen. Komiteti rekomandoi që të udhëheqin gjyqtarët ndërkombëtarë në gjykatat e përziera etnike dhe të ketë kontrollë të fortë ndërkombëtare rreth kualifikimit të gjyqtarëve dhe procedurave gjyqësore që ata i udhëheqin.

Gjatë diskutimeve grupore, shumica e kosovarëve ishin në gjendje ta paramendojnë të ardhmen multietnike, nëse persekutohen krimet individuale e luftës. Disa opinione për këto çështje janë prezentuar në Ndarjen 10.

Ndarja 10. Opinione për një të ardhme multietnike

Nga grupet e anketuara:

Asnjë shtet në botë nuk është i përjashtuar nga multietniciteti. Kriminelët që kanë kryer krime të shëmtuara duhet të largohen. Pavarësisht nga kombësia, duhet të silleni si qenie njerëzore, duhet të jeni tolerant. (vajza të shkollës së mesme, Prishtinë).

Nuk ka vend për kriminelët në jetën tonë të përditshme.....ata duhet të nxirren para drejtësisë.....një shoqëri pluraliste nuk integron kriminelëshumica prej tyre ende janë këtu për shkak të mbrojtjes nga KFOR-it. (të reja nga Gjilani).

Shpresojmë se këto dreqën serb kur më nuk do të kthehen (të reja nga Pirani).

Dëshirojmë ta harrojmë të kaluarën dhe të vazhdojmë tutje ----vuajtëm aq shumë në të kaluarën, mirëpo nuk mund të vazhdojmë të jetojmë me të kaluarën. (të reja nga Gjilani).

Nga intervistat:

Përkundër gjithë kësaj, për hir të parimit islamik të tolerancës, jemi për bashkëpunim me serbët e pafajshëm, por kriminelët duhet të nxirren përpara drejtësisë dhe të dënohen në mënyrë adekuate. Përveç këtyre, nuk shohim ndonjë arsye pse serbët mos të jetojnë në Kosovë, dhe t'i gëzojnë të gjitha të drejtat sikurse pakicat tjera (udhëheqës fetar shqiptar).

Gjatë bombardimit, kam folur për paqen, dashurinë, jetën, bashkimin e njerëzve; nuk i kam pranuar kërcënimet dhe vrasjet.....Sot situata nuk është inkurajuese as për shqiptarët. Është e nevojshme që t'i ndjekim njerëzit që kryen krime, pavarësisht a janë shqiptarë apo serb. Njerëzit e pafajshëm nuk duhet të vuajnë, por duhet të mbizotërojë humanizmi. (udhëheqës fetar serb).

Shumica e qytetarëve të urtë/qetë këtu e mbështesin pajtimin. (zyrtar i UNMIK-ut).

Përgjegjësia për vrasjet në Kosovën e pas luftës

Edhe pse mendimet e ndërkombëtarëve dhe vendësve ndryshojnë rreth asaj se kush është përgjegjës për sulmet, vrasjet dhe djegiet e fundit që i bëhen popullatës joshqiptare në Kosovë (shif Ndarjen 11), shifet se ekziston një mendim i përbashkët për ndikimin negativ të këtyre krimeve përkitazi me perspektivën e bashkëjetesës ndëretnike dhe të legjitimitetit të institucioneve politike shqiptare. Disa të anketuar mendojnë

⁹² Bar Human Rights Committee (2000).

se krimet sistematike indikojnë involvim politik në nivel të lartë, ndërsa të tjerët mendonin se dhuna është pasojë e iniciativave individuale ose lokale jashtë kontrollit të autoriteteve qendrore.⁹³

Ndarja 11. Opinionet për përgjegjësit e dhunës

- Vendësit, shqiptarët e frustruar që marrin *hakun e tyre privat* si pjesë e traditave shqiptare (zyrtarë të TMK-së, anëtarë të komunitetit ndërkombëtar, disa shqiptarë).
- Policia ushtarake këmishëzi të UÇK-së, që vepron me apo pa urdhëra dhe është përfshirë gjithashtu në politikat e kërcënimeve (ICG, 2000c).
- 80 % e vrasjeve kanë arsytim politik ekstremist, 20 deri 25 % janë të bazuara në vrasjet hakmarrëse të *kanunit* (të anketuar në Gjilan).
- Vrasje të kontraktuara të paguara nga persona jashtë shtetit (ndërkombëtarët në Prishtinë).
- Ekstremistët nga jashtë; kriminelë nga Shqipëria; persona të kthyer të cilët u bënë më radikal derisa ishin jashtë shtetit (familje në Prizren).
- Më shumë dhunë anonime nga të huajt dhe ekstremistët shqiptarë se sa nga fqinjët ose mafia (famullitar serb).
- Shqiptarët ilegal nga veriu të veshur me uniforma të UÇK-së (hipoteza lokale të cituara nga ICG (2000c).

Perceptimet e arsimit

Për shqiptarët mësimi filloi vonë në vitin 1991-1992, në fillim të periudhës së dhunshme. Kur filluan në janar të vitit 1992, pas një vonese katër muajshe, nxënësit e shkollave të mesme dhe studentët ia mësynë klasave të improvizuara nëpër shtëpi private, shitore, atik dhe podrume. Ky ishte fillimi i sistemit arsimor paralel në Kosovë pasi shqiptarët refuzuan t'i pranojnë planprogramet shtetërore serbe dhe serbët mohuan qasjen e tyre nëpër shkolla.⁹⁴

Shkollimi paralel vazhdoi deri kur filloi konflikti, ku gati të gjitha objektet e shkollave fillore shfrytëzoheshin nga të dy komunitetet, në ndërrime të ndara. Megjithate, të anketuarit shqiptarë u ankuan se koha e njëjtë i dedikohet 100 nxënësve serb dhe 500 nxënësve shqiptarë. Përveç kësaj, nxënësit shqiptarë për nëntë vjet nuk u lejuan ta përdorin sallën e edukatës fizike (Cërnice).

Pas konfliktit, shqiptarët menjëherë i ripërvehtësuan të gjitha objektet shkollore që nuk ishin shkatërruar, dhe i rindërtuan shumë të tjerë me ndihma ndërkombëtare. Vendimet e familjeve të zhvendosura shqiptare për tu kthyer nëpër shtëpitë e tyre ishin ngushtë të lidhura me mundësitë e tyre për shkollim.

Gati të gjithë të anketuarit e grupeve të anketuara, kishin një apo më tepër anëtarë të familjes që vijonin mësimin nëpër shkolla ose universitet, dhe shumica e të anketuarëve ishin nëpër shkolla apo në universitet. Një numër i të rejave që nuk vijonin shkollimin shprehën mllëfin e tyre pse ishin në pozitë më të palakmueshme krahasuar me anëtarët meshkuj të familjes. Shumica e të anketuarëve, të rinjtë dhe të rriturit, arsimin adekuat e shinin si çelës për punësim në të ardhmen, edhe pse disa të rinjë vënë në pah perspektivën e dobët të punësimit në përgjithësi sepse “të gjithë, së pari punësojnë kushëririn e tyre” (Cërnice). Disa thanë se, moshë mesatare e të rinjëve kosovar është me rëndësi që përpjekjet e vendësve dhe ndërkombëtarëve t'i japin përparësi përmirësimit të sistemit arsimor.

Një veçori e dalluar e shkollave shqiptare të Kosovës, në të vërtetë ende dallohet nga ata të grupeve tjera etnike është ajo se ata ende punësojnë një “pedagog”, puna e të cilit nuk është që të mbajë mësim, por t’ju përgjigjet nxënësve për problemet e posaçme shoqërore dhe psikologjike, dhe të veprojnë si ndërmjetës në mes të personelit mësimor dhe nxënësve. Pedagogët janë të organizuar përmes rrjetit profesional. Intervistat

⁹³ Shif ICG (2000b). Ekipi vlerësues kishte përshtypjen se promovimi i pluralizmit etnil nga aktorët ndërkombëtarë kishte filluar t'i ndryshojë pikëpamjet në mesin e kosovarëve.

⁹⁴ Kostovicova (1999).

e rastit që u zhvilluan me pedagogë, treguan vetëdijësimin e tyre të lartë për problemet e përjashtimit dhe mundësive të kufizuara për femrat në viset rurale; dhe vështirësitë e të mësuarit për fëmijët e traumatizuar, si dhe nevojën e marrjes së informative se si duhet përballur këtë problem.

Ndryshimet dhe kontinuiti

Të gjithë të anketuarit shqiptarë vërejtën një përmirësim fundamental në sistemin arsimor krahasuar me periudhën para konfliktit, dhe këtë e ndërlidhin me ripërvehtësimin e objekteve shkollore dhe fundin e sistemit paralel. Ata potencuan se problemet aktuale duhet shikuar nga ky aspekt. Siç e shprehu një i anketuar, “Sot kemi probleme më të mira” (Pejë).

Perceptimet rreth arsimit dhe sigurisë ndryshonin. Një i anketuar tha se “para luftës kishim çdo gjë përveç sigurisë, kurse tani kemi siguri por nuk kemi libra shkollorë” (Dragobil), ndërsa disa të tjerë thanë se kidnapimet kishin ndodhur në oborret e shkollave (Prishtinë), dhe se prezenca e pakicave është kërcënim për fëmijët që udhëtojnë në shkollë (Cërnice). Megjithatë, të gjithë pajtoheshin se situata momentale është më e mirë se “sistemi i apartheidit” para luftës, dhe se nuk ka kërcënime dhe frikë që lidhen me përjashtimin etnik të shqiptarëve. Ata shpjeguan, p.sh. se fëmijët nuk duhet më t’i fshehin librat shkollorë dhe çantat, apo t’i mbajnë fletoret në prehër sepse tani përsëri mund të ndjekin mësimin nëpër shkolla adekuata me banga dhe karrige. Nuk ekziston më frika e shkeljeve të ligjit nga ana e policies serbe kundër studentëve, nxënësve ose arsimtarëve, e as që ka nevojë për roje në vendet ku mbahej shkollimi paralel. Në Pejë, sjellja e serbëve fajësohej për segregacionin aktual etnik gjatë viteve të 90-ta. Megjithatë, në Gjilan, nxënësit treguan se drejtori i shkollës u lejoi serbëve të kthehen nëpër shkolla, por gati të gjithë të rinjtë serb kishin shkuar.

Një ndryshim tjetër në mes të së kaluarës dhe të tanishmes është shqetësimi për financimin e arsimit. Deris a sistemi i arsimit u financua në masë të madhe nga diaspora, sot, sistemi arsimor është duke u ballafaquar me mungesë të mjeteve financiare përkundër ndihmës ndërkombëtare. Derisa shqiptarët janë mirënjohës për ndihmën ndërkombëtare që jepet për rindërtim dhe pajisjen e objekteve (disa kanë bërë salla të reja kompjuterike). Interesimi ndërkombëtar siç duket ka rënë pasi refugjatët u kthyen në fshatërat e tyre dhe filluan t’i ndërtojnë shtëpitë. Në Dragobil dhe Piranë, disa të anketuar potencuan identifikimin e fuqishëm të fshatit me shkollën. Në Cërnice, nxënësit thane se ndërtimi i klasëve të reja dhe dhënia e bangave dhe karrigave të reja ka pasur efekt pozitiv në motivimin e nxënësve dhe në kualitetin e mësimin. Mirëpo, përkundër përmirësimit të kushteve fizike për shkollim, të rinjtë e qytetit, posaçërisht në Prishtinë u ankuan për kualitetin e dobët dhe të tejkualuar të arsimit dhe stilit autoritar të të mësuarit. Një specialist i arsimit nga UNMIK-u në Pejë ishte gjithashtu i shqetësuar për përhapjen e dënimeve fizike nëpër shkolla, që nënkupton nevojën urgjente për trainimin e arsimtarëve. Përveç kësaj, ekipi vlerësues zbuloi pak organizata të prindërve dhe arsimtarëve në mbarë Kosovën, të cilat do të ushtronin autoritetin e tyre për efekte positive në demokratizimin dhe modernizimin e sistemit shoqëror.

Problemet aktuale

Problemet aktuale në sektorin e arsimit përfshijnë shpenzimet e mëdha të shkollimit, kufizimet në qasje, mungesën e angazhimit nga ana e arsimtarëve, dhe kualitetin e mësimin.

Shpenzimet e shkollimit

Të gjithë të anketuarit potencuan pamundësinë e familjeve për siguruar shkollimin për shkak të vështirësive financiare dhe mungesës së parave të gatshme. Në veçanti, në viset rurale, shpenzimet e udhëtimit (shif Ndarjen 12) dhe shkollimit (përfshirë edhe shpenzimet për ushqim të nxënësve) janë shfaqur si probleme kryesore pas konfliktit. Disa familje nuk kanë mundësi të blejnë libra, as edhe veshëmbathjen e nevojshme për fëmijët (Piranë, Malishevë, Pejë), edhe pse disa libra janë shpërndarë përmes ndihmave humanitare (Gjilan).

Ndarja 12. Shpenzimet e udhëtimit për shkollim

- Në Piranë, duhet harxhar 2 DM për një fëmijë në ditë që ai të udhëtojë në shkollë të mesme në

Prizren; një prind i tre fëmijëve shkollarë duhet të paguajë 6 DM në ditë; arsimtarët fitojnë 200 DM në muaj, dhe shumë arsimtarë të fshatit nuk kanë mundësi t'i dërgojnë fëmijët në shkolla të mesme.

- Në Pejë, një burrë me katër fëmijë i dërgon tre djemë në shkollë të mesme çdo ditë, që i kushton 4 DM çdo ditë për secilin. Ai e bën këtë duke huazuar para privatisht.
- Nga fshatërat e bjeshkëve të Rugovës, udhëtimi me autobus kushton 1.50 DM për të kaluar 15 km deri në shkollë të mesme në Pejë, që kushton 3 DM për një fëmijë në ditë. Edhe shkollat fillore mund të jenë me kilometra larg, dhe vazhdimisht humben orët mësimore për shkak të kushteve të vështira klimatike.

Disa familje i përballojnë këto shpenzime të udhëtimit duke i lënë fëmijët e tyre më të vegjël që të jetojnë me farefisën në qytet (Piranë, Prizren). Të tjerët paguajnë banesa për fëmijët e tyre, apo zhvendosen nëpër qytete gjatë periudhave të shkollimit, ku ka shkolla më të mira se në fshatin e tyre. Disa të anketuar vunë në pah nevojën për grante për fëmijët e talentuar nga viset rurale, por që janë në pozitë të palakmueshme (Dragobil).

Kufizimet në qasje

Në veçanti, nxënësit nga fshatërat janë në pozitë të palakmueshme sepse ata duhet të punojnë në ara përveç ndjekjes së mësimi (Cërnica). Pozita e tyre e palakmueshme është e shoqëruar me faktin se shumë të rritur në viset rurale janë analfabet, edhe pse ky problem po trajtohet me aktivitete lokale, siç janë kurset për shkollimin e të rriturve që udhëhiqet nga shoqata "Motrat Qiriazit". Nëpër qytete, disa fëmijë nuk shkojnë në shkollë për të shitur cigare në rrugë, sepse siç thane ata baballarët e tyre nuk punojnë (Pejë).

Fëmijët që jetojnë në vise multietnike janë posaçërisht në rrezik. Fëmijët shqiptarë nga Cërnica duhet të udhëtojnë nëpër një regjion të fshatërave serbe për të ndjekur shkollimin e mesëm në Gjilan. Të anketuarit thane se kjo ishte arsyeja pse u tërhoqën nga shkolla. Megjithatë, fëmijët serb në viset multietnike e kanë problemin e njëjtë; ata gjithashtu, dëshirojnë të ndjekin shkollimin e mesëm në qytet, por lëvizja dhe qasja e tyre është e kufizuar për arsye të sigurisë. Fëmijët e ashkalinjëve të Fushë-Kosovës⁹⁵ varen tërësisht nga procesi mësimor jashtë komunitetit, dhe udhëheqësit e ashkalinjëve u ankuan për fëmijët e këtij grupi minoritar që nuk përfaqësohet nga zyrtarët e sistemit arsimor.

Në Prishtinë dhe Malishevë, të anketuarit folën për vështirësitë e fëmijëve të traumatizuar në të mësuar, dhe nevoja e tyre për shërbime speciale për të lehtësuar risocializimin e tyre.

Varfëria dhe mungesa e sigurisë në viset rurale do të thotë se djemtë favorizohen më tepër se vajzat, kur familjet vendosin se kush do të shkollohet (shif Ndarjen 13), kurse nëpër qytete, ekziston dallim më i vogël në mes të gjinive përkitazi me arsimimin. Përfundimi i vajzave në vise rurale siç duket është rritur në krahasim me periudhën e para luftës kur shkolloheshin më tepër vajza se sa djem, për shkak se shumë djem dhe burra i "mobilizonin" - d.m.th. duhej të migronin për t'i mbajtur familjet e tyre në shtëpi. Kjo situatë, e kombinuar me mungesë qasjeje në arsimin e lartë nën sistemin paralel, ka rezultuar me mungesën e profesionistëve të kualifikuar në Kosovë. P.sh. "është e pamundur të gjejmë një inxhinier 30 vjeçar," u ankua drejtori i Odës ekonomike në Prizren.

Ndarja 13. Kufizimet dhe aspiratat e të rejave nga fshati

Të rejtat në Dragobil, Cërnica dhe Rugovë në veçanti ndihen në pozitë të palakmueshme në krahasim me djemtë, meqenëse atyre nuk u mundësohet shkollimi i mesëm kryesisht për arsye të sigurisë dhe mungesës së parave. Një e re nga Dragoboli tha, "Vëllezërit mund të vazhdojnë shkollimin e mesëm edhe nëse janë budallenjë, kurse vajza shumë të mençura rrinë në shtëpi tërë ditën" Një vajzë nga Rugova që ka vendosur ta vazhdojë shkollimin e mesëm, do të jetojë me farefisën në Pejë. Asaj i vjen shumë keq që ka humbur një vit të shkollimit për shkak të konfliktit dhe shkatërrimeve. Në Cërnica dhe Dragobil të rejtat u ankuan se

⁹⁵ Ashkalinjtë janë një nga tri grupet e romëve që jetojnë në Kosovë. Shif pjesën mbi pakicat.

janë mbyllur në shtëpi, kopsht apo fusha të fshatit, për shkak të mungesës së parave dhe situatës së vështirë të sigurisë. Ata thanë se prindërit e tyre do t'i kishin lejuar të vazhdojnë shkollimin nëse kishin mjete materiale për këtë, sepse përjashtimi i tyre nuk është nga ajo se ata kanë mentalitet të *katundares*. Edhe ata duan të aftësohen për të gjetur punë.

Angazhimi i arsimtarëve

Pagat e pamjaftueshme i detyrojnë arsimtarët që përpos mësimit të merren edhe me aktivitete tjera. “Ata duhet të mendojnë se si t'i sigurojnë bukë familjes, në vend se të mendojnë për kualitetin e mësimit” (Gjilan). Arsimtarët e anglishtes mund të fitojnë shumë më tepër si përkthyes se sa si arsimtarë. Arsimtarët nga fshati merren me bujqësi dhe gjejnë mënyra tjera për të fituar të ardhura. Përveç kësaj, angazhimi i arsimtarëve është i ndikuar edhe nga shpenzimet e larta të udhëtimit, të cilat mund të arrijnë sa 1/3 e pagës së tyre. Si pasojë e kësaj, është zvogëluar numri i arsimtarëve në Kosovën e pas konfliktit, ndërsa ata që kanë mbetur nuk kanë motivim.

Në Universitetin e Prishtinës, profesorët dhe studentët janë të frustruar pse nuk mund të marrin pjesë në tregun e ri të punës të folëseve të anglishtes, të krijuar nga komuniteti ndërkombëtarë. “Nuk do të thotë se vetëm ata që janë më inteligjent dinë të shprehen mire në gjuhën angleze, por ata gjejnë punë,” tha shefi i katedrës së Sociologjisë/Filozofisë, duke shtuar se kuadrat lokale mbikëqyren nga kuadra ndërkombëtarë. Gjithashtu, u vunë në pah pagat e vogla në universitet, posaçërisht kur krahasohen me ata që ofron komuniteti ndërkombëtar, gjë që ul motivimin e profesorëve.

Kualiteti i mësimit dhe pajisjet

Shumica e të anketuarëve potencuan nevojën për reforma, riorganizim të planprogrameve dhe aftësim profesional. Me sistemin paralel ka qenë e pamundur të sigurohet trainimi praktik ose materiale ilustrative, kështu që të gjitha lëndët (kimia, fizika, sporti dhe çdo gjë profesionale) nuk ishte mësuar, duke i lënë studentët që të fitojnë përshtypjen se arsimimi është shumë i mërzitshëm dhe teorik për t'i përgatitur ata për jetë. Disa vajza nga Cërnica thanë se lëndët ishin “vetëm shembuj” që nuk mund të shëndërrohen në realitet. Të gjithë arsimtarët, prindërit, studentët e nxënësit u ankuan për mungesën e laboratorumeve, kompjuterëve dhe pajisjeve teknike për procesin mësimor. Derisa shumica e pajisjeve u shkatërruan ose u vodhën gjatë konfliktit (Cërnice), objektet dhe inventari, në të shumtën e rasteve, janë shumë të vjetëruara, me vjetërsi deri në 30 vjet” (Pejë), - edhe pse disa shkolla kanë marrë pako speciale të ndihmave ose aparate fotokopjimi. Gjithashtu, përmendën mungesën e lëndëve për ngrohje.

Të anketuarit e theksuan nevojën për “Standarde evropiane” në arsim. Femrat lëvduan metodat e reja transparente të të mësuarit dhe involvimit të prindërve në arsimin parashkollor, dhe këto metoda u implementuan si kusht për mbështetje në rindërtim nga donatorët ndërkombëtarë (Prishtinë).

Studentët e Universitetit të Prishtinës potencuan moskonsistencën në mes të shkollimit të mesëm dhe atij të lartë. Në Prishtinë, studentët shtuan se kualiteti i mësimit ka rënë krahasuar me periudhën e paraluftës, sepse arsimtarët nuk janë adaptuar në situatën e re dhe se klasët janë të stërngarkuara me student. Idealizmin e humbur të arsimtarëve disa e lidhën me faktin e disfatës së armikut të përbashkët kombëtarë – që inspiroi ndjenjën e kohezionit dhe detyrimit. Megjithatë, të tjerët tërhoqën vërejtjen se “shkolla nuk duhet të jetë vend i politizimit” (Cërnice). Planprogramet në disa vende përmbajnë materiale nacionaliste.

Probleme tjera

Disa shkolla janë të ndërtuara afër rrugëve kryesore që në rastin e Piranës dhe Dragobillit e ndajnë fshatin. Nuk ka mjete për kalimin e rrugës, siç janë dritat e trafikut, tunelet apo urat; dhe as nuk ka barriera në rrugë. Në Piranë, kanë ndodhur disa fatkeqësi të rënda ku janë vvarë disa fëmijë të fshatit - shtatë për një herë në një fatkeqësi të fundit.

Perceptimet e grupeve të cënueshme dhe arsyt e cënueshmërisë së tyre

Ekzistonte një mendim i përbashkët në mesin e shqiptarëve rreth grupeve të cenueshme në fshatërat e tyre dhe nëpër lagje si dhe në mbarë Kosovën në tërësi. Të anketuarit e 40 grupeve ishin lutur që të emërojnë sa më shumë grupe të cenueshme që dinë (çdo grup i anketuar u numërua vetëm një herë në çdo kategori). Rezultatet e dhëna në Tabelën 10 tregojnë se kosovarët familjen ende e shohin si garancën më të madhe, dhe ata pa familje i konsiderojnë si anëtarë më të cenueshëm të shoqërisë. Në veçanti, më të cenueshme janë femrat që i kanë humbur meshkujt, fëmijët pa etër dhe vëllezër, të moshuarit pa fëmijë, të sëmurët dhe të hendikepuarit pa familje për tu kujdesur për ta, dhe të tjerët pa meshkuj për t'i mbajtur ata përmes punës së tyre. Megjithatë, cenueshmëria për shkak të varfërisë, papunësisë dhe strehimit të humbur gjithmonë ndikojnë në mbarë familjen. Edhe pse të anketuarëve nuk u ishte shtruar pyetja se cialt janë regjionet me popullatë më të cenueshme, ata potencuan disa regjione që pësuan humbje më të mëdha në njerëz dhe shkatërrim të shtëpive, siç janë Drenica, komuna e Gjakovës dhe fshatërat e Piranës dhe Dragobilit. Ata vënë në pah se, në rrethana të tilla, pak ka gjasa për solidaritet nga fshatërat jashtë familjes së tyre. Të anketuarit nga Prizreni gjithashtu potencuan se 104 fëmijë jetimë janë duke jetuar në një fshat afër Lllupishtes (Has) Atributet specifike të grupeve të shënuara në Tabelën 10 janë përfshirë në Shtojcën III, tabelat 1-8.

Tabela 10. Grupet e cenueshme

Grupet më të cenueshme	përqindja/numri i grupeve (prej 40)	Lloji i grupit
Ata pa familje, në veçanti pa meshkuj		Çfarëdo
Të moshuarit	57.5 % (23 grupe)	Çfarëdo
Ata që humbën strehun dhe pasurinë	55 % (22 grupe)	Çfarëdo
Të papunësuarit ose të varfërit	42.5 % (17 grupe)	Çfarëdo
Të hendikepuarit ose invalidët	37.5 % (15 grupe)	Meshkuj dhe femra, të moshuar dhe të rinjë, 10 urbane dhe 5 rurale
Femra	15 % (6 grupe)	3 femra nga vise rurale dhe 2 urbane, 1 meshkuj të rinjë nga vise urbane
Të rinjtë	12.5 % (5 grupe)	vetëm femra, 4 rurale, 1 urbane
Të sëmurët dhe të traumatizuarit	10 % (4 grupe)	3 femra, 1 meshkuj, rurale dhe urbane
Kombinim	10 % (4 grupe)	Çfarëdo
Meshkuj	2.5 % (1 grup)	Femra nga vise urbane (Gjilan)
Ata me familje shumë të mëdha	2.5 % (1 grup)	Meshkuj të rinjë nga vise rurale (Piranë)

Opinionet e grave për kufizimet e solidaritetit familjar

Derisa meshkujt ndihen përgjegjës për gratë dhe fëmijët, dhe një grup i grave ishte mirënjohës për këtë përgjegjësi të madhe të meshkujve, Gratë janë shumë më të vetëdijshme për kufizimet e solidaritetit familjar dhe cenueshmërinë si pasojë e përjashtimit nga shoqëria më e gjërë. Të rejat e një familje të madhe në Piranë, p. sh. shprehën shqetësimin e tyre për një nënë e cila ishte dashur të kthehej në familjen ku ka lindur dhe t'i lë fëmijët pasi i kishte vdekur burri “pse nuk ishte e lidhur përmes gjakut në familjen.”⁹⁶ Gjithashtu, femrat ishin ata të cilat e potencuan rrezikun nga papunësia dhe kriminaliteti; cenueshmërinë e të moshuarëve, të sëmurëve dhe të hendikepuarëve, dhe të cilat theksuan nevojën e këtyre individëve për shërbime sociale - të cilat ishin si rezultat i kufizimeve të solidaritetit familjar. Kjo siç duket konfirmon

⁹⁶ Raporte të UNIFEM-it (2000) “një shkallë alarmuese e dëbimeve” të vejaneve të reja nga shtëpitë e familjeve të burrit të tyre.

vrojtimet e mëhershme⁹⁷, se femrat janë burim i kapitalit shoqëror të huazuar në Kosovë; që edhe në situata të mbijetesës, kur familja e madhe supozohet të jetë primare. Ata janë të vetëdijshme për situatën e të tjerëve, dhe shpesh veprojnë si ndërmjetës dhe ndërlidhës në mes të strukturave tradicionale dhe individëve e grupeve të jashtme.

Cenueshmëria e femrës

Një çështje që nuk doli në sipërfaqe nga diskutimet e grupeve të anketuara ishte shkalla deri në ç'masë familja e madhe mund të jetë burim i rrezikshëm për gruan. Vejanet që detyrohen ta lënë shtëpinë e familjes së burrit të vdekur mund të humbin jo vetëm fëmijët por edhe tokën e tyre, dhe kështu rrisin shkallën e cenueshmërisë dhe izolimit të tyre. Shumica e këtyre vejaneve janë të reja, të traumatizuara, të pavetëdijshme për të drejtat e tyre ligjore, shpesh pa dokumentacion, dhe me paaftësi fitimprurëse, posaçërisht në viset rurale.⁹⁸ Në raste të pakta, ku femrat janë bashkuar për të filluar biznese të vogla, janë kritikuar ashpër nga meshkujt e komunitetit pse nuk i kanë mbajtur zi burrat një kohë më të gjatë. Ky grup i pafuqishëm dhe i izoluar kanë marrë ndihma të vogla nga organizatat ndërkombëtare, edhe pse numri i tyre është vlerësuar në 10,000 apo më tepër.⁹⁹

Gjithashtu, Kosova ka një përqindje të lartë të femrave të dhunuara gjatë konfliktit - rreth 4 % e popullatës femërore ka treguar se është dhunuar dhe numrat e vërtetë ndoshta janë shumë më të lartë.¹⁰⁰ Pak ka gjasa që këto femra të pranojnë këshillime për dhunim ose traumatizim; përkundrazi, ato shpesh bëhen burim turpi për familjet e tyre, dhe si pasojë e kësaj mund të mos i lejojnë ta përfundojnë shkollimin e tyre ose të punojnë jashtë shtëpisë, edhe pse arsimimi dhe mundësitë ekonomike në përmasa të mëdha janë të njohura nga organizatat ndërkombëtare dhe nga vetë gratë, si një nga nevojat më të rëndësishme përkitazi me sigurinë dhe mirëqenien e tyre.¹⁰¹ Edhe një herë po e përmendim se, në këtë aspekt, femrat që jetojnë në familje të mëdha fshatare janë më të cenueshme. Në disa fshatëra përreth kufirit me Shqipërinë, p. sh. vajzat mund të shiten për martesë deri në 20,000 DM para se arrijnë moshën për shkollim të mesëm. Pra, vendimi për ta dërguar vajzën në shkollë të mesme ka implikime të mëdha financiare për familjen. Përveç kësaj, femrat që jetojnë në familje të mëdha janë në rrezik më të madh nga dhuna, jo vetëm nga bashkëshorti, por edhe nga nëna dhe motrat e bashkëshortit, si dhe të kunatave.¹⁰²

Cenueshmëritë e IDP-ve (personave të zhvendosur brenda vendit)

Edhe pse ka pak informata të besueshme për numrin e përgjithshëm të IDP-ve në Kosovë, është e qartë se ata përbëjnë pjesën më të madhe të popullatës të përqëndruar nëpër qytete, si në Prishtinë,¹⁰³ Prizren dhe Pejë. Bazuar në intervistat me IDP-të, shumica nuk janë kthyer sepse shtëpitë e tyre nuk janë riparuar, nuk kanë kushte për arsimim apo nuk kanë qasje në tokën e tyre bujqësore për shkak të minave. Të tjerët nuk duan tu nënshirohen programeve për aftësim profesional të udhëhequra nga OJQ-të, apo t'i lënë bizneset e vogla që i filluan gjatë zhvendosjeve; ose ata presin për stimulime siç janë huatë e vogla për blerjen e bagëtisë ose materialit ndërtimor. Disa kanë potencuar gjithashtu dëshirën e tyre për t'ju ikur disa traditave specifike. Vejanet e luftës, p. sh. ndoshta nuk duan të kthehen për shkak të cenueshmërisë së tyre ekonomike dhe shoqërore të shoqëruar me statusin e tyre të ri. Disa meshkuj thanë se nuk duan të ngatërrohen në traditat, siç janë gjakmarrjet.

Shumica e IDP-ve që jetojnë nëpër qytete nuk janë të regjistruar, edhe pse disa janë regjistruar në fshatërat e tyre, dhe shkojnë atje për të kërkuar ndihma humanitare (Rugovë). Disa jetojnë me farefisën, disa në

⁹⁷ Shif p. sh. Backer (1983).

⁹⁸ EWD (1999)

⁹⁹ EWD (1999)

¹⁰⁰ Raporti për katër përqind të femrave shqiptare kosovare të dhunuara nga trupat serbe paraqet përpykje të qëllimshme për të demoralizuar popullatën. Shif UNIFEM (2000).

¹⁰¹ UNIFEM (2000).

¹⁰² UNIFEM (2000).

¹⁰³ Sipas vlerësimeve të WFP/FAO, gjatë dimrit të vitit 1999-2000, 200,000 IDP ishin të regjistruar për ndihma ushqimore në Prishtinë.

shtëpitë e të afërmive që jetojnë jashtë apo në qendra kolektive. Të tjerët jetojnë në banesa, shtëpi, apo në podrume që dikur u takonin serbëve. Në disa raste, serbët e kanë shitur pasurinë e tyre dhe kanë blerë pasuri në enklavat serbe ose në pasurinë e Serbisë; në shumë raste kjo pasuri ka qenë e braktisur. Në një hapsirë ndërtimi në Prishtinë, vazhdimisht janë duke ardhur ndihma ushqimore nga një organizatë humanitare arabe të cilat shpërndahen kryefamiljarëve nga një këshill i vetorganizuar; por ekzistojnë probleme të shoqëruara me ujin, higjienën publike dhe kriminalitetin. Përveç kësaj, shumica e qytetarëve i fajësojnë IDP-të, shumica e të cilëve janë nga viset rurale për rënien e pastërtisë publike dhe rendit. Kjo urrejtje e rrit pasigurinë e IDP-ve, shumica e të cilëve i frikohen të ardhmes së tyre të pasigurt.

Cenueshmëria e personave të kthyer

Një numër i madh i shqiptarëve kosovar të cilët ishin në shtetet evropiane si refugjatë ose azilkërkues ose kanë qenë nën masa të tjera të përkohshme mbrojtëse janë duke u kthyer. Ndërmjet qershorit dhe shtatorit të vitit 2000, p.sh. në krahinë janë kthyer 41,500 shqiptarë kosovar. Kjo ka bërë një presion të jashtëzakonshëm në strehimin, arsimimin, shëndetësinë dhe sektorin e punësimit. Përveç kësaj, ky proces po shkakton një shqetësim të madh për ata familje të cilat jetojnë nga paratë e dërguara nga jashtë për të mbijetuar (shif Kapitullin V, Vlerësimi i Diasporës). Serbët, romët dhe grupe tjera etnike gjithashtu, figurojnë në listat e rasteve të shumë shteteve evropiane, ndonëse në numra më të vogël. Për shkak të çështjeve të sigurisë lidhur me këto grupe, luten qeveritë evropiane që mos t'i kthejnë prapë në krahinë derisa kushtet janë më të favorshme. Disa anëtarë të këtyre grupeve janë regjistruar si shqiptarë etnik gjatë krizës për të fituar status azili më të volitshëm. Së fundi, UNHCR-i ka vlerësuar një numër të përgjithshëm prej 180,000 dhe 30,000 IDP-ve nga Kosova në Serbi, respektivisht Mal të Zi, ku shumica e të cilëve e lëshuan Kosovën pas vendosjes së UNMIK-ut.¹⁰⁴

Situata e pakicave

Siç është shënuar në Kapitullin II, gati gjysma e popullatës minoritare të para luftës prej 347,000 (regjistrim i përgjithshëm i vitit 1991) e lëshuan krahinën gjatë 18 muajve të kaluar. Bazuar në raportin e gjashtë të përbashkët mbi pakicat të UNHCR/OSCE,¹⁰⁵ situata për shumicën e pakicave të mbetura mbetet e pasigurt. Edhe pse është zvogëluar shkalla e krimeve të rënda, vazhdojnë sulmet dhe kërcënimet e motivuara në baza etnike në mbarë krahinën. Si pasojë, pakicat përballen me kufizime të mëdha të lirisë dhe lëvizjes, dhe qasjes për punësim dhe shërbime shoqërore, siç janë kujdesi shëndetësor dhe arsimimi - një proces i përjashtimit që pakicat kosovare i bënë shoqërisht dhe ekonomikisht të cenueshme. Bazuar në informatat e kufizuara (ndonjëherë edhe kontradiktore) që i posedojnë këto grupe nga intervistat me serb, rom, slla musliman dhe nga komuniteti turk, ekipi vlerësues u përpoq të shënojë llojet dhe shkallët e ndryshme të cenueshmërisë dhe perspektivën e çdo grupi për bashkëjetesë dhe pajtim me popullatën shumicë shqiptare. Rezultatet kryesore janë si vijon:

- Serbët mund të konsiderohen ekonomikisht më pak të cenueshëm se sa grupet e tjera sepse ata kanë qasje në tokën e tyre dhe bagëtinë, në paga, ndonëse jo të rregullta dhe të vogla nga Beogradi. Megjithatë, ata nuk mund të mbështeten në rrjetin e madh familjar dhe paratë e dërguara nga jashtë siç bënë shqiptarët gjatë dhe pas krizës së fundit. Mirëpo, ajo çka është më me rëndësi, ata kanë përjetuar sulme hakmarrëse dhe zhvendosje më të rënda, dhe ata që kanë mbetur përballen me kufizime të mëdha të lirisë dhe lëvizjeve që ka rezultuar në krijimin e një administrate paralele. Kështu, ky grup përballen me sfidat më të vështira sa i përket bashkëjetesës dhe pajtimit me popullatën shumicë shqiptare.
- Romët janë shoqërisht dhe ekonomikisht më të përjashtuar dhe popullata më e cenueshme. Kanë përjetuar dhunë dhe zhvendosje të llojllojshme të cilët edhe para luftës ishin në pozitë të palakmueshme dhe të varfër, me pak qasje në tokë, bagëti dhe punësim zyrtar. Për më tepër, për dallim nga serbët, ata nuk kanë qasje në pagesa, siç janë pensionet dhe ndihmat sociale nga qeveria e Jugosllavisë. Mirëpo, perspektivat e tyre për bashkëjetesë me shqiptarët, përveç izolimit shoqëror dhe ekonomik, relativisht janë më të mira se sa për serbët.

¹⁰⁴ UNHCR/OSCE (2000c).

¹⁰⁵

- Sllavët musliman janë më pak të cenusshëm nga aspekti shoqëror dhe ekonomik se sa serbët apo romët. Para luftës, ata ishin një grup relativisht i pasur, me të arritura të mëdha arsimore dhe aktivitete sipërmarrëse. Në të njëjtën kohë, ata kanë përjetuar dhunë me motive etnike dhe përjashtime për shkak të lidhjeve të tyre gjuhësore me serbët. Kjo në veçanti është e vërtetë për goranët, të cilët siç duket po përjetojnë më tepër përjashtime shoqërore se sa sllavët musliman. Megjithatë, sllavët musliman kanë perspektiva më të mira për bashkëjetesë dhe integrim ekonomik për shkak të lidhjeve të tyre religjioze me popullatën shqiptare.
- Turqit janë grupi që më së pakti është i cenusshëm në Kosovë, për shkak të lidhjeve të tyre të ngushta me popullatën shqiptare dhe aftësitë e tyre sipërmarrëse. Ata kanë përjetuar më pak sulme hakmarrëse dhe zhvendosje. Perspektivat për përfshirjen shoqërore dhe ekonomike janë më të mirat për këtë grup të pakicave.

Më në fund, është me rëndësi të kihet parasysh se, edhe nëse situata politike stabilizohet, mosnjohja e gjuhës shqipe për shumicën e pakicave në Kosovë do të mbetet pengesë kryesore për riintegrim. Më tepër detaje për situatën e çdo grupi janë thënë në vazhdim.

Serbët

Pullata serbe e Kosovës së para luftës prej rreth 195,000 (regjistrimi i përgjithshëm i vitit 1991) është përqëndruar në katër regjione: (i) regjioni veriperëndimor, që kufizohet me Serbine dhe përfshin edhe Mitrovicën;¹⁰⁶ (ii) regjionet lindore dhe qendrore relativisht pjellore, përfshirë edhe Fushë Kosovën, Ferizajin dhe Gjiljanin; (iii) komuna e izoluar jugore e Shtërpces; dhe (iv) pjesë tjera të krahinës, përfshirë Prizrenin, Rahovecin dhe fshatërat përreth Pejës. Më se gjysma e kësaj popullate u vendos në regjionet lindore dhe qendrore.¹⁰⁷

Kjo popullatë kishte një mënyrë jetese të ngjashme me atë të shqiptarëve me këto dallime: (i) serbët posedonin më tepër tokë për një individ, për shkak të numrit më të vogël të anëtarëve të familjes (pesë krahasuar me dhjetë për popullatën shqiptare); (ii) sasia e parave të gatshme për person ishte e ngjashme për serbët dhe shqiptarët, por burimi i tyre ishte i ndryshëm (punësimi në sektorin publik për serbët dhe paratë e dërguara për shqiptarët); dhe (iii) serbët gëzonin një shkallë më të ulët të mbështetjes farefisnore edhe brenda komunitetit se sa shqiptarët.¹⁰⁸

Edhe pse ekziston një bindje e përgjithshme se serbët u larguan me tërheqjen e forcave jugosllave, ende është prezent mendimi për fajësinë kolektive. Në këtë drejtim, e tërë popullata serbe e mbetur konsiderohet se është në shënjestër të ekstremistëve kosovar të komunitetit shqiptarë. Ka shumë raste kur serbët e moshuar (të cenusshëm) bien viktima të dhunës. Si rezultat i kësaj, ka pasuar egzod masiv për në Serbi dhe Mal të Zi, dhe krijim të enklavave monoetnike brenda Kosovës. Vlerësohet se gati gjysma e popullatës së para luftës e kanë lëshuar krahinën që nga shtatori i vitit 1999.¹⁰⁹

Duhet potencuar dy aspekte të këtij modeli të migrimit. Së pari, shumica e atyre që e lëshojnë krahinën janë të rinjë dhe të aftë, dhe ata që mbesin në masë të madhe janë të moshuarit e cenusshëm, të paafit dhe familjet me një prind. E dyta, siç është shënuar në Kapitullin II, forma mbizotëruese e zhvendosjeve të brendshme është nga viset urbane në ato rurale, meqenëse viset rurale ofrojnë kushte më të mira të sigurisë dhe qasje në prodhimet bujqësore dhe të bagëtisë. Në krahasim me popullatën shqiptare, që si pasojë e konfliktit më tepër është urbanizuar, përqindja e popullatës serbe që jetojnë në viset rurale është rritur prej 60 % deri në 80 %.¹¹⁰ Këto zhvendosje nga qyteti në fshat dhe krijimi i

¹⁰⁶ Bazuar në ICG (2000c), pjesa më e madhe e zonave serbe në veri të Mitrovicës, Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit iu bashkangjitën Kosovës në vitin 1997 nga autoritetet republikane serbe për të rritur numrin e serbëve në krahinë.

¹⁰⁷ WFP/UNHCR (1999b).

¹⁰⁸ WFP/UNHCR (1999b).

¹⁰⁹ WFP/UNHCR (1999b).

¹¹⁰ WFP/UNHCR (1999b).

enklavave serbe kanë rezultuar me shpërndarje të re gjeografike të popullatës të përshkruar në Kapitullin II.

Përveç zhvendosjeve masive, situata e sigurisë gjithashtu ka pasur një ndikim të rëndësishëm në mënyrën e jetesës të popullatës së mbetur serbe. Në shumicën e viseve urbane dhe vise të tjera etnikisht heterogjene ku numri i tyre është reduktuar në disa familje, shumica e serbëve nuk kanë mundësi t'i lëshojnë shtëpitë e tyre, kanë qasje të pakta në të ardhura dhe kërkojnë mbrojtjen e KFOR-it dhe ndihma humanitare. Në viset rurale dhe zonat etnikisht homogjene, situata është diç më e mirë, posaçërisht aty ku serbët kanë qasje në prodhime bujqësore dhe të bagëtisë. Bujqit serb kanë pasur sukses të mbjellin dhe korrin (në shumë raste me ndihmën e mbrojtjes së KFOR-it), por qasja e tyre e kufizuar tek mullinjtë, tregjet dhe punësimi ka rezultuar me zvogëlimin e të ardhurave. Mirëpo, ky izolim nuk është gjithkund. Disa serbë kanë qasje në tregjet e Kosovës veriperëndimore, Serbisë dhe Malit të Zi, ku shpesh herë kërkojnë përcjelljen e KFOR-it. Këto përcjellje të KFOR-it u mundësojnë serbëve t'i marrin pensionet dhe pagesat tjera nga autoritetet jugosllave.¹¹¹ Vetëm në pjesën veriperëndimore të krahinës, serbët nuk përballen me kufizime të mëdha të sigurisë dhe kanë qasje në punësim dhe lehtë i transferojnë paratë e gatshme. Mirëpo, ky regjion ende vuan nga dëmet e ekonomisë së Serbisë, të shkaktuara për shkak të sanksioneve.¹¹²

Sa i përket sigurimit të shërbimeve shoqërore, UNMIK-u siç duket ndjek politikën e bashkëjetesës në vend të multietnicitetit.¹¹³ Në sektorin e arsimit, p.sh. serbët dhe shqiptarët kanë planprograme të ndryshme mësimore, dhe, në të shumtën e rasteve mësimin e mbajnë në shkolla të veçanta. Në sektorin e shëndetësisë, janë duke u themeluar objekte paralele, ku shumica e enklavave kanë qasje në kujdesin shëndetësor primar, që u sigurohet nga pjesëtarët e komunitetit të tyre. Edhe pse programet e transferimit të parave ende nuk kanë filluar, kanalet e dërgimit paralel janë të pashmangshme.

Në intervistat me ekipin vlerësues, serbët në Gjilan shprehën frustrimin e tyre për nevojën që të jetojnë nën mbrojtjen e KFOR-it, për përcjellje të shkojnë dhe të vijnë nga puna në komunitetin ndërkombëtar. Një mbrojtje të tillë kërkojnë gjithashtu kur shkojnë për kujdes shëndetësor në Serbi. Të anketuarit nëpër fshatëra thanë se snajperistët vazhdojnë t'i gjuajnë ata kur punojnë në fushë, edhe pse trupat e KFOR-it janë aty pranë. Duke pasur parasysh këto rrethana, shumica e familjeve, fëmijët e tyre i dërgojnë në Serbi.¹¹⁴ Të tjerët radikalizohen dhe zhvillojnë lidhje të ngushta me Serbinë, duke u mbështetur ekskluzivisht në radio stacionet e Beogradit dhe gazetata e tyre për informim. Shqetësimet më evidente të shumicës së serbëve ishin "liria, ushqimi dhe punësimi."

Participimi politik serb në SPPA përfshin Këshillin nacional serb (KNS), i cili ka status të vëzhguesit në Këshillin e Përkohshëm Administrativ (KPA), së bashku me katër pjesëmarrës të Këshillit Tranzitor të Kosovës (KTK).

Romët

Duke u bazuar në raportin e UNHCR/OSCE-së mbi pakicat në Kosovë, në këtë vlerësim nocioni romë përdoret si term inkluziv duke u qartësuar kur u referohemi komuniteteve specifike: romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve. "Romët etnik" e identifikojnë vehten e tyre si romë, flasin gjuhën rome, si dhe gjuhën shqipe dhe/ose serbokroate, dhe kanë lidhje me komunitetin rom në vendet tjera.¹¹⁵ Ashkalinjtë flasin shqip dhe vetvehten e identifikojnë si shqiptarë, edhe pse nga shqiptarët etnik ata trajtohen ndryshe. Egjiptianët gjithashtu distancohen nga romët etnik dhe flasin gjuhën shqipe, por

¹¹¹ WFP/UNHCR (1999b)

¹¹² ICG (2000c)

¹¹³ Banka Botërore (2000e).

¹¹⁴ Bazuar në WFP/UNHCR (1999b) vendimet lidhur me zhvendosjen, përcillen me shqetësime të shumta, ku siguria është shqetësimi kryesor. Qasja në ushqim siç duket është sekundare.

¹¹⁵ Sipas Polansky (2000), romët etnik të Kosovës janë një ndër komunitetet e rralla të romëve në Evropë që e kanë ruajtur sistemin e tyre shoqëror të hindusve.

pohojnë se paraardhësit e tyre erdhën nga India¹¹⁶ përmes Egjiptit. Shqiptarët kosovar këtë grup të tretë e konsiderojnë si romë ose ashkalinjë; para dhjetë vitesh u krijua ky identitet i veçantë nga autoritetet e Beogradit për të dhënë një pasqyrë të multiethnicitetit, e jo të dominimit shqiptar në Kosovë. Megjithatë, egjiptianët duan të trajtohen si shqiptarë. Edhe ashkalinjtë edhe egjiptianët janë të fesë munslimane, kurse romët etnik mund të jenë orthodox (siç janë romët çergarë), katolik apo musliman.¹¹⁷

Komuniteti i romëve është i përqëndruar në pjesën lindore (Ferizaj) dhe jugperëndimore (Pejë, Gjakovë dhe Prizren) të Kosovës. Siç është shënuar në Kapitullin II, ka mospajtime për numrin e këtyre komuniteteve para dhe pas konfliktit, duke pasur parasysh natyrën e komplikuar të përcaktimit të tyre etnik. Regjistrimi i përgjithshëm jugosllav i vitit 1991 shënon 43,000, por besohet se ky numër është më i vogël, duke ditur bojkotimin e shumë ashkalinjëve dhe egjiptianëve. Një ekspert i romëve ka vlerësuar se 150,000 romë kanë jetuar në 300 bashkësi para konfliktit.¹¹⁸ Së fundi, UNHCR vlerëson se numri i romëve të zhvendosur prej Kosove për në Serbi dhe Mal të Zi është ndërmjet 40,000 - 50,000, ku shumica janë larguar nga krahina pas arritjes së UNMIK-ut, Një numër i romëve të zhvendosur janë duke jetuar në Gjermani, Itali dhe shtete të tjera.¹¹⁹

Sikurse popullatë romë në pjesë tjera të Evropës, ashtu edhe romët e Kosovës, kanë qenë një grup i varfër dhe i marginalizuar,¹²⁰ me qasje të kufizuara në tokë bujqësore, bagëti dhe punësim zyrtar. Tradicionalisht, ata kanë fituar mjete jetese nga punët e rastit, më së shumti në bujqësi, dhe si tregtar endacak. Përveç kësaj, ndërmjet 10 dhe 20 % të romëve të Kosovës¹²¹, marrin para të dërguara nga të afërmit që jetojnë jashtë, krahasuar me gati gjysmën e popullatës shqiptare.¹²²

Shqiptarët besojnë se disa romë, posaçërisht ata etnik, bashkëpunuan me serbët dhe morrën pjesë në shkatërrimet dhe vjedhjet e pasurisë së shqiptarëve. Këto perceptime kanë rezultuar në sulme kundër mijëra romëve kosovar të zhvendosur, brenda dhe jashtë krahinës. Megjithatë, është me rëndësi të potencohet se, shumica e atyre që kanë mbetur, besohet se janë të pafajshëm, sidomos ashkalinjtë dhe egjiptianët që trajtohen më shumë si shqiptarë.¹²³ Megjithatë, ka gjasa që edhe anëtarët e këtyre grupeve të hasin në armiqësi në vise ku nuk janë të njohur. Për shkak të kësaj situatë, romët kanë kërkuar persekutimin e atyre që janë të fajshëm për sjellje kriminale, me shpresë se do t'i japin fund fajësisë kolektive të grupit.¹²⁴

Rritja e mostolerancës dhe zvogëlimi i nevojës për punë të rastit pas konfliktit, ka rezultuar me të ardhura të zvogëluara për të gjitha grupet e romëve. Kushtet e sigurisë dhe mundësitë e punësimit për ashkalinjtë dhe egjiptianët mund të përmirësohen me zhvillimin ekonomik në krahinë, duke i ditur lidhjet tradicionale me komunitetin shqiptarë dhe aftësitë e tyre për të folur gjuhën shqipe. Megjithatë, meqë mendohet se shumica e romëve etnik janë bashkëpunëtor të serbëve, situata e tyre nuk pritët që të

¹¹⁶ Sipas OSBE-së (2000b) analizat gjuhësore i kanë bindur shumë ekspert që të pajtohen se romët zbritën nga viset jugperëndimore në nënkontinentin e Indisë.

¹¹⁷ UNHCR/OSCE (2000c).

¹¹⁸ Polansky (2000).

¹¹⁹ Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve (2000).

¹²⁰ Sipas Bankës Botërore (2000d), ekzistojnë aspekte të ndryshme të kulturës së romëve dhe kushteve të jetesës që "përforcojnë stereotipe dhe i kontribuojnë një rrethi të izolimit dhe marginalizimit." P.sh. "natyra e mbyllur e komunitetit të tyre dhe rezistenca ndaj asimilimit shkaktojnë keqkuptime dhe mosbesim".

¹²¹ WFP (1999).

¹²² WFP (1999).

¹²³ Një rom i intervistuar në Prizren shpjegoi se bashkëjetesa ishte e mundur në qytetin verior përmes kontributit dhënë UÇK-së para luftës dhe TMK-së pas luftës.

¹²⁴ "Deklaratë e propozuar nga Tryeza e rrumbullakët humanitare", material i shumëzuar (2000)

përmirësohet në të ardhmen e afërt, dhe ka gjasa që ata të kërkojnë mbrojtjen e KFOR-it dhe ndihma humanitare.¹²⁵

Ndarja brenda popullatës rome gjithashtu ka pasuar me kërkesa për përfaqësim politik në SPPA-në në linjë etnike e gjuhësore. Deri vonë, në KTK-ja kishte vetëm një vend për komunitetin rom, dhe reprezentuesi ishte një rom etnik. Tani, është bërë edhe një vend për komunitetin e ashkalinjëve dhe egjiptianëve, mirëpo ata nuk mund të pajtohen se kush duhet ta ketë këtë vend, duke insistuar se janë dy komunitete të ndryshme dhe nuk duhet ta kenë së bashku një vend.

Sllavët musliman

Ky grup, që gjithashtu quhen boshnjak, është i përbërë nga muslimanët që flasin gjuhën sllave e që përbënin “Kombin musliman” brenda ish RSFJ-së. Sllavët musliman, ngjashëm me banorët musliman të Bosnjës, dialektin e serbokroatishtes e quajnë dialekt boshnjak. Goranët (shif më poshtë) nga regjioni i Gorës, dhe torbeshët nga regjioni i Zhupës, gjithashtu mund të konsiderohen sllav musliman.¹²⁶

Në vitin 1991, në Kosovë ka pasur 57,000¹²⁷ sllav musliman, që përbën grupin e tretë më të madh, pas shqiptarëve edhe serbëve. Ky grup ishte relativisht me perspektivë, dhe shumica punonin si administratorë, biznesmenë dhe bujq. Gjatë dhe pas luftës, më shumë se gjysma kanë ikur nga krahina, ku rreth 40 % kanë shkuar gjatë sulmeve ajrore, dhe 15 % të tjerë pas vendosjes së forcave të NATO-os.¹²⁸ Shumica shkuan në Novi Pazar (Serbi), Sarajevë (Bosnjë), dhe në disa vise të Maqedonisë.¹²⁹ Përveç kësaj, sipas OSBE-së rreth 20,000 sllavë musliman ndodhen në Evropën Perëndimore, të regjistruar si refugjatë shqiptarë kosovar.

Nga pjesa e popullatës së mbetur, rreth 47,000,¹³⁰ një numër i madh jetojnë në komunën e Prizrenit. Sipas intervistave me anëtarë të komunitetit, shumica e sllavëve musliman tani punojnë në restorante ose janë pronarë të tyre, dhe merren me punë ndërtimore. Të tjerët kanë tentuar që t'i rimëkëmbin bizneset e tyre të shkatëruara që lidhen me bagëti - 70 % e bagëtisë në pronësi të sllavëve musliman u zhduk gjatë luftës. Sllavët musliman ndihen të kurthuar në mes të shqiptarëve, me të cilët kanë religjionin e njëjtë, dhe serbët, me të cilët e ndajnë gjuhën e njëjtë. Para luftës, për shkak të këtyre lidhjeve gjuhësore, fëmijët e tyre shkuan në shkolla serbe dhe nuk e mësuuan gjuhën shqipe. Tani, mosnjohja e gjuhës shqipe në masë të madhe kufizon perspektivat e tyre për punësim në sektorin publik dhe privat, posaçërisht kur ata trajtohen si serb. Mirëpo, sikurse disa romë, të gjithë të anketuarit e sllavëve musliman potencuan faktin se ndihen të sigurtë në një rreth me shqiptarë që i njohin personalisht.¹³¹

¹²⁵ WFP (1999).

¹²⁶ UNHCR/OSCE (2000c).

¹²⁷ Regjistrim i vitit 1991.

¹²⁸ WFP (1999).

¹²⁹ Bazuar në UNHCR/OSCE (2000c), shumica e sllavëve musliman konfirmonë prejardhjen e tyre nga regjioni i Sanxhakut.

¹³⁰ UNHCR.OSCE (2000a).

¹³¹ Intervista me anëtarë të komunitetit të sllavëve musliman në Prizren dhe Pejë, prill 2000.

Goranët

Goranët gjithashtu konsiderohen sllav musliman, por ata flasin një gjuhë sllave më të afërt me maqedonishten dhe banojnë në një regjion gjeografik të pastër; regjioni i Gorës në komunën e Dragashit. Përveç kësaj, shumica e tyre mësuajnë serbisht në shkollë. Sipas regjistrimit të përgjithshëm të vitit 1991, në këtë komunë kishte 20,000 goran.¹³² Që nga mbarimi i luftës, numri i tyre është zvogëluar në 12,000 në mbarë Kosovën, duke u frikësuar nga represaljet shqiptare.¹³³

Goranët konsideroheshin një grup relativisht me perspektivë (ngjashëm me sllavët musliman) me prodhime të llojllojshme nga pylltaria, bujqësia dhe bagëtia, me biznese të vogla dhe punë në administratën publike, kryesisht në nivel profesional.¹³⁴ Historikisht, goranët kanë pasur marrëdhënie të mira me fqinjët e tyre shqiptarë. Megjithatë, tash së voni, disa faktorë e kanë ndryshuar këtë trend të përgjithshëm: (i) lidhjet e tyre gjuhësore me popullatën serbe, (ii) punësimi i tyre në ish administratën serbe, dhe (iii) aftësia e tyre për tu marrë me veprimtari afariste gjatë konfliktit, që shqiptarët e konsiderojnë¹³⁵ indikative për bashkëpunim me ish regjimin serb.¹³⁶

Që nga mbarimi i luftës, shumica e goranëve të punësuar në sektorin publik i kanë humbur vendet e punës dhe shumica e bizneseve të tyre tani janë të mbyllura. Përveç kësaj, ata që jetojnë në kufi me Shqipërinë pësojnë nga plaçkitja e gjedheve, prandaj potencojnë nevojën për përmirësimin e sigurisë kufitare.¹³⁷ Një numër i madh i tyre janë të zhvendosur brenda vendit, në fshatërat e tyre të lindjes në regjionin e Gorës, nga pjesë tjera të Kosovës. Nëse situata e sigurisë dhe punësimit nuk përmirësohet, ka gjasa që ata të shkojnë në pjesë tjera të ish Jugosllavisë apo të bashkohen me të afërmit e tyre në shtetet evropiane.

Turqit

Shumica e turqve në Kosovë flasin turqisht, janë të fesë islame dhe mbajnë lidhje të ngushta me Turqinë. Kushtetuta jugosllave e vitit 1974 i ka njohur turqit si komb, me të

¹³² ICG (1999h).

¹³³ UNHCR/OSCE (2000a).

¹³⁴ WFP/UNHCR (1999b).

¹³⁵

¹³⁶ WFP/UNHCR (1999b)

¹³⁷ Rëndësia e bashkëpunimit ndërkufitar në mes të Shqipërisë dhe Kosovës është diskutuar në raportin e parë të Iniciativës për zhvillim shoqëror të Evropës Juglindore, mbi ndikimin e refugjatëve kosovar në shoqërinë shqiptare (Barjaba dhe La Cava, 2000). Në raport u vu në pah se mund të ndërtohen lidhjet shoqërore dhe kulturore dhe të zvogëlohen tensionet, duke promovuar zhvillimin e lidhjeve natyrore tregtare në mes të qyteteve kufitare. Në fakt, kriza e refugjatëve përcolli lëvizjen spontane në këtë drejtim. P.sh. goranët në pjesën veriore të Kukësit financuan nga burimet vetanake ndërtimin e një rruge që lidhte 20 fshatëra të goranëve në Shqipërinë Lindore, Kosovën Jugperëndimore, dhe Ish RJ të Maqedonisë. Banka Botërore gjithashtu, ka ndihmuar në financimin e ndërtimit të një rruge që lidhte Shqipërinë Verilindore me qytetin e Kosovës, Gjakovën, duke i nxjerrë të dy regjionet nga izolimi që kishin pësuar për shkak të ndarjes së Kosovës me Shqipërinë.

drejta për të përdorur gjuhën dhe kulturën e tyre. Megjithate, në vitin 1989 u ndërpre përdorimi administrativ i gjuhës të pakicës turke.

Momentalisht, UNHCR/OSBE kanë vlerësuar se ka rreth 20,000¹³⁸ turq në Kosovë (prej 11,000 në vitin 1991¹³⁹) me rreth 12,000 në qytetin e Prizrenit, dhe rreth 5,000 në fshatin Mamushë.¹⁴⁰ Turqit jetojnë edhe në Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan (në fshatin Mireshtë), dhe në Vushtri. Tradicionalisht, turqit kanë qenë aktiv në arte, zanate dhe tregti (posaçërisht me Turqinë) në viset urbane. Tash së voni, ata kanë gjetur punë në fabrika dhe inxhiniering. Gjithashtu, ky komunitet merr pjesë aktive në organizatat e shoqërisë civile dhe dhomat ekonomike.

Turqit kanë më shumë lidhje me shqiptarët se çdo grup tjetër etnik. Për shkak të këtyre lidhjeve me Turqinë, një anëtar i NATO-os tha, se serbët i kanë pasur në shënjestër gjatë konfliktit të fundit. Megjithate, në shumicën e rasteve, shtëpitë e tyre nuk ishin të shkatërruara dhe ata nuk përjetuan zhvendosje të mëdha. Mirëpo, me kthimin e refugjatëve shqiptarë, ata kanë pësuar nga incidentet, posaçërisht nga ata që nuk i njihnin personalisht. Gjatë intervistave me ekipin vlerësues, disa të anketuar thanë se nuk ndihen të sigurt kur flasin gjuhën turke jashtë Prizrenit, edhe pse brenda në qytet, fëmijët e tyre vazhdojnë të shkollohen në gjuhën e tyre amtare.

Shqetësimi më i madh për shumicën e turqëve siç duket është punësimi, në veçanti nëpër fabrika. Shumica shpresojnë se do të përfitojnë nga investimet e Turqisë në krahinë në të ardhmen, edhe pse ambienti momental për biznes nuk është i favorshëm. Përveç kësaj, ata janë të shqetësuar nga fakti se, UNMIK-u nuk e njeh gjuhën e tyre si një nga gjuhët zyrtare duke e nxitur komunitetin që të mos merr pjesë në regjistrimin dhe në zgjedhjet e fundit.

Idetë e popullatës vendëse lidhur me zhvillimin e tyre

Kjo pjesë përfundimtare e vlerësimit shoqëror, është shqyrtimi i parashikimeve se si shqiptarët kosovar dhe pakicat i perceptojnë nevojat e tyre imediate, dhe perspektivat e tyre për zhvillim gjatë tri deri në pesë vitet e ardhshme. Rezultatet tregojnë një ndjenjë të vazhdimit të cenueshmërisë për momentin, por edhe optimizëm për të ardhmen, që lidhet me përcaktimin e tyre që të mos mbështeten në ndihmat ndërkombëtare. Megjithate, femrat dhe meshkujt e anketuar shprehën nevojën për ndihmë specifike ndërkombëtare - duke përfshirë edhe mikro - kreditë dhe aftësimin për punë - për ta mundur këtë vetmbështetje. Këto rezultate kanë implikime në hartimin e programeve për ndihma në të ardhmen nga ana e komunitetit ndërkombëtar (shif Kapitullin VI, Konkluzionet).

Perceptimet e popullatës për nevojat e tyre imediate

¹³⁸ UNHCR/OSCE (2000a)

¹³⁹ Regjistrimi i vitit 1991.

¹⁴⁰ UNHCR/OSCE (2000c).

Ekipi vlerësues luti të anketuarit t'i caktojnë nevojat prioritare të komunitetit dhe familjeve të tyre. Shumica nuk i dalluan nevojat e komunitetit dhe të familjes. Shumë prej tyre i përfshinë edhe nevojat e Kosovës në tërësi dhe nevojat e tyre individuale. Rezultatet tregojnë se, shqiptarët kosovar zhvillimin ekonomik të Kosovës, komunitetin dhe familjen, i konsiderojnë të një rëndësie të madhe. Nevojat me prioritet më të lartë ishin punësimi dhe mundësitë për punësim si në viset urbane ashtu edhe ruarje; ku meshkujt dëshironin kredi për t'i mbështetur idetë e tyre sipërmarrëse (shif pjesën në vazhdim), dhe femrat, për dallim nga ata, dëshironin aftësim për punë, në veçanti për rrobaqepësi, floktari, gjuhë angleze dhe shkathtësi kompjuterike. Në viset rurale, meshkujt shpesh përmendën mikro-kreditë për blerjen e mjeteve të prodhimit (farëra, plehëra, pajisje bujqësore, bagëti) dhe zgjerim të biznesit bujqësor. Femrat nga viset rurale dhe urbane kërkonin shërbime më të mira shoqërore (që do të përfshinin edhe jetimat, të moshuarit dhe të traumatizuarit), kujdes më të mirë shëndetësor (duke përfshirë edhe qendra materniteti në vise rurale), sigurim të ushqimit, sigurim fizik (në veçanti spastrimin e minave tokësore), dhe ndihmë me para të gatshme (shif Shtojcën II, Tabela 9). Gjithashtu, gratë kërkonin mundësi për punësimin e djemve të tyre, që të mos detyrohen të punojnë jashtë.

Idetë sipërmarrëse dhe nevojat kreditore

Të anketuarit kishin ide të mira sipërmarrëse që u përshtateshin rrethanave lokale, përfshirë edhe nevojat për kredi, kohën e kthimit të kredisë, dhe numrin e të punësuarëve (shif Shtojcën IV, Ndarja 1). Disa, në mënyrë eksplicite, thanë se duan ta kthejnë kredinë sa më shpejtë për të evituar borxhet afatgjata, që do të rrisë ndjenjën e tyre të cenueshmërisë. Shumica e të tjerëve shprehën dëshirën e madhe për të marrë informacione për agjencitë ku duhet kërkuar kredi, modelet e mundshme kreditore, procedurat për kërkimin e kredisë, projektet relevante, si dhe dëshirën për tu aftësuar në çështje të sektorit privat, siç janë përcaktimi i ofertës dhe kërkesës. Në komentet e bëra që kujtonin ekonominë socialiste, katër meshkuj në mënyrë eksplicite kërkuan ligje ekonomike dhe institucione që do të rregullonin tregun, dhe kontrollin e produkteve, si parakusht për zhvillim dhe investime private në Kosovë. Të tjerët kërkuan garantimin e çmimeve dhe shitje (Cërnice), apo një analizë të kërkesave në berzën e punës, në mënyrë që të arsimohen në pajtim me të (Rugovë).

Gjithashtu, ekipi vlerësues zbuloi se reprezentues të sllavëve musliman në Prizren kishin një sërë ideshë për programe stimuluese ekonomike për të mundësuar kthimin e refugjatëve sllav musliman, dhe për të ndihmuar që Prizrenin ta bëjnë “një lokomotivë për zhvillim ekonomik në viset rurale në Kosovë” (shif Shtojcën IV, Ndarja 2).

Perspektivat për të ardhmen, dhe promovuesit e ndryshimeve

Së fundi, të anketuarit u pyetën të tregojnë parashikimet për të ardhmen e familjes së tyre dhe të komunitetit, dhe kush do të jenë, sipas tyre, promovuesit e ndryshimeve (shif tabelat 11 dhe 12).

Tabela 11. Perspektivat për të ardhmen

<i>Perspektivat, kushtet</i>	<i>Numri i grupeve (prej 40)</i>	<i>Vërejtjet specifike</i>
Në përgjithësi do të përmirësohen, në veçanti në komunitetin/fs hatin tim	19 grupe	6 urbane, 3 rurale
Varet nga përcaktimi i statusit të Kosovës, pavarësisë, integrimin në Evropë, sundimin e së drejtës, themelimin e institucioneve , zgjedhjet e lira	9 grupe	7 urbane 3 rurale
Nga aspekti personal do të përmirësohet (punësimi, zgjerimi i biznesit, krijimi i familjes, arsimimi, pavarësia personale)	7 grupe	5 femra, 2 meshkuj, (5 të rinjë, 2 grupe femrash të rritura)
Nuk do të përmirësohet nëse nuk ndryshojnë kushtet (ekonomia e gjithëmbarshme, siguria, situata politike)	6 grupe	3 urbane 3 rurale
Së paku, në fshatin tim do të përmirësohet	5 grupe	5 rurale

Tabela 12. Promovuesit e ndryshimeve

<i>Promovuesit/aktorët/nxitja</i>	<i>Numri i grupit (prej 40)</i>	<i>Vërejtje specifike</i>
Kombinimi i punës dhe iniciativave të shqiptarëve dhe mbështetja ndërkombëtare, në veçanti investimet	14 grupe	Të gjitha llojet e grupeve
“Puna vetanake”, në veçanti aftësia e meshkujve për punë	13 grupe	Grupet e femrave për meshkujt; grupet e meshkujve për vetveten
Investimet e huaja, kreditë, fillimi i aktiviteteve ekonomike të vogla	11 grupe	10 grupe të meshkujve, 1 grup i femrave, rurale dhe urbane
Vetëm shqiptarët, bashkëpunimi i shqiptarëve me njëri tjetrin	4 grupe	3 grupe të femrave nga viset urbane
Vetëm komuniteti ndërkombëtar (“plane të	2 grupe	Femra të rritura rurale, Meshkuj të rinjë urban

koordinuara”)		
Rinia, studentët	2 grupe	Meshkuj të rinjë urban, femra të reja rurale
Gjithsecili	1 grup	Femra të rritura urbane
Përmes arsimit	1 grup	Femra të rritura rurale
Biznesmenët	1 grup	Meshkuj të rinjë urban
Këshillat e fshatit	1 grup	Femra të rritura urbane
Prindërit	1 grup	Femra të reja rurale

V. VLERËSIMI I DIASPORËS

Në këtë kapitull shqyrtohet situata e diasporës kosovare në Gjermani dhe Zvicër. Në veçanti, vlerësimi përqëndrohet në: (i) historinë e migrimit të shqiptarëve kosovar në këto shtete, moshën, familjen, strukturën, dhe llojet e punësimit të popullatës së zhvendosur; (ii) politikën e shteteve nikoqire dhe programet e ndihmave për komunitetin e zhvendosur; (iii) organizatat e shqiptarëve kosovar dhe marrëdhëniet e komunitetit në shtetet nikoqire; (iv) kriminalitetin e të rinjëve kosovar në shtetet nikoqire; (v) rolin e parave të dërguara prej popullatës së zhvendosur për mbajtjen e familjeve të tyre në Kosovë; (vi) presionet e qeverive nikoqire mbi popullatën e zhvendosur për tu kthyer, dhe programe stimuluese për personat e kthyer (vii) faktorët që ndikojnë në vendimet e popullatës së zhvendosur për tu kthyer dhe (viii) efektet e pritura nga riatdhesimi i një numri të madh të popullatës së zhvendosur. Puna e realizuar në terren për këtë vlerësim, në Berlin, Frankfurt, Ludwigshafen, Zurich, Berne dhe Zhenevë, përfshinte intervistat me zyrtarët e shtetit nikoqir, përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare, ekspert nga popullata e zhvendosur, dhe udhëheqësit e komuniteteve të zhvendosura në këto dy shtete; si dhe grupet e anketuara dhe tubimet e komunitetit ku morrën pjesë popullata e zhvendosur.

Historia dhe demografia¹⁴¹

Komuniteti shqiptarë kosovar është grupi i dytë më i madh i huaj në Gjermani dhe Zvicër që numëron 350,000 - 400,000 dhe 160,000, përkatësisht. Në Gjermani, numri i tyre tejkalohet vetëm nga turqit, kurse në Zvicër, nga italianët. Këto të mërguar erdhën në tri valë të ndryshme: (i) vala e parë (në fund të viteve të 60-ta dhe fillim të viteve të 70-ta) e shqiptarëve kosovar si punëtorë mysafir, shumica e të cilëve ishin pa shkathtësi për punë, pak të arsimuar dhe nga viset rurale të Kosovës; (ii) vala e dytë, prej 1989-1993 në Gjermani dhe 1981-1990 në Zvicër, shumica e të cilëve ishin shqiptarë kosovar të arsimuar më mirë dhe me shkathtësi për punë, dhe nga viset urbane të Kosovës, si dhe të rinjtë që dëshironin t'i ikin shërbimit në ushtrinë jugosllave gjatë luftërave ballkanike (1992-1995); dhe (iii) vala e tretë e azilkërkuesve dhe refugjatëve si pasojë e konfliktit të vitit 1998-1999 në Kosovë, të përzier nga aspekti i arsimit dhe prejardhjes. Tabela 13 ilustron raportet statistikore të zhvendosjeve nga RFJ në Gjermani, ku rreth gjysma janë shqiptarë kosovar.

¹⁴¹ Statistikat e qeverisë së Zvicrës nuk i dallojnë kosovarët nga qytetarët tjerë të RFJ-së; kurse statistikat e qeverisë gjermane filluan t'i dallojnë kosovarët nga qytetarët e tjerë të RFJ-së në gusht të vitit 1999. Qytetarët e tjerë nga Ish Jugosllavia - kroatët, boshnjakët dhe sllovenët - janë të regjistruar ndaras në të dy shtetet.

Tabela 13. Qytetarët e RFJ-së: Koha e qëndrimit në Gjermani, 1997

Më pak se 1 vit	24,000
1-4 vite	101,200
4-6 vite	177,200
6-8 vite	84,400
8-10 vite	33,600
10-15 vite	30,000
15-20 vite	43,200
20-25 vite	65,400
25-30 vite	140,000
30 vite e më tepër	21,900

Burim: Beauftragte der Bundesregierung fuer Auslaenderfragen (1999a).

Të migruarit kanë tentuar të vendosen në vise urbane në shtetet nikoqire. Në Gjermani, ku 97 % e të huajve në përgjithësi jetojnë në Ish Gjermaninë Perëndimore, shqiptarët kosovar janë përqëndruar në katër qytetet e mëdha të katër shteteve: Baden-Wuerttemberg, Berlin, Hesse dhe North-Rhine-Westphalia. Shqiptarët kosovar jetojnë në mbarë Zvicrën, por më tepër janë të përqëndruar në kantonet e Zurichit (më shumë se 50,000), Vaudit (15,000), dhe Berne (5,000). Disa jetojnë nëpër fshatëra, dhe shumica kanë gjetur punë në dy regjionet malore të Bernit dhe Grisonit. Të mërguarit kosovar nga fshati ose qyteti i njëjtë tentojnë të vendosen në të njëjtin vend.¹⁴² Duke krahasuar rivendosjen e tyre rezidenciale në shtetet nikoqire, shifet se shumica e të mërguarëve janë nga viset rurale (66 %) dhe nga viset urbane të Kosovës (34 %).¹⁴³

Situata e punësimit

Situata e punësimit për shqiptarët kosovar është shumë më e vështirë në Gjermani se sa në Zvicër. Në Gjermani, të mërguarit vështirë i marrin lejet e punës, që i detyron ata të punojnë ilegalisht. Refugjatëve të luftës civile dhe azilkërkuesëve mund tu jepet leje e përkohshme për punë, që u mundëson atyre të gjejnë punë, me kusht që të mos ketë gjerman ose ndonjë tjetër të huaj i cili ka një status rezidencial më të sigurt që mund ta bëjë punën e njëjtë. Është zhvilluar një debat në qarqet politike gjermane për nevojën e dhënies së lejeve të punës të huajve, që do të ndihmonte në zvogëlimin e ngarkesës së shtetit në sigurimin e ndihmave sociale.

Shumica e shqiptarëve kosovar nuk mund të gjejnë punë në shtetin nikoqir nga lamia e tyre profesionale. Kështu, ata tentojnë të punojnë në restorante, punë ndërtimore dhe bujqësi dhe, në Gjermani, si punëtorë teknik dhe punëtorë fabrike.

Papunësia në mesin e të huajve është më e lartë se në mesin e popullatës vendëse të shtetit nikoqir; p.sh., në vitin 1998, shkalla e papunësisë e popullatës vendëse ishte 10.5 %, kurse shkalla për gjithë të huajt ishte 20.3 %. Në disa qytete, shkalla e të huajve është më e lartë; p.sh., rreth 30 % në Berlin.¹⁴⁴ Të dhënat e fundit tregojnë se shkalla e papunësisë për qytetarët e RFJ-së (përfshirë edhe ata nga Serbia, Mali i Zi dhe Kosova) që jetojnë në Gjermani është 14.2 %.¹⁴⁵ Në vitin 1998, shkalla e papunësisë të popullatës vendëse në Zvicër ishte 2.5 %, kurse shkalla e papunësisë për të huajt ishte 7.5 %.¹⁴⁶

Për t'ju përgjegjur këtyre vështirësive të punësimit, shqiptarët kosovar në Gjermani dhe Zvicër kanë hapur restorante, agjenci turistike, klube shqiptare, shërbime për interpretim/përkthim, auto shkolla, shitore me

¹⁴² Leuenberger dhe Maillard (1999).

¹⁴³ Vlerësime të RIINVEST-it (1999).

¹⁴⁴ Intervistë, Barbara John, komesariate për çështje të të huajve, Berlin Senate, 26 janar, 2000.

¹⁴⁵ Beauftragte der Bundesregierung fuer Auslaenderfragen (1999a).

¹⁴⁶ Office federal de la Statistique (1999).

mallëra ushqimore, firma transporti, dhe firma ndërtimore/inxhinierike.¹⁴⁷ Bizneset e para në pronësi të shqiptarëve kosovar në Zvicër ishin agjencitë turistike, e pastaj gazetat në gjuhën shqipe, disa prej të cilëve filluan punën tek pronarët e këtyre agjencive turistike.

Struktura e popullatës

Duke ditur mënyrat e mërgimit të shqiptarëve kosovar, diaspora është e dominuar nga të rinjtë dhe meshkujt, nga fakti se, migrimi politik, arsimor dhe ekonomik, ka qenë një fenomen ku kanë dominuar meshkujt. Kjo është thënë më heret në Kapitullin II, ku përshkruhet proporcioni i popullatës së mërguar mashkullore/femërore në Kosovë prej 107 deri 95 meshkuj për 100 femra, ndërmjet 1991 dhe 2000.

Prej 737,204 qytetarë të RFJ-së në Gjermani, rreth gjysma e të cilëve janë shqiptarë, 180,687 janë fëmijë nën moshën 16 vjeçare. Nga numri i përgjithshëm, 366,529 janë të pamartuar (shumica meshkuj të rinjë), dhe 293,439 janë të martuar.¹⁴⁸ Më se 55 % e popullatës nga diaspora janë ndërmjet 18 dhe 35 vjeç, 26.5 % janë ndërmjet moshës 0-17 vjeç, dhe pjesa e mbetur 17.7 % e popullatës së mërguar është 36 vjeç e më të vjetër.¹⁴⁹

Familjet e vjetra nga vala e parë e mërgimit siç duket janë më të mëdha, shpesh prej 6 deri në 8 fëmijë. Të mërguarit e valës së dytë mesatarisht kanë prej 2 deri 4 fëmijë, kurse të mërguarit e rinjë kanë 1 ose 2 fëmijë. Nga intervistat me rininë shihet se shumica dëshirojnë të martohen më në moshë (femrat në moshën 30 vjeçare, meshkujt 25-26 vjeç), të punojnë jashtë shtetësisë, dhe të kenë më pak fëmijë.¹⁵⁰ Derisa shihej se modernizimi kishte ndikuar në strukturën familjare, disa të rinjë kosovar shqiptar dhe disa femra mendonin se shoqëria - përfshirë edhe familjet nga diaspora ktheheshin në disa mënyra tradicionale për shkak të ndikimit të konfliktit.

Solidariteti familjar dhe fisnor në diasporë është shumë i fortë. Megjithatë, konflikti dhe zhvendosja kanë pasur disa efekte të kundërta në disa familje; p.sh. mosmarrëveshje ndërmjet prindërve dhe të rinjëve, sjellje të pahijshme të të rinjëve dhe kriminalitet. Disa, rininë shqiptare kosovare e përshkruan si “gjeneratë e humbur” nga aspekti i arsimimit (në veçanti ata që ndoqën sistemin paralel), punësimit, dhe shpresës për një të ardhme më të mirë. Shumë familje duhet të shërohen në aspektin psikologjik nga traumat që pësuan gjatë konfliktit që ata i përjetuan qoftë në mënyrë direkte apo përmes anëtarëve të familjes në Kosovë.

Politika e shteteve nikoqire dhe programet për ndihma

Gjermania ndodhet në vijën e parë të lëvizjeve më të gjëra në Unionin Evropian (EU) për të krijuar një ndarje të barabartë të ngarkesës duke harmonizuar politikën e azilit dhe refugjatëve brenda 5 viteve, duke filluar me kontrollimin kufitar. Vitet e fundit, imigrimi legal ka shënuar rënie, kurse numri i azilkërkuësve është rritur në mënyrë drastike në UE.

Kërkesat për viza tani janë më strikte, kurse koha e nevojshme për t'i pranuar në mënyrë ligjore kërkuësit e azilit është shkurtuar. Pjesërisht, një gjë e tillë bëhet për të zvogëluar shpenzimet e larta të qeverisë gjermane që i bën për ndihmat për të huajt, ku momentalisht për refugjatët siguron rreth 500 milion DM në vit. Në të njëjtën kohë, ligjet gjermane për nënshtetësi kanë hequr dorë nga kërkesa që kërkuësi të ketë një të afërm për nga gjaku. Si pasojë, janë rritur natyralizimet në mesin e qytetarëve të RFJ-së, por përsëri janë mjaft të ulta (2.4 % e të gjithë natyralizimeve në vitin 1997).

Në Zvicër, kriza e Kosovës riaktivizoi debatin afatgjatë për ligjet e shtetit për azil dhe për refugjatët, ku Partia Popullore e të Djathtëve Ekstremist potenconin ndjenjën negative publike për të huajt në përgjithësi, e në veçanti të shqiptarëve kosovar. Disa ndryshime të mëvonshme në ligjet e Zvicrës i kanë vështirësuar edhe më shumë kushtet për shqiptarë, e kjo nënkupton kufizime më të mëdha në fluskun e refugjatëve,

¹⁴⁷ P.sh. shqiptarët kosovar në Zurich dhe Berlin ishin pronar të disa picerive dhe restoranteve italiane.

Gjithashtu, në Gjermani ka 180 agjenci turistike të shqiptarëve kosovar.

¹⁴⁸ Beauftragte der Bundesregierung fuer Auslaenderfragen (1999c)

¹⁴⁹ Vlerësim i RIINVEST-it (1999).

¹⁵⁰ Intervista me grupe të anketuara në Gjermani dhe Zvicër, janar-shkurt 2000.

azilkërkuesëve dhe të mërguarëve të tjerë. Për më tepër, Zvicra po shikon që jozyrtarisht t'i koordinojë dhe harmonizojë politikat e azilit me shtetet tjera anëtare të EU -së.

Të dy shtetet bëjnë përpjekje të mëdha që t'i trajtojnë çështjet lidhur me të huajt, përfshirë edhe racizmin, sulmet e dhunshme dhe diskriminimin socio-ekonomik kundër të huajve; kriminalitetin në mesin e të huajve; dhe kërcënimet për sigurinë e brendshme nga importimi i lëvizjeve politike dhe konflikteve nga shtetet e tyre amë.

Në Gjermani, çdo shtet ka një zyrë me përfaqësuesin për çështje të të huajve, që t'i trajtojë çështjet ekonomike, ligjore dhe sociale të të huajve që jetojnë në bashkitë e tyre. Këto zyra, gjithashtu sigurojnë konsultime dhe shërbime sociale për të huajt dhe ndihmë për riatdhesim dhe ndihmë për të ndihmuar promovimin e multikulturalizmit, tolerancës dhe integrimin e të huajve në shoqërinë gjermane. Megjithatë, vitet e fundit, ndihma sociale qeveritare dhe ligjore për azilkërkuesit dhe refugjatët e luftës ka rënë dukshëm dhe kushtet për të huajt po bëhen më pak atraktive; p.sh. kufizimet për ribashkimin e familjes, riatdhesim pa pëlqimin e të huajve etj. Politikat e reja nënkuptojnë shkurtimin e ndihmave sociale për kosovarët, në veçanti të atyre që kanë qëndrim të përkohshëm, leje rezidenciale që më së pakti është e siguruar.¹⁵¹

Ngjashëm, qeveria e Zvicrës siguron një sërë programesh për tu ndihmuar të huajve, në mënyrë direkte dhe përmes OJQ-ve, përfshirë edhe arsimimin, aftësimin, këshillimin, shërbime shoqërore dhe ligjore dhe ndihmë për integrim dhe mirëqenie. Universite Populaire Albanaise (UPA) në Gjenevë, në veçanti synon që 10,000 shqiptarëve dhe komunitetit të shqiptarëve kosovar tu sigurojë aktivitete arsimore, sociale, kulturore dhe sportive.

Programet tjera u sigurojnë shqiptarëve kosovar ndihmë për riatdhesim. (shif më poshtë).

Organizatat dhe marrëdhëniet ndërmjet komunitetit në shtetet nikoqire

Para shkatërrimit të Ish Jugosllavisë, në Gjermani kishte një numër të organizatave jugosllave lokale dhe të komunitetit. Që atëherë, të gjitha organizatat jugosllave në Gjermani janë ndarë dhe mbyllur, kurse në ndërkohë janë krijuar organizata lokale dhe të komunitetit, bazuar në kombësinë, prejardhjen etnike dhe religjionin. Shqiptarët kosovar kanë themeluar klubet e tyre të rinisë, organizatat humanitare dhe radiostacione. Klubet nuk janë krijuar në bazë të lidhjeve familjare ose fisnore, por janë në përdorim të gjërë për tërë komunitetin. Jashtë kufijve të këtyre organizatave nuk ekziston asnjë përfaqësues i vetëm apo institucion për komunitetin e shqiptarëve kosovar. Kjo është në kundërshtim me komunitetin më të madh dhe më mirë të organizuar të turqive që jetojnë në Gjermani.

Të gjitha grupet kryesore politike të shqiptarëve kosovar në Gjermani pajtohen se Kosova duhet të jetë e pavarur. Mirëpo, konflikti i fundit, shkaktoi ndarje serioze në mesin e përkrahësve të fraksioneve të ndryshme. LDK-ja mbledhi mjete për Fondin e Republikës së Kosovës prej 1992-1999, ku shqiptarët kosovar kontribuan në mënyrë vullnetare me 3 % nga të ardhurat e tyre, për të financuar arsimimin paralel, strukturat humanitare, sociale dhe politike në Kosovë. Kontributi në këto fonde siç duket është shuar pak pas përfundimit të konfliktit, edhe pse qeveria gjermane së voni ka kërkuar që disa mjete nga ky fondi të shfrytëzohen për rindërtimin e Kosovës.¹⁵²

Gjithashtu, UÇK-ja ka qenë aktive në Gjermani duke mbledhur para nga komuniteti i diasporës përmes fondit "Vendlindja thërret", të themeluar në vitin 1998 dhe të ndërlidhur me qeverinë gjermane. Gjithashtu, ekzistojnë tri organizata të fshehta që punojnë me UÇK-në në Gjermani, të angazhuara në aktivitete politike dhe në ngritjen e fondeve. Shumë luftarë vullnetarë të UÇK-së erdhën nga diaspora në Gjermani dhe Zvicër.

¹⁵¹ Leja e përkohshme u jepet të huajve të cilët janë të obliguar të largohen nga Gjermania në shtetet e tyre amë, por që akoma nuk mundën për shkaqe ligjore, politike dhe të sigurisë. Kjo leje është pezullim i përkohshëm i deportimit dhe zakonisht aplikohet për refugjatët e luftës civile.

¹⁵² Intervista, Ministria gjermane e punëve të jashtme, Berlin, 26 janar 2000.

Në Zvicër, edhe UÇK-ja edhe LDK-ja kanë qenë politikisht aktive në ngritjen e fondeve dhe deri diku edhe të ushtrisë. Në korrik të vitit 1998, qeveria e Zvicrës bllokoi dy llogaritë (fondi i 3 % i drejtuar nga LDK, dhe llogaria e fondit Vendlindja thërret e drejtuar nga UÇK-ja, ku shqiptarët kosovar e dërgonin kontributin e tyre.¹⁵³ Llogaria e UÇK-së në Zvicër, më vonë u mbyll nga autoritetet qeveritare sepse nuk dëshironin që konflikti të financohet nga territori i Zvicrës.¹⁵⁴ Llogaria e 3 % e LDK-së është ende e hapur dhe sipas një burimi ka rreth 60-80 milion SF.¹⁵⁵

Marrëdhëniet e shqiptarëve kosovar që shkuan në Gjermani dhe Zvicër gjatë valëve të ndryshme të migrimit janë të përziera. P. sh. gjenerata më e vjetër e të mërguarëve nuk ka gjëra të përbashkëta me valën e dytë, të cilët ishin më mirë të arsimuar dhe ishin nga vise urbane. Dallimet moshore gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në marrëdhëniet në mes komunitetit. Megjithatë, nuk ka ndarje të mëdha religjioze apo tensione në mesin e shqiptarëve kosovar të krishterë dhe musliman. Shqiptarët e Kosovës bashkëveprojnë më tepër me shqiptarët etnik nga Shqipëria, RFJ-ja, Maqedonia dhe gjetiu.

Kriminaliteti i të rinjëve në shtetet nikoqire

Në Gjermani nuk ka të dhëna statistikore zyrtare të qeverisë federale lidhur me krimet e kryera nga shqiptarët kosovar, edhe pse, krimet e të rinjëve paraqesin problem duke pasur parasysh kushtet e vështira të jetesës. Shqiptarët e Kosovës e dijnë se shumica e meshkujve të rinjë që shkuan në Gjermani hasin në situata dëshpëruese. Në të shpeshtën e rasteve, ata nuk janë shumë të shkolluar ose të aftësuar, dhe ndjehen të izoluar dhe të vetmuar me qasje të pakta në ndihmat sociale.

Në Zvicër, zyrtarët qeveritar e vlerësojnë shkallën e krimeve në mesin e të rinjëve kosovar 10 deri 15 %, ku shumica e krimeve lidhet me drogën.¹⁵⁶ Qeveria federale dhe aktivitetet e financuara nga kantonet synojnë që ta parandalojnë rininë të mos bie në aktivitete kriminale.

Në të dy shtetet shumica e kundërvajtjeve kanë të bëjnë me shkeljen e ligjeve rezidenciale dhe shkelje të tjera më të lehta. Studimet e mëvetësishme vënë në pah vëmendjen e konsiderueshme të mediave për rastet e kriminalitetit në mesin e të rinjëve shqiptarë kosovar. Të gjitha studimet theksojnë kushtet (traumat e luftës, jeta në kushte të pasigurta, ndarja nga familja, mungesa e arsimimit, punësimi dhe paratë) nën të cilat jetojnë të rinjtë shqiptarë kosovar, e që u kontribuojnë sjelljeve kriminale.

Autoritetet gjermane dhe zvicerane kanë filluar t'i kthejnë një numër të kriminelëve shqiptarë kosovar për të cilët ekziston dosje shtesë në Kosovë. Këtij grupi, në veçanti të rinjëve, do t'ju nevojitet ndihmë e posaçme për tu riintegruar në shoqërinë kosovare.

Roli i parave të dërguara për mbajtjen e familjeve në Kosovë

Nuk ekziston ndonjë informtë e saktë lidhur me paratë e dërguara nga komuniteti shqiptarët kosovar në Gjermani dhe Zvicër. Megjithatë, shumat janë substanciale dhe i kanë kontribuar mbijetesës dhe mirëqenies së familjeve në Kosovë dhe ekonomisë kosovare në tërësi. Paratë e dërguara u rritën mjaft si pasojë e konfliktit, prej 24.7 % e të të ardhurave të vendit, në 45.1 % pas luftës.¹⁵⁷

Varësisht nga lloji i burimit, ndryshon vlerësimi i shumës së parave të dërguara. RIINVESTI, ka vlerësuar se gati gjysma e familjeve në Kosovë (46.8 %) marrin deri në 3,000 DM në vit, 25.1 % marrin 3,000–6,000 DM në vit, 10 % marrin 6,000-9,000 DM në vit, dhe 17.2 % marrin 9,000 e më tepër DM në vit. Shuma e tërësishme e parave të dërguara nga jashtë është vlerësuar në 750-850 milion DM në vit.¹⁵⁸ Kosovarët që

¹⁵³ Leuenberger dhe Maillard (1999).

¹⁵⁴ Intervistë, Sami Kurteshi, Berne, shkurt 2000

¹⁵⁵ Intervistë, Ueli Leuenberger, Drejtor, University Populaire Albanais e, Gjenevë, 14 shkurt 2000

¹⁵⁶ Intervistë, Joerg Frieden, Nëpunës federal për refugjatë, Berne, 2 shkurt 2000.

¹⁵⁷ RIINVEST (1999c; 1999d).

¹⁵⁸ RIINVEST (1999c; 1999d).

jetojnë në diasporë vlerësojnë paratë mesatare të dërguara prej 500-1,000 DM në muaj gjatë viteve të 90-ta, ku disa janë përvehtësuar nga policia serbe.¹⁵⁹ Në Kosovë, shumica e këtyre fondeve janë përdorur për strehim (33.4 %), transport (15.2 %), dhe tregti (12.5 %).

Të dhënat zyrtare gjermane mbi paratë e dërguara në RFJ, tregojnë se këto para mesatarisht janë 200-250 DM në vit për vitin 1997-1998.¹⁶⁰ RIINVESTI paratë e dërguara nga Gjermania i vlerëson të jenë 1,000-2,000 DM në vit për një familje. Vlerësimet nga Zvicra pohojnë se 160,000 shqiptarë kosovar që jetojnë në atë shtet dërgojnë deri në 2,000 SF në muaj për një familje në Kosovë, ku më së shumti dërgojnë meshkujt e pamartuar se sa ata me familje.¹⁶¹ Vlerësimet tjera të shqiptarëve kosovar dhe zvicranëve mendojnë se paratë e dërguara janë 500-1,000 SF në muaj.¹⁶²

Shumica e këtyre kontributeve nga diaspora janë dërguar përmes agjencive turistike (nga një komision i agjencisë), vizitave personale, dhe korrirëve special. Duhet shënuar se që nga vjeshta e vitit 1998, agjencitë turistike në Gjermani e kishin të ndaluar me ligj t'i dërgojnë paratë në Kosovë. Paratë e dërguara nga Gjermania dhe Zvisra pritet që të zvogëlohen me riatdhesimin e një numri më të madh të kosovarëve - me pasojë të pavolitshme për mirëqenien sociale dhe shumë familje në Kosovë.

Presioni i qeverive nikoqire dhe nxitjet për tu kthyer

Presionet për tu kthyer

Në Gjermani, 60,000 shqiptarë kosovar ishin të obliguar të kthehen kah fundi i marsit 2000. Përveç kësaj, edhe 180,000 shqiptarë kosovar të para luftës do të detyrohen të kthehen në të ardhmen e afërt. Pjesa dërrmuese e grupit të dytë janë azilkërkues, disa prej të cilëve jetojnë në Gjermani 8-9 vite, kërkesa e të cilëve për azil ishte mohuar. Zyrtarët gjerman parashikojnë një debat të vështirë politik për të ardhmen e këtij grupi.

Gjermania ka bërë disa lëshime të posaçme për disa grupe, përfshirë këtu edhe serbët dhe romët. Ata nuk do të detyrohen të largohen nga Gjermania, dhe zyrtarët qeveritar parashohin nevojën për sigurimin e ndihmave sociale të vazhdueshme për këto grupe. Politika qeveritare gjermane nuk bën dallime për kthimin e shqiptarëve nga Serbia veriore.

Në fazën e parë të programit për personat e kthyer nga Zvicra, 18,480 shqiptarë kosovar u kthyen në Kosovë kah fundi i dhjetorit të vitit 1999. Në fazën e dytë, autoritetet zvicrane kanë pohuar se edhe një numër shtesë prej 64,871 do të detyrohen të kthehen në vitin 2000, përfshirë edhe ata me status të përkohshëm, azilkërkuesit dhe refugjatët e luftës. Tabela 14 ilustron vendbanimin/statusin ligjor të atyre që duhet të kthehen në vitin 2000.

Tabela 14. Vendbanimi/statusi ligjor i shqiptarëve kosovar të kthyer nga Zvicra, 2000

Personat me status të përkohshëm	16, 618
Personat, kërkesa për azil e të cilëve është ende tek autoritetet	34, 081
Personat, ankesa administrative e të cilëve është ende tek autoritetet	2, 296
Personat, kërkesa për azil e të cilëve është refuzuar në baza ligjore	6, 206
Personat, të cilëve u është dhënë vizë gjatë konfliktit	5, 670
Gjithsej	64, 871

Përrjashtimet e vetme janë serbët dhe romët, dhe familjet me fëmijë që momentalisht ndjekin shkollimin; atyre u është zgatur qëndrimi në Zvicër deri në fund të korrikut 2000.

Nxitjet për tu kthyer

¹⁵⁹ Intervistë, diaspora shqiptare kosovare, janar 2000.

¹⁶⁰ Deutsche Bundesbank (1999).

¹⁶¹ Intervistë, Ueli Leuenberger, drejtor, Univerite Populaire Albanaise, Gjenevë, 14 shkurt, 2000.

¹⁶² Intervistë, shqiptarë kosovar dhe Këshilli zvicran për refugjatët, Zvicër, shkurt 2000.

Qeveria e Gjermanisë ka pranuar përafërsisht 80 % të refugjatëve të luftës nga Jugosllavia dhe republikat e saj suksore dhe ka shpenzuar një shumë të përgjithshme prej 17 bilion DM për t'i ndihmuar këta refugjatë që nga fillimi i krizës në Bosnje.¹⁶³ Me shpenzime vjetore prej 500 milion DM, ose rreth 1,500 DM në muaj për një refugjat, qeveria gjermane tani tenton ta zvogëlojë këtë ngarkesë me riatdhesimin e sa më shumë refugjatëve që është e mundur.¹⁶⁴

Në nivel federal, qeveria gjermane siguron ndihma për personat e kthyer nga Kosova sipas dy programeve: programi i reintegrimit dhe emigrimit për azilkërkuesit (REAG), dhe programi për riatdhesim i ndihmuar nga qeveria (GARP). Sipas REAG, qeveria siguron shpenzimet e fluturimit për personat që kthehen dhe transportin lokal, me bagazh të lejuar (150 DM për të rritur dhe 75 DM për fëmijë nën moshën 12 vjeçare, me një maksimum për një familje prej 750 DM), dhe para për udhëtim (150 DM për të rritur dhe 75 DM për fëmijë nën moshën 12 vjeçare, me një maksimum prej 750 DM për një familje). Sipas GARP, qeveria siguron financim shtesë për nxitje për individ dhe familje deri në 450 DM për të rritur dhe 225 DM për fëmijë nën moshën 12 vjeçare, me një maksimum prej 1,350 DM për një familje.

Shteti i Gjermanisë dhe qeveritë qytetare ofrojnë nxitje financiare dhe programe për personat e kthyer nga Kosova. Qeveria shtetërore e Berlinit, p.sh. siguron nxitje financiare dhe ndihmë në transport prej 2,000 DM për person, me një maksimum prej 9,000 DM për një familje. Gjithashtu, qeveria e Berlinit u ndihmon refugjatëve dhe azilkërkuesve me strehim dhe kujdes mjekësor. Gjithashtu, Gjermania ka programe speciale qeveritare për tu dalë në ndihmë kosovarëve që kthehen në aktivitete të sektorit privat. Agjencia e Berlinit për zhvillim ekonomik është duke u ndihmuar ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të Gjermanisë dhe të Berlinit për të gjetur mundësi investimesh në rindërtimin e Kosovës. Qëllimi është të sigurojnë nxitje për kosovarët që të kthehen në Kosovë, në veçanti në Prizren, në sektorin gjerman, ku do të vendoset zyra e agjencisë.

Përveç kësaj, Agjencia gjermane për investime dhe zhvillim (Deutsche Investitions und Entwicklungsgesellschaft, DEG) siguron ndihma financiare dhe konsultime për personat e kthyer që dëshirojnë të investojnë në shtetin e tyre amë, si dhe subvencione nismëtare dhe hua nga qeveria federale gjermane. DEG ofron subvencione nismëtare për personat e kthyer deri në 18,000 për të financuar projektet investuese, dhe 9,000 për vendosjen e subvencioneve për blerjen për herë të parë të pasurisë reale.¹⁶⁵ DEG gjithashtu siguron hua nismëtare deri në 300,000 DM.

Zvicra, sikurse Gjermania, bënte shpenzime më të vogla për programet e nxitjes graduale për kthimin e refugjatëve dhe azilkërkuesve ndaj pagesave për qëndrim në shtetin e tyre. Qeveria harxhon rreth 1.5 bilion SF në vit për ndihma financiare dhe sociale për të gjithë azilkërkuesit dhe refugjatët, ose rreth 15,000 SF për person. Programi nxitës është paraparë që të sigurojë përfitimet më të mëdha për ata shqiptarë kosovar që dëshirojnë të kthehen sa më shpejt që është e mundur; nxitjet dhe përfitimet zvogëlohen gradualisht me qëndrimin e tyre në Zvicër. Pakoja e nxitjes për tu kthyer përfshin ndihmën financiare, materiale dhe transportin (pajime për strehim).

Në fazën e parë, shqiptarët kosovar kanë marrë më se 9,000 pajime strehimi (secila në vlerë prej rreth 600 DM), ndihmë në transport dhe ndihmë financiare në shumë prej 2,000 SF për një të rritur dhe 100 SF për një fëmijë. Familjet me 5 anëtarë kishin të drejtë të zgjedhin tri pajime, familjet me 6-7 anëtarë mund të zgjedhnin 4 pajime, familjet me 8-9 anëtarë mund të zgjedhnin 5 pajime, dhe familjet me 10 e më tepër mund të zgjedhnin 6 pajime. Familjet gjithashtu kishin mundësinë e shitjes së këtyre pajimeve.

Faza dytë, e cila filloi në janar të vitit 2000, siguron transportin prej 1,200 DM për 1 deri 3 persona, dhe 1,800 për 4 ose më shumë persona. Ndihma financiare për nxitje është zvogëluar për gjysmë krahasuar me fazën e parë, në 1,000 SF për një të rritur, dhe 500 DM për një fëmijë; dhe ofrohen më pak pajime strehimi. Familjet me 3 anëtarë mund të zgjedhin 2 pajime, kurse familjet me 4 ose më tepër anëtarë mund të zgjedhin 3 pajime.

¹⁶³ Angenendt (1999).

¹⁶⁴ Intervistë, Barbara John, Përfaqësues për çështje të të huajve, Berlin, 26 janar 2000.

¹⁶⁵ DEG (1999a).

Qeveria zvicerane është duke bërë përpjekje për të bashkuar ndihmat humanitare dhe për zhvillim për personat e kthyer kosovar dhe të mërguarit. P.sh. Drejtoria zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (Direktion fuer Entwicklung und Zusammenarbeit, Deza) u ofron ndihma për zhvillim shteteve ku kthehen të mërguarit. Qëllimi është për të zvogëluar varfërinë dhe arsyt tjera të migrimit në Zvicër.¹⁶⁶ Gjithashtu, Zvicra është bashkuar me Operacionin humanitar multilateral për shpëtim FOCUS, të themeluar nga qeveria e Greqisë, Rusisë dhe Austrisë, për tu ndihmuar viktimave të luftës në tërë RFJ-në.¹⁶⁷ Së fundi, qeveria zvicerane është duke mbështetur një program të posaçëm të mirëqenies, përmes të cilit do të sigurohej arsimimi dhe aftësimi profesional për shqiptarët kosovar për të gjetur punë kur të kthehen në Kosovë.¹⁶⁸ Janë edhe disa organizata joqeveritare zvicerane që punojnë me kosovarët e kthyer. Çdo kanton i Zvicrës ka një zyrë këshillimore për të huajt, për tu ndihmuar atyre për çështje administrative dhe ligjore, t'i informojë për politikat e qeverisë etj. Organizata e Zurich-ut për azil është një organizatë që trajton interesat e refugjatëve dhe azilkërkuesëve. Kjo organizatë ka bërë një vështrim të popullatës së kthyer shqiptare kosovare, përfshirë edhe identifikimin e pengesave për tu kthyer, dhe rekomandime se si duhet trajtuar pengesat e tilla. Së fundi, kjo organizatë ka luajtur një rol mbrojtës përkundrejt qeverisë, OJQ-të dhe, organizatat ndërkombëtare.

UNHCR dhe Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), janë duke punuar me qeverinë gjermane dhe zvicerane për të siguruar kthimin e organizuar të refugjatëve në Kosovë. UNHCR monitoron kthimin e organizuar dhe të sigurt të kosovarëve. IOM ka zhvilluar një sërë projektesh për të ndihmuar kthimin dhe reintegrimin e kosovarëve, përfshirë edhe transportin, vizitat për vlerësimin e situatës, ndihma direkte personave të kthyer, procesin e votimit për zgjedhjet e shqiptarëve kosovar në diasporë, një vështrim socio-demografik dhe për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla. IOM-i ka punuar me qeveritë evropiane për të siguruar që harmonizimi i politikave migruese të EU mos të rezultojë me një politikë restriktive me “ngjashmëri të pakta”.

UNHCR, në veçanti është e shqetësuar për cenueshmërinë e shqiptarëve kosovar të kthyer nga Zvicra, në veçanti për strehimin e tyre, dhe ka lutur qeverinë që mos t'i kthejë njerëzit gjatë muajve të dimrit. Përveç kësaj, UNHCR monitoron politikat për azil dhe refugjatë që mbikqyren nga Partia Popullore e të djathtëve ekstremist, shpreh shqetsimet e saj për planet e qeverisë për t'i kthyer serbët dhe romët e Kosovës në RFJ; dhe mbron adoptimin e një politike tjetër përkundrejt asaj të shqiptarëve kosovar të bazuar në rrethana individuale ose familjare.

Shërbimi social ndërkombëtar (ISS), gjithashtu do të dëshironte që qeveria zvicerane të adoptojë një politikë tjetër lidhur me shqiptarët kosovar të kthyer. Përveç kësaj, ISS është e shqetësuar për faktin se kthimi i një numri të madh të shqiptarëve kosovar mund të jetë kërcënim për situatën financiare dhe ekonomike në Kosovë, ku shumica janë varur nga paratë e dërguara nga jashtë.

Faktorët që ndikojnë në marrjen e vendimeve për tu kthyer

Janë disa faktorë të cilët kanë peshë në favor të të mërguarëve që kthehen në Kosovë, dhe një numër faktorësh të tjerë që peshojnë në favor të atyre që mbeten në shtetet nikoqire.

Faktorët në favor të atyre që kthehen në Kosovë

- **Solidariteti familjar dhe lidhjet e forta me Kosovën.** Këto janë dy arsyt kryesore pse të mërguarit kthehen në Kosovë. Edhe pse shumica shprehën dëshirën e tyre për përmirësimin e kushteve para se të kthehen (shif më poshtë), të tjerët duan të kthehen dhe t'i kontribuojnë rindërtimit të shoqërisë dhe vendlindjeve të tyre.
- **Politika më restriktive e qeverive nikoqire.** Politikat mikpritëse të qeverive nikoqire janë duke u zvogëluar për shqiptarët kosovar dhe të huajt e tjerë. Shpenzimet e mëdha për ndihma qeveritare

¹⁶⁶ Intervistë, Peter Spycher, këshilltar politik, Migrimi dhe zhvillimi, 11 shkurt, 2000.

¹⁶⁷ Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (1999).

¹⁶⁸ Intervistë, Tanya Meier, drejtor, shërbime sociale, Zurich, 9 shkurt, 2000.

për të huajt; “lodhja nga refugjatët” si pasojë e rritjes së numrit të azilkërkuesve dhe refugjatëve; dhe ndryshimi i kushteve sociale, ekonomike, dhe të punësimit në shtetet nikoqire, i kanë kontribuar vështirësimit të politikave për të huajt që jetojnë në Gjermani dhe Zvicër.

- **Programe për nxitjen e kthimit.** Shumë shqiptarë kosovar kanë qenë të shpejtë në shfrytëzimin e programit për nxitjen e kthimit. Shumica e atyre që u kthyen në periudhën e hershme pas konfliktit u gjetën në një situatë më të mirë sepse kishte gjasa që të kenë shtëpia, biznese, apo vende pune ku mund të kthehen. Ata të cilët nuk kthehen në vitin 2000, nuk do të kenë të drejtë në programin e nxitjes për personat e kthyer.
- **Vështirësitë e integrit.** Shqiptarët kosovar përballen me një mori vështirësish në integrimin në shoqërinë e shteteve nikoqire. Qeveritë e shteteve nikoqire u kanë kontribuar këtyre vështirësive sepse deri vonë nuk i kanë dalluar shqiptarët kosovar nga qytetarët tjerë të Jugosllavisë, dhe ka munguar politika për promovimin e integritit të të huajve. Për më tepër, imazhi i shqiptarëve kosovar në shtetet nikoqire është mjaft negativ, ku ka pasur mjaft incidente të diskriminimit dhe dhunës kundër tyre, posaçërisht në Gjermani. Kosovarët, nga ana e tyre, nuk e kanë lehtësuar integrimin për shkak të frikës nga institucionet shtetërore, ndalimi i ushtrimit të profesionit në Jugosllavi; lidhjet e tyre të forta me Kosovën; standardi i tyre relativisht i ulët; shkalla e lartë e papunësisë; strukturat e theksuara familjare; pengesat gjuhësore; shqetësimet e veçanta për gratë dhe vajzat dhe mungesa e organizimit brenda komunitetit për tu ndihmuar të integrohen në shoqëritë nikoqire.

Faktorët në favor të qëndrimit në shtetet nikoqire

- **Kushtet më të mira në shtetet nikoqire se sa në Kosovë.** Përkundër të gjitha vështirësive me të cilat përballen shqiptarët kosovar në shtetet nikoqire, shumicës u konvenon të jetojnë atje. Shumica mund të llogarisin në një standard mesatar të jetesës në shtetet nikoqire që në Kosovë nuk mund ta gjejnë.
- **Të mërguarit e moshuar më të pasigurt për tu kthyer në Kosovë.** Shqiptarët kosovar të cilët kanë jetuar në shtetet nikoqire gjatë 10-30 viteve të fundit kanë krijuar jetën e tyre të re për vehte dhe familjet e tyre, dhe ngurrojnë që ta lënë pasurinë e fituar. Gjithashtu, ata janë të vetëdijshëm për rëndësinë e kontributit të tyre për jetesën dhe mbijetesën e anëtarëve të familjes që i kanë në shtëpi. Shqetësimi për të ardhmen e fëmijëve të tyre është faktor që ndikon në marrjen e vendimit për të qëndruar në shtetet nikoqire deri sa është e mundur.
- **Numri i madh fëmijëve të lindur dhe të rritur në shtetet nikoqire.** Shumë familje kanë fëmijë që kanë lindur dhe kanë kaluar pjesën më të madhe të jetës në shtetet nikoqire. Ata, në përgjithësi, ngurrojnë të kthehen në Kosovë. Kjo ka pasuar me tensione brenda familjeve rreth kthimit të tyre në Kosovë.
- **Kushtet në Kosovë.** Të mërguarit perceptojnë tri pengesa kyçe për tu kthyer në Kosovë: strehimi, puna dhe siguria. Faktorët tjerë mund të jenë mungesa e funksionimit të sistemit gjyqësor, nevoja për forca policore civile shqiptare kosovare, mungesa e qendrave mjekësore, sistemi i dobët arsimor, çështje të pazgjidhura pronësore, dhe shqetësimi për pranimin e tyre nga kosovarët që mbetën në Kosovë. Ekzistojnë edhe pengesa lidhur me rrethanat për biznes: mungesa e kapitalit nismëtar, vështirësitë për transportin e mallërave nga jashtë, çështjet e pazgjidhura pronësore, nevoja për sigurimin e rrezikimit politik, dhe infrastruktura joadekuatë, në veçanti rrugët dhe mjetet transportuese.

Ndikimi i pritur nga riadhesimi

Edhe pse riatdhësimi i shqiptarëve kosovar nga tri valët e migrimit do të ketë ndikim të ndryshëm, është e qartë se zvogëlimi i parave të dërguara do të ketë një efekt negativ në përmasa të mëdha për të ardhurat familjare në Kosovë.

Shumica e të migruarëve nga vala e parë shprehën dëshirën e tyre për tu kthyer në Kosovë. Këto kosovarë më të moshuar, shumica e të cilëve filluan si punëtor të papërvojë, që u aftësuan dhe themeluan biznese, këtë pasuri mund ta sjellin në shtetin e tyre, së bashku me njohuri të gjuhëve të huaja dhe kapital investues për të themeluar biznese dhe për të krijuar vende të reja pune. Disa kanë shprehur dëshirën e tyre për të punuar edhe në shtetin nikoqir edhe në Kosovë duke ndërtuar dy shtëpi dhe investime në dy biznese. Në të njëjtën kohë, nëse gjenerata e moshuar kthehet pasi të pensionohet, kjo do të ishte një ngarkesë shtesë për shërbimet lokale mjekësore dhe të mirëqenies sociale. Fëmijët e tyre, shumica e të cilëve kanë lindur ose janë rritur në shtetet nikoqire, mund të mos shprehin dëshirë të kthehen me ta.

Vala e dytë e të mërguarëve, shumica e të cilëve ishin me arsim të lartë kur e lëshuan Kosovën, do të sillnin shkathtësi të reja, njohuri të gjuhëve të huaja, praktika të biznesit dhe kapital investues. Ky grup ka një mentalitet më modern dhe është i orientuar kah ekonomia e tregut. Shumica e personave prej këtij grupi kanë shprehur dëshirën të krijojnë jetën e tyre në të dy vendet. Fëmijët e familjeve të këtij grupi ka gjasa të kthehen në Kosovë me prindërit e tyre dhe të sigurojnë një përbërje të re të kuadrave të aftësuar dhe të edukuar. Megjithatë, ky grup mund të paraqesë ngarkesë shtesë për strehim dhe bursën e punës, dhe për resurset arsimore dhe mjekësore.

Vala e tretë e të mërguarëve, refugjatët dhe azilkërkuesit, e lëshuan Kosovën në rrethana të tmerrshme, dhe shumica nuk kanë shëpi dhe punë ku të kthehen. Megjithatë, ata mund të kenë fituar shkathtësi dhe aftësi të dobishme, si dhe burime financiare dhe materiale nga programet e qeverive nikoqire. Ata do t'i risin kërkesat për strehim, punë, kujdes mjekësor, dhe sisteme të mirëqenies sociale dhe arsimore.

Meshkujt e rinjë nga ky grup, me arsim të ndërprerë dhe joadekuat do të paraqesin një sfidë speciale. Shumica janë të dezorientuar dhe traumatizuar nga lufta, kanë përjetuar papunësimin, ndarjen nga anëtarët e familjes, diskriminimin, dhe kushte të vështira jetese në shtetet nikoqire. Shumica merren me akte kriminale, dhe ndoshta vazhdojnë të involvohen në krimet që ndodhin në Kosovë. Nevojiten programe të reja për t'i trajtuar nevojat speciale të të rinjëve, në veçanti të atyre më pak të privilegjuar.

VI. KONKLuzionET

Rezultatet kryesore nga ky vlerësim, tregojnë se politikat, programet dhe projektet adekuate mund të ndihmojnë në zhvillimin e kapitalit shoqëror dhe zvogëlimin e konflikteve ndëretnike.

Duhet forcuar institucionet lokale ashtu që të mund të promovojnë kapitalin shoqëror huazues. Sistemi i udhëheqjes së përbashkët është konsideruar se udhëhiqet nga të huajt në shumicën e komunave, dhe duhet bërë përpjekje më të mëdha për të krijuar dhe shfrytëzuar kapacitetin lokal. Nga vlerësimi u konstatua se bashkëudhëheqja është problematike. Edhe pse kjo qasje synonte krijimin e autonomisë me devolucion (marrjen e vendimeve në nivel lokal dhe angazhimin e shoqërisë civile), trajtimin e e çështjeve, siç janë mungesa e legjitimitetit demokratik, dhe mostoleranca ndaj pakicave. Në fakt, zyrtarët lokal shpeshherë mendonin se luanin një rol të vogël në marrjen e vendimeve. Si rezultat i kësaj, dominonte mendimi se zyrtarët e huaj dhe OJQ-të e kontrollonin fatin e krahinës. Në anën tjetër, ekzistojnë disa indikacione se kosovarët nuk angazhohen dhe nuk marrin përgjegjësi, gjë që çon në një rreth vicioz të përjashtimit dhe tërheqjes së tyre.

Nga këto rezultate nënkuptohet nevoja e përpjekjeve sistematike për të krijuar kapacitetin lokal në sektorin qeveritar dhe joqeveritar, duke avancuar përvojën organizative dhe institucionale të fituar gjatë periudhës së bashkëudhëheqjes. Përveç kësaj, ekziston nevoja për programe që do të nxitnin besimin dhe concensusin në mesin e zyrtarëve të huaj dhe lokal, në veçanti, në mesin e grupeve të shoqërisë civile me orientim kah

interesi publik dhe administrata lokale. Me qeveritë e posazgjedhura, dhe emergjencën humanitare në të kaluarën, ndihma ndërkombëtare duhet të zhvendoset nga udhëheqja direkte e aktiviteteve (në veçanti nga OJQ-të ndërkombëtare) kah avancimi i aftësive udhëheqëse të kosovarëve, OJQ-ve ekzistuese, shoqatave, si dhe kah promovimi i krijimit të shoqërive të reja me forcimin e rrjeteve jozyrtare ekzistuese me potencial ndërlidhës. Përfundimisht, këto grupe lokale, duhet të krijojnë marrëdhënie me përfitim të dyanshëm me departamentet relevante komunale, dhe kështu, të rrisin mundësitë për pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe në monitorimin e efektivitetit të shërbimeve publike. Kapitali shoqëror ndërlidhës mund të krijohet me ngritjen e organizatave lokale në disfavor të institucioneve zyrtare për t'i bërë ata më disponibël dhe më të dobishme për qytetarët në përgjithësi, dhe grupeve të marginalizuara në veçanti. Përveç kësaj, zhvillimi institucional adekuat do të rrisë përfitimet e investimeve në arsim (potencialin njerëzor), dhe infrastrukturë (potencialin fizik). P.sh. themelimi i shoqatave të prindërve dhe arsimtarëve me funksionim adekuat mund të jetë një plotësim i nevojshëm për ndërtimin e shkollave dhe aftësimin e arsimtarëve.¹⁶⁹

Komunat, grupet lokale (të orientuara kah interesi publik) dhe komunitetet, duhet të mbështeten për të trajtuar më mirë nevojat e segmenteve të cenueshme dhe të përjashtuara brenda popullatës kosovare shqiptare. Derisa ndihma ekstenzive dhe rritja e ndihmave të qëllimshme duhet tu ofrohet grupeve ekonomikisht të cenueshme për momentin, politikat e mirëqenies sociale nuk i trajtojnë të gjitha nevojat e grupeve shoqërisht të cenueshme dhe të përjashtuara përbrenda komunitetit shqiptar. Qendrat për mirëqenie sociale në nivel lokal kanë në shënjestër mbrojtjen sociale bazuar në kriteret e përcaktuara nga Administrata qendrore e UNMIK-ut. Atyre do t'ju nevojitet autoritet më diskrecional dhe ndihmë teknike për t'i trajtuar format e ndryshme të cenueshmërisë dhe përjashtimit, bazuar në rrethanat dhe nevojat lokale. Kështu, ata duhet përqëndruar jo vetëm në zvogëlimin e varfërisë, por edhe në përjashtimin shoqëror.

Një qasje gjithëpërfshirëse e mbrojtjes sociale, duhet të orientojë shërbimet sociale të bazuara në komunitet që rrisin vetëdijen e komunitetit dhe pjesëmarrjen e tyre për të trajtuar arsimimin e vajzave, izolimin e vejjaneve të luftës, dhe femrat e viktimizuara nga dhuna. Si ndihmë prioritare u identifikua ndihma speciale për të traumatizuarit dhe të paafitit, si dhe grupet tjera të ndikuara nga lufta, në veçanti nga të anketuarit femra të cilat duhet të lirohen nga kjo ngarkesë e tepërt nga ana e familjes. Disa nga këto shërbime ofrohen ad hoc nga ndërkombëtarët, OJQ-të lokale, dhe nga projektet për zhvillimin e komunitetit. Megjithatë, në të ardhmen, rezultatet e suksesshme dhe përvojat më të mira duhet të orientojnë dhe të rriten proporcionalisht për ta mbuluar tërë spektrin e nevojave. Për të qenë kjo ndihmë e qëndrueshme dhe me shpenzime të arsyeshme, është e nevojshme të krijohen kapacitete lokale adekuate përbrenda qendrave të mirëqenies sociale dhe OJQ-ve lokale, duke hequr dorë nga kontraktimi i agjencive ndërkombëtare për qëllime të tilla. Duhet të kufizohet roli i specialistëve ndërkombëtarë në ofrimin e ndihmës teknike dhe krijimit të kuadrave, për të avancuar aftësitë udhëheqëse ekzistuese lokale, ndjeshmërinë gjinore, dhe aftësinë pjesëmarrëse. Ata nuk duhet të involvohen në mënyrë direkte në procesin e shërbimeve sociale.

Projektet siç janë ai i Bankës Botërore për shërbimet sociale të bazuar në komunitet në Shqipëri, Kujdesi i hershëm fëmijëror dhe qasja zhvillimore të realizuar nga UNICEF-i dhe nga Banka Botërore në Ish-RJ të Maqedonisë, mund të ofrojnë modele të dobishme për mobilizimin e komunitetit dhe dhënien e autorizimit për trajtimin e përjashtimeve gjinore në mënyrë të pranueshme nga aspekti i kulturës, në veçanti në viset rurale të Kosovës, të cilat janë më së shumti të izoluara.¹⁷⁰

Trajtimi i nevojës së zhvillimit të shpejtë të qyteteve. Nga makro-analizat, është konstatuar se Kosova ka kaluar nëpër një proces dramatik të urbanizimit që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore, ku proporcioni i popullatës urbane është rritur prej 20 %, në vitin 1953, në 40 % në vitin 1991, dhe 50 % në vitin 2000.

¹⁶⁹ Banka Botërore (2000a)

¹⁷⁰ Një grant i Bankës Botërore prej 2 milion \$ US të implementuara nga UNICEF, mes tjerash krijoi rrjetin e kujdesit të hershëm fëmijëror (ECCD) të nënave në nivel të fshatit dhe komuniteteve të izoluara, prej së cilës, në fazën e parë kanë përfituar më se 5, 000 familje. Aktivitetet e ECCD-së përfshinin jo vetëm kujdesin për fëmijë (arsimi para shkollor, shëndeti i nënës dhe fëmijut, etj.) por, gjithashtu, edhe rritjen e vetëdijes, fillimisht në mesin e nënave të reja e pastaj në mesin e meshkujve farefisnor dhe anëtarëve të komunitetit, për çështje siç janë dhuna që ushtrohet në familje, dhe pjesëmarrje më e madhe e komunitetit në përmirësimin e shërbimeve sociale.

Popullata e qendrave më të mëdha urbane u zhvillua në mënyrë rapide gjatë kësaj periudhe dhe popullata e Prishtinës dhe Prizrenit gati u dyfishuan. Edhe pse ka pasur një zbrapsje të përkohshme të këtij trendi gjatë periudhës së masave të dhunshme kur shqiptarët kosovar shkuan në vise rurale dhe në shtetet fqinje, urbanizimi është përshpejtuar që nga mbarimi i konfliktit. Ky trend nuk është ndikuar në masë të dukshme nga zhvendosjet e mëvonshme të serbëve në enklavat e izoluara rurale në Gjilan dhe Kosovën Veriore. Në të vërtetë, nëse Kosova e ndjek modelin e shteteve të tjera ballkanike do të rritet hovi i urbanizimit.

Zhvillimi rapid i kësaj krahine historikisht rurale ka disa implikime. Qyteteve u mungon infrastruktura, shërbimet publike, kapaciteti administrativ dhe struktura ekonomike për të përmbushur kërkesat e popullatës. Në veçanti ata pësojnë nga uji i pamjaftueshëm dhe higjiena publike, mundësitë e kufizuara të punësimit dhe krimi. Përveç kësaj, trashëgimitë kulturore në Prizren dhe qytete tjera janë duke u degraduar. Prandaj, përpjekjet për ndihma dhe krijimin e politikës duhet të përqëndrohen në planifikimin urban, shërbimet, infrastrukturën, krijimin e vendeve të punës, dhe një kornizë adekuate për politikë publike për të mundësuar zhvillimin e një sistemi urban funksional dhe të qëndrueshëm.

Në hartimin e projekteve dhe programeve zhvillimore të qëndrueshme duhet marrë parasysh karakteristikat lokale dhe atributet. Kosova është larg një regjioni homogjen. Nga vlerësimi u zbulua se ekzistojnë një sërë çështjesh të ndryshme regionale, nënregjionale, lokale, kulturore, shoqërore dhe institucionale që duhe të merren parasysh kur të planifikohen intervenimet zhvillimore. P. sh. traditat historike multietnike dhe të bazuara në komunitet të bashkuara me kërkesat aktuale urbane, kanë nevojë për projekte që do të ruajnë trashëgiminë kulturore të qytetit, të pastrojnë lumin, të përmirësojnë infrastrukturën themelore të trafikut, të zgjërojnë numrin e artizanateve dhe përzierjen e tyre, të forcojnë biznesin tregtar dhe të shoqatave të komunitetit/gruas, të zgjërojnë kapacitetet hotelierike, dhe të ndalin ndërtimin e paligjshëm. Të gjitha këto aktivitete mund të kryhen me një pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve. Në anën tjetër, derisa Prishtinës i mungojnë pasuritë kulturore dhe historike, pasuria e saj kryesore është Universiteti, që tradicionalisht ka luajtur një rol qendror në sigurimin e udhëheqësisë intelektuale dhe teknike në Kosovë. Universiteti i Prishtinës mund t'i trajtojë çështjet urbane me krijimin e rrjeteve profesionale, modernizimin dhe zgjerimin e programeve në planifikimin urban, administratën publike dhe atë të biznesit, dhe në shkencat shoqërore. Në përgjithësi, intervenimet mund të planifikohen në mënyrë specifike për t'ju përshtatur rrethanave lokale (shif Shtojcën V për intervenime të mundshme të këtij lloji), ose, për programe mbarë kosovare, ku ata duhet të adaptohen për të pasur suksese në nënregjionet e ndryshme.

Duhet forcuar pozitën e gruas përmes forcimit të arsimimit të vajzave, qasjes në pasuri produktive, aftësimin për punë, dhe mekanizma të sigurisë që janë të ndieshme për nevojat e gruas. Sa i përket arsimimit, ka nevojë për grante për vajzat në pozitë të pafavorizuar nga viset rurale, duke pasur parasysh shpenzimet e mëdha të transportit, dhe pengesa të tjera kulturore dhe materiale. Përkritazi me pasurinë produktive, femrat fshatare, në veçanti vejanet, kërkonin bagëti për të rritur sigurinë për ushqim për familjet e tyre. Lidhur me aftësimin për punë, femrat e anketuara potencuan rëndësinë e një procedure të përshpejtuar në zhvillimin e roleve profesionale, për t'ju shmangur provokimeve konfrontuese apo izolimeve nga ana e familjes dhe komunitetit. Femrat janë pranuar si arsimitare shumë të mira, punëtore shëndetësore, dhe mikro-sipërmarrëse. Sa i përket sigurisë, ka nevojë për mekanizma dhe institucione, siç janë stacionet policore me police të punësuar femra, ku femrat do të ndihen të sigurta për të denoncuar dhunën gjinore.

Një sistem i fortë gjyqësor dhe programe lokale të përbashkëta mund të nxisin besimin ndëretnik dhe bashkëpunimin. Nga vlerësimi shihet se, përkundër perceptimit të urrejtjes etnike në mbarë vendin, dhe dominimit të frikës nga pastrimi etnik i serbëve, ekzistojnë disa embrione të tolerancës në mes të dy grupeve, që kishin bashkëjetuar në mënyrë më paqesore në nivel të komunitetit para vitit 1989. Pengesat në rithemelimin e kësaj bashkëjetese kryesisht kanë të bëjnë me shqetësimet për sigurinë, siç janë kërcënimet, rrahjet, vrasjet, zjarrevëniet, që vazhdojnë të përdoren nga një një numër i vogël nga të dyja anët. Megjithatë, bazuar në rezultatet e grupeve të anketuara, është e qartë se një përqindje e konsiderueshme e shqiptarëve këto incidente i konsiderojnë si akte kriminale, dhe do të pranonin idenë e bashkëjetesës, me kusht që kundërvajtësit të persekutohen.

Rezultatet na lënë të kuptojmë se rrugëdalja nga çështja e urrejtjes etnike është themelimi i një sistemi zyrtar të gjyqësisë, ku do të përfshihen ligjet, policia, gjykatat dhe burgjet, që ndihmojnë në stabilizimin e

shoqërisë dhe shërimin e plagëve pa dhunë të vazhdueshme. Ata, gjithashtu nënkuptojnë nevojën për programe bazë që bashkarisht do të ndaheshin në mënyrë të qetë, për të lehtësuar dialogun dhe krijimin e mundësive shoqërore dhe ekonomike. E tërë kjo do të ndihmojë në zvogëlimin e tensioneve etnike dhe do të jetë si mbështetje për procesin e shërimit të plagëve. Këto lloje intervenimesh të profilit të ulët do të jenë më pak të prekshme për kërcënimet dhe dhunën që ushtrohet nga ekstremistët se sa përpjekje tjera më të dukshme nga ana e komunitetit ndërkombëtar për të nxitur pajtimin.

Cenueshmëria e pakicave në masë të madhe varet nga përjashtimi shoqëror, ku nevojiten programe për shqyrtimin e efekteve, dhe ku është e mundur, të caktohen shkaktarët e këtyre përjashtimeve. Rezultatet e vlerësimit tregojnë se grupi më i cenueshëm në Kosovë nga pikëpamja shoqërore dhe ekonomike janë pjesa e mbetur e popullatës romë. Nga pikëpamja shoqërore, serbët gjithashtu janë të cenueshëm për shkak të shkallës së lartë të segregacionit fizik të cilin janë duke e përjetuar, por. Nga aspekti ekonomik janë më pak të cenueshëm. Sllavët musliman dhe turqit, janë relativisht më pak të përjashtuar, të arsimuar mirë, dhe me përvojë sipërmarrëse. Çka është më me rëndësi, nuk dyshohet se kanë qenë të involvuar në mënyrë direkte në konfliktin e fundit.

Këto rezultate kanë disa implikime politike: (i) investimet sektorale, duke u rradhitur nga arsimi, shëndetësia, infrastruktura dhe bujqësia, që të gjitha mund të përfshinë pakicat; (ii) projekte në bujqësi, ku zhvillimi i komunitetit dhe zhvillimi i sektorit privat mund të ketë komponente specifike për t'i trajtuar nevojat e grupeve minoritare; (iii) mund të planifikohen intervenime specifike të udhëhequra nga komuniteti për romët, serbët, sllavët musliman dhe goranët me elemente të forta pjesëmarrëse. Në veçanti, sa u përket goranëve komuniteti i donatorëve mund të mbështesë përpjekjet lokale për të rritur bashkëpunimin ndërkufitarë në mes të fshatërave të goranëve në Kosovë dhe Shqipëri.

Marrja në konsideratë e nevojave të pakicave në politikë, programe, dhe në hartimin e projekteve, do të ketë efekte të rëndësishme demonstrative. Kjo në veçanti mund të jetë e dobishme për ta mbajtur këtë popullatë në Kosovë, dhe për të krijuar një ambient më të pranueshëm për kthimin e refugjatëve, derisa kushtet të lejojnë kthimin e tyre.

Duhet bërë më shumë për ta kuptuar cenueshmërinë ekonomike dhe shoqërore të pakicave . Vrojtimi i Masave të Standardit Jetësor (LSMS) që aktualisht është duke u implementuar nga Banka, do të sigurojë informacione kuantitative mbi popullatën serbe. Mirëpo, një gjë e tillë nuk mund të bëhet për pakicat tjera (sllavët musliman, romët dhe turqit) duke pasur parasysh numrin e tyre të vogël dhe shpenzimet e mëdha të modeleve. Përveç kësaj, një vlerësim i vonshëm kualitativ për varfërinë, i realizuar nga një grup mbi varfërinë, përfshinte serbët, sllavët musliman dhe romët. Rezultatet e këtij vlerësimi aktualisht janë duke u përfunduar. Konkluzionet nga ky vlerësim dhe rezultatet preliminare të vlerësimit kualitativ mbi varfërinë tregojnë se çështjet e varfërisë në të vërtetë janë të ndryshme për popullatën pakicë, dhe mund të mos jenë të dukshme kur vlerësohen si pjesë e një vlerësimi më të madh kualitativ apo kuantitativ. Kjo lloj analize është kryesore për të kuptuar përjashtimin shoqëror dhe ekonomik, që do të vazhdojë të jetë çështje qendrore në zhvillimin socio-ekonomik dhe pajtimin në Kosovë.

Zhvillimi i sektorit privat duhet t'i shqyrtojë kërkesat e mikro-sipërmarrjeve dhe atyre të vogla. Projektet për zhvillimin e sektorit privat duhet t'i shënojnë nevojat e shprehura nga meshkujt e anketuar në pesë qendrat e vlerësimit, për të përmirësuar qasjen në kredi, dhe aftësim për çështjet e lidhura me tregun, siç është planifikimi i biznesit dhe strategjitë tregtare. Meqë , bizneset familjare në Kosovë tradicionalisht kanë qenë më të forta se sa në shtetet fqinje ballkanike dhe kanë qenë mbështetje për ekonominë kosovare, duke përforcuar potencialin sipërmarrës lokal, që është mënyra më e mirë për rritjen e sigurisë familjare; krijimin e vendeve të punës, në veçanti për të rinjtë; dhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm ekonomik. Edhe pse, një numër i organizatave janë të involvuara në këtë sferë, duhet bërë më shumë për t'i trajtuar kërkesat për aktivitete të tilla.

Komuniteti nga diaspora është burim i rëndësishëm për investime dhe transferimin e shkathtësive, por nevojitet nxitje për kthimin e tyre. Për të shfrytëzuar në mënyrë produktive burimet financiare dhe sipërmarrëse të diasporës, është e nevojshme të krijohet një ambient i mundshëm dhe nxitje për sipërmarrësit kosovar dhe të mërguarit që ende jetojnë jashtë, të investojnë në Kosovë. Në veçanti, rekomandimet në vijim dalin nga ky vlerësim:

- Forcimi i bankave tregatare në Kosovë për të përcjellur rrjedhën e parave të dërguara.
- Themelimi i sigurimeve për rrezikimin politik të shkallës më të vogël.
- Sigurim më i madh i kredive për fillimin e mikro-bizneseve dhe bizneseve të vogla.
- Të lehtësohen vizitat për vlerësimin e situatës në Kosovë, ashtu që të mërguarit të mund të vlerësojnë kushtet lokale dhe t'i fillojnë përgatitjet për tu kthyer.
- Të krijohet një ambient të përshtatshëm për investime të huaja në sektorin privat në Kosovë, përfshirë edhe mbështetjen ndërkombëtare për sektorin e huaj privat.

Duhet të kemi parasysh trendin afatgjatë për reduktimin e parave të dërguara. Me përmirësimin e kushteve në Kosovë, qeveritë nikoqire janë duke kthyer një numër të konsiderueshëm të shqiptarëve kosovar, duke përfshirë edhe ata që, gati një dekadë, kanë jetuar në Zvicër. Kjo do të rezultojë me zvogëlimin e parave të dërguara nga jashtë, që kanë ndihmuar familjet në Kosovë dhe Kosovën në tërësi shumë vite. Gjithashtu, shumë shqiptarë kosovar të cilët kanë jetuar në Gjermani dhe Zvicër 20 deri 30 vite, siç duket kanë harxhuar burime të konsiderueshme personale gjatë konfliktit të fundit; p.sh. shumë prej tyre i kanë dhënë shtëpitë dhe pronën nën hipotekë për të dërguar para në Kosovë. Banka dhe komuniteti i donatorëve duhet ta kenë parasysh këtë faktor kyç në formulimin e programeve për ndihma në Kosovë.

Egziston nevoja për një rrjedhë më graduale për personat që kthehen. Kthimi i një numri të madh të personave do të ngarkonte infrastrukturën socio-ekonomike në Kosovë. Qeveritë nikoqire dhe organizatat ndërkombëtare duhet të punojnë më tepër në rindërtimin e infrastrukturës socio-ekonomike para se të kthehen të mërguarit. Gjithashtu, duhet bërë më shumë që personat e kthyer të kthehen në qytetet e tyre duke zvogëluar ngarkesën e qendrave urbane siç është Prishtina. UNMIK-u, UNHCR-ri, dhe organizatat tjera ndërkombëtare kanë potencuar nevojën për një rrjedhë graduale të personave që kthehen. Situata për ata që kthehen nga Gjermania është më kritike, sepse qeveria dëshiron të kthejë 180,000 shqiptarë kosovar që shkuan në Gjermani para konfliktit të fundit.

Duhet të kemi parasysh programet speciale për refugjatët e kthyer. Rezultatet e vlerësimit treguan se ka nevojë për programe që do t'i ndihmojnë refugjatët, të mërguarit ilegal dhe meshkujt e rinjë që të kthehen në Kosovë, dhe tu sigurojnë atyre arsimim, aftësim, dhe mjete të tjera materiale. Gjithashtu, do të ketë nevojë për rritjen e shërbimeve sociale (këshillime dhe aktivitetet e lira për fëmijë dhe të rinjë) dhe për të kompensuar humbjen e të ardhurave nga parat e dërguara nga jashtë (aftësim dhe punësim).

Politikat e qeverive nikoqire kanë zhvilluar politika dhe programe të inovuara për shqiptarët e kthyer kosovar. Shqiptarët kosovar, OJQ-të, dhe organizatat ndërkombëtare u pajtuan për politika të llojllojshme të qeverive nikoqire përkitazi me personat e kthyer, që i marrin parasysh rrethanat individuale dhe familjare. Gjithashtu, para se të kthehen një numër i madh i të mërguarëve, duhet të vlerësohem kushtet në Kosovë në mënyrë adekuate. Nga vlerësimi u zbuluan disa mësimet pozitive nga përvoja e qeverive nikoqire, duke përfshirë:

- Ndërlidhjen e ndihmave humanitare dhe atyre për zhvillim për nxitjen e kthimit.
- Mbështetjen e qeverive nikoqire për aftësim profesional, dhe programe arsimore për personat e kthyer.
- Bursa të punës për personat potencial për tu kthyer, nëpërmjet të cilave kosovarët që jetojnë në Evropë mund të konkurrojnë për vende të reja pune në Kosovë.
- Pajisje për nevojat e strehimit për personat e kthyer.

SHTOJCA I

METODOLOGJIA

Përmbajtja, arsyetimi dhe pyetjet hulumtuese

Institucionet shoqërore normalisht ndryshojnë gjatë evoluimit, kështu që dimensionet e *përkohshme* gjatë vlerësimit të tyre zbulojnë shkallën e kontinuitetit dhe ndryshimeve gjatë një periudhe të caktuar kohore. Mirëpo, institucionet ndryshojnë ndonjëherë nga transformimet e papritura, në ç' rast vlerësimi has në një shkallë të lartë të diskontinuitetit me të kaluarën. Rasti i tillë është në Kosovë, ku bëhen transformime të insitucioneve zyrtare nga komuniteti ndërkombëtar në të njëjtën kohë kur shoqëria civile i nënshtrohet një ndryshimi pas konfliktit. Kjo përmbajtje paraqet dimensionin *historik* në vlerësimin e bërë.

Shikuar nga aspekti hi storik, institucionet lokale të udhëhequra në nivel qendror dhe të kontrolluara nga serbët gati një dekadë të tërë paraqesin një ndërprerje krahasuar me periudhën e mëparshme të autonomies lokale në Kosovë¹. Nga shumica e popullatës shqiptare nga kjo përvojë u krijua një sistem alternativ në të cilin institucionet jozyrtare paralele, d.m.th. udhëheqësia politike dhe administrative e njohur vetëm nga shqiptarët kosovar dhe institucionet jozyrtare të shoqërisë civile, d.m.th. shoqatat dhe grupet e gërshetuara të shqiptarëve kosovar. Pastaj, ngjarjet traumatike të konfliktit 1998-99 shkaktuan edhe një ndërprerje tjetër të madhe si edhe përçarje në shoqërinë civile të Kosovës duke e lënë komunitetin ndërkombëtarë me përgjegjësi të mëdha për rindërtimin e të dyjave.

Në këtë kontekst, vlerësimi shoqëror dhe institucional synon të jetë një studim *kërkimor* dhe *operativ* ku duhet studiuar kushtet shoqërore dhe ekonomike para konfliktit dhe format dhe funksionimin e organizatave shoqërore dhe insitucioneve lokale në Kosovë. Pastaj vazhdon me vlerësimin e ndryshimeve të tyre si rezultat i konfliktit. Në të njëjtën kohë ky studim identifikon mundësitë dhe detyrimet shoqërore dhe ekonomike pas konfliktit, funksionet dhe format e shfaqura të organizatave shoqërore dhe insitucioneve në Kosovë dhe vlerëson rëndësinë e tyre momentale dhe në të ardhmen. Ky vlerësim jep disa rekomandime specifike që do të udhëheqeshin nga politika dhe programet e Bankës Botërore në Kosovë.

Vlerësimin e qartësojnë dy grupe të pyetjeve kërkimore. Për të potencuar përmbajtjen e transformimve të thella dhe të papritura në Kosovë, pyetjet janë parashtruar në dy pjesë duke prezentuar ekstremitetet e spektrit të ndryshimeve që eventualisht janë paraqitur në rregullimet insitucionale, përkatësisht ato shoqërore dhe lokale.

Në rregullimin shoqëror, ky vlerësim ka konsistuar në:

- *aftësitë ripërtëritëse ose shkatërrimin* e strukturave dhe funksioneve të ngjashme tradicionale;
- *shfaqjet e përhershme dhe të përkohshmetë* grupeve të cënueshme;
- *lokacionet urbane dhe rurale* për krijimin e mundësive të reja për jetesë;
- *pajtimin apo konfliktin* në mes të popullatës shumicë dhe pakicë;
- *zhdukjen ose adaptimin e* grupeve tradicionale mbi baza bashkiake²;
- *shfaqjen apo mospranimin e* grupeve të reja mbi baza bashkiake;
- *financimin apo zgjerimin e* grupeve të komunitetit nga agjencitë e jashtme dhe OJQ-të.

¹ Kjo periudhë koincidon me e rënien e murit të Berlinit, kollapsin e ekonomive socialiste në Evropën lindore dhe fillimi i dezintegrimi në Jugosllavi.

² Nocioni bashki është përdorur në tërë raportin me kuptime të shumta duke mbuluar: (i) bashkia e vendit p.sh. lagja ose fshati; (ii) bashkia e identitetit; p.sh. prejardhja ose religjioni; dhe (iii) bashkia e interesit; p.sh. gjinia apo butësia.

Në rregullimin institucional lokal ky vlerësim është përqëndruar në:

- *ruajtjen e pjesërishme ose zhdukjen e sistemeve centraliste para konfliktit;*
- *transformimet ose zhdukjet e sistemeve institucionale paralele;*
- *rëndësinë apo parëndësinë e rolit dhe funksionit të sistemit të përkohshëm institucional;*
- *ndërveprimin apo ndarjen në mes të sistemit të përkohshëm institucional dhe institucioneve shoqërore jozyrtare;*
- *bashkëpunimin apo konfliktin në mes të partive politike për institucionet lokale dhe resurset.*

Projektimi i studimit/kërkimit

Për këtë studim kërkimor duhej përgatitur një projekt kërkimor gjithëpërfshirës i cili do të: (i) përfshinte dimensionet kohore dhe hapsinore të përqëndruara në ngjarjet e luftës; (ii) inkorporonte fleksibilitetin e duhur, posaçërisht për punën në terren, në frymën e rrethanave të mundshme detyruese që mund të ndeshen; (iii) shfrytëzonte metoda të shumta, ashtu që besueshmëria e zbulimeve do të rritej përmes konvergencës së tyre; dhe (iv) mbulonte sferën e gjërë të vlerësimit institucional dhe shoqëror, duke ngërthyer çështje të shumta dhe koiciduese. Projekti është përgatitur në Uashington dhe është finalizuar gjatë një periudhe eksperimentale në Kosovë në fillim të marsit 2000.

Zgjedhja e vendit

Përkohësisht, konflikti ishte në qendër të vëmendjes. Në pikëpamje hapsinore, procesi i zgjedhjes filloi me shënimin e ndarjeve shoqërore të krijuara ose të keqësuara nga konflikti në shkallë më të lartë ose më të ulët në mbarë Kosovën. Indikator i përafërt kumulativ për ekonominë regjionale ishte orientimi i tyre i jashtëm. Ishin përfshirë pasojat kyçe të konfliktit, prezenca e komunitetit ndërkombëtar si dhe informatat e grumbulluara gjatë periudhës paraeksperimentale mbi implementimin e sistemit të përkohshëm administrativ. Kjo rezultoi në rregullimin e kriterëve selektuese finale dhe zgjedhjen e pesë vendeve ku u siguria koha dhe fuqia punëtore dhe secili vend përbëhej nga një lokacion rural dhe një urban që në tërësi përbënin dhjetë lokacione gjeografike. Kur nuk kishim qasje në regjionin e shumicës serbe në Mitrovicë, u zgjodh Malisheva për të vrojtuar më për së afërmi institucionet jozyrtare.

Selektimi i çështjeve

Kërkimet e bazuara në dokumentacion mbi trazirat që janë shkaktuar nga konflikti si dhe pasojat përkatëse rezultuan me selektimin e tri çështjeve. Së pari, çështjet e përqëndruara në familje siç janë strategjitë e jetesës, strehimi, zhvendosja dhe arsimi. Së dyti, çështjet e grupeve të përqëndruara në ndarjen e grupeve të njerëzve të cenusshëm dhe gjendja e vështirë e pakicave. Së treti, çështjet lokale të përqëndruara në institucione siç janë përbërja dhe funksionimi i administratave komunale, natyra dhe roli i këshillave të fshatit dhe mundësia e grupeve civile shoqërore që shprehin kapitalin shoqëror të shoqërisë.

Zgjedhja e të anketuarve

Meqenëse ka një varg të tërë të çështjeve që u përkasin familjeve, janë caktuar katër lloje të anketuarve për t'u përgjigjur mbi çështjet nga këndvështrime të ndryshme: meshkujt e rritur, femrat e rritura, meshkujt e rinj dhe femrat e reja. Për çështjet që u përkasin grupeve, u identifikuan katër grupe të cenusshme (Serbët, Romët dhe Ashkalinjt, Turqit dhe Sllavët musliman). Për t'i artikuluar çështjet institucionale lokale u planifikuan intervista me dy grupe të të anketuarve: me anëtarë të KB dhe kosovarë në SPPA në nivele regjionale dhe komunale; dhe një spektër i organizatave të shoqërive civile duke filluar prej atyre religjioze deri tek udhëheqësit afarist, dhe prej shoqatave bëmirëse deri tek këshillat e fshatit dhe organizatave të lagjeve. Të anketuarit e ndryshëm, përveç qasjes që kanë bërë në grupin e çështjeve specifike janë lutur që t'i paraqesin pikëpamjet e tyre për dy grupet tjera të çështjeve (shif Shtojcën II). Intervistat me grupet e cenusshme janë bërë në ato vende ku këto grupe paraqesin numrin më të madh.

Studime që përfshijnë vlerësimin shoqëror dhe institucional

Projekti i përgjithshëm ka nxjerrë në pah një përpjekje kërkimore me përfitim nga përdorimi i metodave të shumta kuantitative dhe kualitative. Përfundimisht, vlerësimi përmban tetë studime kontribuese:

- *Shqyrtimin i dokumenteve dhe literaturës.* Një shqyrtim dhe vlerësim i zgjëruar i dokumenteve të shumta të përpiluara nga agjencitë ndërkombëtare, përfshirë edhe Bankën Botërore dhe e literaturës përmbajtësore akademike.
- *Analizën makrosociale para dhe pas konfliktit.* Analizë e trendeve për ndryshime demografike dhe socioekonomike dhe për zhvendosjen hapsinore të popullatës,
- *Studime nga diaspora.* Kërkim grupor i ndikimit të diasporës kosovare në Zvicër dhe Gjermania mbi institucionet dhe jetesën e popullatës në Kosovë.
- *Intervista me grupe të përqëndruara.* Formim nergut i mostrës së të anketuarve në pesë regjionet duke përdorur udhëzimin gjysëmstrukturor me secilin grup të përcaktuar për nga mosha dhe gjinia ose grupe të përcaktuar sipas çështjeve prej pesë deri në tetë pjesëmarrës.
- *Intervista të strukturuar sipas besimit dhe pjesëmarrjes.* Pyetësorët e përcaktuar që plotësohen në mënyrë individuale nga pjesëmarrësit në grupe të përcaktuar për nga mosha dhe gjinia.
- *Intervista institucionale.* Mostrat e personave të formuara enkas, intervistat e papërcaktuara me zyrtarët e përkohshëm administrativ në nivel regjional, dhe komunal dhe me vëzhguesit e agjencive ndërkombëtare.
- *Intervistat mbi shoqërinë civile dhe institucionet jozyrtare.* Mostrat e personave të formuara enkas për intervistat e papërcaktuara me përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve jozyrtare, përfshirë këtu edhe institucionet paralele si ato në Malishevë.
- *Studimi i rasteve të kapitalit shoqëror.* Në kërkimet e thella mbi prezencën, ndikimin dhe perspektivën e organizatave në shoqërinë civile në dy qytete: Prizren dhe Pejë.

Puna në terren dhe analizat

Përveç studimeve nga diaspora në Zvicër dhe Gjermani, puna në terren u zhvillua edhe në Kosovë nën kushte të vështira logjistike dhe të sigurisë si dhe interval kohor shumë të shkurtër, kryesisht gjatë marsit dhe prillit të vitit 2000. Së pari u përcaktuan vendet dhe materialet intervistuese para testimit, si dhe zgjedhja e të anketuarve. Aspekti i sigurisë e parandaloi ekipin paratestues që të përfshijë shumicën e banorëve serb në Mitrovicë ndër pesë vendet e zgjedhura. Pastaj u vendos që të zgjedhet Malisheva, si një vend që vepron si komunë me institucione jozyrtare.

Përkundër vështirësive, me punën në terren u arritën shumica e synimeve të këtij projekti kërkimor. U realizuan gjithsej 40 intervista të grupeve mbi baza gjinore dhe të moshës, përfshirë 256 pjesëmarrës. Gjithashtu u realizuan edhe 16 intervista me të anketuarit e grupeve të cënueshme, duke përfshirë gjithsej 29 pjesëmarrës. Intervistat institucionale kanë përfshirë 26 zyrtarë të SPPA-së, 27 përfaqësues nga shoqëria civile dhe 9 përfaqësues të institucioneve jozyrtare. Së fundi, intervistat nga diaspora përfshinë 116 zyrtarë nikoqir qeveritar, 9 përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, 21 ekspertë nga emigracioni dhe 25 udhëheqës bashkiak, afarist dhe organizativ. Gjithashtu, ky ekip realizoi 13 intervista me grupe të formuara nga persona të zhvendosur ku tri prej tyre u përqëndruan në rininë, gratë dhe ata që janë aktiv në sektorin privat.

Analizat kualitative të intervistave personale të papërcaktuara, rëndësia e radhitjes së çështjeve dhe strategjitë e jetesës, shpjegimet gojore historike dhe sistematizimi i informatave dokumentuese u integruan me analizat statistikore të të dhënave të regjistrimit të popullsisë dhe familjeve si dhe të dhënat intervistuese mbi pjesëmarrjen në intervista, për të hartuar raportin përfundimtar.

Matrica zgjedhëse e Vendi³ dhe Lokacionit⁴ për çështje qëndrore të zakonshme

	Kriteri i zgjedhjes së vendit dhe lokacionit						Rregullimi institucional
	Dëmtimet nga lufta (strehimi)	Përbërja etnike	Zhvendosja	Mjete jetese	Orientim i jashtëm	Prezenca ndërkombëtare	
<i>Prishtinë</i> 1. Prishtinë 2. Llukarë	i parëndësishëm	Shumica Shqiptarë, Pakica (Romë, Ashkali)	Urbane në emigracion	shërbime, tregti	i ndryshëm	e lartë	Zyrtar (komplet)
<i>Pejë</i> 1. Pejë 2. Rugovë	i rëndë	Shumica Shqiptarë	Rilokim brenda zonave/lagjeve	bujqësi, tregti	Mali i zi	mesatare	Zyrtar (komplet)
<i>Prizren</i> 1. Prizren 2. Piranë	i parëndësishëm	Shumica Shqiptarë, Pakica (Slavë musl. Turqë, Romë)	Urbane në emigracion	shërbime, tregti	Shqipëri	mesatare	Zyrtar (jokomplet)
<i>Gjilan</i> 1. Gjilan 2. Cërnicë	i parëndësishëm	Shumica Shqiptarë, Pakica (Sërb)	i papërfillshëm/parëndësishëm	tregti, bujqësi	Sërbi e Maqedoni	mesatare	Zyrtar (jokomplet)
<i>Malishevë</i> 1. Malishevë 2. Dragobil	i rëndë	Shumica Shqiptarë	jashtë-emigrimit	bujqësi		e ulët	Jozyrtar (komplet), paralelizëm i rreptë

³ Vendi është njësi nënregjionale e analizës që përfshin lokacionin urban dhe rural

⁴ Lokacioni është një vend i caktuar ku është kryer puna në teren

Kriteriumi i zgjedhjes së të anketuarit për çështjet qendrore të familjes

i anketuari Meshkujt e rritur (mbi 25 vjeç)	kriteriumi i zgjedhjes së të anketuarit pensionist, i papunësuar, i punësuar (punëtor mëditës, i punësuar në shitore/restorant, i vetëpunësuar, profesionist, i punësuar qeveritar, i punësuar në komunitetin ndërkombëtar
Femrat e rritura (mbi 25 vjeç)	pensionist, shtëpiake, e papunësuar, e punësuar (shitore/restorant, e vetëpunësuar, profesioniste, e punësuar qeveritare, e punësuar në komunitetin ndërkombëtar
Meshkujt e rinjë (15-25 vjeç)	student (shkolla e lartë dhe fakulteti), vetëm shkollimin fillor, i papunësuar, i punësuar (lokal dhe ndërkombëtar), i martuar, i pamartuar
Femrat e reja (15-25 vjeç)	student (shkolla e lartë dhe fakulteti), vetëm shkollimi fillor, e papunësuar, e punësuar (lokal dhe ndërkombëtar), e martuar, e pamartuar

Intervista për çështjet e grupit të përcaktuar

- Personat e zhvendosur brenda regjionit (IDP)
- Vejanet e luftës
- Të kthyerit
- Serbët
- Romët
- Turqit
- Sllavët musliman

Intervista për çështjet qendrore institucionale

- Intervistat regjionale dhe territoriale të SPPA
- Intervistat komunale të SPPA
- Intervista për shoqërinë pararele/civile
- Intervista me grupe jozyrtare/fqinjje

Studime të rastit

- Kapitali shoqëror i kufizuar dhe shoqëria civile në Pejë

- Kapitali shoqëror i huazuar dhe sistemi i bashkëudhëheqjes në Prizren

SHTOJCA IIA

VLERËSIMI INSTITUCIONAL LOKAL

(Udhëzimi për intervistë)

Sqarimi i “Vlerësimit institucional dhe shoqëror.”

Kjo pjesë, Vlerësimi institucional lokal, përqëndrohet në dy çështje:

- Bashkëudhëheqjen zyrtare dhe sistemin e qeverisjes lokale të përkohshme që tani është duke u implementuar (UNMIK -u dhe komunat).
- Ndërveprimin ndërmjet bashkëudhëheqjes dhe rrjeteve shoqërore civile jozyrtare (p.sh. mbetjet e sistemeve paralele dhe/ose sistemet dhe grupet e reja paralele).

Konteksti i përgjithshëm është ndikimi i luftës në shoqërinë civile dhe institucionet jozyrtare lokale.

Profili/statusi (implementimi i sistemit të bashkëudhëheqjes)

Cili është statusi i bashkëudhëheqjes dhe sistemit të qeverisjes lokale të përkohshme, në këtë regjion/komunë?

Prova:

- shkalla se në ç’masë bashkëudhëheja është në rregull.
- nëse sistemi është ende i pakompletuar (p.sh. njerëz të paemëruar), pse? Arsye të veçanta për vonesë; p.sh. lufta për pushtet politik në mes të grupeve partiake.
- kur ka gjasa sistemi të kompletohet?

Bashkëpunimi (qasja e bashkëudhëheqjes implikon kapacitetin e aktorëve të ndryshëm institucional për bashkëpunim)

Duke u bazuar në muajtë e parë, sa është kooperativ sistemi i bashkëudhëheqjes në këtë regjion/komunë?

Prova:

- shembuj të veçantë të bashkëpunimit
- shembuj të veçantë të konflikteve
- shembuj se si individët e veçantë janë të rëndësishëm/parëndësishëm

Efikasiteti (institucionet lokale, sikurse çdo institucion tjetër, duhet të japin rezultate brenda resurseve të kufizuara që i disponojnë)

Sa është efikas sistemi i bashkëudhëheqjes në këtë regjion/komunë nga aspekti i çështjeve politike në të cilat është përqëndruar studimi ynë: humbja e banesave dhe zhvendosjet që pasuan, humbja e mësimin, dhe rrezikimi i sigurisë?

Prova:

- shkalla e kapacitetit teknik të departamenteve (regjionale/komunale).
- shkalla e të dhënave hyrëse nga organizatat tjera (p.sh. OJQ-të, donatorët, këmbimi i përkrahjes teknike).
- zgjedhja e prioriteteve: cilat?

Efektiviteti (relevant për njerëzit)

Në ç' masë sistemi i bashkëudhëheqjes i qeverisjes lokale në këtë regjion/komunë lidhet me rrjetet zyrtare dhe jozyrtare brenda shoqërisë civile?

Prova:

- ndërveprimi me mbetjet e sistemeve paralele. Jepni shembuj të veçantë.
- promovimi i iniciativave të reja (në partneritet). Jepni shembuj të projekteve të propozuara.
- sjellje ilegale/e papranueshme. Në cilat raste? Jepni shembuj specifik (p.sh. ndërtim i paligjshëm, dorëzim-pranimi i pronës publike, mbrojtja).

Legjitimiteti (A i përfaqëson sistemi i bashkëudhëheqjes popujt e ndryshëm?)

Sa është adekuat përfaqësimi i të gjithë banorëve sipas sistemit të bashkëudhëheqjes në këtë regjion/komunë duke përfshirë edhe pakicat?

Prova:

- Dallimet ndërmjet pakicave në mënyrë përkatëse
- kufizimet në inkorporimin e pakicave
- roli i UNMIK-ut

Perspektivat (për të ardhmen e afërt)

Çka mund të ndodhë me bashkëudhëheqjen brenda një viti?

Prova:

- a do të jetë sistemi i bashkëudhëheqjes i rëndësishëm/ i parëndësishëm?
- a do të jetë efektiv/joefektiv?
- a do të përfshihet nga zhvillimi/stabilizimi politik?
- Pse?
- Çka do të dëshironit të ndodhë me institucionet lokale qeveritare në dy vitet e ardhshme?

SHTOJCA IIB

VLERËSIMI SHOQËROR

(Udhëzime për diskutime grupe)

Prezentoheni (Banka Botërore stafi/këshilltari).

Falenderime për pjesëmarrje

Ne jemi duke u përpjekur të mësojmë diç më shumë për kushtet e jetesës të popullatës së Kosovës sot, pas luftës. Dëshirojmë të dimë se si njerëzit e rëndomtë (për dallim nga “politikanët”) e perceptojnë situatën, të ardhmen e tyre e të familjes dhe të Kosovës. Për këtë arsye, ne jemi duke zhvilluar bisedime me popullatën në mbarë Kosovë; gra dhe burra, të rritur dhe të rinjë, arsimtarë, afarist dhe zyrtarë lokal.

Dëshirojmë të zhvillojmë diskutime grupe për aspekte të ndryshme se si ju dhe familja juaj mbijetoni pas luftës. Duam që të gjithë të merrni pjesë në bisedime sepse mendojmë se secili mund të jep kontribut të ndryshëm dhe të rëndësishëm.

Ju sigurojmë se identiteti juaj nuk do të shpaloset meqë raporti do t'i prezentojë vetëm rezultatet e përgjithshme.

Me kënaqësi do t'ju përgjigjemi pyetjeve që mund t'i shtroni tani apo gjatë diskutimit tonë.

Dëshirojmë tu falenderojmë për kontributin e juaj në këtë punë. Ju lutemi të prezantoheni ashtu që të mund ta njohim njëri tjetrin.

1. Strategjitë e jetesës

Si e siguron ekzistencën familja ose shtëpia juaj për momentin?

- Kush jeton së bashku në familjen/shtëpinë tuaj?
- Kush është i lidhur përnga gjakut dhe kush jo?
- Për atë me të cilën jeni martuar, prej nga është?
- Kush është përgjegjës për vendimmarrje siç është ndarja e të ardhurave?

Prova: kontributet zyrtare dhe jozyrtare për mbështetjen e familjes

1a. Si e siguron ju dhe familja juaj jetesën?

- me kontributin e juaj
- me kontributin e bashkëshortit/es
- nga ndihma e fëmijëve tuaj të rritur (si?)
- nga ndihma e të afërmit në Kosovë (si?)
- nga ndihma e farefisit që jeton në shtetet tjera (si?)
- nga ndihma e miqve tuaj (si?)
- nga ndihma e fqinjëve (si?)
- këmbime jozyrtare mall me mall, ose ndihmë reciproke jofinanciare (çfarë lloji?)
- a keni kopsht, fushë, kafshë? Në ç'masë i mbulonit shpenzimet me produktet tuaja bujqësore?
- nga ndihma humanitare (prej kujt dhe çfarë lloji?)

1b. Si i siguronte mjetet e jetesës familja ose shtëpia juaj para luftës?

1c. Si ishte përbërja e familjes suaj në krahasim me atë të tanishmen?

Prova: kontributet zyrtare dhe jozyrtare për mbështetjen e familjes

- nga kontributi juaj
- nga kontributi i bashkëshortit/es
- ndihmë nga fëmijët e rritur (si?)
- kush ishte përgjegjës për vendimmarrje siç është ndarja e të ardhurave familjare?
- ndihmë nga të afërmit në Kosovë (si?)
- ndihmë nga të afërmit që jetojnë në shtete tjera (si?)
- ndihmë nga miqtë tuaj (si?)
- ndihmë nga fqinjët tuaj (si?)
- këmbime jozyrtare mall me mall, ose ndihma reciproke jofinanciare (çfarë lloji?)
- në ç'masë i mbulonit shpenzimet me produktet tuaja bujqësore ose me ndihma humanitare (prej kujt dhe çfarë lloji?)

2. Strehimi dhe zhvendosja (1998-2000)

2a. A ka jetuar familja juaj në të njëjtën shtëpi/banesë gjatë dy viteve të fundit?

Prova: Nëse po

- sa është e madhe shtëpia juaj (sa kate, dhoma)?

- sa gjenerata/familje të ngushta jetojnë në këtë shtëpi dhe ku?
- për sa kohë e keni ndërtuar shtëpinë?
- a keni planifikuar ta zgjeroni shtëpinë për gjeneratat e ardhshme?

Prova: Nëse jo

- pse? Çka ndodhi?
- a ju ndihmoi dikush në zgjidhjen e kësaj situatë? kush dhe si? (shpjegoni llojin e ndihmës)
- a ishit të kënaqur me mënyrën e zgjidhjes së kësaj situatë?

2b. A kanë jetuar shumica e fqinjëve/anëtarëve të komunitetit tuaj në të njëjtën shtëpi/banesë gjatë dy viteve të fundit? Kush është dëbuar e kush jo?

Prova: nëse jo

- pse? Çka ndodhi?
- a u ndihmoi atyre dikush në zgjidhjen e kësaj situatë? Kush dhe si? (shpjegoni llojin e ndihmës)
- a ishit të kënaqur me mënyrën e zgjidhjes së kësaj situatë?

2c. Situata e zhvendosjes: a jetuat së bashku me familjen kur u dëbuat?

3. Siguria (drejtësia)

Dëshiroj t'ju shtroj pyetje rreth sigurisë, çështje kjo posaçërisht e rëndësishme për gratë dhe fëmijët.

3a. A ndihet e sigurt familja juaj sot?

Prova:

- në shtëpi
- tek fqinjët
- në zona tjera të fshatit/qytezës/qytetit
- në enklava etnike (enklava të mbrojtura)
- në prezencën e UÇK-së/TMK-së
- në prezencën e forcave/policisë ndërkombëtare
- në prezencën e policisë shqiptare
- Serbët: mbrojtje nga miqtë e mëparshëm shqiptar
- a keni humbur kafshë ose tokë?
- nëse keni probleme, a keni kujt t'i drejtoheni për ndihmë nga sistemi paralel?

3a. A ekziston ende rrezik për sigurinë fizike tuajën dhe të familjes tënde për të cilën ju duhet të jeni të vetëdijshëm?

Prova:

- fusha të minuara/mina
- bomba të paeksploduar
- prezenca e UÇK-së/TMK-së
- a keni hasur në kriminalitet?

3b. Cilat masa paraprake, nëse ka nevojë, i ndërmerrni ju dhe familja juaj për t'u ndier të sigurt?

Prova:

- rini në shtëpi pasi të terrohet

- qëndroni në rrugët kryesore
- i mbani fëmijët në shtëpi/jashtë shkollës
- nuk udhëtoni vetëm në autobus/vetura

3c. Nëse ju ose familja juaj do të ishit lënduar, kujt do t'i drejtoheshit për ndihmë? (Kujt i besoni për mbështetje nëse paraqitet ndonjë problem?)

Prova:

- anëtarve të familjes
- shokëve dhe fqinjëve
- policisë civile
- KFOR-it
- UÇK-së/TMK-së
- të tjerëve

4. Arsimimi

4a. A vijoni ju ose anëtari i familjes tuaj aktualisht shkollën (fillore, të mesme, fakultetin)?

4b. Cilat janë problemet kryesore me shkolla/fakultete sot?

Prova:

- siguria
- udhëtimi dhe distanca
- shpenzimet
- planet dhe programet nuk janë adekuat për bursën e punës
- ndryshimi i lëndëve për një afat më të gjatë
- njohja e diplomave/certifikatave të kënaqshme
- arsimarët dhe autoriteti/varshmëria (favorizimet)
- ikja (nga vendi) e arsimtarëve
- lehtësi joadekuate

4c. Në ç' masë ndryshojnë këto probleme në krahasim me ato të paraluftës?

5. Banorë/grupe të cenueshme

5a. Kush është në fshatin tuaj në gjendje më të vështirë?

Cilët banorë të Kosovës sot janë në gjendje më të vështirë sociale?

Prova:

- personat e zhvendosur (brenda vendit); pse?
- të mërguarit rural (në zonat urbane)
- ata pa anëtarë të familjes jashtë Kosovës
- të kthyerit (të riatdhesuar nga shtetet e Evropës)
- vejanet e luftës
- pensionist
- jetimët
- pakicat (Romët)
- gratë e reja pa përkrahje familjare
- të tjerët

6. Nevojat prioritare

6a. Cilat janë tri nevojat me të cilat ballafaqoheni ju dhe familja

juaj sot?

Prova:

- të ardhura adekuate
- strehim adekuate dhe përballues
- ndihmë e shpejtë ose kreditimi për riparimin e dritareve, pullazeve etj.
- siguria
- arsimimi kualitativ
- kujdesi shëndetësor adekuate dhe i përballueshëm
- mundësia për punësimin i të rinjtëve
- të tjera

6b. Cilat janë tri nevojat kryesore të komunitetit me të cilat ballafaqohet fshati/qyteza/qyteti juaj sot?

Prova:

- mundësia për punësim
- banimi
- siguria
- arsimimi
- kujdesi shëndetësor
- mundësia për punësim i të rejave
- infrastruktura fizike (rrugët, shërbimet komunale, etj.)
- të tjera

7. Perspektivat (Tri vitet e ardhshme)

7a. Ku shpresoni të ndodheni ju dhe familja juaj pas tri vitesh?

7b. Si i shihni kushtet për ndryshimet në fshatin/qytezën/qytetin tuaj pas tri vitesh?

Ju lutemi të përcaktoni tri fusha kryesore të ndryshimeve.

7c. Kush do të jenë promovuesit e ndryshimeve të tilla?

7d. Si i shihni marrëdhëniet ndërmjet grupeve të ndryshme etnike në Kosovë në të ardhmen e afërt dhe të largët?

8. Vlerësimet institucionale

8a. A keni punuar ose a punoni në ndonjë organizatë ndërkombëtare?

8b. A keni mirëkuptim për njerëzit që vijnë t'ju pyesin për nevojat e juaja?

8c. A keni parë se ndihmat shpërndahen gabimisht? Çka nuk është në rregull dhe pse?

Në fund, ju lusim t'i plotësoni dy formularë shumë të shkurtër përkitazi me besimin tuaj në institucionet lokale dhe pjesëmarrjen në shoqatat lokale.

SHTOJCA IIC

VLERËSIMI I DIASPORËS

(Udhëzime për diskutim grupor)

Komuniteti i madh i shqiptarëve nga Kosova në diasporë që jetojnë në Gjermani dhe Zvicër ka luajtur dhe do të vazhdojë të luajë një rol kyç në zhvillimet ekonominë shoqërore dhe politike tani dhe në të ardhmen në Kosovë. Prandaj, studimi për diasporën do të përbëjë një pjesë të rëndësishme në vlerësimin e ardhshëm shoqëror të Bankës Botërore për Kosovën.

Pyetje të përgjithshme

1. Çfarë pasojash ka pasur konflikti për ju dhe për statusin tuaj socio-ekonomik, shtëpiak dhe për kushtet e jetesës?
2. A dëshironi të qëndroni në shtetin nikoqir apo të ktheheni në Kosovë? Pse?
3. Cilat janë kufizimet dhe nxitjet për të qëndruar në shtetin nikoqir dhe për tu kthyer në Kosovë?
4. Cilat janë kushtet/nxitjet e nevojshme për t'u kthyer në Kosovë?
5. Cilat janë shqetësimet dhe problemet tuaja kryesore ?
6. Cilat janë shkaqet dhe pasojat e këtyre shqetësimeve dhe problemeve?
7. Cilat janë strategjitë tuaja për t'u ballafaquar me situatën e tanishme?
8. Cili është kontributi juaj për Kosovën (financiar, në artikuj ushqimor, shërbime)?
9. Në çfarë mënyre i keni dhënë këto kontribute (në mënyrë zyrtare, jozyrtare, të organizuar)?
10. Si është i organizuar komuniteti?
11. Çfarë lidhjesh ekzistojnë në mes të komuniteteve dhe individëve të “vjetër” dhe të “ri” nga diaspora?
12. Çfarë dallimesh ekzistojnë në mes të komuniteteve “të vjetra” dhe “të reja” në diasporë nga aspekti i gjeneratave dhe i pikëpamjeve të tyre?
13. Çfarë lidhjesh ekzistojnë në mes të komunitetit kosovar dhe komuniteteve tjera nga diaspora; p.sh. me Turqit, Muslimanët sllavët, etj ?
14. A i kanë ndihmuar komunitetit tuaj organizatat për refugjatë dhe të migruar nga qeveria nikoqire? Në çfarë mënyrash?
15. Prej cilit vend të Kosovës (qytetin/fshatin/komunën) jen ju?
16. Ku i dërgoni paratë? Përmes kujt? Si?
17. A jeni duke dhënë ende kontribut vullnetar (nga fakti se tani UNMIK-u është duke i mbështetur institucionet lokale)? Nëse po, ku shkojnë ato mjete? Cilës partie politike? Në cilin vend në Kosovë? Në cilin sektor?

Pyetje për femra

1. Cilat janë shqetësimet dhe problemet tuaja kryesore?
2. Cilat janë shkaqet dhe pasojat e këtyre shqetësimeve dhe problemeve?
3. Cili është roli dhe përgjegjësia juaj kryesore?
4. Si është e organizuar familja juaj? Si do ta karakterizonit përbërjen e familjes? Cilat janë forcat lëvizëse dhe marrëdhëniet në familje?
5. Cili është profesioni dhe aftësimi juaj?
6. Si ka ndryshuar roli dhe struktura e familjes suaj si pasojë e konfliktit?
7. Çfarë qasjesh keni në resurset e komunitetit?
8. A ka shumë femra që kryesojnë familjen?
9. Cilat janë femrat dhe fëmijët e cenueshëm në komunitetin tuaj?

Pyetje për të rinjtë

1. Cilat janë rolet dhe përgjegjësitë tuaja kryesore?
2. Çfarë lloj arsimimi ju ofrohet?
3. Cilat janë shqetësimet dhe problemet tuaja kryesore?
4. Me çfarë sfidash dhe problemesh ballafaqohesh në shtetin nikoqir?
5. Çfarë qasje ke në resurset e komunitetit?
6. Si ka ndryshuar roli dhe struktura e familjes suaj si pasojë e konfliktit?
7. A janë përfshirë të rinjtë në aktivitete ilegale? (pyetni autoritetet gjermane dhe zvicerane)

Pyetje për sektorin/sipërmarrësit privat

1. A keni ju aktivitet tregtar dhe investues në Kosovë?
2. Cilat janë kufizimet dhe mundësitë për tregti dhe investime në Kosovë?
3. Në cilat sektorë diaspora është më së shumti aktive?
4. A do të dëshironit të ktheheni në Kosovë për një periudhë të caktuar për të dhënë kontributin me përvojën tuaj?
5. Çfarë kontributi i ka dhënë Kosovës sektori privat? (p.sh. janë mbajtur dy konferenca për rritjen e fondeve për të mbledhur mjete për Kosovën në mesin e njerëzve afarist nga diaspora)?
6. Cila është madhësia mesatare dhe kapitalizimi i firmave kosovare në diasporë?
7. Cili është roli që e luan sektori afarist në diasporë për rindërtimin e Kosovës?
8. Çfarë informatash keni marrë ju mbi programet e financuara nga donatorët dhe mundësitë për të ngritur oferta për projekte rindërtimi në Kosovë?
9. A do të kishin qenë të interesuar t'u kontribuoni projekteve të financuara nga Banka Botërore; p.sh. zhvillimit të komunitetit, trashëgimisë kulturore, etj.?

SHTOJCA IID**FORMULARI A: VLERËSIMI I INSTITUCIONEVE LOKALE**

(Vlerësimi shoqëror)

Sa ju besoni institucioneve lokale në vijim? (Shënoni vetëm një kuti për një rresht).

	1 (jo aktive)	2	3	4 (shumë aktive)	5	0 (e papërshtatshme)
1. Grupi i rrugës						
2. Bashkësia lokale						
3. Këshilli i qytetit/faqesit						
4. Administratat komunale						
5. Partitë politike						

FORMULARI B: PJESËMARRJA NË SHOQATA

(Vlerësim shoqëror)

Sa jeni aktiv në shoqatat lokale në vijim? (Shënoni një kuti për një rresht.)

	1 (jo aktive)	2	3	4 (shumë aktive)	5	0 (e pa përshtatshme)
1. Arsimore						
2. Kulturore						
3. Rekreacionale						
4. Profesionale						
5. Politike						
6. Religjioze						
7. Bampirëse						
8. Lidhur me punë						

SHTOJCA III

PERCEPTIMET E CENUESHMËRISË DHE NEVOJAT PRIORITARE

Tabela 1. Cenueshmëria e atyre pa familje, veçanërisht pa meshkuj

<i>Shkalla e cenueshmërisë</i>	<i>Specifikimet</i>	<i>Numri dhe karakteri i këtyre grupeve që e potencojnë këtë specifikë</i>
SHUMËE LARTË	Jetimët, jetimët e luftës, gjysëm jetimët (pa etër dhe pa vëllezër)	23 grupe, çdo lloj karakteri
E LARTË	Ata që humbën anëtarë të familjes gjatë luftës	9 grupe rurale dhe 3 grupe urbane
MESATARISHT E LARTË	Vejanet e luftës	9 grupe, çfarëdo
E MESME	Familjet që humbën meshkujt e tyre	6 grupe, çfarëdo
MESATARISHT E ULËT	Ata, në veçanti femrat që kanë të afërm të burgosur në Serbi	5 grupe, me dominim fshatar, në veçanti nga fshati Llukarë, ku ka raste të tilla
E ULËT	Femrat e reja pa familje, në veçanti pa përkrahje nga meshkujt	2 grupe, urbane
E ULËT	Vejanet me fëmijë të vegjël	2 grupe, urbane dhe rurale
E ULËT	Ata, vetëm me një mashkull në shtëpi	1 grup, urban
E ULËT	Vejanet që duhej të ktheheshin në familjen ku kanë lindur dhe fëmijët është dashur t'i lënë me vjehërritë	1 grup, rural
E ULËT	Vejanet që humbën tërë familjen përfshirë edhe prindërit dhe fëmijët	1 grup, urban
E ULËT	Vejanet që u kanë mbetur vetëm vajzat	1 grup, meshkuj të rinjë fshatar

Tabela 2. Cenueshmëria e të moshuarëve

<i>shkalla e cenueshmërisë</i>	<i>Atributet</i>	<i>numri dhe karakteri i grupeve që</i>
--------------------------------	------------------	---

SHUMË E LARTË	Të moshuarit	<i>potencojnë këtotribute</i> 23 grupe, çfarëdo
E LARTË	Të moshuarit e paaftë për punë	12 grupe, çfarëdo
E MESME	Të moshuarit pa familje, fëmijë, ose burime të tjera të sigurisë	6 grupe, urbane, 1 rural
E ULËT	Të moshuarit e paaftë pa qasje në pensionet e tyre	3 grupe, urbane
E ULËT	Të moshuarit që kanë nevojë për kujdes mjekësor	1 grup, urban

Tabela 3. Cenueshmëria e atyre që humbën strehimin dhe pasurinë

<i>Shkalla e cenueshmërisë</i>	<i>Atributet</i>	<i>Numri dhe karakteri i grupeve që potencojnë këtotribute</i>
SHUMË E LARTË	Ata që humbën shtëpitë e tyre	22 grupe, çfarëdo
MESATARISHT E LARTË	IDP-të (që humbën shtëpitë dhe u detyruan të zhvendosen)	8 grupe, urbane
E ULËT	Ata të viseve rurale	1 grup, femra të reja nga viset urbane

Tabela 4. Cenueshmëria e të papunësuarëve dhe të varfërve

<i>Shkalla e cenueshmërisë</i>	<i>Atributet</i>	<i>Numri dhe karakteri i grupeve që potencojnë këtotribute</i>
E LARTË	Të papunësuar dhe të varfër	17 grupe
E ULËT	Të papunësuar për një kohë të gjatë dhe të varfër	3 grupe, urbane
E ULËT	Ata të cilët tërësisht varen nga ndihmat humanitare, dhe kanë nevojë për ndihma ushqimore	2 grupe, rurale
E ULËT	Ata që humbën pajisjet e punës ose mjetet e prodhimit të të cilëve u shkatërruan (toka, delet)	2 grupe, rurale
E ULËT	Të varfëruarit rishtas, që varen nga ndihma sociale	2 grupe, urbane dhe rurale
E ULËT	Ata që humbën pasurinë për shkak të konfliktit	1 grup, rural
E ULËT	Ata me pasuri të pamjaftueshme, ne veçanti arsimitarët dhe bujqit	1 grup, rural
E ULËT	Ish luftëtarët e UÇK-së në rrezik për tu bërë kriminel	1 grup, meshkuj të rinjë nga viset urbane
E ULËT	Ata që u desht të ndërrojnë mënyrën e jetesës	1 grup, meshkuj të rinjë nga viset rurale
E ULËT	Fshatarët në pozitë të pafavorshme në krahasim me ata që jetojnë në qytet (me paga të ulta)	1 grup, urban

E ULËT	shumë të izoluarit, ata që jetojnë në bjeshkë	1 grup, rural
---------------	---	---------------

Tabela 5. Cenueshmëria e të hendikepuarëve, të paaftëve dhe invalidëve të luftës

<i>Shkalla e cenueshmërisë</i>	<i>Atributet</i>	<i>Numri dhe karakteri i grupeve që potencojnë këto attribute</i>
E LARTË	Të hendikepuarit dhe invalidët	15 grupe
E ULËT	Në veçanti të verbërit	1 grup, femra nga viset urbane
E ULËT	Në veçanti fëmijët e hendikepuar fizikisht ose mentalisht dhe ata të paaftë për mësim	1 grup, femra nga viset urbane

Tabela 6. Cenueshmëria e femrave

<i>Shkalla e cenueshmërisë</i>	<i>Atributet</i>	<i>Numri dhe karakteri i grupeve që potencon këto attribute</i>
MESATAR	Femra	6 grupe
I ULËT	Gratë dhe vajzat e kufizuara në shtëpi	2 grupe, femra nga viset rurale
I ULËT	Femrat e reja në rrezik për tu kidnapuar	1 grup, meshkuj të rinj nga viset rurale
I ULËT	Femrat e diskriminuara në bursën e punës	2 grupe, femra nga viset rurale dhe urbane
I ULËT	Femrat që punojnë vetëm në shtëpi por nuk kanë shporetë elektrik, lavatrice, etj.	1 grup, femra nga viset rurale

Tabela 7. Cenueshmëria e të rinjëve

<i>Shkalla e cenueshmërisë</i>	<i>Atributet</i>	<i>Numri dhe karakteri i grupeve që potencuan këto attribute</i>
MESATAR	Të rinj	5 grupe
I ULËT	Të papunësuar	3 grupe, femra nga viset rurale
I ULËT	Me shkollim të papërfunduar	2 grupe, femra nga viset rurale; 1 grup, femra nga viset urbane
I ULËT	Rini e çorientuar, në rrezik për tu marrë me kriminalitet	1 grup, femra nga viset urbane
I ULËT	Me lëvizje të kufizuara	1 grup, femra nga viset rurale

I ULËT

Me pamundësi për tu martuar për shkak të papunësisë

1 grup, femra nga viset rurale

Tabela 8. Cenueshmëria e të sëmuarëve, traumatizuarëve, ose të tjerë

<i>Shkalla e cenueshmërisë</i>	<i>Atributet</i>	<i>Numri dhe karakteri i grupeve që potencuan këto attribute</i>
I ULËT	Të traumatizuar	2 grupe, femra nga viset urbane
I ULËT	Të sëmurë	1 grup, femra të reja nga viset rurale
I ULËT	Alkoolist	1 grup, meshkuj nga viset rurale

Tabela 9. Nevojat prioritare

<i>Nevojat prioritare</i>	<i>Sfera referente (Kosova, komuniteti, familja, individi)</i>	<i>Përqindja dhe numri i grupeve (nga 40 gjithsej)</i>	<i>Karakteri i grupeve të anketuara</i>
Punësimi, mundësitë për punësim	Familja, komuniteti, Kosova	82.5% (33 grupe)	grupe të barabarta urbane dhe rurale
Strehimi, përkrahja për ndërtim	Komuniteti, Kosova	57.5% (23 grupe)	grupe të barabarta urbane dhe rurale; të anketuarit rural eksluzivisht të lidhur me komunitetin
Investimet, kreditimet, bankat	Familja	50.0% (20 grupe)	kanë dominuar grupet e meshkujve, ide sipërmarrëse
Shërbimet shoqërore, kujdesi shëndetësor	Kosova, komuniteti, familja	45% (18 grupe)	të përzier, shumë femra nga viset rurale
Siguria	Kosova, komuniteti	40% (16 grupe)	
Infrastruktura (rrugët dhe komunikimet)	Komuniteti	37.5% (15 grupe)	kanë dominuar grupet rural
Të ardhura adekuate	Kosova, familja	27, 5% (11 grupe)	kanë dominuar grupet e meshkujve
Arsimimi, kurse të trajnimit	Kosova, individët	25% (10 grupe)	Për Kosovën, kanë dominuar grupet e meshkujve; për individët, 4 grupe të fmrave të reja)
Të hollat	Komuniteti, familja	17.5% (7 grupe)	Vetëm grupe të femrave
Ujitja, higjena	Komuniteti	7.5% (5 grupe)	Vetëm grupe rurale
Mjedisi	Komuniteti	10% (4 grupe)	Vetëm grupe të femrave (3 urbane/1 rurale)
Të tjerta	Komuniteti, individët	Përgjigje të ndryshme personale	

IDETË SIPËRMARRËSE

Ndarja 1. Idetë sipërmarrëse për shqiptarët e Kosovës

- **Llukarë.** Të ndërtohet një fabrikë e vogël për vjeljen dhe përpunimin e frutave për: lajthitë, kërpudhat, boronicat, me një përfitim shtesë të largimit të rinisë nga rruga, duke e angazhuar në vjelje gjatë verës.
- **Llukarë.** Të ndërtohet një fabrikë e tekstilit për punësimin e vajzave.
- **Llukarë.** Të zgjerohet ferma ekzistuese e pulave deri në 240 sish me rendiment prej 190 vezë në ditë: punësimi i 4 persomave; nevojat për kredi rreth 78,000 DM, për ta kthyer me kamatë prej 3 deri në 5 vite.
- **Prizren.** Të ndërtohet një fabrikë e tharmit duke punësuar 50 deri 100 njerëz. Aktualisht në Kosovë, tharmi importohet nga jashtë, ku vetëm në Prizren konsumohen 12 tone brenda javës; nevoja për kredi rreth 200,000 DM.
- **Piranë.** Të ndërtohet një fabrikë e prodhimeve të qumështit; aktualisht qumështi dhe kosi importohen nga Beogradi dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë; “po të kishte fabrikë për prodhimin e produkteve të qumështit, të gjithë do të mund t’ a shitnim qumështin aty, dhe të krijojmë vende pune”.
- **Piranë.** Të fillohet një biznes ndërtimi përfshirë edhe përpunimin e drurit për prodhimin e dritareve dhe dyerve; një fshatar e luti një agjenci për kredi prej 40,000 DM, por u refuzua sepse llogaria i tij u konsiderua e mbivlerësuar.
- **Malishevë.** Të ndërtohet një fabrikë për rrjet përforcues metalik, duke punësuar 20 njerëz; kredia prej 120,000 DM do të kthehej brenda 2 viteve me 12 % kamatë.
- **Bjeshkët e Rugovës .** Të zhvillohet turizmi dhe projektet ekologjike.
- **Gjilan.** Të përtrihet teknologjia në fabrikat e tekstilit dhe të metaleve; të rritet kapaciteti në fabrikën e cigareve.
- **Cërnjë.** Të sigurohen kredi afatshkurtëra për zëvendësimin e maqinave të vjedhuara bujqësore, në mënyrë që bujqit do t’i ndanin mes veti; gjithashtu, edhe kredi për blerjen e deleve, dhive, farave dhe plehërave; të ndërtohet objekt për përpunimin e prodhimeve të qumështit dhe fabrikë e gozhdave (meqenëse ka kërkesa të mëdha për material ndërtimor; bujqit nuk duan borxhe afatgjate.

Ndarja 2. Idetë sipërmarrëse të Sllavëve musliman të Kosovës

- Mbledhja e frutave dhe i bimëve mjekuese nga bjeshkët, posaçërisht shfrytëzimi i bimëve mjekuese nga bjeshkët ekologjikisht të pastëra në viset jugore të Kosovës të banuara me Sllavë musliman. Për një ide konkrete për biznes nevojitet kredi prej 400,000 DM; për të punësuar 700 njerëz (1000 gjatë sezonës së vjeljes), me një fitim të pritur prej 1 milion DM pas vitit të parë. Një kërkesë për kredi veç është dorëzuar në UNMIK përmes Bordit administrativ në Prizren.
- Zhvillimi i turizmit.
- Zhvillimi i bletarisë dhe prodhimit të mjaltit.
- Përtrirja e kullosave dhe ekonomisë bujqësore, me zhvillimin e shumimit të bagëtisë (gjedheve) dhe prodhimin e mishit.

SHTOJCA V

INTERVENIMET E MUNDSHME NË PESË ZONAT E STUDIMIT

Prizren

- **Zhvillimi urban dhe ruajtja e vlerave kulturore dhe historike të komunitetit.** Projekte për ruajtjen e trashëgimisë kulturore të qytetit, pastrimin e lumit, përmirësimin e infrastrukturës bazë të trafikut, zgjerimin e zejeve të përziera, përforcimin e biznesit komercial, konsolidimin e shoqatave të komunitetit, rritjen e kapaciteteve hotelierike, ndalimin e ndërtimit ilegal, mëkëmbjen e rolit të Odës ekonomike dhe profesionale dhe të shoqatës së gruas.
- **Pilotprojektet e zejtarisë.** Projekte të dedikuara shkathësive për përtërirjen e zejtarive të zhdukura në sektorët e artizanateve të zgjedhura dhe investime në zgjerimin e biznesit përkatës.
- **Pilotprojekte dedikuar pakicave.** Projektet për të promovuar aktivitete sipërmarrëse të Goranëve, Turqive dhe Sllavëve musliman në viset grupet e tilla janë prezent në numër të konsiderueshëm, me theks të posaçëm në rininë.
- **Pilotprojekte dedikuar femrave.** Pilotprojekte për të mbështetur rolin profesional dhe sipërmarrës shpresëdhënës të gruas në qytet dhe në vise rurale.

Pejë

- **Program zhvillimor për zonën e tregut të vjetër.** Një program zhvillimor integruar që përfshin rindërtimin e hapësirës së shkatërruar të tregut, që përfshin infrastrukturën dhe shërbimet si dhe riplanifikimit të identitetit të banimit përreth, me pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme në procesin e planifikimit.
- **Planifikimi i lagjes.** Të përdoret *bashkësia lokale* si model për pilotprojektet në Pejë dhe në fshatëra për ofrimin e shërbimeve dhe riplanifikimit të hapësirës së lagjes.
- **Pilotprojektet e promovuara lokale filantropiste.** Pilotprojekte që zhvillojnë filantropinë për njerëzit dhe familjet e pasura, gjë që shpie në zhvillimin e kapitalit shoqëror të huazuar.
- **Pilotprojekte të dedikuara për pakicat.** Projekte dedikuar fshatërave dhe lagjeve ku janë të koncentruara pakicat.

Prishtinë

- **Program dedikuar universitetit të qytetit.** Formimi i rrjetit komunikues dhe profesional në kryeqytet për të përmirësuar problemet e qytetit që lidhen me efikasitetin e administratës komunale, modernizimin dhe zgjerimin e Universitetit të Prishtinës duke përfshirë edhe politikën e shkollimit profesional të orientuar në planifikimin urban, administratën publike, zhvillimin e biznesit të vogël, dhe të shkencave shoqërore. Vendorsja e lidhjeve me universitetet e huaja që i kanë adaptuar modelet e ngjashme.
- **Pilotprojekte dedikuar pakicave.** Projekte dedikuar lagjeve dhe fshatërave ku janë të koncentruara pakicat.

Gjilan

- **Pilotprojekte dedikuar pakicave.** Pilotprojekte dedikuar pakicave serbe për zhvillimin e tregut dhe shërbimeve tjera përbrenda enklavave të tyre për të zbutur izolimin dhe varshmërinë ekonomike.
- **Projekte sektoriale për arsim.** Projekte që sigurojnë qasje për arsimim e pakicave dhe lehtësojnë dialogun përmes shfrytëzimit të përbashkët të objekteve, pjesëmarrjes në ngjarje sportive dhe këmbimin përmes internetit.

Malishevë

- **Pilotprojekte dedikuar femrave të reja.** Projekte për përmirësimin e mundësive të femrave të reja që janë në rrezik t'u mohohet arsimimi, duke shfrytëzuar shoqatat lokale të gruas.
- **Pilotprojekte dedikuar vejaneve.** Projekte për fitimin e të ardhurave, që u dedikohet zhvillimit të shkathtësive të vejaneve, numri i të cilave aktualisht është i madh në këto vise rurale.

